Shabi Rekaj & Sabri Shehu

Monografi

Hyzri Rekaj

Ferizaj, 2023

Redaktor
Mr. Sc. Arif Haliti

Lektor dhe redaktur kompjuterike
Avni Lubishtani

Kopertinën e punoi
StarGraf

Parathënie

Në historinë e kombit tonë, emigracioni ka luajtur një rol vendimtar në zhvillimet e shumë proceseve dhe ngjarjeve historike. Arsyeja pse ka ndodhur kjo, ishte mungesa e lirisë në atdhe, shtypja dhe represioni i vazhueshëm në periudha të ndryshme, burgosja dhe torturat jonjerëzore që bëheshin ndaj secilit që merrte guximin të punonte për idealin kombëtar.

Prandaj duke pasur një hapësirë pune shumë figura të rëndësishme kombëtare morën arratin në mënyrë që të kontribuonin në përpjekjet e vazhuara për liri.

Roli i shoqërive dhe klubeve shqiptare si ai i Stambollit, Bukureshtit, Amerikës ilustrojnë më së miri këtë të vërtetë historike.

Në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar për shkak të kushteve të padurueshme politike dhe ekonomike në atdhe shumë bashkë-kombas kryesisht punëtorë u detyruan të dalin në perëndim për të krijuar një mirëqenje për veti dhe familjen e tyre.

Një rrugëtim të tillë pati edhe patrioti Hyzri Rekaj!

Krahas punës ai asnjëherë nuk e harroj atdheun prej nga vinte, përkundrazi për shkak të mërzisë dhe mallit iu shtua edhe më tepër dashuria ndaj atdheut, vetëm kur je larg e vëren me shumë mungesën e tij.

Në qytetin e Dysseldorfit u vendos edhe Hyzri Rekaj dhe shumë bashkatdhetarë të tjerë sepse ky qytet është kryeqyteti i një republike shumë të zhvilluar industriale dhe nevoja për fuqi punëtore është çdo herë më e madhe.

Në këtë qytet për shkak të emigracionit të madh, shteti i atëhershëm Jugosllav kishte hapur konsullatën e vet që

shërbente për interesat e tyre dhe për mbajtjen të bashkë-shtetasve nën kontroll. Që mbikëqyrja të ishte edhe më e suksesshme Konsullata Jugosllave kishte hapur disa klube të ashtuquajtura klube të punëtorëve Jugosllav dhe një ndër ta ishte edhe ai i punëtorëve që ishin nga Kosova. Hapja e klubit "Emin Duraku" më vonë do të kthehet në një kokëdhembje për autoritetet e atëhershme. Në mesin e punëtorëve shqiptar lindi pakënaqësia për emërtimin e klubit sepse ata ndiheshin të diskriminuar për shkak të emërtimit jugosllav pa treguar përkatësinë e vërtetë kombëtare.

Për pasojë do të kemi edhe prishjen e rapoterteve me autoritetet jugosllave dhe fillimin e një lufte të hapur e cila nuk u ndal asnjëherë!

Bashkatdhetarët vendosën që klubi të quhej klubi i punëtorëve shqiptar dhe me këtë emërtim ta regjistronin në institucionet gjermane.

Për shkak të këtij vendimi Konsullata Jugosllave filloj një betejë të ashpër kundër aktivistëve që për pasojë disave iu ndalua kthimi në Gjermani, Nebih Rekën e burgosën dhe ia ndaluan më vonë kthimin në Gjermani kurse aktivistët e tjerë u syrgjynosën deri në çlirimin e Kosovës!

Figura që mori flamurin e organizimit dhe përballjes me organet jugosllave është një djalosh që doli nga një familje përherë luftarake dhe i cili ia kushtoj jetën e tij idealit deri në frymën e fundit jetës, emri i tij është Hyzri Rekaj!

Vendosja e tij në Gjermani shënon kapitullin e fillimit të një rrugëtimi sa të rrezikshëm aq edhe të lavdishëm e heroik.

Pas shpërthimit të demostratave të studentëve më vitin 1981 klubi shqiptar "Emin Duraku" doli hapur në mbështetje të

demostratave dhe kërkesave të drejta të studentëve për Republikën e Kosovës.

Këto ngjarje janë edhe kulmi i prishjes së raporteve me autoritetet e atëherëshme okupuese. Duhet të thënë edhe një të vërtetë historike e cila jo shpesh pranohet, në shumë aktivitete dhe vendime të klubit një ndikim shumë pozitiv luanin edhe ambasadat shqiptare të kohës që përmes segmenteve të tyre shpërndanin literaturë dhe gazeta duke ngritur atdhedashurinë dhe drejtuar rrugëtimin politik të mërgatës.

Klubi shqiptar "Emin Duraku" me veprimtarin e vet u bë vatër shqiptare që rrezatonte atdhedashuri në mbarë emigracionin.

Nuk ka demostratë që është zhvilluar në perëndim e të mos jetë një delegacion nga Dyssedorfi. Pas ndryshimit të rrethanave një pjesë e aktivistëve u detyruan të marrin edhe familjet e tyre ku roli i femrës shqiptare ka qenë i jashtëzakonshëm në çdo aktivitet.

Hapja e shkollës shqipe është ngjarja kulmore që ndihmoj në ruajtjen e identitetit dhe masivizimin dhe mobilizimin e përgjithshëm në çdo aktivitet, roli i mësuesve ishte i jashtë-zakonshëm!

Klubi shqiptar "Emin Duraku" ka qenë në vazhdimësi qendër shqiptare pavarësisht bindjeve politike, pas viteve të 90-ta kur filloj krijimi i partive politike edhe në diasporë klubi i qëndroj besnik premisës se kjo vatër iu shërben të gjithëve që punojnë për avancimin e interesave kombëtare, lirisht mund të themi se krijimi i një ambienti tolerant dhe demokratik duke dëgjuar dhe pranuar mendimin ndryshe janë vlera të shtuara të klubit. Nuk ka delegacion që ka ardhur nga atdheu që të mos pritej dhe përcillej nga aktivistët e Klubit.

Është i paharruar nga aktivistët koncerti i madh i ansamblit shtetëror të këngës dhe valleve nga RPS e Shqipërisë që lirisht mund të themi se me paraqitjen e tyre para publikut ndezi zemrat, forcoj dhe betonoj dashurinë ndaj atdheut tek çdo zemër shqiptari.

Në vitin 1995 është një takim shumë i paharruar me njeriun më të madh të letrave shqipe Ismail Kadare së bashku me tani të ndjerin poetin Azem Shkreli.

Qeveria në ekzil kishte derën e hapur për çdo aktivitet, aksioni familja ndihmon familjen, aksioni për hapjen e univerzitetit të Tetovës dhe vizita për këtë tematikë e profesorit tani të ndjerë Fadil Sylejmanit.

Fondi i 3% ishte pranuar me kënaqësi nga aktivistët dhe klubi zhvilloj shumë aktivitete në propagandimin e tij.

Në klubin shqiptar më vonë të emërtuar Qendra Kulturore-Informative Shqiptare “Emin Duraku” kanë qenë shumë nga figuarat që tani janë heronjë të atdheut, ata ishin të mirëpritur dhe kishin përkrahjen maksimale dhe kjo ja ngrit edhe më tepër lavdinë.

Dalja në skenë e të lavdishmes UÇK-së, ishte momenti më emocional dhe më shpresdhënës për mërgatën tonë por veçmas për bartësit e aktivitetit në QKISh "Emin Duraku" sepse kjo ngjarje ishte ëndrra e tyre e përherëshme dhe shpresë se më në fund do të vjen liria dhe mund të kthehen në atdhe.

Hyzri Rekaj si bartës kryesor dhe ideolog i organizimeve ishte shumë i gëzuar sepse pas disa dekadave po afrohej dita të vizitonte vendlindjen që aq shumë e deshti!

Në planin e sensibilizimit të opinionit gjerman do të mbetet gjatë në kujtesë demostrata shumë madhështore e organizuar

para parlamentit të NRW në mbështetje të UÇK-së, fjala e lexuar me atë rast jehoj fuqishëm në çdo zemër atdhetare.
Në këtë demostratë madhështore e mbajtur më 2 mars 1998 ishte edhe heroi i Kosovës Harun Beka, por edhe shumë atdhetarë të tjerë që iu bashkuan pastaj radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Ajo kohë ishte kur çdo zemër atdhetare kishte vënë në shërbim të luftës gjithçka që kishte, me një fjalë QKISH "Emin Duraku" e drejtuar nga vizonari Hyzri Rekaj e dha provimin me notën maksimale dhe tregoj se thellë në ndërgjegjen e tyre ishte e ngulitur dashuria ndaj atdheut.
Nga Dysseldorfi shumë të rinjë u inkuadruan në radhët e UÇK-së ku në mesin e tyre ishte edhe Bekim Rexhepi, që u plagos por ka edhe nga ata që dhanë më të shtrenjtën për idealin e kombit, ranë dëshmor të atdheut. Në mesin e tyre janë edhe martirët Xhemail Nuha dhe Jakup Kurtishaj.
Çlirimi i atdheut ishte ngjarja e shumëpritur shekullore andaj edhe Hyzri Rekaj dhe shumë aktivist të tjerë që ndiqeshin nga armiku erdhën sërish, pas disa dekadave, në tokën që i lindi dhe kjo nuk përshkruhet me fjalë, kjo mundet vetëm të përjetohet.
Veprimtaria e QKISh “Emin Duraku” ka vazhduar edhe më tej, por me detyra tani të natyrës zhvillimore.
Sot në qytetin e Dysseldorfit punojnë dhe jetojnë sipërmarrësit më të suksesshëm në hapësirën Shqiptare, kemi firma të mëdha që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ndërtimin e vendit.
Më lejoni në fund të citoj amanetin dhe dëshirën e Hyzri Rekaj:
- Prioritet i prioriteteve sot mbetet blerja e ndonjë objekti i cili

do të ishte në shërbim të kulturës dhe ruajtjes së identitetit kombëtar.

Kurjtimet e bashkëveprimtarëve në këtë libër e plotësojnë nga të gjitha këndet domenin e veprimtarisë dhe shpalosin figurën madhështore të tij!

Lavdi e respekt për jetën dhe veprën e Hyzri Rekaj dhe gjithë atyre aktivistëve që jetën ia kushtuan idealit kombëtar!

Mr. Sc. Arif Haliti

KAPITULLI I

Rrugëtimi i Hyzriut në vendlindje dhe mërgatë

HYZRI BAJRAM REKAJ

(1952-2017)

Për njeriun që mendon, jeta është komedi, por është tragjedi për njeriun që ndjen.

Horace Walpole

Hyzri Rekaj u lind më 7 mars 1952, në fshatin Nerodime e Epërme, në shtëpinë e vjetër ku kishin lindur e ishin rritur shumë paraardhës të tij. Ishte fëmija i gjashtë me radhë, (ndërsa djali i katërt) i prindërve Bajramit dhe Shukries, të cilët i takonin asaj gjenerate prindërish që pavarësisht nga stuhitë me të cilat i përballte jeta, pavarësisht nga kupa e hidhur që u ofronte ajo, përpiqeshin të mos përuleshin, në mënyrë që fëmijëve t'u jepnin shembullin e të jetuarit me dinjitet. Në shtëpinë e vjetër, aty ku çdo grimcë e ajrit ruante në vete diçka nga e kaluara, Hyzriu e kaloi vetëm vitin e parë të jetës dhe në vitin 1953, familja zhvendoset në

Shtëpia ku lindi Hyzriu

shtëpinë e re, ku do të kalojë pjesën më të mirë të jetës, fëmijërinë dhe rininë, deri në vitin 1977 kur u detyrua të emigrojë në Gjermani.

Hyzriu me 6 vëllezër dhe 3 motra, gjithsej 9 fëmijë

Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, në Nerodime dhe atë me mjaft vonesë, për arsye se në atë kohë nuk kishte paralele në gjuhën shqipe në shkollën e Nerodimes. Për fëmijët që donin të ndiqnin mësimet nuk kishte shumë mundësi, ose të mësonin në gjuhën serbe në vendlindje, ose të udhëtonin me kilometra të tëra deri në fshatin Jezerc. Nuk është vështirë të kuptohet se asnjëra nga këto alternativa nuk ishte e përshtatshme për fëmijët, prandaj edhe shumica e prindërve vendosnin që fëmijët t'i dërgonin në shkollë pak më të rritur, që të mund t'i përballonin udhëtimit, kushteve klimatike e vështirësive të tjera.

Shkaqet e mungesës së paraleleve në gjuhën shqipe, në fshatin Nerodime, ishin më se të njohura, sepse nuk ishte hera e parë që shqiptarët po jetonin nën një sistem shtetëror ku serbët ishin të privilegjuar. Qysh nga etapat e mëhershme historike dihej se një nga aspiratat e pushteteve serbe ishte që mos t'u lejohej shqiptarëve shkollimi në gjuhën amtare. Natyrisht që serbët nuk i harronin arritjet që u kishte siguruar ndërshekuj analfabetizmi dhe injoranca e shqiptarëve, prandaj insistonin që të bënin sa më të vështirë shkollimin. Ata e dinin se shqiptarët nuk do të pranonin për fëmijët e tyre shkollimin në gjuhën serbe, por edhe udhëtimi me kilometra të tëra deri në fshatin Jezerc nuk ishte i lehtë.

Hyzriu fëmijë

Pikërisht në kohën kur duhej të fillonte shkollën, Hyzriu nuk ishte në gjendje aq të mirë shëndetësore, dhe udhëtimi deri në Jezerc për shëndetin e tij të dobët ishte i pamundur, po aq sa shkollimi në gjuhën serbe. Nisur nga këto arsye, familja e vlerësoi të nevojshme që ai të bëjë një pauzë deri në vitin 1961, kur i bëri nëntë vjet dhe u hapën për të parën herë në fshatin Nerodime paralelet e mësimit fillor në gjuhën shqipe. Ishte kjo një fitore e vogël në dukje, por që solli ndryshime shumë të mëdha në jetën e fëmijëve shqiptarë të Nerodimes. Tërë ato vite që iu desh të qëndronte në shtëpi, Hyzriut i kishin shërbyer për të grumbulluar energji, për të zgjuar kurreshtjen për njohjen e gjërave të reja, dëshirë për tu zhytur në labirintet e pafund të dijes. Prandaj, Hyzriu e nisi shkollimin fillor jo si shumë nga

Hyzriu 20 vjeçar

moshatarët e tij, me synimin për të përmbushur një obligim, por për të përmbushur një pasion, për të dalë nga shkolla fillore me një bagazh të njohurive. Ky përkushtim i veçantë, doemos që do të sillte suksese, ndaj Hyzriu shumë shpejt u bë i dalluar në shkollë. Zgjuarsia, entuziazmi, edukata e mirë, urtësia dhe gatishmëria për tu ofruar ndihmë të tjerëve e bënë tejet të afërt e dashur, jo vetëm për shokët e shoqet e klasës, por edhe për mësimdhënësit. Ai e përfundoi shkollimin fillor me sukses të shkëlqyeshëm, por përtej suksesit, gjatë atyre viteve Hyzriu kishte arritur ti shtynte më tej kufijtë e njohurive të tij, kishte arritur të kuptonte se sa shumë gjëra të panjohura ka në jetën e njeriut, të cilat qëndrojnë aty në pritje për t'u eksploruar.

Nga gjithë ato gjëra që i kishin tërhequr vëmendjen, gradualisht kishte arritur të ushqente pasionin e tij që formësua në dëshirë për të studiuar stomatologjinë; prandaj për të bërë hapin e parë drejt sendërtimit të ëndrrës së tij, u regjistrua në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prishtinë, në drejtimin Teknik i dhëmbëve. Këtë fazë të shkollimit e ndoqi gjatë viteve 1969-1973, në kohën kur ende ishin të pakët në numër të rinjtë që arrinin t'i kalonin kufijtë e fshatit apo qytetit të lindjes. Regjistrimi i Hyzriut në Shkollën e Mjekësisë në Prishtinë ishte një ngjarje e shënuar për banorët e Nerodimes, sepse ishte i pari që u orientua në një drejtim mjekësor. Deri në atë kohë ishte krijuar një përshtypje e gabuar se mjekësia ishte një fushë e

paarritshme për shqiptarët. Ky hap i Hyzriut i inkurajoi edhe shumë të rinj të tjerë bashkëvendas, të cilët filluan të kuptojnë se këmbë-ngulja qenka një shteg për të prekur ëndrrën.

Mirëpo, për fatin e Hyzriut, në Prishtinë ende nuk kishte Degë të Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë. Ekzistonte si mundësi ndjekja e studimeve në Sarajevë, por kushtet ekonomike të familjes së tij nuk arrinin të përballonin koston e studimeve në Universitetin e Sarajevës, prandaj Hyzriu u gjend para një momenti të dhimbshëm, heqjes dorë, qoftë edhe përkohësisht nga planet e tij. Në një situatë të tillë, si ngushëllim i vetëm i mbetej profesioni i teknikut, për të cilin tanimë ishte i përgatitur. Gjatë viteve pas shkollimit të mesëm për të ndihmuar veten dhe familjen, Hyzriut iu desh të punonte punë të ndryshme private fizike, pa u ankuar dhe pa kundërshtuar, sepse mundësia për të ndihmuar familjen i jepte mundësi të ishte në paqe me veten, ngase punësimi në profesionin e teknikut dukej i pa-realizueshëm, për shkak se pushteti i atëhershëm përdorte masa diferencimi për t'i penguar punësimin e shqiptarëve.

Gjatë viteve 1975/76 hapet një konkurs për teknik të dhëmbëve pranë Shtëpisë së Shëndetit në Ferizaj dhe Hyzriu pranohet në punë, gjë që ishte një befasi për të dhe familjen.

Megjithatë, rrjedha e ngjarjeve të mëtejme ishte e tillë që ky gëzim të ishte jetëshkurtër. Hyzriu e kishte një shokë emigrant, nga i njëjti fshat, që kishte kryer shkollën e mesme në të njëjtin drejtim, teknik i dhëmbëve. Gjendja ekonomike e familjes së tij ishte edhe më rëndë, por edhe më të vështirë e bënte fakti që ai

nuk e kishte babanë, prandaj mbi të binte barra e përkujdesjes ndaj familjes. Nëna e tij erdhi tek Hyzriu dhe iu lut që ti ndihmonte duke ia lëshuar vendin e punës që sapo e kishte siguruar. Ndoshta një kërkesë e tillë për dikë tjetër do të konsiderohej absurde dhe as që do të merrej në konsideratë. Por Hyzriu nuk ishte nga ata njerëz që mjaftoheshin me mirëqenien e vet, ai ishte i ndjeshëm ndaj dhimbjes njerëzore, prandaj lutja e asaj nëne nuk ishte thjesht një kërkesë, për të ajo ishte një sprovë e ndërgjegjes, prandaj ai nuk hezitoi aspak për të marrë vendimin e tërheqjes nga ai vend i punës, për t'ia lëshuar atë shokut të tij. Edhe pse një veprim i tillë humanist ishte vështirë të gjendej në atë kohë, Hyzriu e bëri me shumë modesti.

Në marrëveshje edhe me Shtëpinë e Shëndetit i kreu procedurat e nevojshme dhe definitivisht ia lëshoi vendin e punës shokut.

Ndërkohë Hyzriu shkoi në shërbimin ushtarak, një obligim që duhej përmbushur para se të vendoste për drejtimin e rrugës së tij të mëtejme jetësore. Shërbimin ushtarak e përfundoi në Novi Sad dhe në Podgoricë. Edhe pse kjo periudhë nuk karakterizohet me ndonjë ngjarje të veçantë për Hyzriun, vetë qëndrimi për një

vit në mjedisin që ndryshon nga vendlindja e tij, sikur i shërbeu si parapërgatitje për largimin më të gjatë nga familja. Sapo u kthye nga shërbimi ushtarak e kuptoi se shumëçka brenda tij kishte ndryshuar, nuk ishte më ai i riu i mëparshëm që të gjitha vështirësitë kishte prirje t'i minimizonte, të bënte zgjidhje të aty për atyshme për ngecjet eventuale. E kuptoi se koha e kaluar larg shtëpisë e kishte pajisur me përvojën dhe intuitën e të rriturit që në çdo veprim të kryer investon edhe

diçka nga bota e vet emocionale. Tani botën e shihte nga një perspektivë tjetër dhe çdo përceptim i linte gjurmë më të thella. Hyzriu tanimë e kishte kuptuar se brenda atij sistemi ku promovohej aq zëshëm barazia dhe vllazërim-bashkimi, jo çdo gjë ishte ashtu siç thuhej. E kuptoi se Kosova ishte shumë prapa nëse krahasohej me viset e tjera të federatës. Këto dhe shumë të vërteta të tjera e frymëzuan që të angazhohej në lëvizjen kombëtare ilegale, edhe pse ky angazhim bartte në vete një rrezik të madh.

Në të njëjtën kohë gjendja ekonomike në familjen e Hyzriut po tendosej gjithnjë e mëshumë dhe vështirësitë e të jetuarit po bëheshin çdo ditë e më të papërballueshme. Prandaj tek Hyzriu filloi të merr formë ideja e largimit nga atdheu, për të gjetur punë dhe për t'i ndihmuar familjes; njësoj siç kishte vepruar edhe vëllai i tij Nebihu. Natyrisht, që krahas kontributit që do të jepte në rimëkëmbjen ekonomike të familjes, Hyzriu planifikonte që atje, në Gjermani, të vazhdonte edhe më intensivisht aktivitetin e tij në kuadër të lëvizjes kombëtare. Pas arritjes në Gjermani, në vitin 1977 u punësua si teknik i dhëmbëve në qytetin e Neusit, ku vazhdoi punën deri në vitin 2005.

Më 2 korrik të vitit 1980, Hyzriu erdhi nga Gjermania për t'u martuar. Familja e kishte njoftuar me Meleken, një vajzë nga Vojnovci dhe tanimë çdo gjë ishte gati për ceremoninë e martesës. Mirëpo në atë kohë ishte intensifikuar edhe përcjellja e aktivitetit dhe lëvizje të tij nga ana e organeve shtetërore të punëve të brendshme që kishin grumbulluar mjaft informacione për aktivitetin e tij. Është për t'u habitur se sa efikas bëheshin në grumbullimin e informacioneve për aktivitetin e ilegales andaj

ishte e pritshme se edhe aktiviteti i Hyzriut do të binte në sy të UDB-së. Hyzriu e vazhdoi aktivitetin edhe gjatë atyre ditëve që po qëndronte në Kosovë për t'u martuar, një rast ky që shpërfaq më së miri seriozitetin me të cilin ai i ishte qasur çështjes kombëtare.

Dasma u bë të shtunën e 5 korrikut të vitit 1980 me tërë familjen dhe farefisin. Të hënën, më 7 korrik, ende pa u rikthyer familja në ritmin e përditshmërisë, Hyzriu e ndërmori një aksion duke këmbëngulur që me çdo kusht duhej të kryhej me ndihmën e vëllezërve. Bëhej fjalë për mbi 500 pamflete të shtypura që duhej të shpërndaheshin në relacionin Kaçanik-Ferizaj e Prishtinë.

Pamfletet i kishte hartuar dhe shtypur me shokët dhe bashkatdhetarët e tij në Gjermani dhe kishte organizuar për mrekulli ardhjen e tyre nëpërmjet një shtetasi të huaj. Ato kishin për qëllim vetëdijesimin e popullatës për pozitën në të cilën ndodhej dhe nxitjen për t'iu bashkuar më shumë aktivitetit të ilegales në Kosovë. Brenda dy ditësh, ashtu siç kishte planifikuar Hyzriu, pamfletet u shpërndanë me shpejtësi nga vëllezërit e tij Basriu, Halili e Shabiu, me ndihmën edhe të nipërve e disa të afërmve të tjerë nga rrethi i ngushtë familjar. Basriu e Halili i shpërndanë në Ferizaj e Kaçanik, ndërsa Shabiu në Prishtinë, duke u përqendruar veçmas në hapësirat e Fakultetit Filozofik, aty ku studionte.

Pas shpërndarjes së pamfleteve, më 9 korrik, Nebihu, vëllai i Hyzriut që ishte kryetar i klubit të shqiptarëve në Dysseldorf u burgos, ndërsa në të njëjtën kohë mbi 12 makina të policisë e rrethuan shtëpinë e Hyzriut, për të bastisur. Hyzriu vigjilent si gjithmonë, e kishte nuhatur ngjarjen dhe nuk gjendej në shtëpi.

Pa u përshëndetur fare me familjen, me ndihmën e vëllait Basriut mori arratinë drejt Malit të Zi, pastaj nëpër Itali dhe më 11 korrik arriti në Gjermani. Tërë këto ngjarje ndodhën vetëm brenda pesë ditësh, madje ishin ditët e para pas dasmës së tij.

Me këtë largim nga atdheu, Hyzriu shpëtoi pa rënë në duart e pushtetit serb, mirëpo ai u shpall person i rrezikshëm dhe iu ndalua zyrtarisht kthimi në atdhe, vendim ky që mbeti në fuqi deri në vitin 1999, kur u çlirua Kosova.

Bashkëshortja e tij, që mbeti në Kosovë, më vonë arriti të shkojë tek Hyzriu në Gjermani, mirëpo, bashkëshortësia e tyre qe jetëshkurtër sepse ishin dy personalitete krejtësisht të ndryshme dhe përkundër përpjekjeve të dyanshme për të ruajtur lidhjen, nuk arritën të parandalonin divorcin. Ndarja e tyre u bë në mënyrën më njerëzore, pa armiqësi, pa fajësim të asnjërës palë, madje edhe në mes familjeve pati vazhdimisht mirëkuptim.

Aksioni i ndërmarrë nga Hyzriu, pati një jehonë mjaft të madhe në popullatë dhe në qarqet shtetërore, sepse ishte një akt tejet i guximshëm për kohën kur po shkeleshin të drejtat e shqiptarëve në Kosovë; ishte një hapje e shtegut për shpërthimin e pakënaqësive dhe revoltës popullore. Në fakt, ky efekt u arrit me demonstratat që shpërthyen një vit më vonë, në mars të vitit 1981.

Gjatë tërë viteve të qëndrimit në mërgim, Hyzriu asnjëherë nuk hoqi dorë nga angazhimi dhe veprimtaria kombëtare. Ai ishte këmbëngulës që të luftonte deri në fund kundër padrejtësive shekullore dhe dhunës që po ushtrohej mbi popullin shqiptar nga pushteti serb.

Hyzriu ishte i vendosur që me çdo mjet, çdo formë dhe mundësi t'i kundërvihej pushtetit policor; të punojë e veprojë për të

drejtat e popullit të vet. Përveç punës së përditshme, ai mori mbi supe edhe organizimin e bashkatdhetarëve, u angazhua në afrimin e tyre me njëri-tjetrin, vetëdijesimin e tyre për rëndësinë e të qenit të bashkuar dhe ofrimit të kontributit për lëvizjen kombëtare.

Krahas aktivitetit të ngjeshur që kishte në Dysseldorf, arriti që me ndihmën e bashkatdhetarëve të tjerë vullnetmirë, të marrin iniciativën për hapjen e një foleje shqiptare, nevoja për të cilën ishte permanente. Me këtë iniciativë synohej sensibilizimi i bashkëvendësve, ngritja e vetëdijes kombëtare dhe afirmimi i kulturës, arsimit, dramaturgjisë, sportit dhe gjithë sektorëve që duhet të posedojë një klub.

Me tërë këtë angazhim, në vitin 1978 u hap klubi i parë shqiptar, që përfshinte shqiptarët nga Jugosllavia dhe që u quajt klubi "Emin Duraku". Aktiviteti i këtij klubi tërhoqi shumë bashk-atdhetarë, patriotë e intelektualë të njohur, si nga Kosova, ashtu edhe Shqipëria, në takimet e të cilëve bëheshin analiza të gjendjes së popullit, gërshetoheshin shumë ide dhe mbaheshin fjalime të nivelit më të lartë nga elita mbarëshqiptare. Ky angazhim vazhdoi me ritëm të njëjtë si në kohën e Qeverisë së Përkohshme, ashtu edhe pas dalja në skenë të UÇK-së dhe fillimit të luftës së armatosur, deri në çlirimin përfundimtar me ndihmën e NATO-s. Për shumë mandate me radhë, Hyzriu si kryetar i QKISH "Emin Duraku" tregoi maturi, pjekuri, vizion dhe dinjitet, duke e orientuar aktivitetin kryesorë, në krijimin dhe ruajtjen e unitetit të të gjitha subjekteve, pa dallim nga ngjyrimet politike e ideologjike, i përkrahur gjithnjë nga anëtarësia e klubit. Prandaj, jo rastësisht, Hyzriu edhe në bazë të evokimeve në këtë libër del si një figurë unifikuese për çështjen

madhore kombëtare. Vlen të theksohet se në kohën që zhvillonte aktivitete në mërgatë e sidomos me ilegalen e asaj kohe, kishte bashkëpunim të ngushtë me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhosh Gërvallën dhe me shumë aktivistë të dalluar e intelektualë të asaj kohe, që me angazhimin e tyre të përbashkët i intensifikuan përpjekjet për tu çliruar njëherë e përgjithmonë nga tutela serbo-sllave.

Hyzriu ishte i lidhur ngushtë me historinë, kulturën, zakonet dhe çdo gjë shqiptare; nga dëshira e vullneti për të parë nga afër tokën amë, më 1983 bashkë me disa bashkatdhetarë vendosi të vizitojë Shqipërinë, ku i kaluan disa ditë me radhë duke i vizituar monumentet historike dhe arkeologjike më të rëndësishme. Pasioni për atdheun nuk iu shua asnjëherë, dëshira për të parë Kosovën të lirë ishte ideali më i lartë i tij, prandaj menjëherë pas çlirimit të vendit nga shovinizmi serb, në qershor të vitit 1999, vendosi të vizitojë vendlindjen pas 20 vitesh mërgimi.

Deshi ta shijonte së bashku me familjen lirinë, që aq shumë e deshi dhe aq shumë punoj për të. Nga kjo vizitë, siç rrëfente vetë Hyzriu, u kthye me ndjesinë e hapjes së një kapitulli të ri jetësor dhe me vendosmërinë e thellë për tu kthyer në një të ardhme afërt të jetojë në Nerodimen e tij.

Në vitin 2002 Hyzriu filloi së ndërtuari shtëpinë që vetë e projektoi; mbase në atë projekt ishin gërshetuar të gjitha preokupimet që e kishin shoqëruar tërë jetën. Ajo shtëpi simbolizonte njëherësh sendërtimin e ëndrrës për liri e pavarësi, kthimin në atdhe dhe lidhjen e përjetshme me prindërit. Ata shkuan në botën tjetër me mallin për të, duke i lënë Hyzriut pengun që nuk mundi t'i përcjellte për në banesën e fundit.

Babai, Bajrami vdiq më 13 shtator 1996, ndërsa nëna Shukrije, më 24 prill 1999, vetëm dy muaj para çlirimit. Me gjithë dhimbjen që i shkaktoi vdekja e prindërve dhe pamundësia për t'i parë edhe njëherë, ai ndihej i përmbushur për faktin që po e plotësonte një nga dëshirat e tyre më të mëdha, kthimin në atdhe, madje kthimin pikërisht në fshatin e tij, ashtu siç deshën ata. Një vit më vonë, më 2003, shtëpinë e përfundoi si më së miri.

Në të njëjtën kohë u angazhua për të realizuar edhe planin tjetër të tij, hapjen e një laboratori dentar në fshatin e vet.

Në vitin 2005 hapi laboratorin stomatologjik privat, të pajisur me teknologjinë më të avancuar e moderne që e solli nga Gjermania. Njëkohësisht filloi hapjen e shtigjeve të bashkë-punimit me stomatologët vendës, të cilët e mirëpritën si profesionist me përvojë dhe karrierë të formuar jashtë vendit. Edhe pse gjatë asaj kohe pati mjaft oferta nga Kuvendi Komunal që të vazhdojë punën në strukturat e komunës, nuk u pranoi asnjëherë të ndahej nga profesioni i vet. Krahas punës që bënte në laborator, me shumë vullnet angazhohej në rregullimin e infrastrukturës së fshatit që ishte shkatërruar shumë nga lufta e fundit. Nga bashkëfshatarët gëzonte një respekt e besim të veçantë për elegancën, durimin, sinqeritetin dhe afërsinë vëllazërore me të gjithë. Punën e tij me bashkëfshatarët, më së miri e ilustrojnë, evokimet e tyre në njërin nga kapitujt e këtij libri.

Vullneti i tij për punë ishte i jashtëzakonshëm, interesimi i gjithanshëm; në laboratorin e tij e punësoi edhe një punëtor të rregullt (Bekim Rexhepin), si dhe gjatë periudhës sa punoi, u

ofroi 5-6 nxënësve të bëjnë praktikën e teknikës së dhëmbëve tek ai.

Hyzriu ishte i pasionuar edhe pas librit, ai arriti të botojë broshurën e parë për klubin dhe rreth klubit në vitin 2003, Pasqyra e Mërgimtarit, në kohën kur Klubi "Emin Duraku" mbushi 25 vjet aktivitet kombëtar. Botim tjetër i tij ishte edhe Doracaku për teknikën e dhëmbëve, që u botua në vitin 2010. Kurse drama Dora e Pajtimit, e shkruar në vitin 1986 ka mbetur në dorëshkrim, pa u botuar.

Hyzriu me gruan dhe vajzën e tij

Vlen të theksohet se Hyzriu gjatë kohës sa qëndroi në mërgim, ishte shtylla kryesore e familjes; gjatë krizave të njohura të asaj kohe, e sidomos në vitet '80 e '90, e ndihmoi familjen me mjete financiare. Ndërsa pas dështimit të martesës së parë, Hyzriu ishte martuar në vitin 1988 me Zhaklina Batsen Rekaj, e lindur më 9.12.1952, nga Reimondi i Holandës, që u bë një shtyllë e fortë e familjes dhe aktivitetit kombëtar që Hyzriu zhvillonte në atë kohë.

Vajza e tyre Iliriana e lindur me 19 qershor 1989, një vajzë shumë e edukuar, u kthye bashkë me prindërit në Kosovë dhe vazhdoj Gjimnazin Shkencor në Ferizaj. Më pas filloi studimet në Prishtinë, në Degën e Gjuhë dhe Letërsisë Angleze, të cilat për shkaqe subjektive i ndërpreu dhe ndërkohë u martua me Farukun nga Slivova. Në Gjermani, është interesant të ceket se ajo ushtroi profesionin e babait të saj teknike e dhëmbëve.

Më 17 shkurt 2008 kur u shpall Pavarësia e Kosovës, Hyzriu ishte njeriu më i gëzuar i asaj dite, të tillë na e përshkruajnë

Hyzriu me kolegët gjerman në punë

Hyzriu duke punuar në laborator

bashkëshortja dhe vajza e tij, që në atë moment ndodheshin në Ferizaj. Organizimi ishte bërë nga strukturat komunale, ashtu si në të gjitha qendrat e Kosovës, me ekrane të mëdha. Pavarësia e Kosovës ishte sendërtim i ëndrrës jetësore të Hyzriut, gëzimi që arriti të presë lirinë e shumëpritur, ishte pa përshkruar. Atë ditë i dukej se po frymonte bashkë me tërë ata breza që ishin shuar ndër shekuj duke e ëndrruar atë liri e pavarësi që më në fund u bënë realitet.

Nga fundi i vitit 2016 filloi të mos ndihej mirë, një sëmundje tinëzare kishte filluar të gërmojë shëndetin e tij dhe së shpejti iu desh të intervenojë nëpër të gjitha spitalet më të njohura, si në Kosovë, ashtu edhe në Gjermani. Mirëpo, me gjithë përpjekjet e familjarëve dhe mjekëve për të çrrënjosur këtë sëmundje, Hyzriu dita-ditës po e humbiste fuqinë. Edhe pse kishte një

Foto nga puna në Kosovë

vullnet të madh për të jetuar e vepruar, nuk arriti t'i rezistojë asaj sëmundje.

Hyzriu ndërroi jetë më 11 shtator 2017, në fshatin e tij të lindjes, në Nerodime të Epërme.

Vdekja e tij e parakohshme ishte një humbje e madhe jo vetëm për familjen, por edhe për gjithë bashkëfshatarët, miqtë dhe popullin e Kosovës. Për të u organizua edhe Akademi përkujtimore në Dysseldorf, nga QKISH "Emin Duraku" nga shokët e tij më të ngushtë, më 26 nëntor 2017. E tërë biografia e Hyzriut lidhet ngushtë me punën dhe angazhimin e tij në shërbim të kauzës madhore kombëtare; ishte për unifikim kombëtar dhe kundër ngjyrimeve partiake e ideologjike.

Ai do të mbahet mend për shumë gjëra në shoqërinë ku jetoi e veproi, si në mërgim ashtu edhe në vendlindjen e tij. Lavdi i qoftë dheu i Kosovës!

Prof. Shabi Rekaj

Pamje nga oda shqiptare

Hyzri Reka

Adem Demaci në QKISH "Emin Duraku" në Düsseldorf

Ismail Kadare në klubin "Emin Duraku"

Kapitulli II

Thënia "Trimi i mirë me shokë shumë" më së miri tingëllon tek jeta dhe veprimtaria atdhetare e Hyzri Rekaj.
Duke folur për kontributin e tij, bashkëveprimtarët, shpalosin në këtë rast edhe punën e tyre kolosale në shërbim të lirisë së atdheut.

Në vazhdim ju njohim me shokët e veprimtarisë.

Samedin Ilazi

Së pari përshëndetje të nderuar bashkëveprimtar të diasporës. Pasi që u njoftova për botimin e monografisë, për mikun tim Hyzri Rekaj nga Sabriu e Shabiu ndjehem i nderuar të kontriboj me rrëfimin tim për Hyzriun. Pra, që nga fillimi për hapjen e klubit, u bëmë bashkëpunëtorë, në rrugëtimin e sakrificës së jashtëzakonshme, aso kohe vepronin edhe disa rryma që donin të bënin një klub Jugosllav, disa të tjerë një klub

Kjo fotografi është shkrepur nga Hyzri Rekaj. Shifet Nebihu, unë Samedin Ilazi dhe shumë veprimtar të tjerë që asaj kohe akoma nuk i njihja mirë!

Kosova dhe ne mendonim pak më ndryshe, pra donim një klub ku do të ndjeheshim më të qetë dhe të pa zhurmshëm. Hyzriu fliste gjithmonë me respekt e admirim për veprimet me ide të përbashkëta. Ose do të formohet një klub i gjithë shqiptarëve, ose nuk do të ekziston fare.

1. A ju kujtohet si dhe kur u njohët me Hyzri Rekaj, hapat e parë të bashkëpunimit konkret në shërbim të atdheut?

- Më konkret është fotografia e parë. Meqë jemi ndër të parët të angazhuar për të themeluar një klub për mërgatën tonë, ku asaj kohe shumë mërgimtar frekuentonin klubet Jugosllave. Nga kjo kohë filloi kontributi im në bashkëpunim me Hyzriun dhe Nebihun. Me mbarimin e takimit shkuam në banesën time në Unterat. Aty morëm qëndrim që Nebihu të vazhdoje me angazhimin e kurbetçarëve, me inciativën e hapjes së klubit. Kurse unë dhe Hyzriu të qëndronim më larg, për një kohë të shkurtër. Pasiqë në anën tjetër ishte një grup nga Gjakova me konsulatën, me administratorin Zenel Syka, Hamdiu, Muharemi, Alija. Këta donin një klub që do të bashkëpunonte me përfaqësimin e shtetit Jugosllav. Por, krahu i Nebihut kishte më shumë respekt dhe kishte besimin e mërgatës. Nuk i donim përçarjet në mes dy rrymave në një fushë të jetës politike, shoqërore. Roli i Hyzriut ishte me rëndësi të jashtëzakonshëm, në përballje me ruajtjen e dy taboreve. Por, për fat të mirë përçarja vinte nga konsulata e jo në mes dashamirëve të inciativës, për hapjen e klubit, Hyzriu ishte i angazhuar që të mbajë peshën e një vëzhguesi, sidomos i atyre që vepronin kundër themelimit të këtij klubi. Pra, puna e Hyzriut ishte e një niveli të lartë në ato rrethana të vështira. Megjithatë, ai arriti që të netrualizoj peshën e mendimeve të ndryshme, dhe të bëjë që

edhe ata pak kundërshtar të na bashkohen me qëndrim miqësor dhe të jenë në bashkëpunim me grupin e dashamirëve të devotshëm për bashkëveprim.
Kur po shkruaj këto radhë, po më duket ndonjëherë sikur më shfaqen ëndrrat dhe sot sikur dikur duke qeshur me Hyzriun, ai ishte shumë i nderuar, dëshira e tij ishte me ëndrra të shumta që mbetën pa i përmbyllur. Po edhe Nebihu ishte me një shpirt të madh, një atdhetar i pakompromis.
Respekt pa fund për të ndjerët miqtë e mi, Nebihun dhe Hyzriun.
Atëbotë angazhimet e mërgatës shqiptare në realizimin e idealit kombëtar ishin të fuqishme, këto ideale sa të fuqishme ishin tek Hyzriu?
- Te Hyzriu po mos të përputheshin idealet atëherë s'do të kishte as bashkëpunim në mes nesh. Normal që mosha e bën të veten. Mua me Hyzriun na bashkonte ideali, që në momentin e parë të takimit në banesën time u bëm miq të ngushtë, nëpërmjet të ideve, përpjekjeve që të punonim dhe të shpërndanim materiale të shtypura. Veprimi i parë ishte që të bënim diçka që do t'ju pëlqejë kurbetçarëve. Shpërndanim veprën e Adem Demaçit "Gjarpërinjtë e gjakut" dhe një fotografi të tij.
Nga këtu filloi bashkëpunimi në dobi të vlerave shoqërore të kombit tonë, për diçka që mendonim se mërgatës kjo i mungonte. Asaj kohe ishte vështirë të veprohej siç vepronim ne hapur me mërgatën. Unë punoja në Manesman, aty punonin shumë shqiptarë nga të gjitha trojet tona. Nuk kishim material të nevojshëm për të plotësuar kërkesat e duhura për furnizimin e frymës për atdhedashurit tanë. Më kujtohet që merrnim material nga Partia Marksiste-Leniniste Gjermane, për shpërndarjen e

veprave të ndryshme në gazetat që botoheshin në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Nga këtu filloi nxitja që të bëjmë edhe më shumë në shërbim për vrullin e fuqishëm të kësaj veprimtarie. Pastaj, filluam me revistat që i botonin asaj kohe në perëndim e veçmas në Gjermani dhe Zvicer. Jemi mirënjohës dhe për shtetin tonë Shqipërinë që na i dërgonte falas materialet e duhura. Dhe kur kuptoi mërgata se në klubin tonë shpërndaheshin materiale të ndryshme, ata filluan që të largohen nga klubet Jugosllave dhe të anëtarësoheshin në klubin e punëtorëve shqiptar "Emin Duraku" në Dyseldorf të Gjermanisë. Veprimi ishte një zinxhir që të lidhemi e të mos kapeshim nga UDB-ja, se ajo ishte kudo në mesin tonë. Veprimi ynë ishte në hapa shumë të vështirë, por tek Hyzriu ishte shumë e fuqishme bindja që të veprohet shumë në hapa të sigurtë, për shpërndarjen e materialeve që na i sjellnin bashkëveprimtarët asaj kohe nga Gjermania, Zvicra, Danimarka, Holanda, Belgjika e shumë vende të tjera. Nga këto vende kishim edhe anëtarë të klubit nga Belgjika vëllai i juaj Basriu, nga Danimarka, Remziu, nga Zvicra, Kadri Zeka dhe shumë të tjerë.

3. A mund të numëroni disa aktivitete që i zhvilluat me Hyzriun dhe shokët e juaj?

- Është shumë e vështirë, sepse ne kemi bërë një sakrificë të jashtëzakonshme dhe të vështirë, që mos të biem pre në sytë e UDB-ës. Puna jonë ishte e mendjes, e shpirtit dhe e lidhtë ngusht me zemrën, që mos të merrnim në qafë kurbetçarët. Para demostratave të marsit dërguam materiale të shumta përmes punëtorëve të Turqisë, po mos të ishin këto vepra nuk do ta kishim këtë mërgatë që është sot. Ka ndodh që nuk i kemi njohur të gjithë bashkëveprimtarët në foton e parë, ka edhe

dëshmorë të rënë për lirinë e Kosovës. Unë njihesha me Hyzriun, por jo edhe me të gjithë shokët e tij, por edhe Hyzriu më njihte mua, por jo edhe të gjithë shokët e mi. Me hapjen e klubit filluam të njiheshimn edhe më mirë edhe me më shumë bashkëveprimtar. Prandaj, filluam të jemi më të hapur dhe më të guximshëm dhe të vepronim thuaj se publikisht me idet edhe të mërgatës.

4. Por ju nuk jetonit në Dyseldorf, a kishit njohuri për angazhimet e mërgatës në klubin e parë shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf me rrethinë jashtë programit Jugosllav.

Hyzriu i priu një kohë të gjatë. Si e keni vlerësuar angazhimin e tij në klub e më gjërë?

- Gjithsesi e kam përcjellur se unë kisha lidhje vëIlazërore me familjen e Hyzriut dhe merrja lajme për punën e tij të jashtë-zakonshme me shumë sakrifica. Por, mbasi unë në Dyseldorf kisha familjen time prindërit e mi, familjen e gjerë Iljazi nga Tetova, nga fshati Percë, ku edhe sot janë mbi njëqind anëtarë e më shumë. Mandej, shumë nga familja ime kishin martesa të djemëve dhe të vajzave në Kosovë apo edhe anasjelltas.

Gratë tona kanë bërë një punë të shkëlqyer duke përcjell çdo informatë për çdo gjë që ndodhej asaj kohe në klubin dhe rreth klubit. Sot nuk di a mund të ketë njerëz të tillë që bën atë sakrificë me aq zell e dashuri.

5. Si e vlerësoni aktivitetin e Hyzriut pas paraqitjes së pluralizmit politik, pas themelimeve të instutucioneve të Kosovës, roli i tij ishte partiak apo unifikues në Dyseldorf e më gjerë?

- Me Hyzriun jam takuar disa herë, disa herë në Tetovë dhe disa herë unë me familjarët e mi kemi vizituar Hyzriun në vend-lindjen e tij në Nerodimen e Epërme, këto takime kanë qenë pas mbarimit të luftës së Kosovës. Hyzriu, posa përfundoi lufta, erdhi më vizitoi me të shoqen dhe vajzën e tij. Kam një respekt të madh e të pa mundur t'i përshkruaj emocionet e asaj dite. Kurr se kisha mendur se pas gjithë asaj katrahure, fortune të egër do të takohemi e do të pime kafe në Tetovë e Kosovën e lirë për ti kujtuar veprat tona të idealit, të bashkimit. Ai pikërisht më falenderoi me një mirnjohje për kontributin tim.

6. Kontributi i mërgatës ishte vendimtar në rrugëtimin e Kosovës, sa ka qenë Hyzriu në këtë rrugëtim?

- Gjithsesi që po, nuk mund ta mohoj kontributin e mërgatës e cila na dha zemër e guxim, edhe anëtarë që derdhën jo vetëm djersën e tyre, po edhe gjakun e tyre për lirinë e Kosovës. Ka disa zëra që e ofendojnë se mërgata ishte e pashkolluar. Dhe sikur donin të ofendonin në kuptimin për të përvetësuar gjithë punën për vete. Unë ju them mos ofendoni. Vlerësojeni veprimin e tyre se në fund të fundit çdokush do të dënohet për veprimet e veta. Ata janë njerëz të sakrificës pa interes, por bën gjithçka që Dardania të jetë e lirë dhe e bukura e tyre. E Hyzriu në këtë rrugëtim ka qenë vet i sakrificave të mëdha që është vështirë t'i mas unë si mik i tij. Është i jashtëzakonshëm kontributi i tij.

7. Si e vlerësoni Hyzriun përgjithësisht për bindjen tuaj në radhët e cilës kategori e klasifikoni: (si ushtar i betuar i Atdheut, hero i përgjegjjeve për liri)?

- Hyzriu ishte një vatër e zjarrit për liri e bashkim kombëtar. Kontributi i Hyzriut është i pakontestueshëm dhe i pa zëvendësueshëm për shumë gjëra të asaj kohe si gjatë luftës po edhe pas lufte. Shumë ndihma vinin për UÇK-në për popullatën në Kosovë e jashtë saj. Pra, të gjitha këto vinin edhe nëpërmjet klubit shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf. Po kush tjetër do të jepte atë angazhim pos Hyzriut dhe familjes së tij. Sot e di se shumë mundohen të përvetësojnë këtë kontribut për veten e tyre, si të ishin të parët bajraktar të sakrificës. Kam lexuar informacione në revista, nëpër libra që kanë shkruar për kontributin që kanë dhënë, por jo si ne që dhamë nga djersa jonë. Asnjëherë nuk e drejtoi gishtin nga vetja, Hyzriu. Por, ngeli besnik i bindjeve të tij për liri dhe bashkim kombëtar. Ne ndamë ditë, netë dhe shumë vite së bashku duke i qarë hallet tona për të qenë të lirë e të lumtur. Ai meriton të jetë i klasifikuar si ushtar i betuar i Atdheut, Hero i përjetshëm për Liri.

Unë për vete asnjëherë nuk u mërzita dhe nuk u pendova për rrugëtimin e vuajtejeve të mia. Mblodha veten, shtrëngova dhëmbët dhe i kam ndjerë si të ishin plagë të shëruara.

I vetëditur se për të jetuar i lirë, dhe lirija ka edhe një çmim të dhimbshëm, por aq sa të jetosh i skllavëruar. Nuk e kam pas lehtë para fëmijëve të mi dhe shoqës sime të cilët më mbështetën, më dhanë kurajo edhe më të fortë për të ecur me këmbët e mia. Sepse të jetosh i skllavëruar është të qeshësh me

zor. Shpesh fëmijët më thonin-mos u mërzit babi, na ke neve, sepse po të kontribuosh për liri është lumturi, sepse e bënë për të ardhmën tonë, me mund e kënaqësi e jo me lot e dhimbje në robëri.

Jetën time e bëjnë të veçantë kujtimet e bashkëveprimtarëve të mi, si i organizuam dhe si zgjodhëm të themelonim Klubin e Punëtorëve Shqiptarë "Emin Duraku" në Dysseldorf. Ka ardhur momenti për të bërë sakrifica të vetëdijshme! Dëshiroj të flas me disa bashkëveprimtarë për të gjetur se kush na dha shuplakën më të rëndë gjatë diskutimit që po bënim dhe që për ogurzi askush nuk e përmend. Po të donin studiuesit bashkëkohas do t'ju jap një listë me emrat e bashkëpunëtorëve shqiptar nga Maqedonia dhe Kosova. E vërteta historike duhet të shkruhet pa drojë sepse unë kam një detyrë morale dhe shpirtërore të shkruaj dhe të komunikoj atë që besoj. Ndonëse isha mjaft i ri, përpiqesha të vëzhgoja sa më shumë që mundesha. Sidoqoftë, po vazhdojë me takimin e parë që kam mbajtur me bashkëveprimtarët, Nebih dhe Hyzri Rekën, ku gjithashtu i pranishëm në këtë takim fillestar ishte edhe Muhamet Latifi nga fshati Odër i Maqedonisë. Mund të paraqes edhe dëshmi fotografike të këtij takimi. Në këtë takim fillestar, vendosëm të hapim një klub ku mërgimtarët do mund të shoqërohen dhe takohen. Të nesërmen më thirri Nebih Rekaj dhe u takuam në stacionin e trenit në Dysseldorf, ku më paralajmëroi se në takimin fillestar kishte marrë pjesë edhe Zenel Syka, administrator nga Konsullata Jugosllave në Dysseldorf. Më pas i ndërpreva për një kohë aktivitetet pasi disa ngjarje që ndodhën në atë kohë nuk i kuptoja plotësisht. Kishte ngjarje që kishte planifikuar Konsullata Jugosllave në Dysseldorf.

Më pas, vëllezërit Nebi dhe Hyzri Rekaj më vizituan në banesën time pas këtyre incidenteve fatkeqe që përfshinin qëllime specifike që na ndodhën rreth kohës së themelimit të klubit. Aty ndodheshin Refet dhe Zenel Iljazi, dy kushërinjtë e mi.

U FORMUA ANSAMBLI ARTISTIK «ALEKSANDËR MOJSIU»

Ne qëndruam zgjuar atë natë vonë dhe të nesërmen vendosëm së bashku me Nebihun që t'i organizojmë bashkëveprimtarët për të ndërmarrë veprime konkrete në mbështetje të hapjes së klubit. Duhet shumë punë për të shkruar sot për veprimtarinë e bashkëveprimtarëve, ndoshta dhe koha nuk do të na premtojë, sidoqoftë unë jam dëshmitar i gjallë i historisë të organizmit famëmadh të diasporës dhe jam i shpërfillur nga njerëzit që po bëjnë të gjitha përpjekjet për të kërkuar pronësinë e kësaj veprimtarie madhështore. Familja Rekaj dhe familja Kelmendi ishin të vetmet që qëndruan në kontakt me mua pas rrebeshëve të kohës.

Përfshirja e familjes Rekaj në klub është histori për diskutim në vetvete. Përsa i përket kësaj familje patriotike, kam shumë për të thënë, ku do të filloj duke ju kujtuar disa bashkëpunëtorë të Maqedonisë së Veriut si Xheladin Rustemi nga Hasan Begu i

Shkupit, i cili u dënua me 8 vjet burg pasi u konstatua se ishte anëtar i klubit "Emin Duraku" dhe u cilësua si një irredentist, nacionalist, separatist i papërshtatshëm për Jugosllavinë, më pas, Bilall Mustafa, banues në Kërçovë dhe pjesë e kryesisë qëndrore të klubit "Emin Duraku" Zenel Iljazi, anëtar i kryesisë së klubit dhe pjesëmarrës në të gjitha protestat në perëndim; Imberja Qamili nga fshati Gajre në Tetovë, anëtar i kryesisë dhe më vonë arkëtari i klubit. Anëtarët e tjerë të klubit ishin kryesisht nga Ferizaj dhe rrethi i Ferizajt, por vinin edhe nga Gjilani, Prishtina, e Prizreni.

Kur është fjala për kontributin e familjes Rekaj nga Noredimja e Ferizajt, veçanërisht kontributi i profesor Shabi B. Rekajt në retrospektivë: Takimi i parë me të u bë në Tetovë, kur ai erdhi të më intervistonte mua dhe Xheladin Rustemin, sepse ishte e paqartë pse ne qëndruam në vendlindje dhe për situatën që u krijua rreth nesh. Por koha nuk na dha këtë mundësi, ndërsa Shabiu më delegojë intervistën mua që ta realizojë me Xheladin Rustemin, por për arsye të rrethanave të vështira dhe ndjekjeve nga UDB-ja famëkeqe, si dhe për arsye se Xheladini ishte i burgosur dhe te shtëpia e tij nuk ndodhi askush, unë nuk munda të realizojë intervistën me të. Takimi i dytë me Shabiun do të ishte koha kur kishte filluar lufta në Kosovë, në vitin 1998. Padyshim ky takim ishte shqetësues, sfidues dhe stresues. Shabiu ishte i rrahur për vdekje, i plagos dhe me dëmtime të dukshme nga forcat paramilitare sërbe. Ai erdhi në shtëpinë time në Tetovë nga rajoni i Jezercit dhe Nerodimes, pasi shpëtoi nga bandat paramilitare dhe ushtrisë serbe, ku qëndroi për 4 ditë.

Shfrytëzoj rastin të falënderoj Spitalin Privat “Gallaksia” në Reçic të Vogël, pasi ata bën çdo përpjekje për t'i shëruar plagët.

Dua të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për përpjekjet e tyre për ta ndihmuar në shërimin e tij deri në zhvendosjen e Shabiut në Shqipëri. Dhe kështu ndodhi me Shabiun, i cili 4 ditë mbeti i lënduar dhe me dëmtime serioze përpara se të dërgohej në Shqipëri. Duhet të kuptosh ose të kesh ndjenjën e vuajtjes dhe krenarisë shpirtërore të familjes së Shabiut për të folur për to. Do të ishte tradhti kombëtare të diskutohej për Klubin "Emin Duraku" pa përmendur përfshirjen e kësaj familjeje. Do të më duhet një libër i tërë për të kronolizuar historinë e tyre.
Lavdi veprimtarisë atdhetare të familjes Rekaj.
Lavdi jetës dhe veprimtarisë heroike për lirinë e atdheut shokut Hyzri Rekaj.

Xhemail (Hasan) Nuha

I lindur me 4.5.1934 në fshatin Jezerc.

Sikurse çdo shqiptar në atë kohë që ishin të privuar nga e drejta për shkollim, dhe punësim, përveç punëve fizike që kreu në vendlindje, për vehte dhe për familjen, kushtet e vështira ekonomike dhe padrejtësitë që ndodheshin gjatë viteve 60/70-ta, baci Xhemail detyrohet të merr rrugën e mërgimit për të u ndarë nga familja e ngushtë e farefisi.

Ndamje jo e zakonshme, dhe e dëmshme për një shoqëri, e një shteti që bënte diferencime, në shkollim, në kulturë punësim, ku pasojat ishin të pariparueshme, të jetonë, prindi jashtë vend-lindjes për të siguruar kafshatën e bukës, i ndarë nga fëmijët e bashkëshortja, dhe e tërë familja, vetëm se ishte shqiptarë.

Në vitin 1973 detyrohet të migrojë në Gjermani si gjenerata e fundit, ku u punësua tek firma "Goerg Beker".

Aty punojë një kohë të gjatë, ku me fitimet nga puna u bë shtyllë ndihmëse për vehte dhe për familjen e tij e më gjërë.

Më vonë punojë në firmën "Hoch Tief", deri sa u kthye në vendlindje para penzionimit në vitin 1997, në Nerodime të ulët ku kishte ndërtuar shtëpinë e re.

Ai sikur e nuhati luftën që do të shpërthente në Kosovë, për atë edhe shkojë, ishte një trim e guximtarë i dalluar, ku dëshironte që pas një kohe të kthehej në vendin ku ka lind, ku ka zhvilluar

fëmijërinë, ku i ka munguar me vite ngrohtësia dhe gjiri familjarë.
Ne bashkautorët, në konsulltim me familjen e të ndjerit tash më, martirit të dalluar të çështjes kombëtare vendosëm që në kuadër të kësaj Monografie, të përshkruajmë një itinerar të shkurtër të një njeriu me vlera shoqërore e kombëtare, i cili la gjurmë të pashlyera aty ku punojë e veprojë.
Dhe në bazë të deklaratave të shoqërisë së tij ishim të detyruar të përshkruajmë përsonalitetin e tij.
Baci Xhemail ishte që nga fillimi e deri në fund të jetës së tij, njeri me vlera, i respektonte shokët, i respektonte antarët e klubit, ishte një ndër themeluesit më eminent i formimit të kësaj qerdhe shqiptare në Dysseldorf.
Kur kemi filluar këtë projekt, të Monografisë, për Hyzriun, kemi qenë të detyruar që të përfshijmë edhe bacin Xhemail, sepse edhe bisedat e më hershme, që reflektuan më tej nga e gjithë shoqëria dhe bashkatdhetarët, ku secili prej tyre kishte fjalë miradije dhe respekt të veçantë për të.
Baci Xhemail kishte një zemër të gjërë për shokët që e rrethonin,e sidomos në çështjen humanitare, kombëtare e më gjërë.
Ai ishte i kompletuar, trim, guximtar, dhe që nga viti 1981 e deri sa u kthye në Kosovë pothuajse nuk ka lënë demostratë pa marrë pjesë, edhe në Gjermani dhe jashtë sajë.
Ishte gjithmonë i veshur me rroba tradicionale shqiptare, dhe ishte ndër të parët në renditjen e demostratave.
Dallohej me veshjen e tij kur qëndronte në Odë, pranë klubit, me gjithë dy bacat tjerë ku janë të njohur për ne.

Ishte një nga anëtarët më të rregullt në Klubin "Emin Duraku", ai deri në frymën e fundit të jetës së tij ishte i drejtpërdrejt me të gjithë.

Sa i përket fjalëve që i thoshte për Hyzriun ishte mbreslënës, ku vazhdimisht e përkrahte në vendimet e tij dhe të kryesisë, së Klubit.

I pari ishte që klubit dhe anëtarëve të ju jap kurajo, dhe gjithmonë potenconte se jemi me fat të madhë që e kemi këtë udhëheqje të veçant ku neve na kanë lakmi e tërë mërgata në Gjermani e më gjërë.

Kishte një vullnet të pakrahasueshëm, për t'i dhënë të gjitha nga vetja, nuk kursente asgjë sa i përket çështjes kombëtare, bile në bazë të fjalëve të bashkatdhetarve; po të i kishim të gjithë si baci Xhemail do të fitonim lirinë më herët.

Kemi edhe shumë gjëra për të shkruar për të, dhe për respektin që pati ndaj shoqërisë, ndaj Klubit, ndaj anëtarëve të kryesisë, e sidomos pati një respekt të jashtëzakonshëm për Hyzriun, në aktivitetin e tij që zhvillonte në atë kohë.

Kthimi i tij në vendlindje më 1997, sikur nuhati luftën e UQK-ës, e lindur nga populli, që ishte në prag të fillimit të saj.

Nga viti 1997 e deri më 28 prill të vitit 1998 te shtëpia e bacit Xhemal disa herë policia ka marrë pjesë në bastisje, dhe kanë kërkuar armë prej tij, në biseda informative pas bastisjes, ishin bë rutinë e kohës.

Duke i pa lëvizjet e përgaditjes për luftë edhe pse kishte mundësi të largohej, ai si gjithmonë nuk pranonte të lëshojë shtëpinë e vet.

Ishte trim e guximtar i veçant, nuk e njifte frikën.

Në mëngjesin e 28 prillit 1998, forca të mëdha të paramilitarve dhe ushtarëve Sërbo-sllavë, ju drejtuan shtëpsë së tij.
Gjuajtën në derën metalike, depërtuan mbrenda, ku hasën në kundërshtim me bacin Xhemail, kacafytjet që ndodhën ishin të pabarabarta, përveq tij ishte edhe bashkëshortja e tij e cila i duel në krah burrit, por një polic xhakatar i'a dreton automatikun dhe i thotë ti shko në mal, gjuen në drejtim të saj por për fat i shpëton më të keqes, ndësa bacin Xhemajl e rrëmben dhe sot e kësaj dite nuk dihet ku gjindet kufoma e tij.
Pas ngjarjes makabre të xhakatarve sërbo-sllavë, bashkëshortja e tij shkonë prap te shtëpia për t'i pyetur se q'u bë me burrin tim, ata prap ia drejtojnë automatikun po nuk shkrepin.
Pas kësaj ngjarje të trishtuar, pas një kohe, familja fillon t'i kërkojë gjurmët e tij.
Për këtë deklaron djali i tij Fadili;
Në derën e hyrjes janë gjetur tri vrima plumbash e cila ishte metalike.
Kemi kontrolluar bunarin, kemi gjetur jakën e tij të lëkurës, ku shifen dhe janë të deshifruar 7 vrima të plumbave.
Është gjetë edhe një kapel dhe një sandale.
Për familjen data 28 prill 1998, është edhe dita e vdekjes.
Është për t'u ardhur keq që ky njeri me vlera kombëtare ka mbetë në mëshirën e kohës, që shoqëria jonë dhe shteti nuk ka ndërmarrë asgjë për gjetjen e trupit të tij për të varrosë ashtu siç e meriton me dinjitetin më të lart.
I gjithë ky rrugëtim i tij patriotik që mbrojti pragun e shtëpisë, dhe me këmgulje nuk u lëkund nga dinjiteti si shqiptar i devotshëm, besnik, trim e guximtar, dhe në bazë të rrëfimeve të bashkatdhetarve, bashkëfshatarve, dhe amanetin e shokëve të tij

që vdiqën, e në veçanti Hyzriu i cili kishte një respekt të veçant ndaj bacit Xhemail.
Prandaj morëm obligim për t'i shkruar aktivitetet e tij në mërgatë dhe vendlindjen e tij.
Baci Xhemail do të mbahet mend për shumë gjëra, tek ai dominojë Trimëria e guximi, dashuria për Atdheun, kthimi i tij në Kosovë për të qenë afër bashkëfshatarve të vet, respektin që kishte ndaj të gjithëve që e rrethonin.
Falenderojmë familjen e tij për bashkëpunimin e këtij evokimi, për bacën Xhemail.
I lehtë i qoftë Martirit dheu i Kosovës.

Sofije Dumnica

Sofije & Bajram Dumnica kujtojnë mikun e tyre të ngushtë të bashkë-veprimtarisë për Kosovën tonë të përvuajtur, plagë e pashëruar për çdo shqiptar e atdhetar si Hyzri Rekaj !!!

Që në fillim falënderojmë bashk-autorët që kanë marrë përsipër për të punuar monografi për veprimtarin, atdhetarin e devotshëm dhe të palodhshëm që kontribuoj për interesin kombëtar.

Më kujtohet mirë kur u takuam për herë të parë në protestën e Dysseldorfit, të gjithë shqiptarët e bashkuar, edhe pse në

përcjellje të policisë gjermane, kërkesat tona ishin për Kosovën Republikë, liri për Kosovën dhe popullin e saj.

Hyzriu ishte kryetar i klubit shqiptar "Emin Duraku", ishte i angazhuar tepër që protesta të rrjedhë mirë dhe të jetë efektive, e cila gjithashtu përfundoj me plotë sukses! Po normal që ishin shumë të fuqishme dhe plotë emocione, kur bënë një angazhim, aq të fuqishëm dhe nuk të mungon suksesi, si mendoni ju ... a nuk

është kjo madhështore për atdhetarin që i përjeton me shpirt? Kur arrinë atë që synon në botën e jashtme, që është e fuqishme dhe fiton plotë bindje të mos ndalesh kurrë së vepruari. I tillë ishte Hyzriu sepse ishte i popullit, po Hyzriun e ke gjetur kudo që ka thirrë populli.

Aty ku janë takuar kryesitë e klubeve shqiptare, aty ishte edhe Hyzriu, kudo që ishin apo edhe sa larg ishin, pa kursyer veten asnjëherë, edhe takimet që mbaheshim nëpër aktive të LDK-së. Ishte anëtar i kryesisë së nëndegës për NRW me 65 aktive!

Hyzriu ishte i pandalshëm edhe në organizime kulturore dhe sportive, sidomos në Dysseldorf ku edhe ishte kryetar klubi "Emin Duraku" dhe e kishte të lehtë për organizime të tilla.

Po, Hyzriu ka qenë i popullit dhe pluralizmi politik kishte qenë vetëm për ata që kanë patur synimet e veta, të jenë udhëheqës edhe pas luftës, pa e llogaritur përgatitjen profesionale.

Por në rrugëtimin për Kosovën, Hyzriu ka qenë i përpikët, pa kthim prapa. E jona ishte të fitoj Kosova, të jetë shtet demokratik dhe i pavarur që gjithëherë synonte Hyzriu. Këtë e arrit dhe e përjetoi në vendlindje, kur u shpall pavarësia e Kosovës më 17.2.2008.

Edhe pse i mbylli sytë përgjithmonë, së paku e shijoi lirinë dhe pavarësinë e Kosovës që e donte me gjithë shpirtë, u çmall me tokën e Kosovës dhe hyri në dheun e saj.

Lavdi veprës patriotike të atdhetarit të devotshëm Hyzri Rekaj.

Xhafer Shatri

Hyzri Rekaj, idealist i orëve të para në Mërgatë

Me Hyzriun jam takuar për herë të parë në fund të tetorit të vitit 1982. Nga Zvicra shkuam me Hasan Malën. Në Dysseldorf na pritën Avdi Begisholli dhe Hyzri Reka. Ndejtëm gjatë dhe u informuam për gjendjen në Dysseldorf, në Gjermani po edhe në Ferizaj e rrethinë, sepse që të dy ishin të asaj ane. Për mua që kisha vetëm disa muaj që po shijoja idhtësinë e mërgimit, ishte e rëndësishme të takoj njerëz me përvojë dhe të lidhur me Lëvizjen Kombëtare, siç ishin këta të dy dhe plotë të tjerë aty.

Nga ajo që vërejta, ashtu si edhe në shumë mjedise të tjera në mërgim, ishte se vrasja e prijësave të Lëvizjes Kombëtare vëllezërve Gërvalle e Kadri Zekës nuk i kishte frikësuar as aktivistët e njërës prej vatrave të saj në mërgim që militonin rreth Klubit "Emin Duraku".

Përkundrazi, njerëzit ishin mllefosur e trimëruar edhe më shumë. Në vetëdijen e tyre, krimi në Untergrupegrah, kishte krijuar një humnerë me Jugosllavinë mbi të cilën nuk do të mund të ndërtohej kurrë asnjë urë. Dysseldorfi ishte njëra prej qendrave kryesore të mërgatës së re të Kosovës, aty klubi ynë i parë që ishte pavarësuar nga përfaqësitë dhe përfaqësuesit e

Jugosllavisë. Kjo kishte ndodhur falë aktivitetit të një grupi atdhetarësh aty. Mësova sidomos për përpjekjet perfide të UDB-së për t'i përçarë veprimtarët dhe simpatizantët e klubit. Hyzriu dhe baci ishin burra të pjekur, të përkushtuar dhe të gatshëm për të bërë çdo gjë në favor të lirisë së Kosovës. Ishte kënaqësi të bisedoje me ta.

Më vonë me Hyzriun jemi takuar me 10 dhjetor 1982, në Demonstratën e madhe që mbajtëm para Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Ishte ndër demonstratat më të mëdha e më të suksesshme deri atëherë. Shkaku i saj Kryesia e Jugosllavisë pati kërkuar nga Zvicra që të ndalojè veprimtarinë e Lëvizjes në këtë shtet. Me qëllim që rrëfimi im për Hyzriun të jetë sa më origjinal, po i referohem ditarit, të cilin e kam mbajtur rregullisht.

E martë 18 janar 1983, ishim me Plakun në Bruksel, ku e formuam një lloj rrjeti të Lëvizjes. Dhe pastaj shkuam nè Dysseldorf te Hyzriu. Biseduam gjatë me të. Isha ende nën përshtypjet e rënda të kontakteve ne Bruksel dhe i fola hapur për këtë. Atmosfera politike atje dallonte shumë nga mjediset tjera në mërgim. Ndërkaq, Hyzriu me atë buzëqeshjen e tij të përhershme, ma ktheu: Në Bruksel kanë mbjellë harpaxhikë shumë duar dhe është vështirë të gjinden dhe të lidhen fijet e duhura. Qeshëm të gjithë me shprehjen "harpaxhik". Por takimi më i rëndësishëm me Hyzriun ka qenë më 3 prill 1983, kur ai erdhi në Gjenevë me një ilegal nga Kosova. Ishte ditë me shi. Pasi fola me shokun që kishte ardhur, dolëm me Hyzriun në një park dhe shetitëm gjatë, ani se u bëm qull. Folëm gjatë për gjendjen në Lëvizje, për nevojat e mëdha e mundësitë e vogla, për nevojën që të dalim gradualisht nga gëzhoja e

ilegalitetit dhe të strukturohemi në rrethana të reja. Ishte shumë i qartë. Këtë bisedë pastaj e kam interpretuar te shokët më të afërm dhe disa muaj më vonë, në Biel mbajtëm një mbledhje të zgjeruar, konsultative ku morën pjesë rreth 80 aktivistë të besueshëm të Lëvizjes nga krejt Evropa. Ky ishte takimi më i madh i kuadrove të Lëvizjes që ishte mbajtur ndonjëherë. Aty pati diskutime për gjendjen organizative dhe për çështje programore. U fol hapur edhe për përçarjet që kishin filluar në Lëvizje dhe të cilat do përsëriten në formë kaskadash shumë vjet rresht.

Këtë çështje një aktivist, Shyqeri Ukshini e shtroi në mënyrën e tij atipike: Shokë, çka të bëjmë me disa që po kokokokorizen (Shyqa kur ishte nervoz, belbonte...) në Lëvizje, ndërsa venë po e bëjnë tjetërkund? Edhe Hyzriu diskutoi dhe si gjithnjë dëshmoi edhe aty, me dijen dhe përvojën e tij, se ishte njëri ndër kuadrot kryesor të Lëvizjes. Zatën këtë e pranoi shumë vjet më vonë në një intervistë edhe shefi i UDB-së për Kosovën se Hyzri Rekaj ishte ndër 7-8 shqiptarët më të rrezikshëm për Jugosllavinë në Evropën Perëndimore.

17 dhjetor 1983, sot ia dërgova Hyzriut me postë expres, traktin që do të shpërndahet në Kosovë, me fotografitë e shokëve të rënë dhe me kërkesat themelore të Lëvizjes. Ideja e Hyzriut ishte që trakti të jetë me letër të dyfishtë speciale, në mënyrë që kur t'i hiqet shtresa e poshtme, atëherë trakti të ngjitet kudo dhe të mos mund të hiqet aq lehtë. Traktin pastaj e ka shtypur Hyzriu dhe ia ka dhënë Jakupit, mirëpo, ky si duket është arrestuar në kufi. Nuk më kujtohet saktësisht se çka ka ndodhur pastaj me traktin, a ia ka dhënë edhe ndokujt tjetër apo jo dhe sa është shpërndarë në Kosovë?

16 janar 1984, dje ishin shokët e Dysseldorfit dhe të Lozanës: Hyzriu, Nazmiu, Haxhiu, Hamiti etj. kanë ardhur për ngushëllime, sepse para pesë ditësh janë vrarë në Prishtinë, Rexhep Mala e Nuhi Berisha. Jemi për tokë. Plaku (Hasan Mala) po mbahet mirë, por vetë jam në një gjendje të rëndë dhe nuk po mund të marr veten. Më është errësuar çdo gjë. Kjo është goditja më e rëndë që kemi marrë. Të gjithë shokët që po vijnë, sidomos këta nga Dysseldorfi, u përpoqën të na forcojnë me fjalët e tyre të matura e të vendosura. Por gjëma është tepër e madhe. Pasojat e saj janë të pariparueshme që Lëvizja do t'i vuajë shumë vjet. Kur dolëm t'i përcjellim nuk munda të përmbahem e të mos ia them Hyzriut: është krijuar një kaos që askund nuk po ia shoh fundin. Ata ishin arkitektë të organizimit ilegal...

E diel 30 shtator 1984, ka ardhur Ansambli i Këngëve dhe Valleve nga Shqipëria. Ishim në Lozanë dhe në Bazel. Këtu erdhën shokët nga Dysseldorfi: Hyzriu, Sylë Thaçi, baci Avdi, baca Zymber. Kishin ardhur edhe disa shokë nga Suedia. U gëzuam se u pamë. Më veçoi Hyzriu dhe më tha se po flitet edhe për një përçarje tjetër që po përgatitet. I tregova shkurtimisht për çka është fjala, pa hyrë tepër në detaje. Nuk doja ta dëshproj. Më shikoi me sytë e tij inteligjentë dhe më tha: Kam përshtypjen se prej vrasjes së shokëve ti je disi si në nokdaun. Po, është e vërtetë, i thashë. Por duhet të mbahemi, të luftojmë e të mos dorëzohemi. Shi, më tha, ne duhet të mësohemi me këto gjëra. Te kroatët, ta zëmë, ka përçarje shumë më të mëdha dhe dihet kush i shkakton ato. Por përpjekjet e tyre nuk po ndalen. Ashtu duhet të veprojmë edhe ne. Është e vërtetë kjo, iu përgjigja, por lufta brenda llojit është më e tmerrshmja nga të gjitha dhe dëmet e saj janë të pariparueshme. Mbeti që ai të dërgoje dikë te

familja e Enver Topallit për të marrë ndonjë informatë për rrethanat e arrestimit. Sepse në valën e arrestimeve të fundit që quan te vrasje e Rexhepit dhe Nuhiut, janë bërë dekonspirime dhe lajthitje të tilla si asnjëherë më parë. Thjesht një rrëmet i tmerrshëm është përplasur mbi ne. Janë këputur lidhjet dhe nuk po arrijmë ta kemi një pasqyrë të qartë për gjendjen.

14 shkurt 1985, sot kanë ardhur te ne Hyzriu, Baci dhe Malushi. Po bisedojmë për tërmetin tjetër në Lëvizje. Ishin ato përçarjet e fundvitit 1984 që më bënë të largohem nga Lëvizja. Prandaj u ndjeva shumë keq kur i pashë. Hyzriu ishte në dijeni për shumë çka dhe sipas analizës së tij kjo është një tollovi e madhe që ka për qëllim që qëndresa jonë të dobësohet përmes grindjesh banale në thelb të të cilave janë gishtërinjtë e UDB-së, ambicjet dhe budallakitë e njerëzve tanë.

Selmani, një ndër aktivistët e parë në Gjenevë, e pyeti: a bën me më tregu Hyzri ku po e gjen ti gjithë këtë gjakftohtësi, bre shoq? Ndërsa Hyzriu me atë buzëqeshjen e tij ia ktheu: Pikërisht në momente si këto, njeriu duhet të jetë me këmbë në tokë. 15.5.86, më thirri Hyzriu dhe më tregoi se paskan zgjedhur Këshillin Drejtues të Bashkësisë së klubeve. Aty qenkan disa aktivistë të spikatur të Lëvizjes: Faredin Tafallari, Sylë Thaçi, Qamili dhe Hyzriu. E përgëzova. Paskeni zgjedhur një ekip shumë të mirë. Gjatë gjithë këtyre viteve, Hyzriu ka dërguar letra gjithandej dhe është përpjekur singerisht që Lëvizja jonë Kombëtare të jetë unike, efikase dhe gjithë energjia e saj të koncentrohet në përballje me Serbine. Jo gjithnjë bëhej ashtu siç ai kishte dëshirë. Por përpjekjet e tij fisnike nuk u ndalën asnjëherë.

Njera prej këtyre përpjekjeve ishte edhe debati që Hyzri Rekaj e organizoi në Dysseldorf në dhjetor të vitit 1996, kur lufta po trokiste edhe në dyert e Kosovës. Në debat ishte Profesor Qosja, Petrit Duraku, Ibrahim Kelmendi, Islam Spahiu dhe unë. Ishte një debat interesant me pikëpamjet dhe këndvështrimet më të ndryshme. Me këtë rast Hyzriu lexoj një kumtesë, përmes së cilës vërtetohet dhe njëherë se ai ishte ndër kuadrot më të përgatitur të Lëvizjes tonë Kombëtare në mërgim.

Hyzri Rekaj, analizën e tij të thukët e përfundoi më një thirrje e paralajmërim serioz: Të nderuar bashkatdhetarë, zonja e zotrinj, duke dashur t'i mbetemi konsekuent qëllimit të organizimit të kësaj tribune dhe duke mos pretenduar që t'i ndajmë leksione askujt, mendojmë se është momenti i fundit që i gjithë truri kombëtar të ulet pranë një tryeze të përbashkët dhe të hartojë një platformë të qartë me detyra konkrete afatshkurtëra dhe afatgjata, ku pos tjerash vend të merituar do të zërë organizimi i mërgatës dhe detyrat konkrete të saj në dhënien e ndihmës për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Jemi të sigurt se vet akti i tillë do të ishte faktori qenësor i mobilizimit të gjithëmbarshëm kombëtar dhe do të mundësonte tejkalimin e gjendjes ekzistuese si në Atdhe ashtu edhe në mërgatë.

Hyzri Rekaj kontriboj shumë në rrugëtimin tonë kombëtar por fatkeqësisht vdekja e hershme ia pamundësoj shijimin e lirisë së shumëpritur.

Lavdi jetës dhe veprës së atdhetarit Hyzri Rekaj !

Malush Ademaj

Prej emrave që hyjnë në grupin e idealistëve të vendosur që ishin në ballë të organizimit të masave shqiptare në Dysseldorf në kuadër të Klubit të punëtorëve shqiptar "Emin Duraku", më vonë Qendra Kulturore Informative Shqiptare "Emin Duraku", është atdhetari Malush Ademaj.

I rritur dhe edukuar në një familje dhe mjedis atdhetar, në Pejën e Haxhi Zekës, Malushi për shkak të presioneve dhe shtypjes sistematike nga sunduesi, u detyrua të marrë rrugën e mërgimit.

Në mungesë të prononcimit të tij personal për të përshkruar rolin dhe kontributin e Hyzri Rekaj, ne bashkautorët vendosëm që të shkruajmë disa fjalë që i kemi dëgjuar por edhe si kujtime nga aktivitetet e tij së bashku me Hyzriun pasi që gjithë puna në shërbim të atdheut ishte e përbashkët.

Malushi kishte respekt të veçant për Hyzriut, ai e quante shokë të luftës, sepse në fakt jeta e tyre ishte një luftë me shumë beteja që për fatin tonë historik fal luftës së UÇK-së dhe ndihmës së ShBA me aleancën e Natos, këtë luftë e fituam.

Nuk kishte aktivitet që zhvillohej në Dysseldorf e të mos ishte pjesë dhe ndihmës Malush Ademaj.

Për shkak të veprimtarisë atdhetare Malushi u burgos dy herë nga pushtuesi serb, ky është edhe treguesi faktik i punës së madhe që bënte mërgata jonë në Dysseldorf të prirë nga Hyzri Rekaj me shokë!

Raportet e Malushit dhe Hyzriut ishin shndërruar edhe në miqësi personale, duhet theksuar se reciprokisht ndihmuan njëri tjetrin me pasaporta për bashkimin e familjarëve në mërgatë.
Malushi në një mandat 1984/85 kishte fituar besimin e veprimtarëve në Dysseldorf dhe bëhet kryetar i Klubit shqiptar "Emin Duraku ", pra ai nuk ishte pjesë por ishte me grupin e shokëve në ballë të organizimit.
Si karakter Malushi ishte shumë i ashpër ndaj armiqëve, ishte shumë i drejtpërdrejt, ishte i sinqert dhe besnik.
Dalja në skenë e UÇK-ës kishte qenë gëzimi por edhe bindja e tij se ishim në rrugë të drejt për të fituar njëherë e mirë ndaj pushtuesit serb dhe për të kontribuar në këtë moment historik djali i Malushit bëhet pjesë e saj.
Çlirimi i Kosovës ishte realizim i pjesshëm i qëllimit të Malushit sepse për të quhej e plotë vetëm kur të bashkohen trojet shqiptare në një shtet të përbashkët.
Vdekja e parakohëshme e shokut të idealit Hyzri Rekaj e kishte mërzitur shumë Malushin, nuk mund të pajtohej aspak me faktin që Hyzriu nuk është më në mesin tonë. Si duket edhe jetën në këtë botë e kishin të pamundur ndaras sepse pas pak viteve pas një sëmundje të rënd pushon së rrahuri edhe zemra e atdhetarit dhe patriotit të papërkulur Malush Ademaj, ai na la për të bashkuar shpirtin e tij me shpirtin e Hyzriut në amshim.
Lavdi jetës dhe veprës atdhtare të Malush Ademajt !

Shabi Nuhaj

Hyzri Rekaj njeri i qëndresës



Shabi Nuhaj i lindur më 18.3.1950, Jezerc.
Në Gjermani kam ardhur më 20 maj 1970 në Dysseldorf.
U ndava nga familja si çdo mërgimtar, në atë kohë e cila ishte mjaftë e idhët edhe për mua si dhe për familjen time, që kurr nuk do ta harroj, atë nostalgji të papërshkruar, kur për herë të parë u ndava edhe nga vendlindja ime e dashur, që për neve shqiptarët nuk kishte punë të mjaftueshme.
U ndava me një padrejtësi të madhe nga ai shtet që pretendonte se dominon vëllazërim bashkimi, e drejta për të u punësuar për të gjithë, por ja se ishte e kundërta. Për ne shqiptarët ishte përjashtuese dhe e padrejtë për t'i gëzuar të gjitha të drejtat që u pretendonin në atë kohë.
Për Hyzriun kam shumë kujtime por ka kaluar një kohë bukur e gjatë e ndoshta nuk më kujtohen të gjitha, Hyzriun për herë të parë e kam njohur, diku në vitin 1981 afër stacionit hekurudhor në Dysseldorf. Me insistimin e Hyzriut shkuam në banesën e tij, si bashkëfshatar që ishim pothuajse të një fshati, ku biseduam për shumë çështje të mërgimtarëve, dhe problemet të cilat na rrethonin në atë kohë.
Hyzriun edhe gjatë asaj bisede edhe më vonë në aktivitete të ndryshme e kam parë gjithmone, si një njeri të fortë në karakter,

i përqendruar në punët serioze për të ndihmuar çështjen kombëtare.

Viti 1981 ishte viti ku shpërthyen demostratat e studentëve për të drejta të barabarta me kombet tjera të Jugosllavisë. Të drejta të cilat na e kishin mohuar sistemi Federal i asaj kohe. Më kujtohet kur në Dysseldorf klubi ynë "Emin Duraku" i punëtorëve shqiptar nga Jugosllavia ashtu quhej në ato vite, filloj të organizon demostrata në përkrahje të studentëve të Kosovës.

Hyzriu në atë kohë ishte edhe kryetar i klubit kishte një peshë të madhe mbi supe, sepse Konzullata e Jugosllavisë pengonte po thuajse çdo gjë, që mos të dëgjohet zëri i së vërtetës, dhe mos të përkrahen studentët e Kosovës. Mirëpo vendosmëria e Kryesisë se klubit dhe vullneti i bashkatdhetarëve u vendos që të bëhet një demostrat jashtëzakonisht e madhe në Dysseldorf me të gjitha parullat e pankartat, që mbizotëronte parulla kryesore “Kosova Republikë”.

Kjo demostrat ishte pothuajse një ndër demostratat e para në mërgatë në përkrahje të studentëve nga Kosova, ishte shumë mirë e organizuar kishte kujdestarë të demostratave, si dhe ishim në përcjellje të policisë gjermane. Më kujtohet që për këtë demostrat patën shkruar edhe gazetat gjermane në ballinë të parë.

Klubi udhëhiqej me një vullnet të madh të mërgimtarëve pa dallim feje apo rajoni, që përfshiheshin nga të gjitha pjesët ku banonin shqiptarët, nga Maqedonia, Mali i Zi, Medvegja, Presheva, Bujanovci e vende të tjera për të i dhënë fuqi sa më të madhe çështjes sonë kombëtare.

Klubi kishte edhe resurset e veta: arsim, futboll, shah, dramë, recital, e shumë aktivitete tjera që ishte një shembull i veçantë për t'u marrë si mostër për të tjerët. Kemi pas shumë aktivistë e vullnetarë në atë kohë por po i përmendi disa shokë që kemi qenë pothuajse së bashku. Hyzriu, Mërseli, Neziri, Hagjiu, Ismajli, Brahimi, Rrahmani, Nebihi (u burgos më 1980), Samedini, Malushi, Ilazi, Zyberi, Avdiu, Syla e shumë të tjerë që nuk i përmenda me çka kërkoj ndjesë, por Hyzriu ishte më i shkolluari nga ne dhe ishim krenarë që na udhëhiqte e na këshillonte neve, mirëpo ai e kishte një diskutim paraprak me kryesi të klubit e besa edhe me ne, kurr nuk ka pas raste të marrë vendime të njëanshme, për çdo veprim që organizohej në atë kohë, për klubin dhe rreth klubit.

Në çdo përvjetor të demostratave klubi ynë ishte gjithnjë i përgaditur me të gjitha aspektet dhe vepronte si një qerdhe e shqiptarëve këtu në Dysseldorf.

Më vonë më kujtohet demostrata në Strazburg, ku Hyzriun e kam parë si organizatorë të mirëfilltë ku printe në demostrata, me një qëndrim stoik i vendosur, ku edhe masa e gjerë që ishte jashtëzakonishtë masive në përkrahje të vendimeve që ishin nxjerrë nga klubi për të demostruar në mënyrë dinjitoze.

Unë në të vërtetë nuk kam mundur të jem gjithnjë në klubë dhe rreth klubit sepse punën e kam pas edhe larg por edhe ndërrimet nuk më janë përshtatë për bashkangjitjen me shokët. Por kur kam pasur kohë të përshtatshme kam qenë aty me plotë vullnet.

Më kujtohet në një takim me Hyzriun me tha a po më bënë shoqëri deri në Berlin, pa prit pa kujtuar pranova të shkoj, bashkë me Hyzriun dhe Mustafë Kelmendin i cili na dërgoj deri atje me veturë të veten.

Tash s'po më kujtohet a ishte klubi edhe në Berlin apo kishte direktiva që të hapet edhe atje klubi i shqiptarëve, por edhe aty e kam pa Hyzriun që gëzonte një respekt të madh në atë shoqëri ku ishim nga bashkatdhetarët.

Me një fjalë kishte qëndrime të sakta, me vizion të qartë atdhedashurie, dhe në përfundim të atij takimi në Berlin u ndamë shumë të kënaqur edhe ne e edhe ata.

Edhe në kohën kur kërkohej ndihmë për arsimin pas segrekacionit të shkollave dhe suprimimit të kushtetutës klubi ynë ishte një ndër të parët me mjete materiale dhe gjëra të tjera që nevojiteshin në atë kohë në Kosove. Bile nëse nuk gaboj klubi ynë printe për solidaritet të jashtëzakonshëm, kur u hap edhe Univerziteti i Tetovës, përveç përkrahjes morale patëm mbledhë edhe mjete materiale për të ndihmuar atë qerdhe të dijes në pjesën tjetër të kombit tonë.

Më kujtohet një bisedë me Hyzriun, në kohën e pluralizmit politik në Kosovë e që u interpretua edhe tek ne ku thoshte se tash e kemi më mire situatën sepse janë krijuar Institucionet e Kosovës ku e kemi edhe Qeverinë të dalë nga Kuvendi ku u formua edhe 3% e që ishim të rregullt në pagesë.

Hyzriu ishte nje bashkatdhetar që i kushtohej çështjes kombëtare me plotë dinjitet për një Kosovë të devotshme, ku kishte një vizion të qartë për aktivitete që ndërmerrte.

Me treguar të vërtetën shpesh ne shokët e tjerë nganjëherë fërkoheshim mos të them hidhëroheshim për disa çështje, gjithnjë për Kosovën, mirëpo tek Hyzriu, kurr nuk kam mund të vërej që ndonjëherë është hidhëruar me ndokend, gjithmonë ka qenë i buzëqeshur i ëmbël nga goja, dhe gjithmonë ka qenë

person unifikues në shoqëri. Këto tipare të Hyzriut janë shumë të ralla në historinë tonë, të mërgatës e më gjerë.
Nuk di ç'të them, Hyzriu më duket se ishte i lindur si patriot i devotshëm.
Ndoshta nuk do të bëhem lokalist, por jam i edukuar në mënyrën e sinqertë, isha edhe krenarë për Hyzriun sepse ishte pothuajse nga i njejti fshat.
Hyzriu dinte t'i afronte shokët dhe miqët me atë ngrohtësinë e vetë të përhershme të dashur e patriotike që të bënte për vehte. Kjo ishte veçantia e tij, gjatë aktiviteteve në klub e më gjerë në mërgatë.
Edhe në pragë të luftës së UÇK-së, Hyzriu ishte si gjithmon i përgaditur për të vepruar ashtu siç duhej në momente të caktuara me peshë për ta drejtuar mërgatën sa më mirë që është e mundur.
Për Drenicën heroike më kujtohet kur klubi ynë u solidarizua me plotë dinjitet, për ndihmat materiale, shtretër për spitale e shumë përpjekje të panumërta për të sensibilizuar luftën tonë për liri.
Me sa di unë edhe nga klubi, apo më mirë të themi nga anëtarët e klubit kishte mërgimtarë që morën pjesë direkte në luftën çlirimtare për lirinë e Kosovës.
Normalisht ajo kohë ishte kohë e vështirë për popullin tonë të shumëvuajtur, mirëpo prap se prap përpjekjet e luftës sonë për liri ishin vendimtare, ku edhe me ndihmën e SHBA-ve dhe aleatëve perëndimorë në Qershor të vitit 1999 Kosova u çlirua definitivisht.
Forcat ushtarake-paramilitare serbe kapitulluan, dhe u larguan nga Kosova.

Për mua Hyzriu ka qenë dhe do të mbetet një njeri i veçantë, që veproi i patundur, ishte konsekuent në qëndrimet e tij. Më brengos fakti se Hyzriu për më shumë se 20 vite nuk e shkeli Kosovën, sepse e kishte të ndaluar nga regjimi i atëhershëm, mirëpo shpesh gjatë bisedave me të, kurr nuk ke mundur të vëresh tek ai se është i mërzitur, gjithmon e ka potencuar se mua në të vërtetë më mungon familja, mirëpo familje ju kam juve dhe bashkë me ju do t'a arrijmë qëllimin e luftës sonë për liri.

Kam shumë kujtime të paharruara për Hyzriun, që më kanë lënë mbresa të mëdha, por unë i ceka vetëm disa më kryesoret të cilat nuk mund t'i harroj.

Ai i etur dhe i përkushtuar për lirinë e Kosovës, pas çlirimit dhe pas 20 viteve, definitivisht e lëshoi gjermaninë dhe u kthye në vendlindjen e tij, që aq shumë e deshti dhe kontribuoj për të.

Unë mendoj, se nga të gjithë bashkatdhetarët që ishim dhe vepruam, deri sa u çlirua Kosova, Hyzriu për mua ka qenë dhe do të mbetet, një nga atdhetarët më të dalluar të çështjes kombëtare.

Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekaj.

Mufail Demiri

I lindur me 3.9.1962 Gadime, Lipjan.
Kam përfunduar shkollën e mesme në Lipjan, pas përfundimit të shkollës së mesme kam regjistruar letërsi dhe gjuhë në Universitetin e Prishtinës.
Rrehtanat e krijuara në atë kohë dhe gjendjes se rëndë ekonomike u deturova që për një kohë t'i ndërpres studimet dhe të marr rrugën për Gjermani, në vitin 1984 që të punoj për një sezonë të shkurtë tek migja im Nazmiu i cili ishte në kontakt të ngushtë pranë klubit "Emin Duraku", aty kam qëndruar prej prillit deri në gusht të të njëjtit vit.
Aty ishte kontakti i parë me Hyzri Rekën i cili me në afërsi njerëzore më bëri për vete dhe u mishërova me ide të themi patriotike kulturore idealiste, i gjithë ky frymëzim më bëri edhe më të fortë, sepse aty në klub kishte aktivitete të llojllojshme që zhvilloheshin gjatë fundjavës. Përveç Hyzriut që ishte ndër aktivistët më të dalluar kishte edhe akivistë tjerë që kishin vullnet të jashtëzakonshëm, vlenë të përmend Avdi Begisholli, Ramadan Ramadani, Nazmi Nuha, Qamil Rexhepi, Haxhi Bega, Sylë Nuha, Ibrahim Kelmendi e shumë të tjerë dhe punët në klub i bënin në mënyrë vullnetare.
Në vitin 1985 kam shkuar në Zvicer mirëpo kontaktet i kam mbajtur me Hyzriun dhe të tjerët.
Në vitin 1989 kam shkuar në Dysseldorf si mërgimtarë i përhershëm.

Aty prapë jam takuar me Hyzriun ku idealet e tij ishin ngritur dhe ishin shumë të qëndrueshme si organozator i mirëfillt që rrezatonte dhe shfaqte pozitivitet në mërgatën mbarë shqiptare. Më kujtohen rastet e 28 Nëntorit që klubi organizonte festën e flamurit, ku recitohej për heronjtë tonë kombëtarë, organizoheshin edhe drama të ndryshme kushtuar historisë tonë të lavdishme.

Dy gjëra të mëdha më kanë bërë përshtypje: pllakata e vendosur në ballë të klubit, biblioteka e vendosur në klub ku kishte libra edhe nga Kosova, por edhe nga Shqipëria, me tregu të drejtën lexoja me ëndje librat të cilat në Kosovë ishin të ndaluara që për mua si student i letërsisë dhe gjuhës, më inspiruan aq shumë sa që për mua ishte një universitet i dytë, plus më inspironin edhe shoqëria e bashkatëdhetarët që vepronin për klubin dhe rreth klubit.

Në kohën e pluralizmit politik Hyzriun e kam parë aktiv por te ai nuk ke mund të vëresh njëanëshmëri partiake, për të ka qenë prioritet vetë kauza kombëtare.

Ai kishte influencë jashtëzakonisht të madhe për unifikimin e mërgatës shqipëtare, por edhe te instuticioneve më të larta shtetërore të asaj kohe.

E gjithë kjo veprimtari që zhvillohej në atë kohë nuk mundesha të qëndroja anash e të mos veproj, u inkuadrova me seriozitetin më të madh dhe u bëra një shtyllë e fortë e këtij aktivitei të bashkatëdhetarëve.

Në fillim punoja punë fizike dhe më vonë pata fatin të hapi një agjension turistik “Dituria”. E kisha më lehtë të kontribuoj në fundjavë për obligimet dhe aktivitetin e klubit. Më kujtohen disa aktivitete të cilat kanë pas peshë të madhe dhe ndihmat të cilat i

kemi organizuar së bashku, për universitetin e Prishtinës, Universitetin e Tetovës, për KMDLNJ në Prishtinë dhe shumë ndihma të tjera për Kosovë, kemi qenë së bashku në komision të 3% ku me Hyzriun kemi dhënë kontribut të jashtëzakonshëm.
Ndonjëherë kishim edhe mendime të kundërta dhe nuk pajtoheshim me qëndrime por veçantia e Hyzriut dhe mendimi pozitiv prapë në fund pajtoheshim në qëndrimet madhore.
Fillimi i luftës në Kosovë dhe dalja në skenë e UÇK-së ishte një hap i avancimit për ta larguar armikun shekullor nga Kosova.
Në çdo kohe Hyzriu ishte i përgaditur, ku si një lider largpamës deri në çlirimin e Kosovës ka qenë figurë unifikuese ku në klub nuk ka lejuar që të këtë ngjyrime partiake dhe politike, këtu ishte forca e tij kryesore dhe lirisht mund të them se Dysseldorfi me rrethinë ishte një digë e pathyeshme për të quar luftën e popullit tonë deri në lirinë përfundimtare.
Mërgata e Dysseldorfit aq shumë ishte e organizuar në ndihma marramendëse sa që e gjithë mërgata amerikane nuk ka dhënë ndihma më shumë se vetëm Dysseldorfi me rrethinë.
Shpesh herë kemi pas edhe vështirësi financiare mirëpo falë aktivistëve të dalluar që ishin në atë kohë ne ia dilnim si kryesi ti kalonim këto vështirësi financiare.
Sa i përket 3% dhe vendlindja thërret kam qenë i rregullt në përmbushjen e obligimeve që më kanë takuar mua si aktivist.
Shumë me keqardhje e kam përjetuar vdekjen e tij të hershme dhe lirisht mund të them se ai e ka merituar të shijoj lirinë për të cilën aq shumë dha kontribut në çështjen kombëtare.
Ai për mua ishte njeri i sakrificës, ku për mua mbetet figura më e çmueshme në atdhe dashurinë që kishte.

Mendoj se Hyzriu ishte dhe do të mbetet një atëdhetar i devotshëm i Kosovës për liri.
I lehtë i qoftë dheu i Kosovës.

Mursel Nuha

Në kujtim të veprës atdshetare të Hyzri Rekaj

Mursel Nuha i lindur me 11.11.1939 fshati Jezercë.
Në Gjermani kam ardhur më 27 maj të vitit 1970.
Si çdo shqipëtarë në atë kohë në pamundësi për t'u inkuadruar në punë në vendlindje morëm rrugën e kurbetit të cilën nuk e adhuronim me dëshirën tonë, mirëpo rrethanat e krijuara në Kosovë për ne shqiptarët na u cungua e drejta e punësimit. Si rrjedhojë e kësaj situate të krijuar në vitet 70-ta u detyrova të lëshoj vendlindjen e të vijë në Dysseldorf të Gjermanisë, me synimin që t'i ndihmoj familjes dhe vendit tim.
Unë Hyzriun e kam njohtë në qershor të vitit 1978 në banesë të Nebih Rekës. Prezent në banesë ishin: Nazmi Nuha e Haxhi Bega, Syl Nuha. Në bazë të vlerësimit tim, Hyzriu ishte një djalë i ri në atë kohë, i cili edhe ai si ne kishte ardhë për punësim në Gjermani mirëpo, ai punonte Teknik i dhëmbëve në qytetin e Neuss-it.
Që në fillim të takimit me të, atë mbrëmje, mu krijua bindja tek ai, se ishte një djalë i urtë jo fjalëshumë ku përcillte bisedën të cilën ne zhvillonim për hallet tona të përditshme, njëkohësisht flisnim çdo fundjavë rreth vendlindjes.
Pas formimit të Klubit shqipëtar "Emin Duraku" nga Jugosllavia, i formuar në mars 1978, në bazë të aktiviteteve dhe

punës së tij të palodhur, krijova bindje të thellë për Hyzriun se ishte një mërgimtar i devotshëm sa i përket aktiviteteve për klubin dhe rreth klubit.
Për fat të mirë Hyzriu ishte edhe më i shkolluari në mesin tonë me çka më bëri të ndihem krenar e të shtoj besimin e madh ndaj tij.
Edhe pse patëm shumë vështirësi të mëdha gjatë formimit të klubit sepse Konzullata Jugosllave nuk dëshironte që klubi të emërohej Klubi i shqiptarëve, por të jetë Klub Jugosllave. Këtu pati vështirësi të mëdha, dhe inkriminim edhe të disa mërgimtarëve tanë. Mirëpo vendosmëria, besimi ndaj njëri tjetrit, dashuria për të krijuar një Qerdhe të aktiviteteve kulturore, artistike sikur rruga e vështirësive e përpjekjeve për të arritë qëllimin e përbashkët u kurorëzua me sukses.
Të gjithë ishim një dhe një ishte për të gjithë më duket se kjo na ka bërë edhe më të fortë, sepse të vërsulet Konzullata e një shteti siç ishte Jugosllavia në atë kohë ishte një punë jo e lehtë.
Më kujtohet Aktiviteti i Hyzriut kuptohet me gjithë shokët e asaj kohe çdo vendim që mirrej në Klub diskutohej, gjerë e gjatë pastaj mirrej vendimi kjo ishte bërë një praktikë e klubit.
Pas Rrahman Begës si kryetar i parë i Klubit tonë për një kohë të shkurtër e udhëheqi Hamdi Tuba. Rrethanat e krijuara në atë kohë sollën në ndërrimin e kryetarit. Kyetar i radhës u zgjodh Nebih Rekaj i cili e mbajti mandatin deri ne korrik të vitit 1980, kur edhe e burgosën në vendlindje Ferizaj. Klubi ynë brenda këtyre viteve pësoj një luftë të pakompromis nga organet e Jugosllavisë që tehun e kishin të drejtuar kundër kësaj Qerdhe që ne veç e krijuam edhe me gjak, e burgosje, mirëpo vendos-

mëria e qëndresa jonë e bashkuar arriti të jetësoj qëllimet tona të palëkundura.

Pas korrikut të vitit 1980 që deri atëherë Klubi veç numëronte mbi 300 anëtarë, anëtarë të cilët nuk ishin veç nga Dysseldorfi por kishte edhe të rretheve tjera të Gjermanisë, si dhe të rretheve tjera edhe nga viset shqiptare të Jugosllavisë. Gjatë këtij viti më kujtohet Hyzriu bashkë me shokët që vepronim në atë kohë ishte shumë më shumë i vendosur për të zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore. Gjatë këtyre viteve zhvilluam shumë aktivitete të ndryshme e sidomos festat e 28 nëntorit ku Klubi përgadiste recitime të ndryshme, referate kushtuar heronjëve Kombëtar, pra ishin të formuar resurse adekuate për mërgimtarët tanë të cilët me vullnetin më të madh prisnim që të vie fund java.

Kishte shumë aktivist vullnet mirë në radhët e mërgimtarëve pothuaj në gjithë qytetet e trevat shqiptare të Jugosllavisë, si Samedin Ilazi, Malush Ademaj, Ibrahim Kelmendi, Avdi Kashtanjeva për mos me i cek të gjithë me emra me çka në këtë rast bëhet fjalë për kujtimet për Hyzriun unë kërkoj ndjesë, veç një e di se kishte mërgimtarë nga Kërqova, Tetova, Gostivari, Presheva, nga Mali i Zi. Klubi ynë shqiptar mërgimtarët që vepronin në Dysseldorf me rrethinë i futi në një qerdhe shqiptare ku zhvilloheshin shumë aktivitete kulturore sportive teatrale recitale e tjera.

Klubi në atë kohë ishte në Graf Adolf strasse në Dysseldorf.

Shpërthimi i demostratave në mars 1981, Hyzriun e kam pa si një njeri intelegjent e largëpamës, një vizionar i vendosur si kurr më parë. Në një takim më të më kujtohet kur na tha të gjithëve të pranishëm: Atje në Kosove po derdhet gjaku ynë, gjaku i

Studentëve, por ju kisha preferuar se nga sot vëllezër të dashur mërgimtar të nderuar, lufta e popullit tonë për liri do të zgjat me vite. Të gjitha demostratat në përkrahje të studentëve që zhvilloheshin në Kosovë, Kryesia e Klubit tonë ishte promotore e Republikës NW në Gjermani. Pas një kohe u mor qëndrim unanim që në ballë të klubit të qëdrone parulla Kosova Republikë e cila qëndroj deri në çlirim, e luftës heroike të UÇKsë, dhe Aleatëve tanë.

Më kujtohet demostrata e parë në Bern të Zvicres kur klubi ynë përgaditi parullat pothuajse më kuptimplota edhe pse të gjithë kishin të njejtin qëllim. Pastaj më kujtohet demostrata e Shtutgardit ku prap klubi ynë ishte i organizuar e i përgaditur në nivelin më të mirë e më kuptimplotë. Demostrata e Dysseldorfit ishte një demostrat masive e të gjitha rretheve të ndryshme të Gjermanisë ku u protestua me dinjitetin më të madh.

Hyzriun nga këndi im gjithmonë e kam pa të përgaditur për çështjen kombëtare, me tregu të drejtën, bëhesha krenar edhe për një gjë, sepse Hyzriu ishte i anës së Ferizajt, prandaj e ndijsha vehten shumë më të fortë. Si në tubime të mëdha që i printe masës, si ato të vogla apo në kryesi te klubit ishte shumë i matur i afërt me njerëz e i buzëqeshur me të gjithë.

Shpesh më ka ndodhe kur kishte edhe kundërshtime të llojllojshme, mirëpo prap se prap njeriun e bënte për vehte.

Kjo ishte arma më e fortë e tij, ishte njeri i lindur patriot i dalluar në shoqëri e i respektuar për të gjithë.

Në pluralizmin politik Hyzriu edhe pse ishte në radhët e LDK-së që zhvillonte aktivitete në tërë gjermaninë, ai ruajti, dinjitetin e klubit tonë dhe lirishtë mund të themi se ishte personi më unifikues në NWS.

Ai shpesh na thoshte në klubin tonë nëpër tubime se ne duhet të i respektojme institucionet tona të dalur nga populli, pra Hyzriu në çdo situatë në kohë ka vepruar me një mençuri të pazavendë-sueshme, dhe i fortë në idealin e tij, me çka mund të them lirisht se edhe në kohën më vendimtare të luftës tonë çlirimtare Hyzriun prape e kam pa si një Atdhetar të pjekur kombëtarisht, i cili dinte të ruante masën e ta orientonte aty ku e kërkonte Atdheu.

Me kujtohet një rast të cilin nuk mund ta harroj kurr në banesën e Samedin Ilazit, Hyzriu me Ibrahimin e shokë të tjerë Shtypej Trakti Bashkimi. E që përgaditej të shpërdahej nëpër rrethe të ndryshme të Europës.

Lirisht mund të them se kemi pas fat që kemi pas një udhëheqës si Hyzriu, kuptohet edhe shokët e tij të cilët aq mirë i koordinonin punët, sa që kurr mirrej ndonjë vendim ishte mendim i qëlluar e kuptimplotë. Hyzriu shpesh e pontenconte gjatë viteve të 80 në klub në tubime të ndryshme se ne jemi me fat që i kemi në ballë njerëz më të përgaditur kombëtarisht Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën e Bardhosh Gërvallën.

Mirëpo atentati ndaj tyre nga UDB-ja ishte një goditje e rëndë ndaj mërgatës tonë.

I gjithë populli shqiptar ato ditë ra në zi kombëtare. Mirëpo amaneti i tyre të cilët lanë pas vehtes na bëri edhe më të fortë, prandaj që nga viti 1982 e gjithë mërgata anë e kënd botës filloj në organizime edhe më të qëndrueshme për të arritë amanetin e tyre në kauzën kombëtare.

Largëpamësia e tyre, shkrimet e tyre nëpër gazetat e kohës na forcuan edhe më shumë, me çka mund të them se ata zënë një

vend të veçantë në historinë tonë kombëtare. Hyzriu shpesh përdorte fjalët e tyre që lanë si amanet për fitore përfundimtare.
Hyzriu gjithmonë e potenconte edhe një gjë që mua më dhimbsej, sepse ai plot 20 vite nuk e pa vendlindjen, dhe ishte një mërgimtar i rrallë të cilit iu ndalua nga Shteti Jugosllav të kthehet në vendlindje. Prandaj për mua ishte një burg prej dy dekadash.
Mirëpo gjithnjë kur mblidheshim në klub apo nëpër banesa të shokëve thoshte: unë familje ju kam juve.
Me përfundimin e luftës në Kosovë, ëndrra e tij u realizua, ai diti të veproj edhe në liri. Në vitin 2005 u përshëndet me shokët e anëtarët e klubit dhe bashkë me bashkëshorten Zhaklinën e vajzën Ilirianën u kthyen në Kosovë për ta shijuar atë liri të cilën aq shumë kontribuoj për të.
Në shtator 2017 nga një sëmundje tinëzare, e mora lajmin se Hyzriu kishte ndërruar jetë edhe pse 12 vite i kishte shijuar lirinë dhe kishte punuar teknik i dhëmbëve edhe në Kosovë. Ky lajm më tronditi pa masë dhe ishte një humbje e madhe për mërgimtarët në Gjermani e Ferizaj, lirisht mund të them humbje edhe për Kosovën.
Kisha pas dëshirë të kujtoj vëllain tim Xhemajl Nuha i cili edhe ai punonte e vepronte bashkë me ne në Dysseldorf.
Ai me gjithë aktivitetin që bënte rreth klubit kishte një pasion për odën të cilën e improvizuan në klub. Ishte njeri i fjalës dhe bashkë me bacën Zyber e bacën Avdi kuvendonte në çdo fundjavë, e që ishte bërë si traditë e kulturës sonë.
Kishte një përkrahje të madhe për Hyzriun, shpesh thoshte Hyzriu me shokët e vetë janë udhëheqësit tanë më të mirë dhe me largëpamësi të aktiviteteve në klube dhe jashtë klubit.

Vlenë të theksohet, ishte i rregullt në aktivitete e demostrata, bile në rastet e shpeshta i printe demostratave me parulla që mbante në dorë.
Viti 1998 diku në prill forcat paramilitare serbe e kidnapuan në shtëpinë e vet, dhe sot e asaj dite nuk u gjet kufoma e tij.
Është për të ardhur keq se i ndjeri nuk arriti të gëzoj lirinë sikurse të gjithë të tjerët. Për çdo vendim që merrte për diçka më kujtohet i afrohej Hyzriut dhe konsulltohej me të. Hyzriun shumë e respektonte.
Në ditën kur morëm kujtimet për Hyzriun, Xhyzide Nuha gruaja e Murselit dëshiroj të rrëfej disa kujtime për Hyzriun.
Edhe unë si grua shumë mirë mbaj në mend këto kujtime që i tha Murseli. Përveq punëve që kishim rreth shtëpisë edhe unë isha e kyqur në këto aktivitete të klubit. Për mua klubi ishte edhe një bashkim i grave. Hyzriu gjithmonë na ka respektuar mua dhe të gjitha gratë të cilat në përvjetore të ndryshme ishim bashkë me burrat. Shpesh edhe gazetat gjermane shkruanin për ne gratë, që organizoheshim për 28 nëntorin ose 8 marsin. Më kujtohet një rast kur Hyzriu i tha bashkëshortit tim, o Mursel gruen e ke më patriote se vet.
Punët të cilat ishin rreth klubit e sidomos pastrimin e tij gjithmonë e kemi bë në mënyrë vullnetare, ne gratë në Dysseldorf me çka më kujtohet kur Hyzriu me gjithë shokët na përgëzonin e na jepte kurajo. Për mua Hyzriu ishte një njeri i kompletuar me karakter të fortë. Prandaj unë Mursel Nuha si bashkëveprimtar i tij, Hyzriun e vlerësoj:
Atdhetarë shumë të dalluar, me tipare të një "Heroizmi të veçant"!

Nuhi Bytyqi

Hyzri Rekaj – njeri i matur dhe veprimtar i jashtëzakonshëm

Më erdhi mirë kur dëgjova se po botohet monografia kushtuar veprimtarit dhe atdhetarit të shquar Hyzri Rekaj. Ndihem i respektuar që mu ofrua mundësia që edhe unë ti shkruaj disa fjalë për të dhe kontributin e tij të jashtëzakonshëm në mobilizimin e mërgatës sonë rreth çështjes kombëtare.



Kur si gazetar gjatë vitit 1995 qëndrova një periudhë në Dysseldorf, pata rastin dhe fatin që ti takoj dhe ti njoh për së afërmi edhe shumë veprimtarë të vyeshëm të klubit kulturor shqiptar "Emin Duraku". Në mesin e tyre ishte edhe Hyzri Rekaj. Në shikim të parë fitova përshtypjen e një njeriu shumë të qetë, përherë i buzëqeshur, i kulturuar, i matur dhe shumë i respektuar nga veprimtarët e Klubit dhe të gjithë bashkëkombësit tanë. Gjatë kontakteve që kisha me të në selinë e klubit, gjatë mbledhjeve të Kryesisë së klubit dhe aktiviteteve të tij për mbajtjen gjallë të organizimit të mërgatës sonë rreth Kosovës dhe çështjes shqiptare në përgjithësi, por edhe gjatë takimeve të shpeshta me të në banesën e familjes së tij nën prani të bashkëshortes Zhaklinës dhe vajzës Ilirianës bashkë me Nazmi Nuhën, Rifat Hamitin, Mufail Demirin, Agim Rashanin, Hamdi Gashin, Haxhi Begën, Sylë Nuhën, Sabri Shehun dhe veprimtarë

të tjerë, u binda se Hyzriu ishte ndër veprimtarët më të dalluar të mbarë komunitetit shqiptar në Dysseldorf e më gjerë.
Më kujtohet ku Hyzriu me krenari fliste për atdhetarët Adem Demaçi, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla dhe intelektualët e tjerë, me të cilët ishte takuar dhe bashkëpunuar për interesa madhore.
Hyzriu në vitin 1995 ishte në krye të Klubit Kulturor Shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf. Ndonëse unë kisha një vizë të përkohshme turistike, me qëllim të realizimit të disa emisioneve për Televizionin Shqiptar në Tiranë dhe të kthehesha në Kosovë, pra nuk kisha ndonjë plan që të qëndroja më gjatë në Gjermani, as të aplikoja për strehim politik, Hyzriu më ofroi bashkëpunim të sinqertë dhe më bëri pjesë e aktiviteteve të Klubit kulturor Shqiptar në Dysseldorf. Në muajin tetor të vitit 1995 Kryesia e Klubit mori vendim për shënimin e 10-vjetorit të punës së Shkollës Shqipe në Dysseldorf dhe Dormagen. Hyzriu më propozoi që edhe unë të jem në Këshillin organizativ për shënimin e këtij jubileu dhe me detyrë konkrete që bashkë me Rifat Hamitin, Agim Rashanin, Halil Hetemin, Dr. Sadik Shaqirin, Sadije Shaqirin dhe M & C Jusajn të përgatisim monografinë për 10 vjetorin e punës së Shkollës Shqipe në Dysseldorf e Dormagen. Hyzriu na inkurajonte, duke na ofruar materiale, dokumente dhe fotografi për këtë monografi. Dhe kështu, falë mbështetjes së Hyzriut dhe të bashkë-punëtorëve të tij, si dhe afaristëve shqiptarë në krye me Lazim Destanin, arritëm që monografinë ta përgatisim në mënyrë profesionale dhe ta botojmë brenda një afati shumë të shkurtër. Hyzriu na përgëzoi dhe falënderoi përzemërsisht për punën e realizuar me sukses.

Pas kthimit në Kosovë, Hyzriu më ka marrë në telefon dhe më ka angazhuar që të realizoj disa intervista me disa nga ish-veprimtarët e Klubit Kulturor Shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf, të cilët ishin kthyer dhe jetonin e punonin në Kosovë. Këto intervista ishin planifikuar që të përfshihen në Monografinë kushtuar veprimtarisë së Klubit Kulturor Shqiptar të Dysseldorfit. Unë fillova dhe i realizova intervistat dhe ia dërgova Hyzriut, por pas shpërthimit të luftës frontale midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave policore dhe ushtarake serbe unë isha i fokusuar për të raportuar dhe realizuar emisione televizive nga zonat e luftës për Televizionit Shqiptar në Tiranë dhe nuk kisha mundësi të mbaja kontakte të rregullta me Hyzriun dhe veprimtarët e tjerë të Klubit në Dysseldorf, nuk e di se a janë përfshirë ato në monografinë e paraparë.

Mund të them se Hyzri Rekaj ishte ndër veprimtarët dhe drejtuesit më të dalluar, të vendosur të mërgatës shqiptare në Gjermani, veçmas në kuadër të Klubit Kulturor Shqiptar, ku dha kontribut të jashtëzakonshëm në mobilizimin e mërgatës sonë rreth mbështetjes së luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sidomos në grumbullimin e mjeteve financiare përmes Fondit "Vendlindja thërret", mobilizimin e vullnetarëve nga Gjermania për të marrë pjesë në betejat përfundimtare të UÇK-së.

Ai iu gëzua shumë lirisë dhe shpalljes së shtetit të pavarur e sovran të Kosovës, duke dhënë kontribut të posaçëm në realizimin e kësaj aspirate shumë shekullore të popullit shqiptar të Kosovës. Kështu, ai në vitin 2005 u kthye për të jetuar dhe punuar në Kosovën e lirë, ne vendlindjen e tij, në Nerodime të Ferizajt dhe kontribuoi në rindërtimin e saj.

Mirëpo, vdekja e hershme e tij e ndërpreu nga realizimi i ëndrrave të tij të tjera të popullit shqiptar, veçmas për bashkimin kombëtar.

Hyzri Rekaj do të mbetet përherë një shembull i një atdhetari të devotshëm, i cili në vazhdimësi ishte në shërbim të çështjes sonë kombëtare. Familja e tij dhe të gjithë bashkëveprimtarët e shokët e tij duhet përherë ta kujtojnë dhe të jetë krenarë me veprën e tij me interes për shqiptarinë.

Në kujtim të veprës atdhetare të Hyzri Rekaj.

Nezir Nuha

Lindur me 15.05.1935 në fshatin Jezerc.

Në Gjermani kam ardhur më 20 maj 1970. Më kujtohet ajo ditë mirë kur u ndava nga familja, ishte një ditë e kobshme për mua, sepse u shkëputa edhe nga familja edhe nga vendi im i cili për rrethana jo korrekte ndaj popullit shqiptar bënte dallimin në punësime.

Pas punësimit në gjermani si çdo mërgimtar mblidheshim nëpër banesa me shokë e sidomos të rrethit tonë në fillim.

Me kujtohet shumë mirë kur jam takuar me Hyzriun në banesën time Ader str. në Dysseldorf ishim duke festuar 28 nëntorin 1977, pjesëmarrës ishin shumë shokë e sidomos të rrethit tonë, si gjithmonë festat kombëtare neve mërgimtarëve na bashkonin pothuajse në çdo përvjetor mirëpo kishte raste kur bashkoheshim çdo fundjavë.

Hyzriu atë natë shpesh e merrte fjalën dhe na shpjegonte neve të pranishmëve për rëndësinë historike të kësaj feste kombëtare për Pavarësinë e Shqipërisë dhe ngritjen e Flamurit Kombëtar.

Pas formimit të klubit shqiptar në Dysseldorf klub i cili mblodhi rreth vetes shumë anëtarë bile edhe të rretheve tjera, Hyzriu me shokët e tij ju përvishën punës që të mbajnë të gjallë frymën e

atdhedashurisë për mërgimtarët që gjendeshim dhe vepronim në këtë qytet.

Në klub u formuan resor të ndryshëm kulturore, artistike, sportive bile më kujtohet u mbante edhe kursi për të kryer shkollën fillore sepse shumë nga në ishim pa shkollë.

Më kujtohet edhe formimi i shoqërisë kulturo-artistike Aleksandër Moisiu që e udhëheqte Isak Guta ku organizoi shumë drama si Lidhja e Prizrenit e shumë aktivitete të llojllojshme që bëheshin në atë kohë për nder të festave kombëtare. Më kujtohet shumë mirë kur Hyzriu me Samedinin luanin në skenë.

Sa i përket demostratave të cilat ishin në përkrahje të studentëve dhe parullës "Kosovë Republikë" në klubin tonë si asnjëherë më parë ishim të përgatitur e të organizuar si në referate të cilat i bënte klubi në pankarta të ndryshme me një fjalë kishim udhëheqës të ngritur kombëtarisht që na prinin me dinjitetin më të madh. Më kujtohen të gjitha demostratat si në Zvicer, Gjermani e shumë vende tjera, Hyzriu ishte gjithmonë pothuajse në ballë të saj.

Ai kishte një durim të jashtëzakonshëm, ishte i palëkundur në vendimet që merrte, ishe një djalë pothuajse i lindur për të quar para kauzën tonë kombëtare. Më kujtohet kur thoshte shpesh në klub ne kemi fatin që i kemi shokët më të mirë të idealit, Jusufin e Kadriun, Bardhin të cilët aq shumë po bëjnë për Kosovën.

Pas atentatit të vëllezërve nga UDB-ja Jugosllavia që në atë kohë në trojet tona i gjithë kombi shqiptar ra në zi e sidomos mërgata të cilës i prijnë me një përkushtim të jashtëzakonshëm. Humbja e tyre ishte e madhe por amanetet të cilat na i lanë neve

në mërgim na dhanë kurajo edhe më shumë që të arrijmë atë liri që aq shumë e deshtën.
Në kohën e pluralizmit politik Hyzriun gjithmonë e kam parë në vijën e duhur në përkrahje të institucioneve të Kosovës edhe pse kishte nga pak fërkime, ky ishte personi i cili na bashkonte të gjithëve rreth një qëllimi të përbashkët.
Më kujtohet edhe organizimi që bëhej për arsimin në Kosovë, ndihmat të cilat i dërgonim nga klubi ynë. Hyzriu me shokët e vet te klubit shpesh e potenconte se ne mërgimtarët çdo kërkesë që vjen nga vendlindja duhet t'i përgjigjemi me seriozitetin më të madh.
Hyzriu ishte një atdhetar i dalluar, më kujtohet shumë mirë kur banesa e tij ishte afër klubit në Pioner str. Dysseldorf ishte edhe një mikëpritës me zemër të madhe që shumë nga shokët jashtë rrethit të Dysseldorfit e kishin adresën tek ai.
Shpeshherë klubi ynë merrte aksione të ndryshme për tubimin e të hollave për t'i dërguar në vendlindje e sidomos në Luftën e UÇK-së. Klubi ynë dallohej në shuma të mëdha që dërgoheshin atje për të ndihmuar luftën çlirimtare. Hyzriu me shokët e tij kishin besimin më të madh të mërgimtarëve për atë arsye edhe sukseset ishin të dalluara nga rrethet tjera.
Më kujtohet organizimi i klubit kur marshuam drejt Rambujesë për ta përkrahur delegacionin tonë. U organizuam si më mirë të përgatitur me të gjitha parullat e mbishkrimet që i dhanë mbështetje të madhe delegacionit tonë.
Me përfundimin e luftës sonë heroike të UÇK-së e aleatëve tanë Kosova u çliria definitivisht nga tutela Serbe në qershor të vitit 1999.

Si gjithmonë dhe në çdo kohë Hyzriu dinte të vepronte në kohë e hapësirë, ai me qëndrimet e tij të vendosura lëshoi Gjermaninë me gruan e tij Zhaklinën dhe vajzën Ilirianën ku u kthye në Kosovë për të shijuar lirinë e vendit të vet që aq shumë sakrifikoi e punoi me zell për të arritur qëllimin që i kishte shtruar vetes. Hyzriun nuk do ta harroj kurrë dhe gjithmonë do ta kem në kujtesë si udhëheqës i dinjitetshëm, parimor ku për mua ai ishte e do të jetë si një pishtar për Lirinë e Kosovës. Hyzriu kishte tipare të veçanta, ishte i lindur të jetë udhëheqës prandaj unë pata fatin të kem udhëheqës timin në këto dekada sa jetuam në mërgim.

Unë, Hyzriun e vlerësoj Atdhetar të betuar të çështjes Kombëtare!!!

Maj, 2020

Ryshë Blenishti

Rysh Blinishti, fshati, Zaskok, Ferizaj Kosovë.
Me banim në Hennef, Gjermani

Kujtimet e paharrueshme për shokun e dashur, vëllanë Hyzri Rekaj, i cili nuk ndodhet më në mesin tonë.

Për Hyzriun kemi shumë kujtime që kanë mbetur të freskëta në mendjen tonë. Hyzriu ishte njeri i sinqertë që rrezatonte energji pozitive dhe atdhedashuri ndaj vendlindjes.

Për Hyzriun ndjejë mungesë që nuk kisha pasur mundësi për të ndejur më shumë me të. Mirëpo edhe gjatë qëndrimit pak kohë me mua, ai ka lënë mbresa të mira dhe të paharrueshme.

Brezit tonë të tanishëm Hyzri Rekaj i mungon shumë dhe përherë do tu mungojë brezave patriotike shqiptar. Hyzriu dinte t'i afrojë shokët dhe miqët me ngrohtësinë e vet të përhershme të dashur e patriotike.

Me sjelljet e tij aq të afërta e atraktive me rrethin, pati mundësi që për një kohë të gjatë të drejtojë Klubin "Emin Duraku", në Dysseldorf.

Gjatë asaj kohe Hyzriu priti e përcolli mysafirë dhe antarë të klubit duke u ofruar respekt, dashuri dhe ngrohtësi, dhe me sjelljen e tij patriotike arriti të tubojë qindra anëtarë për të frekuentuar në klubin e shqiptarëve „Emin Duraku", në Dysseldorf.

Më kujtohet kur u hap Oda Shqiptare në Diasporë në kuadër të klubit, më thirri në telefon, dhe më tha: "Eja të shikosh se çfarë

bëjmë në Dysseldorfi. Pastaj shkova dhe u befasove. Ambienti i Odës, kishte pamje origjinale sikur të ishte Oda Shqiptare diku në Kosovë.

Rysha: Në Odë takova shumë shokë. Ishte Isak Guta, Ibrahim Kelmendi, e shumë veprimtarë tjerë të asaj kohe. Gjatë bisedës, me Hyzriun, shprehi interesim për të sjellë një gazetarë i cili do të përshkruante angazhimin tonë në Odën Shqiptare, për të marrë vesh mbarë bota shqiptare. Fjala ishte për të ftuar korrespondentin Ymer Bajra, i cili aso kohe punonte për Gazeten "Rilindja". Mirëpo ishte e pamundur, sepse, i shkreti, zotëri Bajra, kishte frikë për të vizituar ambientet dhe anëtarësinë e Klubit "Emin Duraku", në Dysseldorf.

Hyzri Rekën, këtë njeri të madh do ta kujtojnë shumë njerëz përherë.

Ashtu më lindi Ideja për të organizuar një Tubim Proteste, që të dëgjohet zëri, Kosova Republikë, prej nesh që ishim nga rrethina e Bonit dhe Këlnit. Për fat të mirë, aso kohe vinte një ansambël artistik nga Kosova për të mbajtur një koncert në qytetin Këln. Ndaj për mua ishte më lehtë.

Aso kohe, kisha besim vetëm në dypersona. Ata ishin baca Isa Elshani, me banim në Siegburg, dhe Jahir Prenka, me banim në Këln.

Rysha: Për atë çështje i jam drejtuar shokut Hyzri Rekaj, dhe e njoftova lidhur me idenë që kisha për organizimin e protestës. Se për çfarë proteste ishte fjala, mund ta gjeni në Monografinë për klubin "Emin Duraku", në Dysseldorf, në faqen 53.

Hyzriut iu drejtova me fjalët: "Hyzri nuk kemi shumë njerëz në Bon dhe Këln, dhe iu luta të më dërgojë 30 persona. Ai qeshi sa mundi, dhe më tha: "Hallall të qoftë Ryshë, për obligimin që ke

marrë, i cili është aq i rëndësishëm. Dhe më tha, jo 30 veta, por dy autobusa plot njerëz do ti dërgoj ditën e protestës.
Manifestimin pastaj e kryem me sukses të lartë.
Me Hyzriun jam njoftuar në vitet e 80-ta, kur ishte kryetar klubi.
Një kujtim i veçant që kurr nuk mund ta harroj.
Menjëherë, pas lufte, Hyzriu pat vendosur të shkojë në Kosovë, për të kontribuar si stomatolog.
Pasi mori vendim për tu kthyer në atdhe, i ftoi në një mbrëmje përshëndetëse rasti, të gjithë shokët dhe miqtë, për ti njoftuar se ai po kthehet në Kosovë.
Mua mu drejtua me këto fjalë: Unë po shkoj, e ti a do kthehesh?
Përgjigja ime ishte Jo ! Do vij por pas disa vitesh.
Pak humor bëmë por shumë të qëlluar për rastin. Në ato momente të humorit ishin edhe Nazmi Nuha, Ibrahim Kelmendi e miq tjerë. Pastaj ai tha, përse keni punuar gjer më tani, pasi nuk po vini!
Hyzriu mbetet i paharrur për të gjithë ata që e kanë njohur dhe kanë qëndruar me të.
Qoftë i paharrur kujtimi për Hyzri Rekën !

Haxhi Bega

Unë Haxhi Bega si bashkëfshatar dhe si bashkëveprimtar në Dysseldorf me të ndjerin Hyzri Rekaj, kam dëshirë të rrëfej për punën dhe veprimtarinë e Hyzriut që me të vërtetën kam shumë për të thënë për këtë veprimtar të palodhshëm dhe shumë i drejtpërdrejt. Hyzriun e kam njohur edhe në vendlindje me gjithë familjen e tij. Ishte një familje e thjesht dhe shumë e ndershme, por ne si të rinjë që ishim në Kosovë njiheshim vetëm thjesht si bashkëfshatarë. Për fat të keq në vitet 70-ta as që bëhej fjalë për punësim në Kosovë. Dhe për fat të keq na u është dashtë të marrim rrugën e kurbetit. Unë isha 3 vite më i vjetër se Hyzriu, ai ishte ende në shkollë ndërsa në vitin 1973 unë u detyrova të marr rrugën e Kurbetit për në Gjermani, saktësisht në Dysseldorf.

Për fat aty gjeta edhe disa bashkëfshatarë të mi ku punonim dhe banonim bashkë me ta dhe disa shokë të tjerë. Në atë kohë ende kishte pak kosovarë në gjermani por ne vazhdimisht në fundjavë shkonim tek njëri tjetri për tu çmallur, ku dhe kalonim shumë mirë me njëri tjetrin. Për me thënë të vërtetën pasi erdhëm në gjermani si punëtorë krahu filluam me i pa padrejtësitë që na bënte neve si popull shqiptar sistemi Serbo-sllav (Jugosllav).

Në ato mbledhje filluam me disa shokë të diskutonim hapjen e një klubi të shqiptarëve në Dysseldorf. Në atë kohë Konsullata Jugosllave kishte hapur klube Serbo-Jugosllave, Serbo-Kroate, Serbo-Maqedone dhe Serbo-Boshnjake. Dhe ne deshtën të na fusnin në klubet e tyre, për të na mbajt nën vëzhgimin e

sigurimit jugosllav. Por ne disa shokë ngulëm këmb për të hapur klubin tonë për shqiptar që jetonin dhe vepronin në Dysseldorf.
Dhe më në fund ata u detyruan të bënin një gjë të tillë por me kusht që të quhej klubi, "Klubi i punëtorëve nga Jugosllavia". Për fat të keq disa deshtën të pranojnë një gjë të tillë, por ne disa shokë që nuk kam nevoj ti ceki me emra sepse kanë qenë bukur shumë këmbëngulës që klubi të quhej "Klubi i punëtorëve shqiptar nga Jugosllavia". Dhe këtu filloj përqarja mes disa shokëve dhe me Konsullatën Jugosllave në Dysseldorf, si dhe me disa vegla shqipare që ishin projugosllav. Që mos ta zgjat më shumë se po ti hynim gjerë e gjatë për punët dhe problemet e kurbetgjinjëve të vjetër, mund të shkruhen libra të pafund. Por tani dua të mirrem me punën dhe vepritarinë e bashkëveprimtarit tim Hyzri Rekaj. Për mua Hyzriu ka qenë një shok shumë i mirë dhe besnik, dhe gjatë gjithë jetës se tij ka punuar dhe vepruar në të mirën e atdheut. Hyzriu ka ardhur në një moshë shumë të re në Dysseldorf por atë në asnjë moment nuk e mashtruan rrugët e pandershme që për fat të keq disa të rinjë kishin ra pre e tyre. Por Hyzriu nuk e bëri një gjë të tillë për arsye se u rrit në një familje të ndershme dhe patriotike. Me hapjen e klubit emrin "Emin Duraku" ky i fundit u bë shtyllë e fortë e çështjes kombëtare.
Ai kishte talent për vallëzim dhe ky me disa shokë ishte iniciator në krijimin e ansamblit „Aleksandër Moisiu" në kuadër të klubit "Emin Duraku", ku ky ansambël luante një rol shumë të madh për argëtimin e punëtorëve tanë që në atë kohë shumica prej tyre ishin pa familje. Dhe kohë pas kohe ishte anëtar i kryesisë së klubit, ku pjesën më të madhe ka qenë kryetar i klubit. Ku e udhëhoqi me përkushtim shumë të madh. Ishte djalë shumë i

dashur dhe i urtë dhe kishte aftësi njerëzore për ti mbajtur njerëzit afër njëritjetrit. Me thënë të vërtetën ishte i palodhshëm. Ai kurr nuk ju iku punëve sado të rënda që ishin, çdo gjë e merrte seriozisht dhe e kryente me shumë përkushtim. Dhe unë nuk e di ndonjë veprim që është bërë në klubin tonë dhe jashtë tij që mos te ketë kontribuar Hyzriu. Ndër të tjera Hyzriu ishte dhe një organizator shumë i mirë, dinte të drejtonte organizimin e klubit shumë mirë me një urtësi të paparë. Ai i urrente përqarjet apo ngatërresat në mes shokëve. Për fat të keq ne kishim në atë kohë shumë probleme me konsullin jugosllav, por Hyzriu me shokë dinte ti bënte ballë shumë mirë intrigave serbo-sllave. Për fat të keq konsulli jugosllav në Dysseldorf i keqpërdorte disa shqiptar të cilët besonin në të ashtuquajturën "Bashkim vëllaznim" jugosllav, dhe ata mundoheshin të bënin punën e tyre kundër çështjes kombëtare. Hyzriu dinte dhe këtu me një gjakftohtësi të pashoq ti tejkalonte këto mosmarrëveshje mes nesh dhe disa veglave qorre. Me një fjalë ishte shumë vizionar. Kur u formua LPRK-ja në vitin 1982 Hyzriu dhe disa shokë u bëmë anëtarë të kësaj organizate me plot dëshirë, ku punoj me shumë nder. Deri kur filloj plurarizmi ku pas një kohe Hyzriu aderoj në Partinë e LDK-së. Hyzriu edhe aty kontribuoj dhe punoj në favor të çështjes kombëtare, pa pikë dyshimi që aty u ndaheshin mendimet sa i përket krijimit të një force ushtarke për çlirimin e Kosovës edhe këtu Hyzriu ishte një përkrahës i pakompromis për formimin e UÇK-së duke dhënë një kontribut bukur të madh, në organizimin e të rinjëve dhe të rejave që në mënyrë vullnetare donin ti bashkoheshin grupeve të UÇK-së e sidomos pas luftës së komandantit legjendar Adem Jashari që e bëri me forcat ushtarako paramilitare jugosllave.

Dhe pikërisht aty populli shqiptar u zgjua dhe u bashkua si një trup i vetëm pa kursyer pasurinë apo jetën për ta çliruar Kosovën. Bashkimi i shqiptarëve pa dallim krahinash, feje apo partie, dhe pikërisht ky bashkim me UÇK-ën i bëri ball rezhimit të Millosheviqit, ku bashkë me miqtë tanë e shporrën ushtrinë jugosllave njëherë e mirë nga Kosova. Shqiptarët më në fund e kuptuan se e vetmja rrugë për çlirimin e Kosovës është lufta, përndryshe jugosllavët nuk njohën gjuhë dialogu apo marrë-veshje mes dy popujve, dhe ne shqiptarët e quam në fund fjalën e nënëlokës të malësisë ku thoshte më mirë shqipojnë një ditë se sorrë 100 vjet. Gjatë gjithë kohës së luftës Hyzriu kontribuoj për organizimin vullnetarë për grumbullimin e mjeteve për ndihmë të UÇK-së dhe popullit të pambrojtur. Hyzriu për të mirën e çështjes kombëtare bëri gjithçka që diti dhe mundi pa u lodhur dhe atë me shumë devotshmëri por edhe pas luftës Kosova doli shumë e dëmtuar ku forcat serbe nuk kursyen të shkatërrojnë dhe të djegin çdo gjë që ju doli përpara. U dogjën qindra fshatra u vranë dhe u masakruan me mijëra pleq plaka dhe fëmijë, u dhunuan dhe përdhunuan shumë gra dhe vasha.

U dogjën shkolla dhe spitale dhe prap Hyzriu nuk e ndali veprimtarinë e tij. Duke organizuar ndihma për spitale dhe shkolla pa u lodhur. Me një fjalë Hyzriu veprimtarinë e tij nuk e ndali deri në vdekjen e tij ku për fat të keq vdekja na e mori shumë herët ku ne shokët e tij kemi ndi shumë dhimbje dhe mungesë për të. I qoft për jetë dheu i lehtë i Kosovës. Unë dhe shokët e mi vlerësuam shumë punën e tij patriotike se ai ashtu dhe ishte patriot i vërtetë. Ai e gëzonte një respekt të veçantë në shoqërinë tonë. Hyzriu ishte një shokë shumë i mirë, një vëlla një familjar dhe një baba shumë i respektuar. Ishte një krah

shumë i fortë i çështjes kombëtare, ishte një ushtarë shumë i devotshëm i çështjes kombëtare.

Do ta kujtojë deri në amshim një shokë të idealit dhe të çështjes kombëtare deri në vdekjen e tij. Unë Haxhi Bega kam aq shumë fakte të gjalla për vëllain tonë të paharruar sa mund të shkruaj libra të tërë. Por me kaq po e përfundoj pjesën time meqë dua tu lë vend edhe shumë shokëve të mi dhe të tij, që edhe ata të tregojnë për punën dhe veprat që bëri vëllai ynë Hyzri Rekaj. Por në fund veprimtarin e tij nuk e ndali deri në vdekjen e tij ku për fat të keq vdekja na e mori shumë herët ku ne shokët e tij kemi ndi shumë dhimbje dhe mungesë për të. I qoftë për jetë dheu i lehtë i Kosovës. Unë dhe shokët e mi vlerësuam shumë punën e tij patriotike se ai ashtu dhe ishte patriot i vërtetë. Ai e gëzonte një respekt të veçantë në shoqërinë tonë. Hyzriu ishte një shokë shumë i mirë, një vëlla, një familjar dhe një baba shumë i respektuar. Ishte një krah shumë i fortë i çështjes kombëtare, ishte një ushtar shumë i devotshëm i çështjes kombëtare.

Por në fund nuk mund të rri pa i shkruar disa rreshta sa i përket disa shokëve tanë që hynë në pushtet pas lufte. Me thanë të vërtetën, unë jam shumë i zhgënjyer me punën dhe sjelljet e tyre ndaj popullit dhe ndaj atdheut. Për ata burra të cilët gjithmon morën forcë dhe kurajo nga rilindasit tanë si Bajram Curri, Hasan Prishtina e Isë Boletini, por që në fund fatkeqësisht na zhgënjyen ne dhe rilindasit sepse këta të fundit e dhanë gjithë pasurinë, mundin dhe gjakun për të bërë shtetin shqiptare, kurse këta shokët tanë të idealit e bënë të kundërtën, këta i mashtruan interest personale për tu pasuruar në dëm të shtetit të Kosovës ende pa u bërë, duke zhvatë gjithçka ju vjen për dore. Dhe ende

më keq këta janë në gjendje të kundërvihen njëri tjetrin vetëm e vetëm, për karrikë dhe pushtet. Unë dëshiroj shumë që këta shokë të zgjohen njëherë e mirë dhe të udhëheqin këtë tokë të shenjtë me nderë e devotshmëri si i ka hije një patrioti shqiptar qe e do këtë vend me shpirt e me gjak. Mua më kujtohen shumë herë fjalët e të madhit Jusuf Gërvalla ku vazhdimisht e përdorte një fjalë shumë të madhe ku thonte: Në ballë të popullit dhe te këmbët e popullit.

Për fat të keq disa shokë të tij dhe të tonë po bëjnë sot të kundërtën, ishin në ballë të popullit por tani po shalojnë në shpinë të popullit. Uroj që të kthjellen dhe mos të shkelin mbi gjakun e shokëve dhe vëllezërve të tyre. Unë kërkoj falje për këto fjalë që po i them, por unë nuk po i them si kritikues por si njeri i këtij populli. Me shumë dashamirësi ndaj gjithë atyre njerëzve që kontribuan sado pak për çështjen kombëtare, ju jam mirënjohës për jetë e mot unë Haxhi Bega, fshati Jezerc.

Gani Nuha
(1968)

Pas përfundimit të shkollës së mesme, për shkak të kushteve ekonomike që më pamundësonin vazhdimin e shkollimit të mëtejmë, u detyrova të emigroj në vitin 1989 në Gjermani pasi që atje ishte edhe vëllai im Nazmiu.

Para se të them fjalën time për atdhetarin Hyzri Rekaj, dua ca fjalë për familjen e prindit të Hyzriut, bacit Bajram, që i njoh shumë mirë meqë jemi edhe vendas.

Kjo familje atdhtare që nga demostratat e 1981 kanë qenë të diferencuar në të gjitha format nga sistemi i atëhershëm jugosllav.

Për klubin "Emin Duraku" dhe veprimtarët e tij të palodhshëm kisha dëgjuar ende pa u vendosur në Dysseldorf. Hyzriu ishte ndër intelektualët e rrallë atdhetar në Dysseldorf prandaj gëzonte një respekt të veçant.

Posa erdha në Dysseldorf edhe unë iu bashkangjita veprimtarëve që ishin të organizuar në Klubin "Emin Duraku" dhe u bëra edhe anëtarë formal i saj. Duhet përmendur se në klubin tonë oda që kishim, ka luajtur një rol të madh ngjajshëm me odat shqiptare në atdhe.

Në kuadër të klubit tonë ishte edhe ekipi i futbollit FC Kosova që si i ri që isha u angazhova menjëherë.

Të gjitha organizimet e shqiptarëve në Dysseldorf pa rolin dhe kontributin e Hyzri Rekës nuk do të kishin rezultate të tilla çfarë i kanë.

Me krijimin e qeverisë në mërgim Hyzriu u angazhua maksimalisht në përkrahje të qeverisë përderisa unë isha i angazhuar në LPK dhe në fillimin e luftës në vitin 1998 u angazhova në radhët e UÇK-së dhe pas atentatin ndaj Ilir Konushevcit unë mora përsipër detyrat e tij duke vazhduar deri në çlirimin e plotë të Kosovës.

Hyzriu për mua mbetet një figurë e ndritshme e historisë kombëtare, për fat të keq vdekja e parakohshme ja ndërpreu veprimtarinë që zhvillonte edhe në Kosovë si teknik i stomatologjisë.

Ndihem i nderuar dhe krenar që isha edhe unë pjesë e veprimtarisë me Hyzriun në kuadër të QKISh "Emin Duraku".

Do ta kujtojmë me pietet veprën e ndritur të Hyzri Rekës.

Lavdi Jetës dhe veprës së Hyzri Rekës!

Sherif Gashi

Sherif Gashi lindur më 27.2.1968 Dubravë, Suharekë. Ishte data 7.9.1991 kur si dhe shumë shqiptar nga Kosova edhe unë pata fatin (fatkeqësinë) të marrë rrugën e mërgimit, jetova për disa muaj në qytetin e Mynihut, Po për shkaqe personale mu pamundësua të vendosem në Mynih dhe vendosa të largohem në Dysseldorf, më 2 korrik të vitit 1992 erdha në Dysseldorf. Atë ditë ishte organizuar një koncert në këtë qytet për nderë të 2 korrikut diku kah ora 14 me disa shokë shkuam në klubin "Emin Duraku" u takova me kushëririn tim Hamdi Gashin u përshëndetëm ishte me disa shokë dhe më njohtoi nuk e njihja asnjërin për pos mësuesin Rifat. Por ai ishte i angazhur me nxënësit e shkollës, por njëri nga shokët e bacit Hamdi ishte Hyzri Rekaj një njeri i qetë i afërt me secilin njeri i cili ishte aty prezent me një rrezatim brilant gjithmon pozitiv, aq më priti mirë unë mendova që vetëm pse jam kushëriri i bacit Hamdi por më vonë e pash se ishte me të gjithë ashtu në anën pozitive me vonë e pyeta bacin Hamdi. Pas nja tri apo katër kontakteve dhe ndejav e pyeta, më tregoi historinë se është i përndjekur nga Kosova, kishte shumë vite që ishte larguar nga Kosova aq shumë mu rrit respekti ndaj ti sa mezi pritsha të takoi dhe të rri me të aq shumë ishte i afërt me mua edhe pse kishim një diferencë me moshë, bisedonte me mua si me qenë miku e shoku i tij i fëmijërisë, shpesh herë jemi takuar në klub pastaj kur filloi edhe lufta në Kosovë takoheshim për çdo mbrëmje në

klubin “Emin Duraku” edhe pse kishte ndonjëherë disa situata të pakëndshme, ishte baci Hyzri ai i cili veq kah e mira shkonte. Pasi përfundoi lufta kur ndëgjova se kishte udhëtuar për Kosovë pas 18 viteve mos gabofsha u gëzova sikur për vete edhe pse kisha diku 7 apo 8 vite pa shkuar në Kosovë por për shkaqe statusi se pas lufte s’kishim probleme tjera.

Për të veçuar një respekt që më bëri mua dhe familjes sime ku ato gjeste nuk mungonin te baci Hyzri kur në një pushim në Kosovë me bacin Hamdi bënë një vizitë te babai im në Dubravë të Suharekës, ku babai im Sinan Gashi kishte organizuar me një traktor ti sillte në bjeshkët e Delovcit për të vizituar një shokë të bacit Hyzri e bashkëfshatar e bashkëpunëtorë të bacit Hamdi Hysen Gegën, e kishin kaluar një ditë të paharruar për të gjithë deri sa janë në këtë botë ku për mua ishte një nder i veçantë ku prindit ja shëron zemrën se të gjithë sot jemi prind kur shohin fëmijën po rrika me një njeri siç ishte baci Hyzri ku dhe kishin ndërru numrat e telefonit dhe ndëgjoheshin shumë herë se për bacin Hamdi ishin rrit së bashku. Kurse për mua është një natë e veçantë kur u takuam në pizzerin e mësuesit Rifat, pimë nga një pije, ideja ishte e bacit Hamdi është një moment që deri sa të jetojë s’do ta harroj siç e thirrke ai Shoqi a shkojmë sot diku në muzikë, qe Sherifi na vozit ai me shiqoi me një buzëgjeshje siç e kishte baci Hyzri, po unë pa hezitu fare thashë ku të doni ju jam në shërbim tuajin. Shkuam diku nuk ju pëlqeu më thanë a po na qon në Leverkusen, unë prap ju përgjegja o ju kam thanë ku të doni ju, shkuam në Leverkusen, baci Hyzri i vinte keq se ata pishin e bënin qef e unë isha në shërbim të tyre që deri në mëngjes kur u mbyll lokali po për mua mbeti një kujtim e edhe sot ndjejë një nderë e respekt që pata fatin dhe mu

dha rasti të ju shërbej sado pak dy njerëzve që tërë jetën i shërbyen atdheut e Kosovës siç ishte baci Hyzri e baci Hamdi e për mua ishte një natë që mbeti në kujtimin tim prej më të mirëve. E pata që sa të jetoj në mërgim që për fat të keq ne shqiptarët e kemi një të metë, nuk dijmë ti çmojmë njerëzit e mëdhenjë sa i kemi në këtë botë por për mua dhe familjen time do të kenë respektin dhe nderimin për mot e jetë për bacin Hyzri por pas asaj ndeje mësova që baci Hyzri do të kthehet për të jetuar në Kosovë, s'pata çka të them veç ta përgëzoj për vendimin e marrë por më vonë ndëgjova qe nuk është mirë nga shëndeti. Për një njeri të cilin e do dhe gëzon respekt gjithmon ja dëshiron të jetë e kalushme por edhe pse të gjitha betejat i pat fituar, sëmundja ishte një betejë e pamundshme por shumë mirë e pat cekë në një shkrim një mik i tij Halil Gashi fortunat rrëzojnë gjithmonë lisat e mëdhenjë e ne të cilët jemi ende në këtë botë s'na mbetet asgjë tjetër veç ti kujtojmë me nderë e respektë.

Gani Nebih Kashtanjeva

I lindur më 03.07.1951 në Nerodime të ulët.

Unë në Gjermani kam ardhur më 25.07.1973 në Dysseldorf.

Si çdo mërgimtarë edhe unë në bazë të kushteve të cilat ishin krijuar në atë kohë kur neve shqiptarëve pushteti Jugosllavë na i mohonte të drejtat e punësimit, u detyrova të lëshoj vendlindjen e të ndahem nga familja, me çka mund të konkludoj se ishte një moment shumë prekës dhe emocional.

Për herë të parë Hyzriun e kam takuar në banesën e Idriz Rekës, ishte edhe Avdi Rekaj e disa shokë të tjerë që për momentin nuk më kujtohen. Në gusht të vitit 1978 kur veç ishte i themeluar edhe klubi i punëtorëve shqiptare nga Jugosllavia "Emin Duraku".

Hyzriu ishte mërgimtari më i ri se ne mirëpo gjatë bisedës i cili nganjëherë u inkuadronte fitova një bindje se ishte njeri me karakter të veçantë dhe më i shkolluar se ne. Hyzriun e kam njohur edhe në Kosovë por jo si mërgimtar.

Edhe pse kishim probleme mjaft të mëdha nga Konsullata Jugosllave ne mërgimtarët sikur bashkoheshim e mblidheshim edhe më shumë forcoheshim për të ruajtur qerdhen tonë ku aty zhvillonim aktivitete të llojllojshme kushtuar festave tona kombëtare e sidomos 28 nëntorin, Ditën e Flamurit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Hyzriu ishte një aktivist i dalluar, i pjekur, i matur dhe plot energji.

Ai pas burgosjes se Nebiut 1980 pas një periudhe kohore u bë kryetar i klubit ku bashkë me shokët e tjerë që kishte përreth më kujtohen kur formuan resurset në klub.

Dramatik nga Isak Guta, Grupi i vallëtarëve, recitues bile më kujtohet kur u hap kursi për të kryer shkollën fillore.

Me iniciativë të kryesisë së klubit më kujtohet kur u improvizua një odë burrash me të gjitha gjësendet e një ode që i takonte kulturës sonë në vendlindje.

Në odë i kishim dy baca, baci Avdi dhe baci Zyber të cilët mbanin fjalime kuptimplota e domethënëse për gjithë të pranishmit.

Numri i anëtarëve shtohej dita-ditës, me sa mbaj mend unë diku mbi 200 anëtarë bile kishte edhe të rretheve tjera jashtë Dysseldorfit.

Demonstratat e vitit 1981 për Kosovën Republikë u përkrahën edhe tek ne në klub, nga anëtarsia e gjerë sepse atje u derdh gjaku i studentëve, i bijave e bijve më të çmuar të kombit tonë.

Aty e kam parë Hyzriun në çdo fjalim që mbante apo ndonjë tubim, ishte i vendosur, këmbëngulës dhe kishtë një ideal të fortë për kauzën kombëtare.

Demostrata e Dysseldorfit ishte një ndër të parat në përkrahje të Kosovës Republikë, ku iu dha mbështetje e madhe mbarë popullit shqiptar ku jetonte e vepronte. Kjo demostratë ishte shumë mirë e përgatitur si nga kryesia e klubit në krye me Hyzriun, ashtu edhe nga anëtarët ku nga të cilët secili kryente punën të cilën ishte i ngarkuar.

Më kujtohet një rast kur unë e Avdi Begisholli blemë një shtof të kuq, ku e përgatitëm mirë dhe iu shpërndam ku kishim për detyrë që kurdelat e kuq të i mbajmë në krahë për tu dalluar prej të tjerëve bile edhe ishim të caktuar që të mbajmë rendin aty ku vepronim.

Në të njejtën kohë në Ballinën e Klubit veç ishte vendos parulla e madhe "Kosova Republikë", me sa e di unë kjo parullë ka qëndruar deri sa ka përfunduar lufta çlirimtare e Kosovës.

Më kujtohet shumë mirë edhe nje rast që nuk mund ta harroj, kur në Bon mbahej greva e urisë në përkrahje të Minatorëve kur të gjithë së bashku organizuam vendosjen e tendave, nuk kishte dallime edhe pse organizoheshin edhe përveç klubit kishte edhe parti tjera, mirëpo lufta e përpjekjet tona ishin të përbashkëta dhe të gjithë ishim për një dhe një për të gjithë. Aty bile Muhamet Kelmendi u sëmur shumë dhe e dërguan në spital, kjo grevë pati jehonë në Gjermani e më gjerë.

Kur filloj pluralizmi politik Hyzriun e kam parë prapë si një udhëheqës, i vendosur në parimet e tij të palëkundura, ku shpesh potenconte fjalën vëllezër mërgimtar tash janë formuar institucionet tona, kurse ne duhet t'iu përgjigjemi e ti respek-tojmë me të gjitha mjetet që i posedojmë.

Filluan ndihmat për arsim në Kosovë pas segregacionit të shkollave.

Hyzriu për ne ishte një udhërrëfyes ku patëm fatin ta kemi udhëheqës dy dekada, ishte njeri i pathyeshëm edhe kur kishte kundërshtar apo fërkime të llojit të vet ai dinte të zbuste situatën.

Më kujtohen demostratat në Rambuje të organizuara nga klubi ynë në përkrahje të Delegacionit tonë, me sa di unë ishim mbi 7 autobus nga Dysseldorfi.

Edhe 3% e “Vendlindja thërret” Dysseldorfi me rrethinë ishin të parët të cilët dhanë më së shumti mjete për ndihma për Kosovën e sidomos në luftën e UÇK-së për çlirimin përfundimtar.
Kur Kosova u çlirua përfundimisht nga Serbia me ndihmën edhe të ShBA-ve dhe Shteteve Perëndimore (Nato), Hyzriu pas një kohe vendosi të lëshoj Gjermanin e të kthehej në vendlindjen e çliruar që aq shumë e vuajti prej se punoi, veproi më shumë se dy dekada. Është interesant edhe pse e kishte të ndaluar shkuarjen në Kosovë ai kurrë nuk u ankua, gjithmonë potenconte një fjalë të cilën nuk mund ta harroj, “Mua edhe pse më mungon familja e ngushtë, familje ju kam juve”.
Për mua Hyzriu ka qenë e do të mbetet një njeri i nderuar, i lindur patriot me karakter shumë të fortë njerëzor e kombëtar.
Ka edhe shumë çka të shkruhet për të, por ky njeri do të mbahet mend me gjenerata të tëra.
Prandaj unë Hyzriun e vlerësoj si ushtar i betuar i çështjes kombëtare i një heroizmi të veçantë.

Ismet Rashiti

Veprimtar i orëve të para

Viti historik 1981 nxori një plejadë të tërë veprimtarësh të cilët me kohë u radhitën përkrah kërkesave të drejta që shtruan për zgjidhje studentët dhe mbarë populli shqiptar përmes protestave dhe demonstratave në Kosovë. Në këtë kuadër mërgata patriotike nuk mund të rrinte e heshtur.

Pavarësisht masave propagandistike, shantazheve dhe kërcnimeve që kishte ndërmarrë UDB-ja ish Jugosllave, patriotët shqiptarë me kohë ditën të radhiten aty ku e kërkonte zëri i Atdheut. Punëtorët shqiptarë në mërgatë, jo vetëm që nuk i dënuan demonstratat gjithëpopullore në Kosovë, ashtu siç kërkonin ambasadat ish Jugosllave, por e mbështetën si një kërkesë të drejtë dhe dolën hapur në përkrahje të studentëve dhe kërkesës Kosova Republikë!

Njëri nga këta atdhetar të përkushtuar, padyshim ishte edhe Hyzri Rekaj, një djalë i heshtur në dukje, por tepër i vendosur dhe energjik në kauzën e drejtë kombëtare. Sapo ishte përhapur lajmi për organizimin e mërgatës shqiptare në mbështetje të kërkesës Kosova Republikë, Hyzri Rekaj, ky pinjoll i një familje me traditë të lashtë patriotike, kishte filluar t'i bënte hapat e parë në Dysseldorf dhe rrethinë. Propagandimi i drejtë i çështjes

kombëtare, shpërndarja e literaturës, trakteve dhe gazetave, ishin bërë pjesë e rrugëtimit të tij të gjatë.

Atdhetari i përkushtuar, Hyzri Rekaj, me kohë kishte filluar të merrte frymë me kërkesat e drejta të popullit shqiptar. Kosova Republikë dhe bashkimi kombëtar, ishin bërë buka dhe ajri i tij jetësor, pa të cilat nuk mund të jetonte.

Kontaktet dhe bashkëpunimi i tij me Kadri Zekën (Zeqën), Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, i kishin dhënë edhe më shumë forcë, kurajo dhe besim në fitoren e sigurt.

Ishte e pamundur të organizohej ndonjë veprimtari kombëtare, protestë, demonstrate apo tubim, që t'mos ishte i pranishëm Hyzriu. Dhe jo vetëm i pranishëm, por edhe organizator i mirë dhe udhëheqës i urtë me vlera të mëdha njerëzore. Hyzriu nuk ishte nga ata që bënte zhurmë pa asgjë. Ishte shumë i matur në mendime dhe veprime. Mik i mirë, i besueshëm dhe i afërt me të gjithë.

Hyzri Rekaj ishte njeri i unitetit dhe i veprimit konkret. Përveç kontributit të madh në Klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf, që nga orët e para të vitit historik 1981, Hyzriu ishte bërë emër i njohur në tërë Gjermaninë. Madje, i njohur dhe i dashur, ishte bërë edhe në Zvicër, Bruksel, Francë e Gjermani. Falë punës së Hyzriut dhe veprimtarëve tjerë, Klubi "Emin Duraku", ishte bërë një vatër e ngrohët e atdhetarizmit. Një shembull i mirë se si duhet të punohet e veprohet për ruajtjen e traditës kombëtare dhe afirmimin e lëvizjes çlirimtare. Pas pavarësimit të "Emin Durakut" nga përfaqësitë diplomatike ish jugosllave, klube të ngjajshme të pavarura, u themeluan edhe në shumë qytete e shtete tjera në Evropë të cilat dhanë kontriut të jashtëzakonshëm në ruajtjen dhe afirmimin e vlerave kombëtare shqiptare.

Atdhetari i përkushtuar ndaj çështjes kombëtare, Hyzri Rekaj, ishte organizator i mirë dhe pjesëmarrës në të gjitha demonstratat e atyre viteve të vështira për Republikën e Kosovës. Gjatë viteve tetëdhjeta, duke filluar nga viti 1981, e kam takuar në Dysseldorf, Bon, Shtudgard, Gjenevë, Bern, Cyrih, Bruksel, Paris, Vjenë, Frankfurt. Gjatë bisedava që kisha më kujtohet se Hyzriu gjithnjë ishte optimist për fitoren. "Kjo punë do të kryhet gjithsesi, vetëm na duhet përkushtim dhe sakrificë. Liria nuk fitohet pa luftë"- thoshte Hyzriu.

Më kujtohet si sot takimi në themelimin e odës së parë shqiptare në klubin "Emin Duraku" të Dysseldorfit në vitin 1981. Aty ishte edhe dëshmori Kadri Zeka (Zeqa), ulur këmbëkryq në odë. Të pranishmit i bënin pyetje me radhë, sipas traditës, e Kadri Zeka u përgjigjej të gjithëve. Hyzriu i ngazëllyer lëvizte sa andej këndej. Priste dhe përcillte njerëz me atë buzëqeshjen e tij të pëzemërt.

Atdhetari, Hyzri Rekaj, përveç si organizator dhe pjesëmarrës në tubime e demonstrata, ishte edhe kontribues i madh me mjete financiare. Sa herë që kërkohej, e në ato vite kërkohej shumë, Hyzriu nuk hezitonte për asnjë moment.

Puna e madhe dhe përkushtimi me mish e me shpirtë për çlirimin e Kosovës, kishin bërë që Hyzri Rekaj të rrezikohej nga UDB-ja jugosllave. Dosja e tij sa vinte e trashej në sirtarët e Sekretariatit të Punëve të Brendëshme (SPB) të Ferizajt dhe pritej momenti i kthimit për burgosjen dhe dënimin me vite të gjata burgu. Kjo kishte bërë që Hyzriu të mos kthehej në vendlindjen e tij për dy dekada rresht. Jo pse friksohej personalisht, por pse i duhej çështjes kombëtare, u duhej bashkëveprimtarëve dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila

kishte nevojë shumë të madhe për veprimtarë të kalibrit të Hyzri Rekës.

Ai u kthye në Kosovë bashkë me çlirimin e Kosovës. U kthye që ti kontribuonte zhvillimit dhe përparimit të vendit sikurse çlirimit dhe pavarësisë, por sëmundja e pamshirëshme e rrëmbeu shpejtë. Hyzriu ndërroj jetë, por ka lënë mbrapa një veprimtari të madhe kombëtare që nuk vdes kurrë.

Hyzri Rekaj do të mbetet një shembull i mirë se si duhet të punohet për lirinë e vendit. Emri i tij do të shkruhet me shkronja të arta në ndonjërën nga rrugët e vendlindjes, e figura e tij një ditë do të përjetësohet në bronx, diku në sheshet e barrikadave kundër pushtuesve serbë!

Lavdi e përjetëshme jetës dhe veprës së Atdhetarit, Hyzri Rekaj!

Më, 7 korrik 2022, Zvicër Ismet Rashiti.

Dëfrim Ramadani

Hyzriun e kam njohur qysh kur isha fëmijë, sepse jemi nga i njejti fshat dhe familjet tona kanë pas gjithmonë raporte të mira. Përveç kësaj, babai im ka punuar dhe jetuar në Gjermani së bashku me dy vëllezërit e Hyzriut (Nebihu dhe Basriu).
Familja e gjerë e Hyzriut ka qenë një familje e arsimuar dhe atdhetare, dhe gjithmonë në shënjestër të pushtetit. Me Hyzriun nuk kishin shumë kontakte në Kosovë nga se dallonim në moshë dhe ai shumë i ri kishte emigruar në Gjermani, por i njihja vëllezërit e tij (Ganiun që e kisha drejtor shkolle dhe Shabiun që ishte arsimtar im i historisë).
Pas demonstratave të vitit '81 për Hyzriun dhe aktivitetin e tij patriotik fillova të dëgjoj çdo ditë e më shumë nga mërgimtarët të cilët vinin në Kosovë.
Në vitin '88 për shkak të përndjekjeve, u detyrova të arratisem edhe unë dhe të kërkoj azil në Gjermani. Aty pata rastin të njoh nga afër Hyzriun dhe punën e tij patriotike! Isha shumë më fat, sepse nga një idol, për mua Hyzriu u bë bashkëpunëtor, udhërrëfyes dhe mentor. Me rrinte afër dhe me këshillonte për çdo gjë. Kur fillova të frekuentoj klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf (për të cilin kisha dëgjuar qysh kur isha në Kosovë) e vërejta se Hyzriu ishte strumbullari i aktiviteteve politike, patriotike dhe kulturore në atë klub. Ishte katalizatori i të gjitha veprimtarive. Ishte i afërt me njerëzit, kishte kulturë komunikimi dhe mbi të gjitha kishte njohuri të gjithanshme.

Veprimtaria ynë e përbashkët në klubin "Emin Duraku" ishte shumë e ngushtë, ngase dy mandate ai ishte kryetar i klubit dhe unë sekretar. Ishin vitet kur klubi kishte vështirësi të mëdha ekzistenciale dhe rrezikonte të shuhej, për arsye të ndryshme, por falë punës dhe mundit të Hyzriut, klubi arriti të mbijetoj, dhe të bëhet qendër e gjithë spektrit politik të kohës. Në Gjermani në vitet 90-ta vërehej një lloj ndarje dhe divergjence mes grupimeve të ndryshme politike, por kjo nuk ndikonte të Hyzriu. Ai ishte i dashur për të gjithë, u ndihmonte të gjithëve dhe bashkëpunonte me të gjithë, pa dallim partie, apo orientimi politik. Për të kishte rëndësi që çështja jonë kombëtare të shkonte përpara. Kurrë nuk ka folur keq për njeri dhe kurrë nuk ka krijuar ndasi. Përkundrazi, ka qenë njeriu që i ka shuar gjakërat dhe i ka bashkuar njerëzit e spektreve të ndryshme politike. Për të nuk ekzistonin partitë, por atdheu. Atdheu ishte partia e tij! Në fillimin e viteve 90-ta, në kohën sa Hyzriu ishte kryetar i klubit u organizuan shumë demonstrata dhe manifestime të ndryshme, takime me struktura shtetërore gjermane, takime me liderët politik nga Kosova (Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Zekirja Cana, etj.) dhe pjesën më të madhe të këtyre aktiviteteve, ai i ka finansuar nga xhepi i vet, sepse buxheti i klubit nuk arrinte ti mbulonte të gjitha shpenzimet. Ishte i pa lodhshëm dhe i papërtueshëm. E donte popullin e tij të lirë dhe ishte i gatshëm të sakrifikonte gjithçka për të! Me netë të tëra rrinte pa gjumë dhe nuk ankohej! Mua më mungon vokabulari, që të përshkruaj Hyzriun si njeri, si atdhetar dhe si veprimtar i devotshëm i çështjes kombëtare. Për mua është emblema e intelektualizmit, patriotizmit, guximit, dhe atdhedashurisë. Këtë e ka dëshmuar me punën dhe veprën e tij.

Hasan Hoti

I lindur 19. 9. 1963 në Prishtinë.
Në Gjermani kam ardhur në vitin 1990 meqë me profesion jam kuzhinier, më ndihmuan disa shokë me familjar.
Kam nderin të marrë pjesë në këtë mongrafi për atdhetarin, patriotin dhe organizatorin e pa epur për çështjen kombëtare Hyzri Rekaj.
Unë shkova për herë të parë në lokalin e klubit shqiptar "Emrin Duraku" në vitin 1991. Meqë nga njohja kuptova se kishim të bëjmë me një fole atdhetare unë i shpeshtova takimet edhe angazhimet e mia nga viti 1992.
Unë jetoja dhe punoja në Rethin e Kleves në qytetin Goch.
Angazhimet fillestare ishin me disa shokë të cilët kishin bashkë-punonim të ngusht me Hyzriun, shokët në Goch ishin Hasan Kurtaj, Daut Tishuki, Gzim Nikçi, Dëfrim Ramadani, e shumë të tjerë.
Kontributi i Hyzriut ishte jashtzakonisht i madh, shumë dimensional, ai ishte i palodhshëm, udhëtonte nëpër shumë vendqëndrime të shqiptarëve, na vizitoj edhe në Goch me disa shokë, ishte i gatshëm për këshilla sygjerime, ishte i afërt me të gjithë, vepra, intelektualiteti i tj ka dëshmuar se mbi të gjitha në jetën e tij ishte Shqiptaria.
Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekës!

Gzim Nikqi

Përshëndetje bashkautor të Monografisë.
Unë Hyzriun e njoha diku në vitet 1992-93 me angazhimet tona të ndihmave humanitare për Atdheun tonë, edhe pse kontaktet tona nuk ishin të shpeshta sepse ishim nga një zonë larg Dysseldorfit, çdo herë në takimet tona më linte një përshtypje të veçant për ta takuar sa më shumë, sepse krijova bindje të veçantë se ishte një idealist dhe veprimtar i madh i çështjes kombëtare.
Hyzriu ishte një njeri shumë i qetë i afërt me një respekt shumë të ngrohtë njerëzor.
Angazhimet e tija për vendlindjen tonë ishin në çdo aspekt dhe çdo kohë pa u lodhur asnjëherë.
Kontributi i tij ka përmasat e një Heroj të vërtetë në shërbim të Atdheun tonë. Ishte fat i madh dhe nder i veçantë që njoha një burrë me zemër të pastër Shqiptare.
Përshëndetje të përzemërta nga Gzim Nikqi.

Bujar Neziri

Bacin Hyzri e kam takuar për herë të parë në Qendrën kulturore "Emin Duraku" kurse si emër e kam dëgjuar në vitet e 80 kur kam qenë në Kosovë për aktivitet e tij pasi që ishim të njejtit fshat dhe kanë qenë një familje patriotike, kur kam shkuar në vitin 1990 në Dysseldorf e kam takur në klubin "Emin Duraku" kam pas nderin të punojë me të edhe unë si anëtarë i kryesisë së klubit "Emin Duraku", baci Hyzri ka qenë gjithmon i qeshur bashkëpunues edhe na këshillonte se si duhet të kontribuojmë për çështje kombëtare pasi që ka qenë edhe kryetar i qendrës së klubit "Emin Duraku" në organizimet që janë bërë për demostrata, ndihma financiare, organizime të ndryshime që janë bë në Dysseldorf e rrethinë. Gjithmonë ka qenë unifikues, asnjëherë i njëanshëm me qëllime të qarta me karakter bashkimi pavarësisht se çfarë partie apo ideologjie ai gjithmonë thoshte kombi mbi gjitha, ka dhënë një kontribut të jashtëzonshem për bashkim të gjithve po asnjë dallim që ti kontibuojmë për Kosovën e okupuar një kontribut për mbledhjen e 3% pastaj për aksionin e atëherë të qeverisë në Egzil për fondin e armatimit ka ndihmuar për klubin futbollistik Kosova Dysseldorf që në fillimet e para nuk ka qenë aspak e lehtë, kontribues për ndihma për arsmin në Kosovë. Baci Hyzri gjithmonë na këshillonte për të mirë, ka qenë i gatshëm gjithmonë për çdo iniciativë me karakter kombëtarë duke qenë se shumicën e rasteve inicues i këtyre

organizimeve edhe këmbëngulës në arritjen e qëllimeve. Unë jam krenar që kam pas mundësinë ta njohë edhe të punojë me të, për mu ka qenë udhërrëfues edhe një Hero i çështjes kombëtare.
Me bacin Hyzri aktivitete në Demostrata në Bon, Vjenë, Bern. Pritje të Delegacioneve që vinin në atë kohë prej Kosove Bukoshi, Azem Shkreli, Adem Demaçi etj. Aksioni për armatim ku baci Hyzri ka qenë në këshillin inicues (unë i kam dhënë 10000 DM prej qeverisë i kam marrë 10 bona).
Baci Hyzri ishte emblema e organizimit shqiptar në Dysseldorf,
Lavdi jetës dhe veprës së Bacit Hyzri.

Arif Haliti

Me Veprimtarin dhe Patriotin Hyzri Rekaj, jam njohur në vitin

1992 në klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf.

Pasi që kam emigruar në Gjermani dhe jam vendosur në Dysseldorf, veprimtarinë time Politike, do të dëshiroja që ta vazhdoj edhe në Emigracion. Andaj menjëherë frekuentova klubin me Famë të madhe shqiptare në Dysseldorf, ku ky klub ishte një pikë e fortë e organizimit të emigracionit shqiptar.

Unë si i Ri dhe me një bagazh të pasur të aktivitetit tim politik në Kosovë, dëshiroja që menjëherë pa humbur kohë, të bie në kontakt me veprimtarët-patriotët shqiptar të emigracionit në Dysseldorf dhe ta vazhdoj aktivitetin tim politik për Kosovën tonë.

Andaj një Fat të madh kam patur që jam njohur me Patriotin e çështjes Kombëtare të madhin Hyzri Rekajn, dhe ne kemi patur një gjuhë të përbashkët për vazhdimin e aktiviteteve tona Politike.

Hyzriu kishte një autoritet të madh tek popullata e jonë, për vepritarin e tij Patriotike në Gjermani, andaj unë si djalë i Ri në emigracion dhe Jurist me Profesion, gjatë bisedave dhe diskutimeve tona gjetëm një gjuhë të përbashkët Politike dhe një përkrahje enorme për të rinjët entuziast për veprimtari Politike.

Unë me shokët e mi: Veseli, Sabriu, Arsimi kemi biseduar gjer e gjatë me Hyzriun, ku i kemi shpalos idet tona, vizionin e Presidentit Rugova dhe kemi ra dakord, që Hyzriun ta kemi promotorin-shtytësin dhe përkrahsin tonë në vazhdimin e aktiviteteve politike. Dhe këtë përkrahje e kemi patur gjer në shkuarjen e tij në Amshim. Aktivitetet e mia me Hyzri Rekajn kanë qenë të shumta:

Kemi qenë së bashku delegat në Nëndegën e LDK-së për NRW, të zgjedhur më 26.9.1993.

Unë jam zgjedhur Kryetar i Aktivit të LDK-së për Dysseldorf, kurse Hyzriu ka qenë Njeriu më i fuqishëm Politik i LDK-së në NRW. Simbol dhe emblemë e Organizimit të emigracionit në Dysseldorf dhe në Gjermani.

Andaj aktivitetet i kemi organizuar dhe drejtuar gjithmon me bekimin dhe udhëzimet briljante të Hyzriut.

Hyzriu ishte njëri ndër Patriotët më me përvojë dhe më me autoritet në emigracionin shqiptar, pas rënjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës.

Çdo mbrëmje përkujtimore, që nga data 22.1.1994 në lokalin „Artemis“ në Dysseldorf, të organizuar nga LDK-ja e Dysseldorfit, ku e drejtoja unë, pa përkrahjen e Hyzriut dhe Kontributin e tij, këto mbrëmje nuk do të kishin shkëlqesinë e tyre.

Çdo demonstrat e organizuar në Dysseldorf, si kjo e 19.2.1994 Hyzri Rekaj ka qenë Violina e Parë e Këshillit Organizativ.

Të gjitha mbrëmjet informative që i kam organizuar si Kryetar i LDK-së së Dysseldorfit, pa Patriotin Hyzri Rekajn nuk do të funksiononin, ashtu të Arta që shkëlqenin me prezencën e këtij Patrioti të madh shqiptar. Një mbrëmje e tillë ishte edhe ajo e organizuar me 27.2.1994 në Blücher str. 6 në Dysseldorf me Prof. Fehmi Aganin.

Çdo takim me palën Gjermane dhe njohtimet për internacionalizimin e çështjes së Kosovës, Hyzri Rekaj ka qenë në Ballë të delegacionit tonë.

Hyzriu ka qenë gjithmonë Unifikues i mërgatës shqiptare edhe pse ishin me bindje të ndryshme politike, kjo më së miri e dëshmon mbledhjet e përbashkëta të të gjitha subjeketeve politike të organizuar më 24 mars 1994 në Dysseldorf, ku Kryetar i Këshillit të tryezës ishte Hyzri Rekaj, me anëtarët Mufail Demiri, Nazmi Nuha, Haxhi Bega, Sylë Nuha, Arif Haliti, Muhamet Latifi, Sabri Shehu, Arsim Rexhepi.

Me Hyzriun kemi qenë të deleguar edhe nga nëndega e LDK-së për NRW për organizimin sa më të madh të aktiviteteve në Aktivat e LDK-së, si në aktivin e Viersenit me Kryetar Hilmi Gashin, aktivin e Heinsbergut me kryetar Abedin Gashin, aktivin e Krefeldit kryetar Sejdi Fekën.

Hyzri Rekaj është një Patriot me një bagazh të madh Kombëtar, një oganizator i shkëlqyer i mërgatës shqiptare, një burrë i fjalës dhe i besës. Jam shumë krenar që kam punuar së bashku me Hyzriun në organizimet dhe inter-nacionalizimin e çështjes kombëtare.

Pa Hyzri Rekajn Dysseldorfi kurrën e kurrës nuk do ta kishte pluralizimin e mendimeve të ndryshme politike.

Hyzri Rekaj ishte dhe përgjithmonë do të mbetet hero i çështjes kombëtare për Kosovën.

Tërë jetën dhe veprën ia kushtoi lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Unë ndihem shumë krenar që kam punuar së bashku me Hyzri Rekajn për vepën dhe figurën e tij madhore.

Hyzriu ishte, burrë i madh i Kosovës, njeri, mendje dhe zemër të madhe.

Me Hyzri Rekajn Dysseldorfi ka frymëzuar lirshëm me një mendim të lirë pluralist, inspirues dhe edukues shumë i mirë i gjeneratave që do të vijnë pas neve.

Veprimtaria politike e Patriotit Hyzri Rekajt, duhet që ti shpërblehet me emërimin e Klubit Kulturor “Hyzri Rekaj“ në Dysseldorf.

Lavdi dhe nderime të përjetshme jetës dhe veprës madhore të Hyzri Rekaj!

Mehmet Breznica

Hyzri Rekaj ky shërbestar i madh i çështjes shqiptare

E njoha në vitin 1993 në klubin "Emin Duraku" të Dysseldorfit. Klubi shqiptar në Dysseldorf kishte një histori në vete që lidhej edhe me emrin e këtij veprimtari të madh të çështjes shqiptare, Hyzri Rekaj. Hyzri Rekaj kishte emigruar herët nga Kosova, si pasojë e persekutimeve serbe të inelegjencës shqiptare në Kosovë. Ai veprimtarinë e vet kombëtare e kishte vazhduar edhe në Gjermani. Të gjitha klubet shqiptare në atë kohë mbikëqyreshin nga shërbimi sekret jugosllavë UDB-ja që vepronte atë kohë e maskuar nën petkun diplomatik brenda ambasadave jugosllave në Gjermani. Hyzriu bashkë me disa shqiptarë të tjerë patriot kishte arritur që ta shkëpuste këtë klub nga ndikimi i ambasadës jugosllave dhe ta shndërronte këtë klub në vatër të rezistencës kombëtare shqiptare, ku organizoheshin të gjitha veprimtarit kombëtare shqiptare, në përkrahje të kërkesave të rinisë shqiptare në demonstratat studentore të vitit 1981. Nga ky klub ku militonte atdhetari Hyzri Rekaj, ishin organizuar edhe shumë demonstrata në përkrahje të kërkesave të ligjshme të studentëve në Prishtinë për Kosovën Republikë. Pra, ky ishte klubi i parë shqiptarë në gjermani që ishte shkëputur nga tutela e ambasadës Jugosllave dhe ndikimi i saj, fal veprimtarit të çështjes sonë kombëtare,

Hizri Rekës me bashkëveprimtarëve të tjerë shqiptar. Më kujtohen ato kohë kur në emisionet e lajmeve në Kosovë, nga agjensitë e lajmeve në radio e në televizion stigmatizohej ky klub si "qerdhe e nacionalizmit shqiptar". Bile, më kujtohet kur në Dysseldorf pat shkuar një autobus me këngëtar të "bashkë-jetesës jugosllave" i sponsorizuar nga Ambasada Jugosllave për të dhënë një koncert me motive të kësaj bashkëjetese, Hyzriu bashkë me shokë e prishën këtë koncert duke brohoritur: "Kosova Republikë!". Autobusët e këtij pelegrinazhi të këtij koncerti me mision të diferencimit ideo-politik të shqiptarëve, u ngjyrosën të gjithë me parullën: "Kosova Republikë!". Këtë akt "anti jugosllav" e pasqyruan të nesërmen të gjitha mjetet e informimit në Jugosllavi. Të gjitha këto veprimtari të Klubit shqiptar të Dysseldorfit, ku Kryetar ishte Hyzri Rekaj, reflektoi dhe mobilizoi shumë rezistencën shqiptare në Kosovë. Nga të gjitha këto veprime atdhetare të Hyzri Rekajt në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare kishte tërbuar personelin e Ambasadës Jugosllave në Gjermani, e cila e kishte ndjekur Hyzri Rekën, por fal kujdesit të tij të shtuar, kishte arritur ti shpëtoi ndonjë atentati të mundshëm, sikur ai që ndodhi në Shtutgard me vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën me 17 janar të vitit 1982. Në këtë klub, ku Hyzri Rekaj ishe Kryetar, ishin organizuar edhe disa tubime informative dhe mobilizuese të dëshmorit Jusuf Gërvalla, pikërisht në organizimin e Hyzri Rekës me bashkë-veprimtar. Pra, me të gjitha këto veprime patriotike, në shërbim të Kombit dhe të Atdheut, Hyzri Rekaj kishte krijuar një autoritet të madh te mërgata shqiptare. Hyzri Rekaj nuk kishte ideologji, ai kishte përkushtim atdhetar. Ideologjia e tij ishte shqiptaria. Ai ishte një shërbestar i çështjes

shqiptare, pa dallim feje e ideje. Ai donte Kosovën me vise të lirë dhe të bashkuar me Nënën Shqipëri. Takimi im i parë pra me Hyzri Rekën në vitin 1993, Hyzri Rekën e gjeta si kryetar klubi dhe një ndër themeluesit e degës së LDK-ës në Dysseldorf. Dalja e LDK-ës në skenën politike shqiptare me 23 dhjetor 1989, Hyzri Rekën e kishte entuziazmuar shumë, pasiqë në krye të saj ishin vënë intelektualët më të mëdhenjë të Kosovës, në të cilën populli i kishte varë shpresat për liri dhe demokraci. Brenda kësaj partie veproja edhe unë. Në një Kuvend të Nord Rain Westfalen, bashkë me Hyzriun u zgjodhëm anëtarë të Kryesisë së këtij Landi. Bile, pikërisht Hyzri Rekaj brenda kësaj kryesie më pat propozuar si koordinator të kulturës brenda kësaj partie për Landin Nort Rajn Westfalen. Bashkë me Hyzri Rekën dhe me mësuesit e shkollave shqipe të këtij Landi, ndërtuam shoqëritë kulturore brenda klubeve shqiptare. Hyzri Rekaj ishte i palodhshëm. Ai më organizoi të gjitha takimet me Klubet shqiptare në këtë Land dhe me personelin mësimor të këtij Landi që në audicion më sollën nxënësit e tyre që ti ndërtoja këta mekanizma kulturorë që bashkonin shqiptarët. Vetëm formimi i një sektori që e kishim në projekt na dështoi. Ai ishte sektori i Radio amatorëve. Ky projekt na dështoi, jo me fajin tonë, por me fajin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzil. Ajo nuk na mbështeti me mjete financiare, e as moralisht. Krijimi i këtij sektori ishte shumë i rëndësishëm për situatat e reja që do të krijoheshin në Kosovë. Me përgatitjen e kuadrove brenda këtij sektori kishim për qëllim krijimin e disa grupeve të radistëve që do të komunikonin me radio-lidhje në rast lufte në Kosovë. Këtë sektor të rëndësisë së veçantë e kamufluam nën emrin e krijimit të Shoqatës së radio-

amatorëve dhe si të tillë mund ta regjistronim edhe në organet gjermane. Gjatë punës në terren, u lajmëruan edhe disa epror ushtarak shqiptar të ish armatës jugosllave të cilët kishin dezertuar dhe ishin të gatshëm që të viheshin në shërbim të Atdheut me të gjitha kapacitetet e tyre dhe e mirëpritën këtë iniciativë duke e ditur rëndësinë e saj në rast lufte në Kosovë. Por, mospërfillja e Qeverisë në egzil ishte zhgënjyese. Punën po thuaj njëvjeçare, në krijimin e këtyre Bashkësive Kulturore, ku Hyzri Rekaj kishte rol të veçantë, e kurorëzuam me 2 Korrik 1995, në përkujtim të Dekleratës Kushtetuese të 2 Korrikut në të cilën deputetët shqiptar të asaj kohe shpallën Kosovën Shtet të pavarur dhe demokratik. Asnjëherë më parë në emigracion e as në Kosovë nuk ishte shënuar kjo datë historike, deri këtë vit që e shënuam ne, me një shfaqje poetike që organizuam bashkë me nxënësit dhe personelin mësimor të këtij Landi, ku interpretova edhe vetë, bashkë me një kolegun tim aktor nga Maqedonia. Shfaqja poetike "Besa e brezave", në Dortmund pati jehonë edhe në shtypin gjerman, por edhe ju dha hapësirë edhe në lajmet në gjuhën shqipe në valët e radio Zagrebit. Shikuesit shqiptar e pritën me lot në sy dhe entuziazëm të madh këtë shfaqje me mesazh kombëtar. E veçanta e kësaj date është që asnjë personalitet udhëheqës të kreut të LDK-ës si dhe Qeverisë së Kosovës nuk iu përgjigjën që të jenë pjesë e këtij manifestimi, edhe pse të gjithëve iu kishim dërguar ftesat me kohë!? Nga Qeveria e Republikës së Kosovës kishte ardhur vetëm Mujë Rugova, i cili me një fjalë përshëndeti manifestimin. Kjo e dëshpëroi shumë Hyzriun dhe gjithë ne të tjerëve që kishim punuar shumë në këtë projekt, vetëm me shpenzimet tona materiale. Kjo ishte një kohë kur në diasporën

shqiptare në mërgim, kishte shpërthyer një luftë e madhe mes disa oponentëve të LDK-ës dhe Qeverisë së Kosovës në ekzil. Kjo luftë e brendshme brenda faktorit të brendshëm shqiptar, na ka marrë kohë shumë dhe krijuar përçarje të mëdha në veprimtarinë tonë kombëtare në diasporë. Edhe në këto raste, Hyzriu u tregua shumë i matur. Ai u tregua shumë i arsyeshëm dhe përgjatë tërë këtyre ndasive, luajti rolin përbashkues. Edhe mbajtja e Konferencës së Dejtonit, ku Kosova nuk u përfshi fare, e dëshpëroi shumë Hyzri Rekën. Ishte asociative atëherë kur ish Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Klaus Kinkel, në përgjigje të një letre plot shqetësim që i kishin dërguar ca bashkatdhetar tanë në lidhje më mospërfshirjen e Kosovës si pjesë e Konferencës së Dejtonit, ai pat deklaruar publikisht se "Në Dejton janë përfshirë vetëm palët që kanë luftuar". Kjo ishte një përgjigje mjaft diplomatike dhe asociative për rrugën që duhej ta ndiqte Kosova për të ardhur deri te pavarësia e vet. Si produkt i kësaj indinjate, Hyzri Rekaj pa hezitim përkrahu demonstratat e studentëve shqiptar në vitin 1997. Tani më për Hyzri Rekën çdo gjë ishte e qartë, çështja e Pavarësisë së Kosovës, mund të zgjidhej vetëm me luftë. Ai i pari në diasporën shqiptare, bashkë me Kryesinë e klubit shqiptar "Emin Duraku" organizoi demonstratën në Dysseldorf, në denoncimin e masakrës sërbe në Qirez, si dhe në mbështetje të shqiptarëve në Drenicë. Kjo demonstratë ishte një ndër demonstratat më emocionale dhe më mobilizuese të asaj kohe. Ajo që ra në sy në këtë protestë ishte fjalimi i zjarrtë i oratorit Sabri Shehut i cili të bëhej se nxirrte zjarr nga goja në dënimin e masakrës serbe në Qirez, me ç'rast ishte vrarë edhe mësuesi Halil Geci. Ajo që e karakterizonte Hyzriun ishte që ai gjith-

monë në demonstrata të tilla i favorizonte të rinjtë dhe kudo u jepte vend parësor. Kështu ndodhi edhe me rastin e vrasjes së familjes Jashari, si dhe Komandantit legjendar, Adem Jasharit. Me rastin e marrjes së këtij lajmi tragjik për Kombin shqiptar, në diasporën shqiptare mbretëronte një atmosferë e zymtë dhe shpërthyese. Hyzri Rekaj prapë ishte në krye të detyrës kombëtare, bashkë me grupin e të rinjve që kishte rreth vetës. Prapë ishte në krye të demonstratës kundër gjenocidit serb në Dysseldorf. Një popull i tërë ishte në këmbë në mbrojtje të dinjitetit dhe identitetit të vet. Ishte ndër të parët që në Klubin shqiptar në Dysseldorf organizoi aksionin: "Kosova ndihmon Drenicën", mjete këto që u dërguan në Drenicë, në zbutjen e situatës së rëndë humanitare. Me daljen e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hyzri Rekaj doli i pari publikisht që e përkrahu. Menjëherë pas tragjedisë në Prekaz dhe vrasjen e Komandantit legjendar, Adem Jasharit, Hyzri Rekaj formoi Shtabin e Emergjencës në Dysseldorf për tu vënë në shërbim të UÇK-ës me të gjitha kapacitetet mendore, materiale dhe fizike, bashkë me komunitetin shqiptar të Dysseldorfit. Të njejtat institucione së shpejti u formuan në tërë Evropën dhe kudo në botë ku kishte komunitet shqiptar. Këto institucione në pamje të parë dukeshin si institucione humanitare, por në esencë ishin institucione lufte ku mblidheshin mjete materiale dhe rekru-toheshin rekrut vullnetar për t'ju bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Së shpejti në Landin Nord Rajn Westvalen krijuam Kuvendin Shtabeve të Emërgjencës dhe zgjodhëm organet udhëheqëse të këtij organi, pjesë e të cilit ishte edhe Hyzri Rekaj. Përherë të parë brenda këtij institucioni në të cilën u unifikuan shtatë organizata humanitare shqiptare.

Ndër to më e organizuara ka qenë Shoqata humanitare: "Kosova" e udhëhequr nga një ish i burgosur politik, Avdi Fejza. Ky atdhetar, së bashku me shoqatën humanitare: "Kapanamur", mblodhi me miliona mjete materiale dhe veshmbathje dhe i dërgoi ndihmë materiale refugjatëve të Kosovës në Shqipëri. Kryesia e Shtabeve të Emërgjencës për Nord Rain Westfalen, anëtar i Kryesisë të së cilës ishte Hyzri Rekaj, organizoi në secilin qytet të këtij Landi demonstrata në sensibilizimin e opinionit botëror me situatën në Kosovë. Të gjitha këto demonstrata gjetën hapësirë edhe në të gjitha mjetet informative gjermane. Ishte koha kur UÇK-ja ende klasifikohej si organizatë terroriste, në bazë të kualifikimit të diplomatit amerikan Gelbard. Është me interes që të përmendet demonstrata që u organizua në Këln, nën masa të rrepta të sigurisë nga policia gjermane. Në këtë demonstratë kishim caktuar Hyzri Rekën si përfaqësues për mediat gjermane që të komunikonte në emër të demonstruesve. Këtë e bëmë përshkak të përvojës së tij në këtë veprimtari, si dhe në bazë të njohjes së tij perfekte të gjuhës gjermane. Orator të kësaj demonstrate kishim caktuar Sabri Shehun me disa të rijnë, që shkëlqyen me disiplinën dhe me oratorinë e tyre. Pjesëmarrja e shqiptarëve ishte masive duke filluar edhe me gratë me fëmijë të vegjël. Më kujtohet kur një agjensi e lajmeve, në intervistë me z. Hyzri Rekën, UÇK-ën e quajtën organizatë terroriste, Hyzri Rekaj reagoi duke thënë: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës është ushtri e popullit tonë të cilën e ka krijuar vetë populli për tu mbrojtur nga gjenocidi serb. Atë e ka krijuar vetë populli dhe vetë populli e ushqen dhe e financon. Pjesë e asaj ushtrie jemi edhe ne këtu që po e përkrahim dhe jemi të gatshëm që të gjithë të vihemi nën armë në

mbrojtje të popullit tone". Nga ajo deklaratë për shtyp të Hyzri Rekajt, nuk kemi dëgjuar më që në mjetet e informimit gjerman, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të quhej më organizatë terroriste. Të tilla Demonstrata me Hyzriun dhe Kryesinë, organizuam demonstrata në tërë qytetet e Landit Nord Rain Vestfalen edhe gjatë intervenimit të Nato-s në Kosovë. Në këtë periudhë kemi pasur edhe protesta të serbve kundër intervenimit të Nato-s në serbi, por në disa raste edhe i kemi pas shpërnda fizikisht. Kjo pra ishte jeta jonë në mërgim me patriotin Hyzri Rekaj. Pa gjumë, natë e ditë të angazhuar në mënyrë që të mund të bënim sa do një shërbesë të vogël për Komb dhe Atdhe. Të gjitha i bëmë me mjetet tona materiale. Por në të gjitha këto aktivitete kishim popullin e pa lodhur që na respektonte dhe na vinte prapa. Do ta kujtoja edhe një rast. Në Kempen humbi jetën tragjikisht një shqiptar nga Shqipëria dhe ishte java e tretë që mbahej në morg. Më erdhi një mik i imi dhe më tha që kishin ardhur një vëlla dhe djalë i axhës që ta merrnin kufomën por nuk kishin mjete materiale. Unë dola menjëherë që të mblidhja mjete në komunitetin shqiptar në Krefeld. Punova deri vonë në këtë drejtim, por shumën që mblodha nuk më dukej e mjaftueshme. I telefonova Hyzriut në ora njëzet dhe i tregova rastin. Ai u alarmua dhe më ftoi në Klubin e Dysseldorfit ku mblodhi një sasi të të hollove të cilat u bënë të mjaftueshme të cilat ia dhamë vëllait të viktimës dhe e nisëm Kufomën për Shqipëri. Ishte prekse momenti kur i dorëzova të hollat vëllait të viktimës. Ai u përlot dhe u falënderua duke thënë që për këto mjete materiale, do të më duhej që të punoja për gjashtë vite në Shqipëri dhe nuk do të mund që ti siguroja. Bashkë me mjetet materiale i dhamë edhe listën e kontribuesve. Në atë listë ishte edhe emri i Hyzri

Rekës, përveç që më ndihmoi në tubimin e mjeteve, ai kontribuoi edhe vetë. Në secilin aktivitet kombëtar, ishte i pranishëm Hyzri Rekaj. Pata fatin që e njoha dhe kontribuova me të. Për herë të fundit, u takuam në Kosovë në vitin 2007, pranë shtatores së Skënderbeut. Unë isha me ca shokë, kur një dorë më preku në kraharorë. Ktheve kokën prapa dhe pash Hyzriun. Një buzëqeshje e lehtë iu shqua nën mustaqe. U përqafuam. Nuk e dita që ky do të ishte takimi ynë i fundit. Të dytë evokuam kujtime nga emigracioni dhe bashkë iu gëzuam lirisë së Kosovës. Shpirti i tij pastë dritë në amshim! Respekt në shkallë kombëtare! Falemderit për krejt ato që bëre për lirinë e Kosovës. Prehu në paqe, miku im! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!

Tafil Januzi

Jam Tafil Januzi i lindur më 29.12.1958 në fshatin Revuq të komunës së Podujevës. Qysh në rini jam angazhuar në veprimtarinë kundër regjimit të atëhershëm serbo-jugosllav duke marrë pjesë aktive në demostratat e vitit 1981. Ndërsa, që nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës 1989, jam aktivist i saj, e gjithashtu edhe ushtarë i FARK-ut.

I ndjekur nga pushteti serb më 27.5.1992 kam migruar në Gjermani, në Dysseldorf. Pasi jam vendosur aty, jam bërë pjesë e klubit të shqiptarëve "Emin Duraku", të kësaj republike gjermane. Aty kam takuar patriotin dhe veprimtarin e çështjes kombëtare Hyzri Rekajn, i cili nga viti 1981 kishte bashkë-punuar me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Kadri Zekën, Zymer Kryeziun (bacin), Nazmi Nuhën.

Përmes Hyzriut jam ra në kontakt me Zymer Kryeziun, Nazmi Nuhën, Mufail Demirin, Arif Halitin e të tjerë. Hyzriu më ka treguar për veprimtarinë e tij politike dhe jemi angazhuar për organizimin e demonstratave në Dysseldorf, Bon, Bruksel, Gjenevë, Vjenë dhe Rambuje.

Hyzriu ishte një patriot i shquar i cili tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare dhe çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb.

Bashkë me Hyzriun kemi marrë pjesë në shumë manifestime për çështjen e Kosovës që organizoheshin në perëndim. Merrnim

pjesë edhe në organizimin e përvjetorëve të vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Hyzriu ka organizuar edhe pritje për udhëheqës e politikanë shqiptarë të Kosovës që vinin në Gjermani, siç ishin Fehmi Agani e Adem Demaçi.

Hyzriu me shokë ka organizuar edhe aksionin e grumbullimit të hollave dhe mjeteve të tjera për luftën në Kosovë. Ai ka organizuar edhe tubime të ndryshme me shoqata, patriotë e veprimtarë në klubet e shqiptarëve, në mënyrë që të dërgoheshin mjete në Kosovë për të ndihmuar formacionet ushtarake çlirimtare, qofshin ato të FARK-ut apo të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Hyzriu ishte njeri unifikues i të gjithë shqiptarëve dhe veprimtarëve të çështjes kombëtare pa dallim shteti a rajoni, që i takonin.

Me fjalë tjera Hyzriu ishte veprimtarë i palodhshëm dhe patriot që tërë jetën ia kushtoi çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb.

Me shkruarjen e tij, Kosova ka humbur një veprimtarë të rrallë, një hero e një patriot dhe një burrë të guximshëm.

Sejdi Sopi

Më 11 shtator 2017, në vendlindjen e tij Nerodime komuna e Ferizajt, u nda nga jeta, veprimtari i shquar kombëtar Hyzri Rekaj.
Hyzri Rekaj, nga viti 1978 e deri në kthimin e tij në atdhe më 1999, ishte veprimtar i dalluar në Dysseldorf, në klubin shqiptar "Emin Duraku" që nga themelimi.
Shpërthimi i demonstratave gjithë-popullore në Kosovë në pranverë të vitit 1981, Hyzriu, ndodhet në krye të klubit shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf, ku priu në të gjitha aktivitetet dhe demonstratat e mërgimtarëve në Dysseldorf në shenjë soli-darizimi me demonstratat e studentëve dhe popullit në Kosovë.
Përkrah veprimtarëve të shquar në Gjermani, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Ibrahim Kelmendi e shumë të tjerë, Hyzriu luajti rol të rëndësishëm në organizimin e mërgatës shqiptare në veprimtari patriotike. Me Hyzriun, më kanë ngelur kujtime të çmuara, si atdhetar, i kultivuar, i palodhur në veprimtari atdhetare, i përafërt, kolegial shembullor, sjellje shembullore dhe mik i dashur për të gjithë që e njohën dhe patën kënaqësinë të punojnë me të.
Me Hyzriun u njoha në nëntor 1982 në Gjenevë, kur erdhi me një grup bashkëveprimtarësh, për të koordinuar veprimtarinë e përbashkët kombëtare mes klubit "Emin Duraku" të Dysseldorfit dhe klubit shqiptar "Igballe Prishtina" në Gjenevë.

Gjatë punës dyditore në Gjenevë, u fascionova me njohuritë e tij të situatës politike në Kosovë dhe të shqiptarëve në hapësirën etnike në ish Jugosllavinë dhe kulturën që e karakterizonte në diskutime.

Urat e bashkëpunimit me Hyzriun mbetën të përhershme edhe pse në distancë, por me vendosjen time në Gjermani më 1991, bashkëpunimi ynë u intensifikua dhe deri në mbarim të luftës në Kosovë, thuajse në të gjitha aktivitetet ishim bashkëpjesëmarrës.

Hyzriu, pas luftës u kthye në Kosovë, ku hapi ordinancën e stomatologjisë, punoi me nder dhe përkushtim, si një patriot i dëshmuar.

Për emrin, veprën kolosale kombëtare dhe shembulltyrën e mikut tim të shtrenjtë Hyzri Rekaj, ruaj kujtimet më të mira, si njeri, bashkëveprimtar dhe atdhedashës, kontribues deri në ditën e fundit të jetës.

Lavdi dhe nderim i përjetshëm, jetës dhe veprës së patriotit Hyzri Rekaj!

Sadri Bega

I lindur më 13.7.1945, në fshatin Jezerc.
Në Gjermani kam ardhë, më 20 maj 1970, në Dysseldorf, ku takimi im i parë ishte me bashkëvendasit e mi, po të njejtit fshat, dhe atë me, Nazmi Nuhaj, Sylë Nuhaj, e Haxhi Bega. Më vonë u takuam edhe me bashkëveprimtarët tjerë, Nebih Reka, Samedin Ilazi, Ramadan Ramadani, Hyzri Rekaj, Ibrahim Kelmendi, e shumë të tjerë, me të cilët bisedonim nëpër banesa të njëri tjetrit në çdo fundjavë.
Më kujtohet sikur sot, kur po e jap këtë rrëfim, kur u ndava nga familja, jo me dëshirën time, por më vonë e kam kuptuar se shteti i Jugosllavisë, nuk e dëshironte që ne shqiptarët të punësohemi, e t'i edukojmë fëmijët, t'i shkollojmë dhe të qëndrojmë pranë tyre.
Shkëputja nga Familja ishte e rëndë, barra ju mbeti gjinisë femërore, për gjithë kujdesin për familje dhe rreth familjes. Ishte një ndjenjë e paparashikueshme, se si vetëm për ne shqiptarët, nuk kishte vende pune ndërsa për të tjerët as që bëhej fjalë.
Më vonë i kuptuam qëllimet e këtij shteti, të bazuar në programet e njohura e të organizuara mirë, që sa më pak shqiptarë të ketë Kosova.
Duhet përmendur gjithsesi, se puna ishte e garantuar nga firma "Jork Boker", që mirrej me ndërtimtari, si punëtorë krahu, nëpër punishte të ndryshme.

Kontaktin e parë me Hyzriun, e kam pas kur filluar së bashku, nëpër banesa të bisedonim se si të formojmë edhe ne një qerdhe të përbashkët, shqiptare për të senzibilizuar e promovuar vlerat dhe traditat tona në këtë gurbet të hidhur.

Këto biseda vazhduan çdo fundjavë, e sidomos në marsin e vitit 1978.

Në një fundjavë vendosëm që së bashku të përgadisim dokumentin për regjistrimin e një klubi, më kujtohet ku aty ishin prezent, Rrahman Bega, Nebih Reka, Nazmi Nuha, Mursel Nuha, Samedin Ilazi, Ibrahim Kelmendi, Ramadan Ramadani, e shumë e shumë mërgimtarë të tjerë që për fat të keq nuk më kujtohen të gjithë emrat.

Ideja për themelimin e klubit ishte që sa më shumë të përfshihen trojet shqiptare në ish Jugosllavi.

Qëndrimet për themelimin e klubit ishin njëzërit, që të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të quhet, ”Klubi i punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia Emin Duraku”.

Filluan kundërshtimet e para nga Konzullata Jugosllave, shkaku i emërtimit të emrit shqiptarë, mirëpo qëndrimi i ynë ishte stoik dhe i vendosur që ky emërtim të jetë ashtu sikurse ne dëshiruam. Këtu e kam vërejt vendosmërinë e Hyzriut që ishte këmbëngulës dhe i vendosur në qështje bashkë me të tjerët.

Duhet përmendur që kryetar i parë i zgjedhur Rrahman Bega, mirëpo ndodhi një rast jo i mirë nxitur nga Konzullata Jugosllave ku pësoi lëndime trupore. Pas tij si kryetar u zgjodh Nebih Reka dhe anëtarësia nëse nuk gaboj ka qenë mbi 300 anëtarë.

Gjatë vitit 1980 Nebihu u burgos dhe iu konfisku pasaporta dhe iu ndalua kthimi në Gjermani.

Kryetari i ardhshëm u zgjodh Hyzri Rekaj i cili ishte ndër ne më i shkolluari dhe kishte vizion të një intelektuali, ku do të udhëhiqte klubin me shumë mandate si kryetar.

Më kujtohet kur u formuan resourset e klubit grupi i teatrit, grupi i vallëtarëve, recitatorëve, sportit, në veçanti u hapën edhe kurset në gjuhën shqipe për ata të cilët nuk e kishin kryer shkollën fillore pra, klubi mori mbi supe si instuticion arsimor dhe i dha mundësi mërgimtarëve për t'u pajisur me dëftesa të shkollës fillore.

Ndihmë të madhe në këtë drejtim na dha nga ministria e arsimit të Kosovës Nehat Islami.

Gjatë vitit 1981 Hyzriun e kam parë si njeri që bashkë me kryesinë filluan që ti organizojë demonstratat për Kosovën Republikë. Një ndër demonstratat e para që u organizuan për përkrahjen e popullit shqiptarë ishte edhe ajo e Dusseldorfit, kuptohet që Hyzriu bashkë me kryesinë organizoi demonstratën pothuajse më të madhen në Gjermani.

Pas demonstratve të njëpasnjëshme edhe në vende tjera klubi "Emin Duraku" vendosi pllakatën "Kosova Republikë" në ballë të murëve të klubit dhe aty qëndroi deri sa u çlirua Kosova nga UÇK dhe Nato në krye me SHBA.

Vitet kaloni dhe koha ndryshonte, me ardhjen e pluralizmit politikë gjithandej ndryshuan edhe rrethanat edhe në mërgim u formuan degë të LDK-së si dhe të partive tjera ku edhe Hyzriu ishte i inkuadruar në këtë proces sepse u formuan instuticionet e Kosovës.

Këtu e kam parë Hyzriun duke potencuar se ne kemi nevojë për instucione shtetërore dhe këtu qëndron esenca e luftës tonë deri në çlirimin definitiv.
Hyzriu gëzonte një respekt të veçantë, kishte një durim taman të një lideri ku kishe edhe kundërshtarë në qështje ideologjike por me një buzëqeshje vëllazërore shumë bashkatëdhetarë i bënte për vete.
Më kujtohet kur Hyzriut iu pat ndaluar kthimi në vendlindje nga regjimi Jugosllav, mirëpo kur bisedonim rreth kësaj qështje ai gjithmonë potenconte se unë familje ju kam juve, kurr nuk ke mund të vëresh mungesën që kishte për familjen e ngushtë. Gjatë vitit 1992-1993 më kujtohet kur Hyzriu me kryesi dhanë propozimin që klubi të ndërroj emërtimin në "Qendra kulturore infromative shqiptare", vetë ndërrimi i emrit na tregon se nga kjo qendër u bashkuan të gjitha klubet shqiptare në Gjermani, ku si pikë referimi ishte klubi QKISH.
Hyzriu ishte një promotor i çështjeve madhore kombëtare, ku edhe gjatë luftës se UÇK-së klubi dha një kontribut jashtë-zakonisht të madh si në ndihma të luftës të të plagosurëve, ku nga ky klub organizuan edhe luftëtarë të lirisë, që shumë prej tyre ranë në altarin e lirisë.
Hyzriu ishte për mua një njeri i veçantë me tipare të larta kombëtare, i palëkundur në qëndrimet e tija, për unitet të përbashkët, të të gjithë shqiptarëve, për ta arritë lirinë e shumë kërkuar.
Ai pas 20 vitëve pas çlirimit të Kosovës u kthye ne vendlindje për të shijuar lirinë që aq shumë e deshti.

Për Hyzriun kam edhe shumë gjëra tjera të flasë por për t'u lënë të tjerëve rrëfimet e tyre unë Sadri Bega po e përmbylli këtë rrëfim me një dhimbje të madhe që Hyzriu i ndjerë nuk pat fatin që të vazhdojë jetën në liri ashtu siç edhe punoi për të. Për mua Hyzriu ka qenë një heroi i përpjekjëve për liri, idealist i dalluar kombëtarë.
I lehtë i qoftë dheu i Kosovës.

Vesel Ismaili

Gjykatës në gjykatën themelore Prishtinë

Të nderuar bashkëkombas, miqë e koleg Sabri Shehu dhe Shabi Rekaj.

Të shkruash dhe të evokosh kujtime për bashkëveprimtarin, atdhetarin dhe mikun tonë të dashur dhe të përjetshëm Hyzri Rekaj, fillimisht duhesh të vet-përmbahesh me emocionet që përjetojmë. Unë pata nderin dhe privelegjin që Hyzriun ta njoh në shkurt-mars të vitit 1992 në klubin kulturor shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf të Gjermanisë, në atë botë kur kemi qenë të detyruar nga okupatori barbarë serbë-qetnik të lëmë vendet e punës dhe atdheun tonë e ta marrim rrugën e kurbetit. Hyzriu me një dhembshuri, por me një zemër të madhe e bujare dhe mikëpritje të pashoqe na priti, na ofroj afër vehtes, duke na këshilluar, sugjeruar dhe udhëzuar se si të gjendemi në atdhe të huaj, si të sillemi dhe të punojmë që të huajve tu tregojmë për dinjitetin, sakrificën, dhe çështjen tonë të pazgjidhur kombëtare dhe shtetërore. Hyzriu me atë zë të ëmbël e të qetë, gjithëherë buzëgaz na mësoi ne të rinjëve që veç sa kishim emigruar nga një vend me represion, aparthejd me plotë tortura dhe masakrime si të bashkohemi njëri me tjetrin, si të kalojmë së bashku dhe si të angazhohemi për të dhënë kontributin maksimal për atdheun tonë siç thoshte ai "Edhe nga këtu bëhet shumë për atdheun dhe për kombin tonë". Për Hyzriun kurrë asnjëherë nuk ka qenë prioritet se nga cili regjion

vjen, nuk ka qenë bindja politike, fetare, mosha apo gjinia, nga se Hyzriu të ka shikuar dhe të ka pranuar vetëm si shqiptar. Për veprimtarinë kombëtare e atdhetare të Hyzriut unë e konsideroj vetën të vogël të themë, ngase kam frikë të madhe se nuk do t'ia dalë. E konsideroj të arsyshme ti themë vetëm disa fjalë rreth bashkë-veprimtarisë së përbashkët me veprimtarinë e pa-lodhshme të Hyzriut. Po të njejtin vit që u strehova në Dusseldorf, (ende pa lejeqëndrim fare, isha tërësisht me qëndrim ilegal) miku im dhe kolegu i studimeve Arif Haliti më dërgoi në lokalin e K.K.SH. (Emin Duraku) në Dysseldorf, aty u njohtova me shumë bashkatdhetarë tonë, më pritën shumë mirë, por siç theksova më lartë më i dalluari ishte Hyzriu, pas 2-3 javësh nga nata kur për herë të parë shkova në klube u organizuan zgjedhjet për kryesi të klubit, normalisht që unë ditën e parë që shkova në klube u anëtarësova dhe u pajisa me librezën e klubit (të cilën ende e posedoj) andaj në mbledhjen zgjedhore që tani data nuk më kujtohet por viti ka qenë 1992 vetë Hyzriu më propozoj për anëtarë të kryesisë së klubit, duke e dhënë edhe arsyen para anëtarëve të klubit pse po më propozon, një arsyetim të shkurtë, por konkrete dhe bindshëm për gjithë anëtarët. Më kujtohet shumë mirë kur ju tha se neve na duhen njerëz të ri, me përgaditje superiore që tani kemi mjaft siç është bashkatdhetari jonë Vesel Ismaili që me profesion është jurist i diplomuar dhe me një përvojë pune në organet e drejtësisë së Kosovës. Të rinjët të cilët vijnë nga Kosova t'i ofrojmë afër, ti këshillojmë t'u ndihmojmë dhe ti angazhojmë në organizime dhe aksione për çështje kombëtare, pa dallim regjionesh dhe feje. Falë diskutimit dhe apelit të Hyzriut unë i fitova votat e mjaftueshme për tu zgjedhë anëtarë i kryesisë së klubit, e që më pas nga

anëtarët e kryesisë së klubit u zgjodha në pozitën e sekretarit të kryesisë së klubit, pozitë që e ushtrova për dy mandate rreshtë. Kjo pozitë më obligoi edhe më shumë që të angazhohem dhe të veproj në të mirën e bashkatdhetarëve tonë në Dysseldorf me rrethinë po edhe më shumë për atdheun tonë, duke ndërmarrë aksione të ndryshme humanitare, siç ishin për arsimin shqip në Kosovë, për minatorët e Trepçës, e shumë aksione tjera për tërë popullatën shqiptare të Kosovës, por gjithnjë me inciativën, këshillimin dhe sygjerimin e Hyzri Rekaj, ai gjithnjë ishte i pa lodhshëm, i paprituesëm dhe i pakursyer si me mjete financiare ashtu edhe me punë, shpeshherë edhe duke mos kursyer edhe humbjen e orarit të punës së tij po edhe kohën kur është dashur që të kalon me familjen e tij të ngushtë ose të gjerë. Edhe kur bënim organizime për festa kombëtare siç ishin 28 nëntori, 2 korriku, 7 shtatori e të tjera gjithnjë referatet kam kërkuar prej Hyzriut që ai ti kontrollonte, ti korigjonte dhe të shtonte ato që unë i kisha harruar ose nuk i kisha ditur të shkruaj. Hyzriu gjithmonë ka qenë i afërt me bashkatdhetarët tonë pa dallim moshe siç e ceka edhe më lartë, banesa e tij ka qenë edhe një odë për gjithë bashkëkombasit tanë, ka qenë jashtëzakonisht mikëpritës i madh, bukëdhënës i pakursyer. Me Hyzriun unë kam qenë i priveligjuar se edhe pas kthimit në atdheun tonë kam pasur kontakte dhe vizita të ndërsjellta të vazhdueshme, jemi takuar shpesh, kemi biseduar për tema të ndryshme kemi marrë pjesë së bashku në promovim librash nga autor të ndryshëm shqiptar po kemi marrë pjesë edhe në varrimin e bashkatdhetarit dhe veprimtarit tonë Selim Kryeziu i cili ka ndërruar jetë në Dysseldorf e që Hyzriu e kishte përgaditur një fjalë mortore për veprimtarinë e Selimit e cila fjalë u prit shumë mirë nga të

pranishmit. Për Hyzriun ka çka të flitet shumë po gjithëherë me drojën që asnjëherë nuk mundesh me i përfshirë të gjithë veprimtarinë e tij në aspektin kombëtar e shtetëror, por edhe përkundër dhimbjes dhe pikllimit që Hyzriun nuk e kemi në mesin tonë, jam shumë i lumtur që arriti të përjetoj çlirimin e Kosovës dhe Pavarësinë e saj.

I qoftë i lehtë dheu i Kosovës që aq shumë e deshti.

Sadri Gashi

Në përkujtim të shokut Hyzri Rekaj

Shpaloj ca copëza kujtimesh për Hyzri Rekajn.

Për të folur, për të evokuar për veprimtarinë e çështjes sonë Kombëtare në Gjermani, Hyzri Rekajn, mikun e bashkëveprimtarin e Jusuf e Bardhosh Gërvallës, e Kadri Zekës, të Ibrahim e Muhamet Kelmendit dhe të kryetarit disa herë të klubit më të zëshëm në vitet e 80-ta në Gjermani e më gjerë të klubit "Emin Duraku" në Dysseldorf, kanë evokuar dhjetëra e dhjetëra shokë, miq e bashkatdhetarë të tjerë. Mirëpo meqë po insiston i vëllai i tij Shabiu do përpiqem t'i përshkruaj disa copëza kujtimesh për mikun, shokun tim tash i ndjeri dhe i pavdekshmi Hyzri Rekaj.

Me Hyzriun u njoha në shtator të vitit 1982. Dy tre muaj pasi u rehatova me banim në Gjermani, vajta me Idriz Bajrajn, me mikun shokun, bashkë-vendasin tim Idriz Bajrajn (tash i ndjerë) në klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf. Aty më pritën shumë mirë të dy bacat: baca Avdi, baca Zymer, Hyzriu, baca Jakup baca Nazmi, Sylë Nuha, Malush Ademaj dhe sa e sa të tjerë, që për hirë të natyrës së punimit s'po i ceku me emëra. Baca Avdi më tregoi se Hyzriu është kryetar klubi dhe me të mund të flasësh si me vëllanë se është shumë i afërt me secilin. Ashtu

edhe më doli. Mu bë mik, shokë e vëlla, se shoku i mirë shpesh herë zëvendëson edhe villain e gjakut.

Deri atëherë manifestimet kulturore, për nder të festave si moderator i udhëhiqte Hyzriu mbase ishte edhe orator shumë i mirë dhe tash në shenjë dashurie e respekti m'i la mua.

Në vitin 1983 në korrik, me një grup shokësh vizituam Shqipërinë Nënë, 14-të veta, të organizuar nga klubi "Emin Duraku". Meqë isha i papunë shokët kishin prerë biletën fluturuese me aeroplan Vjenë-Tiranë vajtje e ardhje. Kur shkuam në Shqipëri na pritën si më së miri. Fjetjen e kishim të siguruar për 14-të ditë në hotel "Alb Turizmi". Dhe pos kësaj e kishim një kombibus për të na shetitur nëpër disa vende, që ishin me vlera të mëdha historike e interetsante për ne. Kuptohet se me ne ishin dy shoqërues emrat e të cilëve s'po më kujtohen.

Secilën natë na pyesnin për ndonjë dëshirë tonën, që kishim për të nesërmen për të na plotësuasr. Vetëm një natë fjetëm në Shkodër të ndarë në dy a tri grupe. Të nesërmen duke ndejtur në një park rastisi të takoheshim me babain e heroit të punës Ismet Sali Bruqaj - me Sali Bruqajn, i cili përmes të birit të tij mua e Idriz Bajrës na i solli nga një kg duhan "Kotroban" të Shkodrës, të sapo vjelur nga Kooperativa kultivuese e duhanit.

Pastaj shokët të gjithë vajtën në vreshtë të rrushit për të parë dhe për të ngrënë rrush vreshte e unë u ndava nga shokët dhe dola për të vizituar bibliotekat e Shkodrës në kërkim ndonjë materiali arkivor për bacë Adem Demaçin. Me njërin prej shoqëruesve pastaj patëm një mosmarrëveshje të vogël pse unë s'mora pjesë në vizitë të vreshtës.

- Po ti s'ngrëne asnjë kalavesh rrush më tha.

- Për mua më shumë vlerë ka vizita që bëra nëpër bibliotekë se ndonjè kalavesh rrushi.

- Po, por përshkrimi i përshtypjeve në librin vizitues në emër të grupit.

- Po, atë e ka bërë shoku im Kryetari ynë - Shoku Hyzri Rekaj. Dhe besoj se e ka shkruar shumë mirë. Sepse kur mungoja unë i plotësonte Hyzriu. Ai ndoshta i shkruante edhe më mirë se unë, por grupi më pat zgjedhur mua.

A e shkrove Hyzri? - i thashe në sy të shoqëruesit?

E Hyzriu mu përgjigj:

"Po, po. E Shkrova Sadri. Por diçka s'po kërkon më tepër...?"
- Po, por unë kam pasë dëshirë që ti ta bësh... Unë s'kam asnjë vërejtje për Hyzriun. Një herë dolëm në plazhë të Durrësit dhe nisëm të luanim një ndeshje futbolli të vogël me vëllezërit nga Shqipëria. I emërtuam grupet futbollistike "Prishtina" për ne të Kosovës dhe "Tirana" për atë të Shqipërisë. Dhe ashtu siç pritej humbëm 7 me 1. Është me rëndësi të ceku edhe një rast në ditën e parafundit të vizitës sonë në Shqipëri. Mbasi drekuam erdhë arkëtari dhe po na pyet si do t'ia bëjmë me pagesën e ushqimit, fjetjes dhe shetitjes me kombi-bus? Ishin nga 269 dollarë.

Ne mbetëm si të shtangur nga se i kishim harxhuar të gjitha të hollat duke blerë gjësende nga Shqipëria dhe atë gjë as që e kishim menduar fare. Vetëm njëri nga 14-të veta kishte kredit kartë dhe të 13-të të tjerët ngelëm borxh t'ua dërgojmë përmes ambasadave. Njeri në formë humori shpotitës na thotë: "Mos u mërzitni fare! Rrini këtu të punoni deri sa të shlyeni borxhin". Për nder tonin organizuan një pjesë të koncertit të festivalit të Gjirokastrës, Rrethi i Durrësit.

Dhe pas koncertit morëm fotografi me rapsodët kosovarë nga Rrëshbulli në krye me Dervish Shaqën e Demush Nezirin. Dhe ata më dhanë këngën kushtuar atdhetarit Rifat Berisha për t'ia dërguar Shpendit - djalit të Dervishit që ishte në Zvicer për ta kënduar.

Dhe sot sa e sa i vjellin njëmijë e një të zezë gjoja për rexhimin e atëhershëm.

Me Hyzriun ishim shokë të mirë. Disa herë kam fjetur në banesë të tij. Mbasi ktheheshim nga demonstratat që i bënin në Zvicer, meqë ishte vonë të vija në Bochum, Hyzriu më merrte në banesë të tij, i cili atëbotë banonte së bashku me bacën Jakup (të martirizuarin në luftën e Jezercit). Ata të dy shkonin diku tjetër dhe unë me shoqe flija në banesën e tyre.

Në vitin 1985-86 unë isha sekretar e Hyzriu ishte kryetar i klubit "Emin Duraku" dhe çdo gjë funksiononte si më së miri. Atëbotë si çdoherë që ka aty-këtu ndonjë mosmarrëveshje me Hyzriun i zgjidhnim pa asnjë problem, ngase ishte i lindur dhe i brumosur vetëm për zgjedhje problemesh. Andaj shpesh herë i bëj pyetje të parreshtuara vetës time: Vallë pse kjo botë e sotshme po i humb ... vetëm njerëzit e mirë? Vetëm e vetëm që të jetojë pavdekësia a!!???

Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së Hyzri Rekajt!

Bochum, më 19 Nëntor 2021

Rifat Hamiti

Portreti i Hyzri Rekajt në mbamendjen time

Në fillim të ardhjes sime në Dyseldorf e pata pak të vështirë të integrohem në shoqërinë gjermane, për shkak të gjuhës, por nuk e pata fare të vështirë të inkuadrohem e të përshtatem me vullnet e me tërë qenjen time në rrethin e ri shoqëror shqiptar, të cilët kryesisht ishin të organizuar e tubuar rreth klubit të shqiptarëve nga Jugosllavia „Emin Duraku“ e edhe nëpër organizata e Parti politike.

Që në momentin e parë mësova se e gjithë anëtarësia përkrahnin dhe punonin për Kosovën Republikë, i cili mbishkrim kishte zënë vend në murin ballor të lokalit e shkruar në një pano me shkronja të mëdha të dimesioneve diku 2 x 1,5m. Shpejt e

mësova se shumica e anëtarësisë ishin punëtorë krahu, të paarsimuar dhe thirreshin në ideologjinë marksiste-leniniste. Kjo dëshmohej edhe me një fotografi të ideologëve të marksizmit Marksit-Engelsit e Leninit, që ishte vendosur në një mur të lokalit, në mesin e shumë fotografive e portreteve të figurave historike kombëtare, ku vend meritor zinin edhe vëllezërit Gërvalla, Jusufi e Bardhoshi që i kisha njohur mirë edhe personalisht dhe Kadri Zeka. E rëndësishme ishte se të gjithë anëtarët e klubit atë ideologji e kishin të akumuluar në dashurinë ndaj Shqipërisë, Enver Hoxhës, Kosovës dhe trojeve tjera etnike, për çlirimin dhe bashkimin e të cilave po punonin dhe vepronin me përkushtim të madh.

Ky orientim më gëzonte shumë dhe siç kam theksuar përherë figurativisht se „*Në klub gjeta teshat që më përshtateshin për trupin tim"*. Edhe unë vija me një ideologji e organizim të tillë. Si mësues dhe duke qenë në rrethin e ri shoqëror vendosa të veproja në bashkëpunim të ngushtë dhe në harmoni me platformën kombëtare, që në përgjithësi zhvillohej në kuadër të klubit, pra t'i shërbeja profesionit tim dhe përcaktimeve të mia politike e kombëtare.

Njeriu me të cilin u njoha që në fillim të hyrjes sime në klub ishte kryetari, Hyzri Rekaj, nga Nerodimja, me profesion teknik i dhëmbëve. Në kontaktet e para e pashë se ishte i përkushtruar në kauzën kombëtare, i zgjuar dhe njohës i mirë i rrethanave shoqëroro-politike në Atdhe dhe në botë. Me Hyzriun pos bashkëpunëtorë të ngusht gjatë gjithë kohës u bëmë edhe shokë të mirë e intim. Të gjitha aktivitetet e vendimet që merreshin në kuadër të QKISH „Emin Duraku" paraprakisht i diskutonim së

bashku me Hyzriun, dajën Hamdi (Gashi) e pastaj edhe me gjithë Kryesinë dhe anëtarësinë e klubit.

Unë erdha në Dyseldorf në kohën e themelimit të LDK-së në Kosovë, në dhjetor të vitit 1989, me kryetar Dr. Ibrahim Rugovën. Edhe në perëndim u formua Dega e LDK-së për Gjermani, me qendër në Shtutgart, Nëndegët nëpër Lande (Republika) dhe Aktivet nëpër qytete të mëdha përgjatë gjithë Gjermanisë. Një aktiv i LDK ishte formua edhe në qytetin e Dysseldorfit. Kryetar i parë i saj ishte zgjedhur Hyzri Rekaj. Pra në vitin 1991 Hyzriu barti edhe detyrën e kryetarit të klubit edhe atë të kryetarit të Aktivit të LDK-ës në Dysseldorf. Edhepse unë pa hezitim u inkuadrova në klub, anëtarësimin në LDK nuk e pëlqeja, jo për shkak të ndonjë dyshimi në filozofinë politike të saj, sepse atë e konsideroja si lëvizje gjithëpopullore, e cila do të punonte në rrafshin politik për çlirimin dhe mëvetësimin e Kosovës si shtet i pavarur, por për shkak se si mësues nuk dëshiroja të veshem me petkun partiak, edhepse kisha ardhur si militant i organizimeve ilegale në Kosovë. Si lëvizje gjithë-popullore e konsideronte edhe Hyzriu LDK-në, për këtë arsye edhe e kishte pranuar inkuadrimin në të dhe zgjedhjen për kryetar të Aktivit. Pas njohjes sonë më të thellë me Hyzriun kemi biseduar për shumë gjëra shoqërore e programatike, deri në intimitet të thellë, të cilat edhe sot e kësaj dite unë i mbaj në zemër e Hyzriu i ka marrë me vete në amshim.

Gjatë aktivitetit e vërejta se Hyzriut paksa ia zinin për të madhe disa nga aktiviste, që nga anëtari i LPRK, kishte pranuar të futej në LDK, madje edhe të udhëhiqte Aktivin në Dysseldorf. Por Hyzriu kishte marrë këtë detyrë që tani në mënyrë legale të punonte për të mirën e kombit dhe të Atdheut. Kur iu afrua koha

Hyzriut që të lejë mandatin e kryetarit të Aktivit, e të ngjitet më lartë në hiearkinë organizative të LDK-së, më pat thënë që unë të pranojë atë detyrë. I pata thënë se unë kam vendosur të punojë pa u kursyer në mesim dhe çështjen kombëtare, por nuk dua të marrë ngjyrime dhe detyra partiake, sepse mendoj se e dëmtoj shkollën shqipe. Më kujtohet më pat thënë: *„Po, se më lehtë është të punosh nën dhe se sa mbi dhe“.* E kishte fjalën për punë në ilegalitet dhe legalitet. Prandaj, kur ai mbaroi mandatin në vitin 1992 unë me pajtimin e të gjithë kryesisë pranova detyrën e kryetarit të Aktivit të LDK-ës në Dysseldorf, kurse ai shkoi në Kryesinë e Degës së LDK-së në Gjermani. Hyzriu anjëherë e në asnjë moment nuk shfaqte mosdurim e fanatizëm ndaj organizimeve tjera politike. Përkundrazi i vlerësonte ato por edhe pakursyer, si edhe unë, punonte për homogjenizimin e faktorit shqiptar në Dysseldorf e në Gjermani. Duke mos qenë partiak fanatik, ashtu siç njihej Hyzriu për unitet. Në atë kohë u formua Këshilli Koordinues i Partive dhe Shoqatave në Dysseldorf dhe më gjërë. Hyzriu ishte përkrahës i kompromiseve me të gjitha organizimet politike dhe homogjenizimin e tyre në interes të veprimit të përbashkët politik e atdhetar.

Me Hyzriun dhe dajën Hamdi, e nga viti 1995 kur erdhë edhe Halil Gashi, gazetar nga Peja takoheshim e bisedonim për problemet tona organizative në Dysseldorf edhe në banesat tona, pra u bëmë edhe miq shtëpie. Së bashku ishim në çdo situatë të mirë dhe nganjëherë edhe të vështirë. Në të gjitha situatat Hyzriu vepronte shumë me gjakftohtësi, me vendosmëri, mençuri, pa fanatizëm partiak dhe me përkushtim. Në hartimin e referateve e kumtesave që në të shumtën e rasteve ishin barrë e

imja, Hyzriu merrte pjesë me ide e përcaktime të drejta, të matura dhe të kjarta. Kohë pas kohe në gjëra të tilla na bashkangjitej, kur kishte kohë edhe Sabri Shehu, shokë e bashkëpunëtor i yni që nga viti 1992.

Pos Hyzriut në klub qendër unë njoha edhe shumë bashkatdhetar e anëtarë me disa prej të cilëve bashkëpunova e bashkëveprova gjatë gjithë jetës sime këtu në Gjermani, por bashkëpunëtorë i ngushtë e i pandarë për mua ishte Hyzriu, deri sa do të kthehej përfundimisht për në Kosovë por që edhe pas kthimit në atdhe kontaktet i mbanim në vazhdimësi.

Pak vite pas çlirimit të Kosovës, për të cilën gjë punoi shumë me vetmohim, Hyzriu pas qëndrimit mbi 25 vjeçar në Gjermani, prej të cilave mbi 20 vite pa të drejtë për të vizituar Kosovën nga përndjekjet që i bëheshin nga sigurimi sekret i Jugosllavisë, në vitin 2005 u kthye në Kosovë së bashku me bashkëshorten Jaklinën dhe vajzën Ilirianën dhe hapi Ordinancën Stomatologjike në vendlindje-Nerodime. Me këtë rast Qendra mbeti pa një aktivist të pashembullt, por edhe unë mbeta pa bashkëpunëtorin e bashkëveprimtarin më të ngusht, por e rëndësishme ishte se Hyzriu shkoi të shijojë lirinë e Kosovës që e deshti e punoi shumë për të.

Në Kosovë u kthye edhe Halil Gashi, i cili qëndronte me statusin e refugjatit në Gjermani dhe vazhdoi punën e gazetarit në Radio në Pejë. Ata u kthyen kurse unë dhe Hamdiu vazhduam punën këtu, së bashku me aktivistët tjerë të Qendrës. Megjithatë unë, por edhe Hamdiu vazhduam t'i mbajmë kontaktet dhe shoqërinë me ta edhe pas kthimit të tyre në Kosovë. Unë i vizitoja në shtëpitë e tyre në Nerodime e Pejë, por edhe ata më vizitonin në Mushtisht. Çdo 7 Mars unë e uroja

Hyzriun për ditëlindjen e tij, kurse ai më uronte Ditën e Mësuesit. Për fat të keq që të dy vdiqën pak herët Hyzriu në vitin 2017, kurse Halili në vitin 2021. Ata shkuan në amshim por mbrapa lanë kujtime të mira me angazhimin e tyre për çështjen kombëtare. Madje Hyzriu la edhe një monografi të vogël për klubin respektivisht Qendrën tonë të shkruar në vitin 2003. Një monografi voluminoze prej 445 faqesh la edhe Halili, e cila u botua në vitin 2020, por për shkak të pandemisë Covid-19 nuk kishte fatin ta promovonte, edhepse ishte caktuar vendi dhe data. Edhe Hamdi Gashi, i cili nuk iu nda aktivitetit asnjëherë, vdiq në janar të vitit 2021. Unë në të tri rastet ndjeva dhembje të madhe për të tre, se i pata shokë e bashkëpunëtorë të ngushtë për vite të tëra. Kur vdiq Hyzriu nje grup bashkë-veprimtarësh morëm pjesë në varrimin e tij, vendosëm një kurorë mbi varrin e tij dhe unë lexova fjalët lamtumirëse, të cilat do i shkruaj më posht.

Hafiz Gagica

Kujtimi për Hyzri Rekën, na vie si një obligim moral dhe kombëtar. Ikja e tij e hershme në amshim, na obligon edhe më shumë që të shkruajmë për Hyzriun, pasi që veprimtaria e tij u ndal para kohe. Me këtë rast dua ti përgëzoi vëllain dhe mikun e tij për librin monografik që po e përgatisin për vëllain dhe shokun e tyre por njëherësh për bashkëpunëtorin tim dhe veprimtarin e palodhshëm të çështjes kombëtare.

Lajmin për vdekjen e Hyzriut, e mora me vonesë. Ishte lajm i dhimbshëm sepse humbëm një njeri me vlera të larta burrërore e patriotike.

Me Hyzriun jam njohur në vitet e 80-ta. Ai në atë kohë ishte aktiv në klubin ''Emin Duraku'' në Dysseldorf. Duke qenë në postin e kryetarit të atij klubi, ai kishte krijuar kontakte dhe afërsi me të gjithë aktivistët e çështjes kombëtare, të cilët në atë kohë nuk kanë qenë të shumtë siç jemi tani. Patriotë të cilët e donin me shpirt dhe mendje Atdheun e tyre.

Hyzriu ishte i urtë, i matur dhe fjalëpak. Dallohej për punë, korrektësi dhe bashkërenditje të aktiviteteve kulturore, sportive por në veçanti ato me karakter kombëtar e patriotik. Fati i mirë i Hyzriut ishte që në rrethin ku vepronte, kishte një varg patriotësh të cilët koordinonin aktivitetet e tyre me lëvizjen kombëtare dhe të drejtat e shqiptarëve.

Angazhimet i tij për të mobilizuar dhe afruar mërgatën e rrethit të Dysseldorfit në protesta kundër dhunës që ushtronte regjimi jugosllav si dhe kërkesat për njohjen e pavarësisë së Kosovës ishin veprime që e bën Hyzriun një emër të respektuar ndër mërgimtarët. Poashtu ai ishte shumë aktiv edhe në kohën e thirrjes për t'iu bashkangjitur rezistencës kombëtare ndër mërgimtarët.

Hyzriu së bashku me një grup patriotësh nga viset e ndryshme të hapësirës shqiptare, si i ri ishte rreshtuar përkrah lëvizjes kombëtare për liri dhe pavarësi. Ai e kishte përkrahur në mënyrë aktive nismën e madhe të Jusuf Gërvallës për një mërgatë aktive politike, siç e kishte përkrahur edhe Kadri Zekën për një mobilizim të gjithë bashkëkombasve tanë për lirinë e Kosovës.

Hyzriu, do të dallohet në krijimin e urave mes të gjitha grupmoshave dhe grupeve politike të kohës që gravitonin në Dysseldorf, në rrethinë si dhe gjithandej në Gjermani.

Fundi i viteve 80 ta, Hyzriun si shumicën e mërgatës do e gjejë në përkrahje të fuqishme të rezistencës kombëtare të Kosovës. Në mbrojtje të institucioneve të asaj kohe dhe me themelimin e LDK-së, në Kosovë. Ai do të rreshtohet ndër të parët në këshillin nismëtar për themelimin e LDK-së, në Dysseldorf dhe Gjermani dhe kështu nga 6 maji 1990 ai edhe do të zgjidhet anëtarë i kryesisë së Degës në Gjermani.

Hyzriu ka kontribuar në mbarvajtjen e tubimeve informative për bashkëkombasit tanë, ka kontribuar në afirmimin e fondit të parë humanitar legal me seli në Aachen, kryetar i të cilit ka qenë, Marjan Tunaj, fondi i themeluar në nëntor 1990, ka ndihmuar minatorët e Trepçës, sindikatën e arsimit, shëndetësisë,

komisionin e solidariteit të LDK-së, si dhe shoqatën Nënë Tereza.

Hyzriu gjithashtu ka kontribuar në themelimin e fondit për vetëmbrojtje, fond i cili ka ndihmuar organizimin e rezistencës kombëtare, që për opinion njihet me grupet e para të ushtruara në Shqipëri në vitin 1991, por ai kryesisht ka ndihmuar rezistencën e gjithëmbarshme në Kosovë dhe konsolidimin e mekanizmave të vetëmbrojtjes në Kosovë.

Nga viti 1992, kur edhe fillon punën Qeveria e Kosovës në eksil, fillimisht me seli në Shtutgart, Hyzriu do jetë përkrahës i fuqishëm i institucioneve të Republikës së Kosovës edhe pse ato institucione ishin jashtë vendit. Me kohë do të provojnë për të krijuar dualisëm në politikën kosovare apo për të qenë më konkret Qeveria e Kosovës në perëndim me kohë do filloj ti kundërvihet politikës së Presidentit Rugova i cili me urtësi po provonte të afirmonte çështjen e Pavarësisë së Kosovës.

Hyzriu për asnjë çast nuk u ndal së punuari për afirmimin e politikës së LDK-së, që zhvillonim në Gjermani dhe e cila ishte pjesë përbërëse e politikës së LDK-së, në Kosovë e kryesuar nga Kryetari Rugova!

Hyzriu ishte gjithënjë aktiv në tubime, fjala e tij kishte peshë të veçantë. Ai ishte një burrë i ngritur, njohës i mirë i rrethanave politike dhe artikulonte qartë në frymën patriotike dhe shtetërore.

Për Hyrziun, mund të flitet dhe shkruhet shumë, siç mund të shkruhet edhe për një varg veprimtarësh, për të cilët kemi obligim të flasim në mënyrë që të plotësojmë historikun e angazhimeve patriotike për lirinë e Kosovës që kanë zhvilluar bashkatëdhetarët tanë. Ndër to janë protestat e vazhdueshme për afirmimin e çështjes shqiptare dhe demonstrimin e një force reale edhe jashtë vendit, ku merrnin pjesë me dhjetra mijëra bashkëkombas dhe përfqësues politik të shtetit gjerman.

Duhet të shkruhet dhe të përjetësohet ajo kohë dhe punë e palodhëshme e njerëzve tanë, siç ishte Hyzri Reka.
Ai do të mbetet, njeri nga aktivistën e dalluar të mërgatës shqiptare në Gjermani dhe në Dysseldorf me rethinë në veçanti. Puna, sakrifica dhe dëshira për të ndihmuar, Luftën Çlirimtare e Hyzriut dhe e mijëra mërgimtarëve patriot, u jetësua me 12 qershor 1999, me lirinë e Kosovës dhe me 17 shkurt 2008, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.
Hyzriu u kthye për të jetuar në Kosovë, atje ku ndihej mirë, atje ku e kishte përkundur nëna e tij. Atje ku kishte pa ëndërrat e para nën qiellin e Kosovës, ku edhe dielli rrezon më ndryshe.
Tani atje përjetshëm i pushon trupi.
I qoftë i lehtë dheu i vendlindjes të cilën e deshti për të cilën punoj dhe ku prehet tani!
Lavdi jetës dhe veprës së veprimtarit Hyzri Rekës.

Sabri Shehu

Hyzri Rekaj - figurë qendrore e organizimit shqiptar në Dysseldorf

Fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta shënon fillimin e fundit të krijesës artificiale të quajtur Jugasllavi, krijesë kjo e formuar në kurriz të kombit shqiptarë. Kjo dridhje tektonike e këtij shteti dhe shpërbërja me dhunë e më vonshme e tij, ishte paralajmëruar edhe nga udhëheqësi i shtetit shqiptar Enver Hoxha. Duke bërë një rikapitullim të një të kaluare jo shumë të largët, mund të themi me shumë bindje se, një kontribut madhor në këtë rikonfigurim të kufinjëve ka luajtur edhe emigracioni shqiptare por jo vetëm. Figurat qendrore të organizimit të mërgatës shqiptare në fund të viteve të 70-ta u bënë vëllezërit (Jusuf, Bardhosh) Gërvalla dhe Kadri Zeka, të cilët kontribuan fuqishëm në çdo kënd ku ishin bashkatdhetarët tanë në formësimin dhe mirëorganizimin atdhetar.

Të frymëzuar nga një frymë e shëndosh kombëtare që po fryente, edhe bashkatdhetarët në Dysseldorf, me Hyzri Rekajn në ballë, shumëfishuan veprimtarinë në shërbim të atdheut. Hyzriu me shokë krijuan lidhje bashkëpunimi organizativ dhe vëllazëror me Jusufin dhe Kadriun, këtë fakt e ilustrojmë edhe me pjesëmarrjen e tij me shokë në martesën e Kadri Zekës me Saime Isufin.

Në fund të vitit 92 për shkak të dhunës serbe, si shumë të rinjë tjerë, u detyrova edhe unë të lëshoj atdheun për t'u vendosur në qytetin e Dysseldorfit (NRW) të Gjermanisë. Më rastisi të vija në periudhën e festave të Nëntorit prandaj edhe pata mundësi të merrja pjesë në një manifestim të organizuar nga Klubi shqiptar "Emin Duraku" për nder të festës së Flamurit. Ky moment ishte njohja e parë me bartësit e aktivitetit kombëtar në Dysseldorf në kuadër të klubit.

Duke u ndarë i kënaqur me punën e tyre vendosa të bëhem edhe unë pjesë e tyre për t'a dhënë kontributin tim modest. Duhet theksuar se në këtë qytet, pjesa më e madhe e bashkatdhetarëve vinin nga vija edhe unë, pra nga Ferizaj dhe rrethina, prandaj shpejt vendosa kontaktet fillestare. Jo vetëm që kontaktova por kur iu tregova për rrugëtimin tim jetësor më mirëpritën vëllazërisht. Këtu njoha edhe bartësin kryesor të aktiviteteve, njeriun që me shokët e vet kishte shndërruar Dysseldorfin në qendër graviteti të atdhetarizmit në Gjermani dhe jo vetëm, dhe ai ishte i urti Hyzri Rekaj.

Pamja e tij elegante dhe buzëqeshur përherë, afërsia dhe ngrohtësia vëllazërore, sinqeriteti, atdhedashuria e zjarrtë, vizioni për rrugën që duhet ndjekur, gatishmëria për bashkë-punim edhe me ata që nuk mendonin si ai, ishin vlerat që e bënin të kompletuar si njeri dhe si karakter.

Pasi i tregova për arsyet e ardhjes dhe gatishmërinë time për të kontribuar, më uroj mirëseardhje duke më dhënë një pasqyrë të aktivitetit të shqiptarëve në Dysseldorf por pa folur asnjëherë në vetën e parë. Kjo formë e bisedës më bëri të krijoj simpati të veçantë dhe të shoh si flakadan dhe flamurtar organizativ.

Prej vitit 1993 u bëra bashkëpunëtor për aq sa më lejonin rrethanat. Nga 9 maj i vitit 1981 kur kishin organizuar demostratën e parë në diasporë në përkrahje të studentëve në Kosovë raportet me Konsullatën Jugosllave ishin bërë tani më armiqësore dhe me këtë iu pamundësua shumë aktivistëve kthimi në atdhe, ndër ta natyrisht edhe Hyzriut pasi ishte balli organizativ. Kjo periudhë shënon prerjen përfundimtare dhe kapitullin e ri në rrugëtimin jetësor si individ dhe si komunitet. Hyzri Rekaj kishte punuar në shumë plane për të ngritur moralin kombëtar tek bashkëkombasit, ai kishte shkruar pamflete dhe trakte të ndryshme, kishte shpërndarë literaturë me përmbajtje patriotike, kishte organizuar mbrëmje duke shfaqur filma shqiptar, duke mbajtur fjalime të zjarrta mobilizuese për kohën, me një fjalë ishte shndërruar në një simbol që rrezatonte dritë lirie. Nuk ishte e lehte të pranosh të bëhesh syrgjyn gjallë, të pranosh një sakrificë për moskthim në atdhe pa e ditur për sa kohë, por kjo përballohej vetëm me bindjen se fitorja do të jetë e sigurt, vetëm kjo bindje ishte ushqimi shpirtëror për të marshuar edhe më fuqishëm në rrugëtimin liridashës.

Hapja e shkollës shqipe në Dysseldorf me mësues Rifat Hamitin ishte një ngjarje me rëndësi të veçantë në organizimin e mëtejmë sepse përmes shkollës shqipe shumë prindër u bashkangjitën në aktivitete të ndryshme duke e thelluar edhe më tej punën në shërbim të vendit. Tani përmes shkollës shqipe çdo manifestim pasurohej me këngët patriotike të nxënësve dhe vallet e ndryshme të tyre duke kontribuar shumë edhe në ruajtjen e identitetit kombëtar tek brezi i ri.

Hyzri Rekaj ishte një personalitet me bindje institucionale, organizimi klandestin përmban rreziqe thoshte ai sepse armiku e

ka lehtë të rekrutoj njerëz brenda, prandaj edhe dalja publike e një organizimi të parë politik (Lidhja Demokratike e Kosovës) në atdhe, do të gëzojë pa masë dhe pa asnjë hezitim do t'a gjejmë me veprimtarët e parë në themelimin e degëve në diasporë. Edhe pse tani filloj të veproj i angazhuar në një parti politike qëllimi i tij i kalonte kufinjtë partiak prandaj edhe duke iu falënderuar kontributit të tij në Dysseldorf asnjëherë nuk kishim përplasje politike, edhe atëherë kur paraqiteshin element të tillë shpejt arrinim që të tillët të demaskoheshin menjëherë.

Por edhe pse kjo forcë politike mendohej si lëvizje kombëtare, periudha e mëvonshme do të qartësoj pozicionin e segmenteve të caktuar të udhëheqjes politike që duke mbrojtur me fanatizëm një pozicion të caktuar politik filluan me "Gjuajtjen e shtrigave" duke luftuar fuqishëm të gjithë zërat që mendonin ndryshe. Duke parë këtë frymë të re brenda partisë dhe duke qenë i bindur se vepronte në interes të të gjithëve Hyzri Rekaj largohet nga strukturat partiake duke iu kthyer edhe më me përkushtim fuqizimit të Klubit Shqiptar "Emin Duraku" që për hirë të vërtetës me propozimin tim u shndërrua në Qendër Kulturore Informative Shqiptare "Emin Duraku".

Tani rrethanat në atdhe kishin ndryshuar, shteti jugosllav kishte filluar shpërbërjen, për ne ishte një sinjal se lufta ishte e pashmangshme. Gjithë fokusi i aktivitetit ishte në ruajtjen e unitetit kombëtar dhe përkrahjen me të gjitha format e nevojave që paraqiteshin në atdhe. U punua shumë në fondin e Qeverisë së Kosovës duke mundësuar në këtë formë funksionimin e shumë segmenteve bazike por më vonë edhe ndihmën e madhe për fondin "Vendlindja thërret" duke kontribuar në forcimin e krahut luftarak që mori emrin Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Më 2 Mars 1998 u organizua një demostratë e fuqishme para Landtagut në Dysseldorf duke shprehur publikisht përkrahjen për UÇK-ën dhe duke ftuar rininë që të bashkohen në frontin e luftës për të luftuar me të gjitha mjetet ushtrinë kriminale serbe që kishte shndërruar Kosovën në një arenë përgjakjesh dhe krimeve të panumërta. Kjo demostratë do të mbahet në mendje si ngjarja më masovike që organizoj QKISh "Emin Duraku" me Hyzri Rekajn në ballë. Gazetat dhe Televizioni gjerman NTV i dhanë publicitet dhe pasqyruan në formën më të mirë kërkesat tona dhe apelin për botën demokratike që të ndihmohet ushtria dhe populli jonë i cili gjindej para momentit hamletian "Të jesh apo të mos jesh".

Ngjarjet në muajt në vazhdim morën drejtimin edhe më të rrezikshëm duke e bërë Kosovën një tokë të djegur dhe të pastruar etnikisht nga elementi shqiptar. Ky zhvillim imponoj organizimin e një konference ndërkombëtare të njohur si Konferenca e Rambujesë, QKISh "Emin Duraku" organizoj autobus me bashkatdhetarë për të shkuar në Rambuje në përkrahje të delegacionit Shqiptar. Qendra jonë ishte bërë bazë e organizimit dhe e takimeve të ndryshme në përkrahje të UÇK-së. Nga Dysseldorfi ishin mbledhur miliona euro dhe ishin rekrutuar shumë ushtar që luftuan nën emblemën e ushtrisë sonë të lavdishme, UÇK-së. Nga qendra e Dysseldorfit u dërgua me ushqime një aeroplan ushtarak gjerman që do mbetet në historinë e aktivitetit si ngjarje shumë e rëndësishme. Duhet falënderuar shtetin gjerman që në këtë periudhë ka dhënë një mbështetje të parezervë qendrës sonë dhe aktivitetit tonë në luftë për çlirimin e vendit.

Përpjekja dhe lufta e Hyzriut me shokë të ndihmuar nga bota demokratike me ShBA, Gjermaninë dhe shtete tjera u kurorëzuan me çlirimin e Kosovës. Dëshira dhe vullneti jetësor i Hyzriut u realizua prandaj vendosi ti thotë lamtumirë shtetit gjerman duke u kthyer në atdhe për të dhënë kontribut në sferën e profesionit të tij si teknik i dhëmbëve.

Por ajo dëshirë e madhe për të jetuar dhe kontribuar në atdheun e munguar gjatë fatëkeqësisht iu pamundësua nga një sëmundje e rënd që iu paraqit. Hyzri Rekaj vdiq në vendlindjen e tij duke u mbuluar me dheun e asaj toke për të cilën luftoj tërë jetën.

Hyzri Rekaj hynë në radhën e misionarëve atdhetar që gjason me figurat e periudhës së rilindjes kombëtare si Nikolla Naços e shumë të tjerë, që dhanë çka patën për lirinë dhe përparimin e atdheut. Ai ishte një hero i gjallë i organizimit shqiptar, heronjët mbeten të gjallë edhe pas vdekjes sepse rrugëtimi i tyre jetësor i bënë të përjetshëm. Brezat e ardhshëm do të mësojnë në libra emrin e tij si figurë me vlera të mëdha që dha gjithçka që kishte për çlirimin e vendit.

Jeta dhe vepra e Hyzri Rekës është referencë për të gjithë brezat që vijnë, ai mbetet në historinë e lavdisë shqiptare.

Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekës.

Jacquelina Rekaj Baetsen

E lindur më 9.12.1952 në Roermond të Holandës.

Me Hyzriun jam njohur më 19 prill të vitit 1985, në një mbrëmje rinore në Dyseldorf të Gjermanisë, ku rastësisht në një bisedë, gjatë vallëzimit me të më la një përshtypje jashtëzakonisht të veçantë, si person me veti të veçanta.

Në atë kohë unë isha me vendbanim në Mönchengladbach ndërsa Hyzriu në Dysseldorf. Kaluan dy vite duke u takuar e njohur thellësisht deri sa vendosëm të gjejmë një banesë të përbashkët në Erftal të Neussit. Ku u vendosëm pikërisht në dhjetor të vitit 1987.

Arsyja pse u vendosëm në Neus ishte puna e Hyzriut si Teknik i dhëmbëve që gjendej ne Qendër të qytetit. Gjatë këtij viti kemi kaluar çaste mjaftë të bukura e të lumtura, ku së bashku me Hyzriun vendosëm që të martohemi, pikërisht më 6 prill 1988.

Hyzriu shpesh më rrëfente për familjen e vetë atje në Kosovë, si dhe më tregonte për ngjarjet të cilat ndodhnin në Kosovë nga regjimi i Jugosllavisë kundër popullit shqiptar, dhe aty e kam vërejtë Hyzriun se kishte një dashuri të madhe ndaj atdheut, për mua ishte e vështirë ta kuptoja, mirëpo më vonë duke e mësuar gjuhën shqipe, shumë shpejtë fillova të integrohem në traditat shqiptare dhe gjërat më interesonin pa masë, sepse Hyzriun këto gjëra e mundonin.

Gjatë këtyre viteve Hyzriu gjithnjë më rrëfente se kur kanë filluar demostratat e vitit 1981 në Kosovë, dhe si i kemi

përkrahë ato këtu në Dysseldorf bashkë me bashkatdhetarët. Ai gjithmonë fliste me një admirim, ku ishte shumë i vendosur drejt rrugës të cilën, gjithmonë thoshte se ne duhet të i fitojmë të drejtat tona të cilat na i kanë mohuar me shekuj.

Një ditë më kujtohet kur më pat thënë se unë e kam të ndaluar të shkoj ne vendlindje që nga viti 1980, nga pushteti Jugosllavë, atëherë e kuptova se bashkëshorti im kishte një ideal të fortë që rrallëkush mund ta kishte. Edhe unë si bashkëshorte e tij fillova ta mbështes me tërë qenjën njerëzore duke i dhënë shpresë dhe duke e mbështetur në çdo aktivitet të tij.

Aktivitetet i zhvillonte në klubin "Emin Duraku" ne Dysseldorf ku aty ishte një qerdhe familjare e mërgimtarëve ku pothuajse çdo fundjavë ishim prezentë së bashku. Aty Hyzriu më njoftonte me aktivitetet të cilat i ndërmerrnin së bashku. Gradualisht fillova të njoftohem edhe me gratë e shokëve të Hyzriut, ku gjithnjë e më shumë integrohesha me ndihmën e tyre.

Situata në Kosovë filloj të vështirësohej edhe më shumë kur filloj greva e minatorëve të Trepçës, dhe më vonë kur u bë Suprimimi i Kushtetutës të vitit 1989, atëherë popullata filloj të emigroj në Gjermani si dhe në vendet perëndimore.

Më kujtohet në verë të vitit 1988 tek ne arriti djali i vëllait të Hyzriut Zaimi (Nebihut), ku qëndroj plot 4 vite tek ne. Hyzriu e ndiente vehtën më të avansuar familjarisht. Pastaj në fund të këtij viti, nëntor kisha nderin dhe kënaqësinë të i njohtoj tani edhe prindërit e Hyzriut që kishin ardhur të na vizitonin, babain Bajram e nënën Shukrije. Kemi kaluar një kohë shumë të bukur së bashku me ta, ku ishin njerëz shumë zemërgjerë e të dashur, bile mua më kanë respektuar si të isha vajza e tyre. Ky respekt të

cilët edhe ata e kishin ndaj meje, unë isha jashtëzakonisht e lumtur dhe e dashur me ta, sepse isha e mallëngjyer për arsye se prindërit e mi nuk i kisha më, prandaj unë fillova t'i respektoj si prindërit e mi.

Jeta dhe bashkëshortësia me Hyzriun ishte një jetë të cilën arrita që përmes Hyzriut të mësoj shpejtë edhe gjuhën dhe kulturën shqiptare për të cilën isha shumë e lumtur sepse aty gjeta një bujari e një respekt të paparë deri më tani. Hyzriu si gjithnjë vazhdonte të punonte në punën e tij teknik i dhëmbëve mirëpo, fundjava e tij bashkë me mua ishte klubi që bënte aktivitete me shokët e tij.

Pas një kohe perëndija na gëzoj me një vajzë, më 19 qershor 1989, ku Hyzriu e quante princeshë e babit, ku e pagëzuam me emrin lliriana. Nga viti 1988 unë po thuajse për çdo vit kam shkuar në Kosovë, ku pritja më është bërë me shumë respekt prej të gjithë familjarëve të Hyzriut. Hyzriu e kishte të ndaluar tokën e Kosovës nga regjimi i Jugosllavisë si njeri i rrezikshëm për atë shtet, edhe pse aktivitetet e klubit ishin për të drejtat elementare për të gjithë kombet siç ishin shqiptarët e Kosovës në këto vite që i përmenda së bashku me Hyzriun gjithmonë e kemi ndihmuar familjen me gjësende, e edhe me mjete financiare aq sa kemi pas mundësi. Sepse situara e krijuar në atë kohë ishte tejet e vështirë e sidomos pas vitit 1989 e këndej kur u suprimua Kushtetuta e 1974 nga regjimi serbo-sllavë.

Në klub dhe nga klubi organizonim protesta demostrata në përkrahje të qëndrimeve e të drejtat tona për liri e barazi.

Më kujtohet kur Hyzriu me shokë organizuan që klubi "Emin Duraku" pasi që në këtë klub frekuentonin edhe shqiptarët nga viset tjera shqiptare, atëherë u vendos që klubi të ndryshoj

emërtimin nga klubi i punëtorëve shqiptar nga Jugosllavi të quhet QKISH “Emin Duraku”.
Aty në klub shpesh organizonim edhe pritjen e 28 Nëntorit, pritjet e vitit të ri me familje të shumta që ndodheshin në Dysseldorf me rrethinë.
Ai si kryetar i klubit u angazhonte edhe për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, një prej tyre më kujtohet kur kam qenë e angazhuar për shkollën në Neuss ku edhe e arritëm qëllimin, që sot e kësaj dite ekziston.
Gjithashtu më kujtohet edhe kur ishte në LDK, por edhe kur punonte me shokë për çështjen kombëtare ishte gjithnjë i gatshëm të jepte kontributin maksimal, kurr nuk ishte i kënaqur me punën që e bënte, gjithnjë thoshte: mirë është po ka qenë dashtë të bëhet edhe më mirë e më shumë për Kosovën.
Gjatë vitit 1989 deri në vitin 1992 në Gjermani arritën të vijnë vëllezërit e Hyzriut, së pari Basriu, Halili dhe Nebihu, me çka ishte një lehtësim mjaftë i madh për Hyzriun, ku një pjesë të familjes e kishte pranë vehtes, ku edhe këta filluan të i ndihmojnë në çështjen e klubit të organizimeve të ndryshme që u bënte në atë kohë.
Në kohën e luftës Hyzriu bashkë me bashkëveprimtarët u angazhuan për t’i ndihmuar luftës së UÇK-së me mjete financiare, me paketa në veshëmbathje në ushqim mirëpo ndihma më e madhe përveç 3% klubi me rrethinë me sa mbaj mend ka qenë ndihma më e madhe nëse nuk gaboj në perëndim e qe besa edhe në botë nga mërgimtarët tanë.
Unë me ju tregu drejt përveç ndihmës që i dhashë burrit tim ndihesha shumë krenare për punën e tij të palodhur, shumë i

dalluar, ku si person e kishte një zemër të madhe, si një idealist i përbetuar i çështjes kombëtare.
Veprat të cilat i bënte me përkushtim të thellë e domethënës, më dukej se ishte i lindur një patriot, hero për kauzën tonë kombëtare.
Të gjitha këto kujtime që i përmenda unë gjithnjë kam qëndruar pranë tij, ku e kam mbështet dhe i kam dhënë ndihmën e pakursyer.
Pas përfundimit të luftës 1999 kur u lirua Kosova Hyzriu kishte një gëzim të madh për ta pa Kosovën pas 19 viteve.
Në verë të vitit 1999 u nisëm për Kosovë bashkë me vajzën Ilirianën dhe vëllain Nebihun. Hyzriu ishte shumë i gëzuar dhe i emocionuar kur hyri në vendlindjen e vet që aq shumë i kishte munguar, por megjithatë i përballonte si gjithmonë, atë e mundonte shumë nëna e tij që kishte ndërruar jetë më 26 prill të atij viti, ku me emocione të thella më tha se kishte me qenë mirë të më priste sot në Kosovën e lirë.
Mirëpo si gjithmonë Hyzriu ishte shumë i durueshëm, i kuptueshëm për ngjarjet që kanë ndodhur në vendlindjen e tij.
Ajo ditë ishte edhe gëzim por kishte edhe momente shumë prekëse, ku vendosëm të shkojme tek motra e madhe Miradija në Varosh.
Aty na priten si është më së miri. Të nesërmen shkuam në Nerodime, ku pamë tmerre. Të gjitha shtëpitë e djegura, nga okupatori Serbo-sllave, kur e pyeta Hyzriun se si po e ndien vehten ai mu përgjigj: Nuk mund të besoj këtë tragjedi, por kur e di se çfarë armiku kemi pas prap se prap jeta duhet vazhduar. Me keqardhje po e them se Hyzriu edhe në këtë situatë të rëndë kishte fuqi të i përballoj.

Pas 2 dite kemi shkuar tek varri i babait në Nerodime, i kemi bë nderime me kurora lulesh, mirëpo Hyzriu nuk u përmbajtë me lotë në sy, duke i referuar se O baba im edhe pse je në amshim po të tregoj se liria na erdhi në Kosovë. Këto ishin fjalët e Hyzriut, të cilat edhe mua si gruaja e tij më lanë mbresa, dhe quditesha si mundet njeriu të gjejë fjalët e duhura ndaj prindit të vet. Të nesërmen shkuam në Varosh ku aty ishte varrosur nëna e tij në prill të vitit 1999. Bile kishte qenë e malltretuar nga paramilitaret serbë që ishin futur në këtë fshat tek motra Miradije.

Morëm një kurorë dhe ju afruam varrit të nënës, aty nuk mundi të përmbahej dhe shpërtheu në lotë, i kërkoj "Hallallin" qante me zë, me një ofshamë të thellë tha: Oj Nanë pse s'më prite edhe pak!! ja ku erdha në Kosovën e lirë.

Kësaj radhe në Kosovë qendruam tri javë, në Varosh duhet cekur se mikëpritja ishte jashtëzakonishtë e ngrohtë si nga dhëndërri Shefqeti nipat mbesat e gjithë farefisi i tyre. Ata ishin kujdesur edhe për nënën tonë në kohë lufte në mënyrën më të mirë të mundshme.

Hyzriu kishte dëshirë e vullnet shumë të madhe të kthehet në Kosovë, kishte dëshirë të ndërtonte një shtëpi, mirëpo gjatë vitit 2000 ishim të zanun në martesën e Eshrefit me Biankën vajzën time të madhe.

Nga viti 2001 deri në vitin 2002 së bashku me Hyzriun arritëm të ndërtojmë një shtëpi në Nerodime, ku ëndërra e tij për të qëndruar i lirë në Kosovë gradualishtë realizohej. Nga viti 2002 deri në vitin 2005 pushimet i kemi kaluar në Nerodime në shtëpinë tonë, kurse prej 1999 deri në 2002 pushimet i kemi kaluar në Varosh tek motra Miradije.

Në vitin 2005 Hyzriu bashkë me mua definitivisht vendosëm të kthehemi përgjithmonë. Hyzriu kishte një vullnet jashtë-zakonishtë të madh për vendlindjen e vet, ku gjithnjë më thoshte, nuk mund të qëndroj më në kurbet. Është koha që të çmallem me familje e me farefisin tim që aq shumë më ka munguar.

U organizuam si më së miri, deri në korrik e mobiluam edhe shtëpinë, ku bashkë me mobilim nga gjermania sollëm edhe një laboratorë të kompletuar, ku Hyzriu do të fillonte punën e vet private në Kosovë.

Ashtu edhe u bë në korrik të vitit 2005 definitivisht u kthyem për Kosovë.

Kur u vendosëm dhe ja filloje punës me vullnet si gjithmonë çdo ditë pasha në fytyrën e tij plot buzëqeshje, harmoni me farefis e me shokë të cilët na vinin për vizita. Ai shpejtë u inkuadrua në punën e tij si teknik i dhëmbëve me mjekët në Ferizaj, ku kishte një përparësi nga të tjerët, edhe për punën shumë vjeçare në gjermani por edhe për Laboratorin që e kishim sjellë nga Gjermania.

Ishte i flaktë që vajzën llirianën ta regjistroj në gjimnaz drejtimi shkencat natyrore, ashtu edhe u bë, gjithnjë dëshirat e tij plotësoheshin, sepse punët i bënte me plotë dashuri e pasion.

Dal nga dal filluam të rehabilitohemi në vendlindje që aq shumë e deshti dhe e ëndërroj Hyzriu këtë vand të bekuar. Puna dhe vepra e tij që punoj me përkushtim më të madh, për lirinë e Kosovës iu shpërblye më 17 shkurt 2008 kur u shpallë Pavarësia e shumëpritur e Kosovës, bile atë ditë me vëllezërit e Hyzriut

ishim në qendër të qytetit nën ekrane të mëdha, kur u shpallë Shteti ynë i pavarur. Unë pashë në fytyrën e Hyzriut një emocion të paparashikueshëm, por edhe një gëzim të paparë deri në ato momente. Mua mu duk sikur e gjithë bota po qëndronte në zemrën e tij.

Iliriana pas kryerjes së gjimnazit, si çdo femër e gjeti fatin e vet me Faruk Regjepin nga Slivova e që jetonte në Gjermani, ku edhe u martua.

Hyzriu e unë si prindë e përcjellëm vajzën tonë ashtu siç e donë traditat tona. Ajo më 31.7.2009 u martua në Duisburg të Gjermanisë. Pas martesës llirianes i lindi një vajzë 10 korrik 2010 Aida, ku Hyzriu bashkë me mua ishim të gëzuar pa mas për lindjen e mbesës tonë. Pas lindjes së vajzës lliriana kreu shkollën e lartë si të Hyzriut Teknike e dhëmbëve me çka Hyzriu e kishte një ëndërr që profesionin e tij të vazhdoj pikërisht vajza e tij, ku në Janar të viti 2015 diplomoj për këtë profesion. Tek Hyzriu pashë një gëzim të papërshkruar, ku edhe vetë mori pjesë kur mori diplomën me notë shumë të mirë.

Hyzriu ishte shumë i angazhuar edhe në punën e fshatit për të rregulluar infrastrukturën, disa vite ishte edhe kryetar i fshatit edhe pse kishte shumë punë të tjera në laboratorin e tij. Kishte shumë kërkesa nga Komuna që të punoj më lartë, mirëpo i refuzoj të gjitha, dëshironte ta rregullonte fshatin e vet ashtu siç duhet. Punoj në shumë projekte të fshatit dhe bëri lidhje të mira me Komunën për infrastrukturë të lartëpërmendur.

Më 29 korrik 2015 vajza jonë lindi një djal Argintin ku na erdhi edhe një gëzim tjetër, një nip i mrekullueshëm me çka bëheshim krenarë së bashku e gjithë familja.

Mund të them se jeta në Kosovë ishte perfekte jetonim të lumtur edhe si familje, por edhe me farefisë të gjerë. Lumturia vinte gjithnjë duke u shtuar, ku Hyzriu shpesh përmendte vitet e shumta që nuk ka qenë në Kosovë, mirëpo përmendte edhe prindërit të cilët nuk e kishin përjetuar ardhjen e tij.

Viti 2016 ishte një vit jo i mirë për ne, ku filluan çrregullimet shëndetësore, megjithatë, kishte një forcë të pazëvendësueshme, kurajo për jetë. Në atë verë shkuam së bashku me familje me nipër e mbesa me Halilin e Nafijen, dhe me vëllain tim Pjetrin në Shëngjin ku kaluam për mrekulli.

Hyzriu gjithmonë thoshte unë kam qenë e do të jem i fortë. Këto fjalë ishin inkurajuese për neve familjarët. Për të larguar sa më shpejtë këtë sëmudje të rëndë vendosi të operohet në QKUK në Prishtinë me shpresën se do të kaloj sipas informacioni të mjekëve, në spital qëndroj 5 ditë i shoqëruar nga unë dhe personeli mjekësor. Gjendja e tij filloj të përmirësohet dhe të gjithë menduam se përfundoj kjo sëmundje e rëndë. Në dhjetor të vitit 2016 erdhëm për vizitë tek vajza si çdo herë, pas dy tri jave Hyzriu prap nuk ndihej mirë, dhe filloj kontrollat tek mjekët gjerman, në disa kontrolla rutine e të detajuara prap na u kthye lajmi i zi!! Kanceri ju kishte shpërndarë në pjesët ashtore. Mjekët filluan rrezatimin, pas një kohe hyri edhe në terapi kimike çdo katër javë, mirëpo sëmundjen e kishte shumë agresive edhe pse kishte imunitet të jashtëzakonshëm, ku shpesh potenconte se do të ia dalë edhe kësaj pengese. Terapia e fundit ishte me disa kapsulla më modernja që kishte dalë, mirëpo prap se prap nuk pati sukses. Mjeku preferoj të përdorë edhe medikamente mjekësore të natyrës bio nga mjekët alternativ popullorë. Pas kthimit në Kosovë diku kah korriku na erdhi një

informatë nga një mjeke popullore në Tuz në Mal të Zi. Hyzriu dëshironte të i provoj të gjitha mundësitë për t'u shëruar, nuk dëshironte të lë jetën, pasi donte të jetojë e të luftojë për të. Shkuam me Zaimin e Burimin ku edhe e morëm atë bari, filloj të përdori, për një kohë mirë e ndjente vehten, mirëpo agresiviteti i kancerit po e bënte të vehten, filloj të lodhej dhe gradualishte e humbte apetitin. U angazhuam bashkë me Shabiun me një mjek shtëpiak si dhe me onkologun në Prishtinë për t'i ndihmuar e për të ia shtuar apetitin, mirëpo çdo ditë sëmundja vinte duke e kapluar, ku filloj të lodhej me të madhe. Më 10 shtator 2017 ishte nata e fundit ku ndërruam biseda, pra ishin fjalët e fundit që na i la.

Të nesërmen me 11 shtator 2017 ndërroj jetë në ora 11.08 h. Kjo çka ndodhi ishte një padrejtësi e madhe për Hyzriun, shumë pak e shijoj larinë e Kosovës, shumë pak e shijoj vendlindjen ku kishte lindur, shumë pak e shijoj familjen e farefisin. Hyzriu kishte nevojë të jetojë edhe shumë më gjatë sepse ishte një njeri i dalluar me karakter të veçantë. Hyzriu nuk ishte vetëm një bashkëshort por edhe shokë, ka qenë një baba i mrekullueshëm. Kemi pasur një jetë shumë të lumtur së bashku.

Do të na mbetet gjithmonë në zemrat tona, do të mbetet në kujtimet dhe veprat e tij të paharruara për kauzën tonë kombëtare. Me lot e pikëllim, 13.9.2017 u bë varrimi me nder e ceremoni madhështore siç ishte vetë vepra e tij.

Qofshin të paharruara kujtimet për të.

Për Hyzriun i qoftë i lehtë dheu i Kosovës!!!

Hamdi Gashi

Në fillim ju falenderoj për mundësinë që më jepni të flasë për kontributin atdhetar të Hyzri Rekës. Unë vëllaun e Hyzriut (Nebihun) e njoha në fillimet e para kur e regjistruam klubin dhe në telashet që patëm me Konsullatën Jugosllave.

Mandej një dekadë unë nuk kam qenë joaktiv. Me fillimin e çfaqjes së LDK-së unë u angazhova në formimin dhe masivizimin e saj, pikërisht ky ka qenë momenti kur kemi filluar bashkëpunimin përmbajtësor me Hyzriun.

Gjatë angazhimit tim me Hyzriun do t'i përmend dy momente pikante krahas gjithë aktivitetit tjetër që është bërë.

Një ditë Hyzriu më njoftoj (viti 1993 ose 1994 nuk më kujtohet saktësisht) se kyetari i Kuvendit të Shqipërisë z. Pjetër Arbnori gjendet në vizitë në Gjermani në ambasadën shqiptare (atëherë ishte në Bon) dhe se duhej organizuar një konferencë për shtyp, unë menjëherë marrë në telefon kryeredaktorin e gazetës "Rheinische Post" z. Subota dhe e njofotj për rastin dhe e pyes për mundësinë e mbajtjes se një konference për shtyp, ai më pyet se për kur, unë i them menjeherë, kështu që në një kohë rekorde organizuam këtë konferencë. Pastaj mundësuam edhe takimin me kryetaren e Parlamentit (Bundestagut) Federal znj. Rita Süssmuth. Prandaj me këtë veprim Hyzriu me shokë i bëri një ndihmesë shumë të madhe shtetit shqiptar.

Një ngjarje tjetër por që më ka mbetur në mbamendje dhe që është për të përmend ka qenë ndihmat që kemi dërguar në Shqipëri gjatë luftës në Kosovë 1999, besoj se kemi qenë i vetmi qytet në diasporë që kemi arritur përmes miqëve në institucione shtetërore të dërgojmë një aeroplan ushtarak me ndihma për ushtarë dhe civilë, këto ndihma janë mbledhur nga Qendra Kulturore Informative Shqiptare "Emin Duraku" në Dysseldorf.
Pra kjo tregon më së miri edhe nivelin e organizimit dhe potencialin e madh organizativ që kishim, prandaj për këtë periudhë ndihem krenar që isha pjesë e pandashme e Hyzriut dhe shokëve të tjerë.
QKISH "Emin Duraku" gjatë kohës së luftës në Kosovë ka dhënë kontribut shembullor si në ndihma materiale, logjistike, informative dhe në rekrutimin e të rinjëve në frontet e luftës.
Pra me një fjalë z. Hyzri Rekaj ka qenë bërthama e organizimit të shqiptarëve në Dysseldorf. Jeta dhe vepra e tij heroike ka qenë përherë në shërbim të atdheut dhe interesit kombëtar, i qoftë i lehtë dheu i Kosovës që shumë e deshi!
Lavdi veprimtarit Hyzri Rekaj.

Enver Hoxha – Klein

Përkujtime në nderim për bacin Hyzri!

Emri i bacës Hyzri Rekaj lidhet pashkëputshëm dhe është i

ndërlidhur drejtpërdrejt më emrin e klubit famë-madh kulturor dhe arsimor të qytetit të Dysseldorfit siç nuk mund të imagjinohet po i njejti pa bacën Hyzri.

Klubi "Emin Duraku", një qendër graviteti i veprimtarisē atdhetare spikati jo vetëm në nivel federal tē shtetit gjerman por gëzonte reputacion në nivel perëndimor të shteteve tjera.

Duke i shkruar këto rreshta dhe përpiluar këtë evokim dedikuar atdhetarit të dalluar më pedigre bacës Hyzri Rekës siç iu referoheshim në shenjë respekti për mirësjelljen e tij në komunikim më ne dhe bashkatdhetarë të tjerë më duhet të lëshohëm për herë të parë (pasi më është ofruar ky nder nga Shabi Rekaj) në retrospektiv në një kohë të shkuar në të kaluarën kujtime gati të shlyera ndër kohë nga kujtesa që mezi arrihen të ringjallën përmes kujtimeve të vagullta që datojnë mbi qerek shekulli nga fillim vitet e 90-ta kur unë dhe vëllai im Fadili u rikthyem nga Kosova pas mbylljes së shkollave shqipe që ngjau me suprimimin, zhbërjen juridike të dhunshëm të statusit autonom që mbante Kosova deri më atëherë.

Fadili dhe unë jetuam nga viti 1982 (pas demonstratave të '81shit) deri në 1990 në qytetin e Ferizajt, komunë nga e cila vinte edhe baca Hyzri.

Duhet cekur së klubin "Emin Duraku" e kemi në mbamendje edhe para së të vinim për jetesë dhe shkollim në Kosovë nga vitet e 70-ta, ambientet e të cilit në krijimin e tij fillestar gjendeshin në afërsi të stacionit kryesor të trenit të Dysseldorfit në rrugën ....., hapësirat që i ngjanin një ode tipike zbukuruar më qylyma dhe instrumente muzikore të varur në murë në katin e dytë apo të tretë të një ndërtesë aty pranë.

Ambientet e "Emin Durakut" do ti shkelnim sërish pas gati një dekade të qëndrimit tonë në Kosovë në një bodrum disa katësh të nëndheshëm përgjatë rrugës Kölnerstrasse aty ku gjindet edhe parkingu i tramvajave (U-Bahn Station).

Ai ambient i ngjante më tepër një bunkeri atomik së sa i bënte nder një klubi kulturor por pavarësisht këtij gjykimi ne vinim gati rregullisht fundjavevë më babanë (Gani Budakova) nga Krefeldi për të takuar dhe kaluar çaste më bashkatdhetarët tjerë të cilët konsideronin njëri tjetrin më respekt dhe trajtonim gati si familjar.

Këtu fillojnë edhe kujtimet e kontakteve të para më bacën Hyzri i cili ishte një shokë dhe bashkëveprimtar mē babin tonë Ganiun.

Ndonëse ne si të rinj adoleshent kishim diferencë të madhe në moshë, baca Hyzri na paraqitej gjithnjë më mirësjelljen dhe buzëqeshjen e tij tipike që ishte karakteristikë e tij e dalluar.

Takimet e bashkatdhëtarëve ndodhnin rendomtë ditëve të fundjavës nga e premte, shtunë, të dielave. Aso kohë nuk ekzistonin celularët personal siç janë pjesë e pandashme e

çdonjërit nga ne në ditët tona sot, andaj takimet ndodhnin befasisht këndshëm.

Janë kujtime të një kohë kur Shqiptarët si komunitet ishin të pavërejtshëm, të panjohur në metropolet e mëdha perëndimore, ngaqë njiheshin në rradh të parë nga komuniteti gjerman dhe ai i huaj (të huajt e tjerë) si Jugosllav.

Shqiptarët e vërtet konsideroheshin, njiheshin ata të shtetit shqiptar, të një vendi të (vet) izoluar dhe thuajse gati të panjohur asokohe nga shumica e njerëzve të huaj, përjashtim bënin ata të paktë që rezultonin me njohuri për politikën. Shkurt, shqiptarët ishin të panjohur dhe Shqipëria një "Terra Incognito" një vend i pandëgjuar.

Baca Hyzri për moshën që kishte njihej haptasi si njëri ndër eksponentët kryesor në angazhimet patriotike shqiptare.

Përgjatë viteve të 70-ta do kishte organizime të panumërta të demonstratave për të drejtat shqiptare ku shtrohej edhe kërkesa për "Kosova Republikë", avancimin e njësisë teritoriale autonome në atë të barabartë më Republikat tjera Jugosllave.

Vlenë dhe duhet të theksohet së në ato demonstrata nuk merrnin pjesë në masë të konsiderueshme emigrantët (Gastarbeiter) shqiptar në nivel të Federatës së shtetit Jugosllav (jo vetëm ata nga Kosova por edhe ata që banonin në Republikat tjera të asaj sajese).

Rradhët e demonstruesve i ngjeshnin guximtarët, pra ishin patriotët e vërtet, që nuk bënin jetën vetëm sa për bukën e gojës dhe të ushqenin familjet e tyre në vendlindje por këta ishin "Rrezikantët që ishin të rrallët ndër të rrallët".

Asokohe Jugosllavia ishte për shumë syresh "Superfuqi" dhe Marshall Tito sinonim i perandorit që gëzonte në masë repu-

tacionin gjerë në përulje skajshmërisht të pështirë tek një pjesë e konsideruar nga komuniteti shqiptar (ndoshta do u shkonte më tepër epiteti i të qenurit shqipfolës!).
Dominonte bindja e rrënjosur së Jugosllavia do të ishte e përhershme por ajo profeci nuk do dilte e saktë pasi në embrionin e krijesës së saj të sajuar padrejtësisht dhe në veçanti rëndonte amputimi, copëtimi i hapësirës natyrore gjeografike dhe kolektive kombëtare shqiptare nga e cila do të merrte tatpjetën, do fillonte rrënimi i saj.
Shkatërimi i sajesës Jugosllave pas disa dekadash të ekzistencës së saj do vinte në masë të madhe nga "burrat e dheut" të migruar jashtë vendbanimit natyror dhe të paktë në numër.
Është po kjo pakicë burrash që kanë merita të mëdha që me ndërgjegjësimin e tyre kishin vetëdijen dhe kurajon të mos ndaleshin para asnjë frikësimi që mund të vinte në organizimet e shumë demonstratave nëpër kryeqendrat e shumta të shteteve evropiane.
Këto aktivitete të parreshtura ishin zgjimi i ngadaltë por gradualisht nga apatia, kllapa, koma kolektive që kishte mbërthyer Shqiptarët ndër dekada të shtypjes dhe të represaljeve sistematike shtetërore Jugosllave.
Këto aktivitete sado të luftuar nga qarqet antishqiptare por edhe të nënçmuar nga disa segmente konformiste në rradhët shqiptare do ishin shkëndijat e para që tërhoqën vëmendjen e opinionit publik evropian dhe ndërkombëtar në sensibilizimin për padrejtësitë dhe dhunën që ushtrohej ndaj Shqiptarëve në Jugosllavi por edhe të çështjes shqiptare në përgjithësi si çështje specifike gjeopolitike siç do dëshmohej në të ardhmën (që vazhdon edhe sot).

Bacën Hyzri Rekaj për aq sa mund ta kujtoj nga vitet e 90-ta do ta gjejë në ballë të çdo organizimi, në çdo tryezë e panelë organizative, në pritjen e figurave politike nga vendlindja me mision për tu takuar më zyrtarë të politikës gjermane ndër ta organizimi i pritjes së simbolit të rezistencës shqiptare Adem Demaqit në Dysseldorf, vijojnë organizimet e panumërta në kohë lufte, aksione këto të natyrës mobilizuese dhe humanitare etj. në lokalet e klubit që gjindej asokohe në rrugën Friedrich Ebert Strasse.

Çdokund dhe çdoherë do gjeje bacën Hyzri, nuk mund të mos ishte ndryshe.

Një respekt të veçant që kisha për atdhetarin karizmatik që dallohej në komunitetin shqiptar të Dysseldorfit më rrethinë vendosa ta ftoja për darkën e "Hallashtisjes" (lamtumirës/ përshëndetjes) të shtruar për miq, shokë e familjar para së të

nisesha rrugën që më shpiente në shtetin shqiptar për t'u mobilizuar në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ajo mbrëmje do mbahej në banesën tonë në Ross Strasse në Krefeld në fillim të muajit Nëntor '98, ku atij takimi, darkës së shtruar do ia bashkangjes disa fotografi të shkrepura për botim e librit.

Ndonëse sot në vitin 2022, pra mbi 2 dekada pas lufte jetojmë në një kohë ku dominimi materialist ka kapluar njeriun dhe shoqëritë dhe matet çdo gjë skajshëm me po atë kut (njësi), ku të vërtetat shpeshherë shtrembërohen faktet, mohohen kontributet, "harrohen" qëllimisht personalitete të dalluar duke vijuar gjerë në atë shkallë edhe të përvetësimit autorial të ngjarjeve që kanë bërë historinë më të re shqiptare. Andaj ndjej detyrim moral përballë atyre që nuk duhet dhe që nuk mund të anashkalohen pasi pa ta nuk do ndodhnin ndryshimet. Pa "kurajozët" më vetëdije të ngritur dhe dinjitet kombëtar që ishin një pakicë ndër Shqiptarët ajo do mbetej një masë gri e cila nuk do veçohej si etnitet në vete kulturor e kombëtar me specifikat e saj dalluese gjuhësore etj. por do mbetej e pakokë në orientimin, do fundosej në vorbullën e zhvillimeve në prag të ndodhive dhe do përcaktonin shtegun për të ardhmen. Pa bacën Hyzri e të tjerë që ishin më se të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që duhej të kishte çdo shqiptar tjetër do fundosej elementi shqiptar nga sipërfaqja e realpolitikës, politikës ditore për të mos u shfaqur në betejat që do zhvillonin (zhvillohen edhe sot!) në mes shteteve, kulturave. Ndodh që eksistonin qarqe me struktura të padukshme në prapaskenë të ndërlidhur në kontinuitet nivel rajonal e më gjerë që sot mundohen të zhvlerësojnë këtë qasje të gjykimit mbi historinë dhe protagonistët e saj duke dashur të

imponojnë një mënyrë tjetër të të menduarit ku zhvillimet rajonale, kontinentale dhe ndërkombëtare në orvatjen e përcaktimit të rregullave reja të rendit të ri botëror, që kanë si qëllim edhe përvijimin e vijave të reja gjeografike shtetërore, zonave të influencës gjeopolitike, çasjet në resurset natyrore ku së fundmi faktikisht shtetet kombëtare janë të dobët dhe vetmashtrohen pasi një shtresë elitare më pushtet global trajton aspiratat e tilla si të tejkaluar.

Askush nuk mund ta parasheh të ardhmën së çfarë ajo do të jetë por sigurisht mund të ndikojmë secili nga ne, secili qytetar, çdo shqiptar që mëton të jetë i tillë në kuptimin më të mirë për ndryshime progresive të nevojshme në përditshmërinë shoqërore që parasheh ndërgjegjësim dhe kurajon civile.

Ajo sot duhej të ishte prezent si dukuri e theksuar në masë të gjerë pasi rëndomtë kurajozët (në pakicë) e bëjnë dallimin, e sjellin ndryshimin, që i kontribuojnë lirisë, emancipimit të një shoqërie, evolucionit në përgjithësi, janë po ata që jo rallë herë e pësojnë, anatemohen e mohohen nga smira dhe xhelozia.

Faleminderit baca Hyzri që të njohëm, që ishe dhe do mbetesh përherë ndër ne në kujtimet më të mira.

Je protagonist i mërgatës shqiptare, pjesë e historisë më të re e cila do të shkruhet kur të ketë ardhur koha e duhur, momenti që të shkruhet epilogu i "Sagës" shqiptare, në fillesat e këtij mijëvjeçarit të ri, të hyjë si e tillë në analet e historiografisë njerëzore.

Ju faleminderit

Mustafë Rugova

Për herë të parë me Hyzriun jam njohur-takuar në qershor të vitit 1987. Ai atëherë edhe pse nuk aderonte në asnjë organizatë kombëtare, në mesin e mërgimtarëve gëzonte autoritet si askush tjetër. Me Hyzriun u njohëm fillimisht në Klubin e Punëtorëve Shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf. Që nga dita e parë e në vazhdimësi unë dhe Sabri Duraku, me Hyzriun kemi krijuar një miqësi të ngushtë e shumë vëllazërore. Ishte Hyzriu, Ai që i paraprinte kësaj miqësie e ku nuk besoj të ketë një të dytë që dinte ta kultivonte miqësinë me aq fisnikëri. Në çdo ndeje që kishim me të, të linte përshtypjet më të mira. Ishte i urtë, i qetë dhe shumë dashamirës me të gjithë. Kur ndodhte të mos pajtohej me ndonjë opinion tonin, ai kurrë nuk bëhej agresiv, përkundrazi, edhe atëherë e ruante qetësinë dhe debatin e bënte gjakftohtë e me shumë kujdes.

Vlen të përmendet poashtu dhe veçanërisht përballja e Tij me disa eksponente të atëhershëm të LPK-së, të cilët donin me çdo kusht ta monopolizonin klubin. Në këtë pikë Hyzriu ishte i pakompromis dhe i pakapërcyeshëm. Kurrkush më me ngulm se Hyzriu nuk i ka dalë zot statusit të klubit, çka qe tendenca e të lartpërmendurve për të bërë klubin pronë të tyre, ishte në të shumtën e rasteve bizare.

Në klub shpesh herë debatonim për rrjedhën e situatës sonë politike. Fliste qetë e me fakte, dhe nuk ka ndodh gati asnjëherë që mos ta fitojë debatin. E fitonte sepse nuk kishte komplekse dhe kurrë nuk paragjykonte. Ata që mundoheshin ta ulin nivelin e bashkëbisedimit, i zhgënjente keq, sepse ishte e pamundur që ta zbresin në nivelin e tyre të ulët. Përçarësit e asaj kohe, i shihte me përbuzje dhe me përçmim, të cilëve shpesh qëllimet dhe planet e tyre djallëzore ua digjte në xhep. Hyzriu ishte komunikuesi me brilantë i asaj kohe, ku të gjithë ne e admironim për mënyrën e sjelljes dhe për tiparet e tij të jashtëzakonshme njerëzore.

Me mua dhe me Sabriun sidomos, e në veçanti me Sabriun, sillej vëllazërisht, dhe kënaqej kur na dëgjonte, ngase shihej qartë se kishte ndier mungesë të madhe në shpirt për shokë që kanë ide dhe parashikime të njejta rreth çështjes kombëtare. Hyzriu ishte mërgimtari më urban që kam njohur ndonjëherë. Ai për kohën ishte një ndër intelektualët me rëndësi në Krahinën e Rurit, dhe s'kishte si mos të ishte, sepse me gjasë për të qenë i tillë, në masë të madhe kishte ndikuar dhe shoqërimi me Jusuf Gërvallën e më vonë edhe me Xhafer Shatrin.

Lajmi se ka ikur në botën e përtejme është humbje e madhe për të gjithë. Ai ishte dhe do të kujtohet përjetësisht si mendja dhe shembëlltyra më e bukur e mërgatës.

Unë këtë njeri të mirë, këtë mik të shtrenjtë e kujtoj me mall e me krenari. Është fat i madh të kesh mik dikend që kurrë nuk u tregua më pak se njeri. Krejt qenia e Tij ishte bekim.

Shpirti dritë i bëftë!

Faridin Tafallari

Për shokun tim të idealit, bashkëveprimtarin Hyzri Rekaj...!

Sado që koha kalon dhe vitet e moshës ja lenë vendin njëri tjetrit, kurrë nuk të hiqen nga kujtesa veprimtaritë atdhetare, në ato vite të stuhishme, për lirinë e Bashkimin Kombëtar. Jo vetëm më rrinë të freskëta në kujtesë, por kam mall për ato vite, për atë kohë të artë... Kam mall për gjithçka të asaj kohe!?... Kam mall për shokët e mi bashkëveprimtarë, shokët e idealit, që vepruam së bashku me besë, krah për krah, natën e bëmë ditë, pa përtuar, pa u lodhur, pa kursyer asgjë për Kosovë, komb e shqiptari! I sjell në kujtesë shokët e mi bashkëveprimtarë e sytë më mbushen me lot, me lot malli... Mallëngjimi më kaplon e dëshiroj t'i takoj si dikur në ndeja, në aktivitete, në takime, në mbledhje a tubime të ndryshme, në demonstrata e protesta...Dua t'jua dëgjoj zërin, qoftë edhe përmes cingërimës së telefonit, ku aspak se kam harruar oshëtimën e atyre zërave të dashur!... Po koha e ka bërë të vetën e disa syresh nuk janë më midis nesh!...

Dhe ja, shoku i idealit dhe bashkëveprimtari im Hyzri Rekaj, tashmë i ndjerë! E sjell në kujtesë Hyzriun, shokun tim, bashkëveprimtarin mikun dhe njeriun, bashkëkombasin tim, që nuk kurseu asgjë, duke dhënë kontributin e tij gjatë disa dekadave në mërgim. në Gjermani, për çështjen e madhe, për

lirinë dhe çlirimin e Kosovës e në përgjithësi të trojeve shqiptare nën okupimin e ish-Jugosllavisë shoveniste.

Hyzri Rekaj, i pari nga të parët në çdo aktivitet dhe në ballë të demonstratave, që nga marsi i vitit 1981, në mbështetje të popullit dhe rinisë shqiptare në Kosovë dhe viseve të tjera nën ish-Jugosllavi. I pandarë dhe i kudondodhur në veprimtaritë tona atdhetare, një njeri tepër miqësor e i ngrohtë me shokët me bashkëkombasit mërgimtarë. Me oratorinë e tij të kuptueshme e të qartë, në ato diskutimet e tij, jepte mendime konkrete e të dobishme për kohën, në të cilën vepronim e përpiqeshim ne, atdhetarët në mërgim. Me sjelljen burrërore dhe fjalën e tij të mençur e të matur Hyzriu ishte i mirëpritur kudo që shkonte ndër mërgimtarë.

Që në vitet e para Hyzriu u njoh edhe me figurat më kryesore të Lëvizjes, siç ishin Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka. Ai u lidh ngushtë me Lëvizjen e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe vazhdoi rregullisht veprimtarinë e tij atdhetare, si një aktivist i dalluar, edhe pas rënies së shokëve tanë, Jusufit e Kadriut, yjeve të pavdekësisë, të vrarë nga dora gjakatare e UDB-ës Jugosllave në 17 janarin e vitit 1982.

Hyzri Rekaj, i papërtuar e i palodhur! Atë e gjeje kudo në lëvizje, të parin në çdo veprimtari, jo vetëm në Gjermani, por, edhe në çdo veprimtari atdhetare, që organizohej në Zvicër, Belgjikë, Francë e në shtete të tjera perëndimore. Kurrë nuk i bishtroj veprimtarisë apo aktivitetit, pa e kursyer kurrë veten, por ishte kudo e kurdoherë, ku e kërkonte detyra ndaj atdheut e popullit të tij, ndaj Kosovës së shtrenjtë!!!

Me Hyzriun, unë pata fatin të njihesha gjatë aktiviteteve, si anëtar i Lëvizjes, që isha, por edhe në klubet shqiptare, që

vepronin në Evropën Perëndimore, ku mjerisht, në atë kohë, klubet ishin nën komandën apo në lidhje me ambasadat e konsullatat serbo-jugosllave!? Dhe, për t'i shkëput klubet shqiptare nga çerdhet fashiste jugosllave duhej shumë punë, angazhim dhe guxim!? Sepse, duhej guxim për t'u përballur me serbosllavët po se po, por edhe me shqipfolësit, se, në atë kohë këta zagarë, Jugosllavinë titiste e njihnin si shtetin e tyre!? E të tillë, që punonin e spiunonin për armikun, kishte plot. Por kishte edhe nga ata, që ishin punëtorë krahu këtu dhe spiunazhin e bënin në mënyrë vullnetare!? Për çdo gjë ata shkonin në dyert e ambasadës apo Konsullatës Jugosllave për ta spiunuar bashkë-vendasin e tij shqiptar, pa marrë parasysh nëse, ishte edhe i afërm i tij e ai e lajmëronte si armik të Jugosllavisë!?...

Këto spiunime u vunë re se, po sillnin shumë dëme sidomos në klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf. Kështu që, për klubin në fjalë, Hyzriu dha një kontribut të madh e të qmuar, deri sa ia arritën ta hiqnin klubin si çerdhe e armikut serbosllav e për ta bërë vërtet vatër shqiptare, klub shqiptar, ku të mblidheshin shqiptarët mërgimtarë për të kaluar ato pak orë të lira me njëri tjetri. Po përsëri, ekzistonte një rrezik për spiunimin e atyre shqiptarëve, që kërkonin, shkëputjen nga Jugosllavia titiste, sepse fatkeqësisht klubet ishin nën emblemën e ish-Jugosllavisë. Por forca përparimtare ia arriti që, klubin "Emin Duraku", (ku shumë herë, kryetar i tij u zgjodh i përkushtuari në këtë detyrë të rëndësishme Hyzri Rekaj) si edhe shumë klube të tjera t'i pavarësonin nga konsullatat armike jugosllave. Dhe kështu me një punë tepër vetmohuese i kaluan krejtësisht në shërbim të shqiptarëve, ku për tu informuar më shumë, kini rastin t'i lexoni disa materiale të atyre viteve të stuhishme, për përpjekjet e

mundimshme e të guximshme, që bënte mërgata jonë revolucionare shqiptare, për tu çliruar nga armiku shekullor serbo-jugosllave...

Pak po përfitoj nga rasti se, me Hyzriun e edhe me shumë shokë të tjerë jo vetëm u shoqëruam, por edhe u vëllazëruam. Atë kohë ekzistonte një dashuri e madhe në mes të shokëve veprimtarë atdhetarë dhe në veçanti të atyre, që ishin inkuadruar edhe nëpër lëvizje si dhe në klube, të cilët armiku i quante irredentistë, antijugosllavë, seperatistë, nacionalistë etj. Por këto të „ashtuquajtura“ neve na shtonin edhe më shumë dashurinë mes vete për atdheun e okupuar dhe urrejtjen ndaj armikut jugosllav.

Me Hyzriun kemi pasur hyrje e dalje edhe familijarisht si shokë e si vëllezër. Mund ta përmend edhe filmin dokumentar të regjizorit Esat Brajshori, “Çka ke bërë për Kosovën”. Hyzriu erdhi në shtëpinë time në Haiterbach-Nagold, ku e bëri intervistën dhe bashkë me bashkëshorten dhe vajzën e tij, atë natë, ndejti te unë, po ashtu, edhe unë kam qenë në shtëpinë e tij, ku edhe kam qëndruar një natë dhe e kemi bërë një foto së bashku në shtëpinë e tij.

Jemi takuar me Hyzriun edhe gjatë pluralizmit politik, në partitë e formuara e në veçanti në LDK. Por ajo kohë ndryshojë, sepse, plasi ai ankthi i viteve të të ashtuquajtura të ilegalitetit. Kështu që, nëpër këto parti u futën e u antarësuan thuaj se, të gjithë... me ish-udbashë e spiunë... Megjithatë populli u organizua ku, edhe nëpër këto aktivitete nuk mungoi kurrë as kontibuti i Hyzriut e edhe i shokëve të tjerë.

Ky bashkëveprim i yni vazhdoj edhe gjatë luftës së UÇK-së. ku as aty nuk mungoi kontributi i konsiderueshëm i Hyzri Rekajt...

Duke qenë njëri nga veprimtarët e radhëve të para në mërgim, i përkushtuar e i palodhur, Hyzri Rekaj qe disa herë kryetar i klubit ‘’Emin Duraku’’në Dysseldorf, detyrë të cilën e vlerësojë me seriozitetin e një atdhetari të devotshëm!

...Ja se çfarë më shkruan Hyzriu, si kryetar i klubit „Emin Duraku“, në një nga letrat e tij, që më ka dërguar më 5 qershor të vitit 1986:

Gjermani, 5.6.1986

Tungjatjeta shoku Faridin!

Po të lajmërohem me anë të kësaj letre, ku të sqaroj se, unë gjindem mirë me shëndet edhe shokët e tjerë mirë janë. Ti si je, familjen si e ke, me punë e halle si qëndron? Shokët e asaj ane si i kanë hallet?

Të thirra një natë në telefon, por ishte vonë dhe kishe qenë në gjumë. Pas tubimit, që patëm në Hamburg, ishte mirë që të takohemi edhe njëherë, që të bisedojmë për çështjen e B.K. por ja që akoma nuk patëm rastin, për një takim të tillë, prandaj edhe vendosa që t’i shkruaj disa fjalë, sesi mendoj që në fillim të veprimtarisë së B.K. (Bashkësia e Klubeve). Para se të tubohemi ne, të KDP-së (Këshilli Drejtues i Punës) e të bisedojmë, për një planprogram të punës dhe për çështje të tjera rreth B.K. ku duhet gjithsesi të thirret një tubim së shpejti (unë mendoj diku kah mesi i këtij muaji, pasi që e kemi një ditë feste). Si detyrë e imediate, pra para se të tubohemi, e shoh të nevojshme që, nga secili klub, gjegjësisht çdo rreth, të dërgohet nga një Peticion, në adresë të KQ të LKJ, por edhe të gjitha KQ, të të gjitha Republikave dhe Krahinave, në prag të Kongresit. Prandaj, pasi që e ke dokumentacionin e B. (Bashksisë) me gjithë vulë, të kisha propozuar që, ta formulosh një letër për këtë çështje dhe

tua dërgosh të gjitha klubeve-rretheve, që edhe adresat besoj se i ke! Pra sa më shpejt kishte me qenë e rrugës që ta bësh një letër se, me të vërtetë është mirë.
Këtu, në klubin tonë, mirë janë punët, të shtunën që shkoi e kemi pasë mbledhjen zgjedhore, pra zgjedhjet dhe mirë ka shkuar mbledhja. Janë rrahur çështjet bukur mirë dhe më në fund u zgjodh edhe Udhëheqësia e Re, ku për kryetar më kanë zgjedhur mua.
Duke përfunduar, ju shprehi të gjithëve përshëndetje vëllezërore! Të lutem më lajmëro, për çdo eventualitet. Hyzriu

Përgjigjja ime, dërguar Hyzriut:
Nagold, 6.6.1986

I nderuari shoku Hyzri!

Letrën tënde posa e mora dhe e lexova me vëmendje. Në tërësi jam me mendimet dhe propozimet tuaja. Ke bërë shumë mirë, që më ke shkruar. Kuptohet se, kur janë mendime të përbashkëta, me siguri janë më të arsyeshme dhe më të fuqishme. Nuk ka dyshim, se neve na lidh një çështje e përbashkët, i njëjti ideal dhe padyshim i ndihmojmë çështjes së madhe të popullit. Pra edhe ne mundemi me ato mundësi, që i kemi, t'i ndihmojmë. Unë, me këta shokët e bisedova dhe janë dakord. Por, siç po shihet, koha nuk pret, ditët po afrohen dhe ne duhet të kalojmë në punë konkretisht. Takimi duhet pa tjetër! Unë kam menduar se, këtë takim ta mbajmë ne, kryesia e Bashkësisë me

këshilltarët, po nëse na del kohë mundemi edhe ashtu si e ke menduar...

Për Peticionin, që duhet t'ja dërgojmë KQ të LKJ-së, dhe atyre të Republikave e Krahinave, jam plotësisht dakord dhe është shumë me vend, që të ju dërgohet nga të gjitha klubet! Dhe një, do të jetë mirë që, t'i dërgohet në emër të Bashkësisë së Klubeve Shqiptare të Punëtorëve nga Jugosllavia, përkohësisht në Mërgim!? Po këto do t'i formulojmë në takim së bashku. Takimi duhet mbajtur dhe është mirë që, të mbahet në këto data, 14 ose 15 qershor, në Dysseldorf, pasi është edhe më qendër për të gjitha vendet. U informova edhe për zgjedhjet, prandaj dhe ju uroj nga zemra, punë të mbarë e suksese të mirëfillta, në të gjitha drejtimet! Unë me familje dhe me të gjithë shokët jemi shëndosh e mirë! Ju përshëndesim që të gjithë së bashku, juve me shokë, duke ju dëshiruar gjitha të mirat!

I juaji Faridini

P. S. Shoku H. (Hyzri) nuk di si është puna në Hamburg. Kam informata se, kanë thirrë një mbledhje pa u konsultuar as me ne, Bashkësinë e Klubeve dhe as me klubin "Ibe Palikuqi"!? Por si do që të jetë, nuk bën me u ngut se, po kënaqet armiku! Nëse ata kanë menduar që, ta mbajnë këtë mbledhje, le ta mbajnë, kurse ne pastaj do të mbajmë qëndrim edhe për këto punë të pahijëshme, që po ndodhin!?

Nuk di ç'është me telefonin, edhe unë kam provuar shumë herë dhe nuk më lajmërohet askush?!… F. Tafallari- Nënshkrimi im

Për tu informuar edhe më gjerësisht për kontributin atdhetar të Hyzri Rekajt, mund të shfletoni librat e mi tashmë të botuar, ku

unë, midis të tjerash, kam shkruar për të, kryesisht për kontributin e tij atdhetar:

1- Faridin Tafallari; ’’Terror, dhimbje, qëndresë’’, fq: 359-361

2- Faridin Tafallari; ’’Dhimbje krenare”, fq: 259-296

3- Faridin Tafallari; “Për kohën e artë”, fq: 57-68

Sylejman Jakupi

Lindur më 28.10.1973 në Ferizaj.
Kam nderin dhe kënaqësinë më të madhe fillimisht që kam takuar por dhe që po shkruaj për një person me vlera të shumta njerëzore e atdhetare siç ishte z. Hyzri Rekaj.
Unë në Gjermani kam ardhur gjatë vitit 1993, fillimet gjithmonë janë të vështira por që tani me profesion jam ndërrmarrës.
Takimi im i parë me z. Rekaj ishte në vitin 1997 në Dysseldorf, pikërisht nga ai takim unë kuptova që kisha takuar një person me një ideal të lartë kombëtar dhe një punëtor të palodhshëm të çështjes kombëtare. Asokohe unë isha një i ri ku nga ai mora shumë këshilla. Bashkëpunimet e mija me të vazhduan gradualisht gjatë viteve. Poashtu pata nderin që z. Rekaj ta kisha mysafir dhe në shtëpinë time për një vizitë.
Kontributi i tij ishte shumë i madh dhe i pazëvedësueshëm si në çështjet kombëtare por dhe ne ndihmesën, këshillat dhe sygjerimet që ua dha të gjithë shqiptarëve të sapoardhur në shtetin gjerman. Por mbi të gjitha për të ideali më i lartë ishte Shqiptaria. Edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë përpjekjet për kauzën kombëtare nuk përfunduan deri në ditët e fundit të jetës së tij, por fatkeqësisht rrethanat ndryshuan sepse organizimet e tilla mbaruan nga mungesa e përkrahjes nga pjesa dërmuese.
Viti 2017 ishte një vit i hidhur për të gjithë ne që e njohëm atë nga afër sepse ne humbëm një njeri që na deshi të gjithë ne por

mbi të gjitha kombin e tij. Ai më nuk është prezent në mesin tonë por që veprat dhe kontributi i tij janë të pavdekshme.
Do të jemi përjetësisht mirënjohës ndaj të ndjerit për kontributin madhor për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ruajtjen e identitetit, kulturës dhe traditës shqiptare.
Lavdi jetës dhe veprimtarisë së Hyzri Rekës!

Hysen Gega

Nga bashkautorët Shabi Rekaj dhe Sabri Shehu u njoftova për iniciativën e tyre për shkruarjen e një monografie kushtuar atdhetarit Hyzri Rekaj, prandaj me kënaqësi vendosa të bëhem pjesë e saj.
Unë e them me sinqeritet se Hyzri Rekajn e njoh shumë pak (e kam takuar vetëm një herë në Klubin shqiptar "Emin Duraku" në Dysseldorf) por duke njohur aktivitetin kolosal të Klubit është normale që të gëzoj respekt të veçant edhe për Hyzriun me shokë pasi ata ishin drejtuesit kryesor të të gjitha aktiviteteve dhe angazhimeve kombëtare.
Unë kam jetuar një periudhë në Shtutgard dhe aty kam pas nderin dhe kënaqësinë të bashkëpunoj me heronjët e Kosovës Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën dhe ka ndodhur që gjatë aktiviteteve të flitej edhe për punën shembullore që bëhej në Klubin e Dysseldorfit në avancimin e organizimit kombëtar dhe ata çdo herë thonin se ngjajshëm si Dysseldorfi duhet t'i organizojmë gjitha Klubet në mërgatë.
Unë e di se në shenjë respekti për shokët e Dysseldorfit, Kadri Zeka kur u martua me Saime Isufin i ka ftuar në dasëm edhe një delegacion nga atje me në ballë Hyzri Rekën, kjo është ajo dëshmia dhe argumenti thelbësor që tregon për respektin e heronjëve ndaj aktivistëve të Dysseldorfit.
Veprimtaria ime u ndërpre herët pasi që u arrestova dhe u dënova me 12 vite e gjysmë herën e parë dhe me 3 vite e gjysmë

herën e dytë, prandaj edhe më nuk di çka të them për aktivitetin e tyre të mëtejmë.
Nga viti 1997 u bëra pjesë u UÇK dhe vazhdova deri në çlirimin e plotë të vendit.
Liria jonë është e larë me gjakun e bijave dhe bijëve më të mirë të kombit të drejtuar nga e lavdishmja Ushtria Çlirimtare e Kosovës por edhe nga ndihma vendimtare e aleancës ushtarake të Nato-s të udhëhequra nga SHBA -së.
Në vitin 2007 pata kënaqësin të pres në shtëpin time atdhetarin Hyzri Rekajn së bashku me Hamdi Gashin dhe Sinan Gashin, ishte një vizitë që kurrë nuk e kisha pritur (ndoshta ata që i prisja, nuk më erdhën) prandaj më bëri të ndjehesha shumë i gëzuar. Biseda me ta ishte shumë e përzemërt dhe vëllazërore, gjithçka që folëm ishte rreth organizimit të mërgatës dhe kontributit madhor të tyre, Hyzriu me një sinqeritet vëllazëror potencoj nevojën e themelimit dhe blerjes së objekteve nëpër qytete të mëdha në diasporë në mënyrë që të organizojmë më mirë bashkatdhetarët në ruajtjen e indentitetit kombëtar.
Nga Hyzriu dëgjova se ishte kthyer përfundimisht në Kosovë dhe kishte hapur një ordinancë stomatologjike në Nerodime dhe po kontribuonte në shëndetin e qytetarëve, unë e përgëzova dhe i urova suksese dhe shëndet në punën e tij të filluar në atdheun e vet që aq shumë e donte.
Me dhimbje dhe pikëllim të thellë mora vesh se nga një sëmundje e rënd kishte ndërruar jetë në vendlindjen e tij, shpreh konsideratën time më të lart për figurën e tij shembullore. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës, lavdi jetës dhe veprës se Hyzri Rekës!

Iliriana H. Rekaj

E lindur më 19.6.1989 në Gjermani.
Babi im i dashur !!!, ditët, javët, muajt dhe vitet po kalojnë, por malli e kujtimet për ty mbetën në memorien time të pashlyer, deri në përjetësi.
Kur më njoftuan autorët për botimin e Monografisë, për babin tim, më erdhi një nostalgji, dhe për një moment isha e shtangur në mes të emocioneve dhe obligimit që të japë një rrëfim, apo mos të jam pjesë e këtij projekti.
Mirëpo kontributi e sjellja e tij ndaj meje, familjes dhe kombit ishin të mëdha me sakrifica që të rrallë janë ata prind që e bëjnë.
Ishte më se e vështirë ta përkujtosh një prind me aq vlera njerëzore, por edhe ndihesha krenare për veprat që la pas vehtes, për mua për familje dhe shoqërinë në përgjithësi.
Vendosa t'i bashkangjitem edhe unë karavanit të evokimeve të bashkatdhetarve dhe bashkëfshatarve të tij.
Unë shkollën fillore e kreva në Neuss të Gjermanisë, mirëpo gjatë gjithë kohës mësoja edhe gjuhën shqipe në shkollën plotësuese, dhe isha aktive, në grupin e valltarëve dhe recitimit, në evenimentet, që organizonte shkolla në kuadër të QKISH "Emin Duraku" në Dysseldorf, e sidomos për festat e Nëntorit.
Ishin vitet ku jetoja në një shtet demokratik, dhe si e re nuk e kuptoja babin, që çdo fundjavë, po thuajse nuk ishte në shtëpi, ishte bë rutinë; unë shkova në Klub, ose unë shkova në demostrat, këto ishin fjalët që më se tepërmi i dëgjoja, deri sa e

kam kuptuar se Kosova nuk i gëzonte të drejtat elementare demokratike sikur çdo vend i botës.
Këtë sqarim të mirëfilltë, falë babit tim, kur kreva shkollën fillore e kuptova peshën dhe rëndësinë e kësaj padrejtësie që i'u bënte popullit tonë në Kosovë.
Me çlirimin e Kosovës, në qershor të vitit 1999, Babi im ishte shumë i gëzuar, dhe i entuziasmur, që më në fund Kosova fitojë lirinë, me luftën e UQK-së, me SHBA-në, dhe Nato-n në krye.
Viti i çlirimit të Kosovës, ishte një vit plotë energji nga e gjithë populli shqiptar, e në veçanti për Babin tim i cili plot 19 vite e kishte të ndaluar nga sistemi xhakatar sërbo-sllavë, të vizitojë vendlindjen.
Kishte edhe një qëllim që vazhdimisht e potenconte, pa rreshtur, kur më thonte, se shkollën e mesme do e vazhdosh në Kosovë, pastaj do t'i kryesh edhe studimet në Prishtinë.
Ashtu edhe ndodhi, pas kthimit në atdhe, u regjistrova në Gjimnazin e Ferizajt ku e përfundova, pak me vështirësi se më pengonte gjuha gramatikore, mirëpo me ndihmet e prindëve dhe të shoqërisë, arrita të përfundojë, e pastaj u regjistrova në Fakultet Filozofik -dega letërsi e gjuhë angleze.
Më vonë për shkak të vështirësive të asaj që thash më herët hasa në vështirsi, dhe u detyrova të ndërprej fakultetin.
Babit i ndihmoja në punë në laborin që kishte, dhe si zakonisht, si çdo vajzë krahas jetës dëshiron të krijojë folenë e vetë.
Pas disa viteve u njoftova me Farukun nga Slivova, me banim në Gjermani.
U martuam dhe menjëherë, i dhashë fjalën babit se do e kryej profesionin tënd; teknike e dhëmbëve, me ç'ka i'a arrita.

Ai si gjithmonë, njeri i qetë, prap më përkrahte në çdo pore të jetës.

Më kujtohet kur u shpall Pavarësia e Kosovës 17.2 2008 ishim së bashku, babi, mami dhe unë, para Kuvendit Komunal, në Ferizaj aty e kam pa gëzimin e papërshkrueshëm, që vërehej në fytyrën e tij, i buzëqeshur, ku në mes të tjerash tha e tash i'a arritëm qëllimit, e kemi shtetin tonë.

Vitet kalonin, kishim një harmoni familjare, babi punonte në Laborin e tij, por ai kishte një energji të madhe për të punuar edhe për fshatin, për të rregulluar infrastrukturën, që ishte shkatërruar nga lufta, bashkë me bashkëfshatarët.

Nga viti 2016 fillojë disi me disa ankesa e dhimbje, ku për mua ishte një ndjenjë e papërshkruar, nuk mund të besoja se si babi im ankohej, nuk isha mësuar që ai të ankohej për diçka.

Viti 2016 dhe fillimi i vitit 2017, ishin vitet më të zymta në jetën për mua, dhe familjet time.

Edhe pse intervenimin e bëmë me kohë nëpër qendra spitalore, duke e përfshi edhe Gjermaninë, sëmundja tinzare fillojë ta kaplojë, dhe nuk ndihej mirë, pavarësisht nuk i besoja syve dhe bindjes sime, se si një njeri me kaq shumë vullnet për jetë, i

fortë me energji pozitive, që ende kisha nevojë për të dhe për fjalët e ëmbla që mi thoshte në çdo moment, e kohë që kisha nevojë.

Më 11.9.2017, pushojë së rrahuri zemra e njeriut më të mirë në botë, ”Babai im”.

Babi im i dashur, i cili tërë jetën që jetojë e veprojë ishte një inspirim dhe udhrrëfyes në jetën time.

“Do ta kujtojë dhe përkujtojë në përjetësi.!!!

Bija jote, Iliriana.!!!!

Kapitulli III

Krenaria e një vendi rritet me kontributin e figurave kryesore të tij, për të folur për vlerat, kontributin dhe idealin e kryefjalës së librit që personifikon krenarin e vendlindjes në vazhdim japim kujtimet e bashkëvendasve

Dr. Asllan Bajrami

Portret modest për bashkëvendësin tim Hyzri Rekaj

Në kujtesën e banorëve të çdo rajoni mbeten të pashlyer disa personalitete, veprimtaria dhe rrugëtimi jetësor i të cilëve hapë shtigje të reja për bashkëvendësit. I tillë ishte edhe Hyzri Rekaj, i pari nga rajoni i Neredimes që u orientua në fushën e mjekësisë qysh në shkollimin e mesëm. Është ky elementi i parë, në dukje i vogël, që e bën të veçantë Hyzriun. Kjo sepse orientimi i tij profesional ishte një kthesë e rëndësishme jo vetëm për karrierën e tij jetësore, por edhe për shumë të rinj të tjerë që i ndoqën gjurmët e tij. Por ky ishte vetëm fillimi, ngase personaliteti i Hyzri Rekës në vazhdimësi do t'i shpërfaqë, gjithnjë e më të theksuara, virtytet që e bënin atë njeri të veçantë. Kur them të veçantë nuk mendoj në ato aktet heroike folklorike që nuk hezitojmë t'u mveshim personave edhe pa argument, por mendoj në novatorizmin e ideve që shkëputen nga idealet e zakonshme për grupmosha të caktuara. Në këtë kuptim, Hyzri nuk u josh nga trendët e kohës, për të investuar në përpjekjet që të krijonte një mirëqenie të qëndrueshme vetëm për vete dhe familjen. Kufijtë e egos së tij ishin shumë të gjerë për të lejuar synime të tilla. Aspiratat e tij, qysh herët, krijuan një simbiozë me idealet e bashkëkombësve të tij. Kjo u dëshmua qysh në fillim të karrierës së tij, kur konkuroi për punësim në

Shtëpinë e Shëndetit në Ferizaj, bashkë me shokun e tij, i diplomuar një vit më vonë. Edhe pse sipas kritereve të kohës, përparësia në punësim lidhej me kohën e diplomimit, Hyzriu i ofroi mundësinë shokut të tij që të pranohej, për shkak të rrethanave të tij familjare dhe ekonomike. Tërheqja e Hyzriut për t'i dhënë mundësi shokut të vet, që nuk e kishte babanë, flet më së miri për virtytet dhe personalitetin e tij të formuar qysh në moshë të re. Pikërisht ky personalitet dhe natyra e tij, bënë që Hyzriu të vëzhgonte më me hollësi realitetin e asaj kohe, të vërente me kohë se kishte një shpërputhje të madhe mes situatës reale të shqiptarëve në ish-Jugosllavisë dhe propagandës që bënte pushteti. Ai nuk mundi të qëndrojë indiferent ndaj pamjes së asaj bote që iu shpalos përpara; nuk mund të pajohej me pozitës në të cilën ndodheshin shqiptarët. Qysh herët Hyzriu e kuptoi se populli i tij nuk konsiderohej i barabartë me popujt e tjerë jugosllavë dhe se aspiratat e atyre që u angazhuan për çlirimin e Kosovës nga fashizmi, nuk përkonin me realitetin në të cilin ndodheshin. Ishin pikërisht këto shqetësime që e bënë t'i bashkohej lëvizjes ilegale e cila synonte t'i kthente dinjitetin kombit shqiptar në Kosovë, që paraqet edhe nivelin e lartë të vetëdijes së tij kolektive.

Largimi i pavullnetshëm nga atdheu, ishte që i dha një kah të paparashikuar jetës së tij, theksoi edhe një herë aftësitë e tij për të gjetur vendin dhe preokupimet e veta brenda botës së madhe. Këtë e dëshmoi me vazhdimësinë e ruajtjes së lidhjeve me atdheun; gjeti mënyrën për të ofruar kontributin e tij në çështjen kombëtare, duke udhëhequr për pesë mandate me radhë klubin shqiptar në Dysseldorf, njëri ndër klubet më të mëdha në diasporë. Seriozitetin e preokupimit me fatin e bashkëkombësve

e dëshmoi edhe me aktin e kthimit në Kosovë pas luftës; i vetëdijshëm që arsyet për të cilat e kishte braktisur vendlindjen tanimë i takonin të kaluarës, Hyzriu nuk u hamend në marrjen e këtij vendimi që qindra mijëra të tjerë nuk e morën dot, as sot e kësaj dite. Mendoj që ky ishte një akt ku Hyzriu u shfaq para nesh me tërë pjekurinë, civilizimin dhe virtytet humane, sepse ky kthim nuk ishte ashtu siç e kishte menduar, ishte shumë më i vështirë, për faktin që kërkonte durim të pashterur për ri-vendosjen e marrëdhënieve me kolegët. Vet akti i hapjes së laboratorit dentar shumë të avancuar për kohën në fshatin e lindjes, tregoi se Hyzriu ishte ai që me kohë i kishte dalë përballë uniformitetit të ideve; nuk vrapoi në qendra të qyteteve, e as nuk u përpoq të rrëmbente punë përtej kapaciteteve të laboratorit dhe ajo që është më me rëndësi, nuk e pa punën e vet si një biznes, të shkëputur dhunshëm nga fusha e mjekësisë.

Këto qëndrime të tij, krahas çasjes specifike ndaj punës, pedantëria dhe respektimi i kufijve profesional, krijoi një lloj hendeku mes tij dhe shumicës së teknikëve dentarë, të cilët kaherë i kishin shkelur kufijtë e kompetencave profesionale. Por pavarësisht nga rrethanat, ai u përqendrua në punë, vazhdoi të ruante etikën profesionale, të kultivonte vlerat e larta humane dhe t'i shmangej rivalitetit që vërehej te kolegët. Me të gjitha këto cilësi që e karakterizuan tërë jetën: njeri i formuar, vizionar, këmbëngulës në realizimin e synimeve, novator në ide e punë, pedant, i matur në fjalë, i përkushtuar në punë, i pajisur me kulturë të gjerë dhe dhuntinë për t'i respektuar të tjerët, imazhi i Hyzri Rekës do të ruhet gjithnjë në kujtesën time; jam i bindur që të tillë do ta kujtojnë edhe bashkëvendësit e tjerë dhe të gjithë ata që e njohën.

Muharrem Kashtanjeva

Kam nderin të shkruajë disa fjalë për Hyzriun edhe pse fjalët janë të pakta dhe ky shkrim nuk mjafton që ti përmbledhi kujtimet me Hyzriun.

Pas kthimit të Hyzriut nga Gjermania në Kosovë dhe vendosjes së tij në krye të fshatit si kryetar, pata nderin të punoj me të si zëvendës krytar i fshatit ishte kënaqësi dhe privilegj me punu me Hyzrin, ishte njeri i qetë i afërt me gjithë pa dallim, çdo problem, çdo sfidë që kishim përpara e tejkalum së bashku me urtësinë dhe mençurinë e tij.

Më kujtohet kur kishim një takim në objektin e komunës me krytarin e Komunës, me palën serbe dhe në prezencë të ndërkombëtarve, Kforit, Unmikut, kishte edhe përkthyes. Pala serbe insistonin të kthehëshin në fshatin tonë, përfaqësues të fshatiti tonë ishin Hyzri Reka,, Unë Muharrem Kashtanjeva dhe Blerim Ramadani.

Ishim shumë të përgaditur me fakte dhe me prova dëshmuam se më nuk mund të bashkëjetojmë me ta. Ku unë e mora fjalën dhe e ceka aty, se ishim dikur fqinjë dhe bashkëjetonim por tani më mbaroj gjithçka sepse këta (serbët) na rrahën, na torturuan, na dogjën, na vranë e na masakruan e si është e mundur të jetojmë përsëri me ta?!? Dhe kështu pas një diskutimi të gjatë, gjithçka përfundoj pa kurrfar marrëveshje.

Por ata (serbët) insistuan dhe në bashkëpunim me ndër-kombëtarët vendosën të vijnë në fshatin tonë pa na pyetur fare, dhe kështu ata morën përgjegjen e duhur nga ne si fshat.
Fshati në krye me Hyzri Rekën dhe ne si anëtarë të kryesisë së bashku me gjithë fshatin vendosëm të bllokojmë rrugën me një protest masive me pankarta në duar duke ju thënë JO kthimit të kriminelëve në fshatin tonë dhe kështu ja dolëm dhe ndaluam ardhjen e tyre në fshatin tonë. Me Hyzriun morëm pjesë edhe në afrimin (pajtimin) e ngatërresave e mos marrëveshjeve që kishin bashkëvendasit tanë.
Hyzriu kurr nuk pushoi së vepruari në të mirën e fshatit në gjitha aspektet.
Ikja e tij e herëshme më pikëllojë shumë, më mërziti shumë, sepse humba një shoq, një bashkëpunëtorë të mirë që kisha, por jo veç për mua por edhe për fshatin ishte një humbje e madhe!! Qoftë i përjetshëm kujtimi për të!

Blerim Ramadani

Ishim të vegjël dhe shkonim në klasë të parë si fëmijë të fshatit, unë, Bardhi, Burimi, Ariani, Shpendi, Urani etj, dhe duke u rritë ishim kurreshtar sa mixhallarë ke ti jo unë kam më shumë siç bëjnë fëmijët, Burimi thoshte kam 5 mixhallarë, nga aty ia mësova emrin bacit Hyzri, por siç thash më lart njohja me emrin por jo dhe fizikisht, arsyeja ishte se baci Hyzri si veprimtar atje ku ishte në Gjermani ishte i padëshiruar për organet e shtetit Jugosllavë dhe ai nuk guxonte të vizitonte familjen dhe vendlindjen.

Rrjedhën si rrjedhën ngjarjet në Kosovë dhe lufta, për tu kthyer pas lufte dhe ta njohur nga afër dhe fizikisht axhin Hyzri.

Vendimin për tu kthyer në vendlindje baci Hyzri e kishte marrë në 2005 për të ndëruar shtëpi e vendosur jetën e mbetur apo thënë pleqërin ta jetuar në vendlindje.

Baca Hyzri me kthimin në Nerodime, ta ushtroj dhe profesionin të cilin ishte përgaditur si teknik i stomatologjisë dhe për të hapur një lokal Laborator Stomatologjisë dhe pasuruar fshatin Nerodime me një pasuri profesionale.

E veçanta e bacit Hyzri ishte që me kthimin e tij në Nerodime filloi një vizitë nëpër çdo familje rend me rend pa dalluar fis apo kabilje, qëllimi ishte çmallja me fshatin dhe të jep një shembull për bashkimin e familjeve në fshat.

Baca Hyzri si tip i dashtun që ishte, i buzëqeshur me bërjen e Laboratorit nuk ndihej rehat pa bërë dhe diçka më shumë për fshatin.

Na tuboi në restaurant Villa dhe me konsulta dhe bisedime u dakorduam të zgjedhim kryesinë e fshatit dhe kryetarin që unanimisht ne si kryesi votuam për kryetar Hyzri Rekaj.

Hyzriu edhe pse kishte oferta nga organet komunale për tu futë në strukturat e saj, ai pranoj që të punoj për fshatin që të rregulloj infrastrukturën e fshatit. Pas disa viteve të punës së zellshme që bëm me kryesinë e fshatit, erdhi një moment jo i këndshëm që të ballafaqohemi edhe një herë me hordhit serbe, të cilët tentuan bashkë me organet ndërkomtare të vizitojnë shtëpitë e tyre.

Ne morëm aksion, si fshatarë të bashkur, i dhamë mesazhin e qartë, të ish fqinjëve serbë se bashkëjetesa në Nerodime të Epërme nuk mund të jetë e mundur pa u dorëzuar kriminelët para drejtësisë.

Përveç ballafaqimit në rrugë afër Neredimes, kërkuam që me pëlqimin e ndërkombëtarëve, të ballafaqohemi edhe në sallën e Kuvendit Komunal. Aty kërkesat e tyre në prezencën e ndërkombëtarve, prap si kryesi e fshatit ishim të organizuar njëzërit, ku kërkesat e tyre për vizitë ua ndaluam.

Pati përplasje në mes pjesëmarrësve në sallë, por shumë diskutues nga fshati kishin të njejtat qëndrime, se nuk ju lejohet që ata të vijnë e vizitojnë Nerodimen, dhe në fund ashtu edhe përfundojë.

Unë si anëtarë i kryesisë, mbajë kujtime të pashlyera, për bacin Hyzri, kishte një përsonalitet të rrallë ku vetitë e tij mund t‘i shihje në organizim, ku me zellin dhe përkushtimin që

posedonte i kthente njerëzit për vete, për qëllime të përbashkëta të fshatit.

Sëmundja tinzare e cila e kaplojë, mu në vitet kur kishte nevojë që ta shijonte jetën në Kosovë, lirinë për të cilën dha një kontribut të çmueshëm, edhe në mërgatë edhe në vendin e lindjes, për mua ishte një tronditje dhe ndjenjë jo e mirë.

Me gjithë përpjekjet që bëri për të mund sëmundjen, që ishte në shërim edhe në Gjermani, ai për mua dhe për tërë fshatin sa punoj e veproj ishte një humbje e madhe.

Për mua baci Hyzri ishte një ushtarë i përbetuar i çështjes kombëtare.

Jam krenar që e njoha një njëri aq shumë i përkushtuar për qështje madhore Kombëtare.

Lavdi i qoftë dheu i Kosovës.

Fehmi Reka

Hyzriun e kam njohur nga distanca. Kjo për faktin se ky për shkak aktivitetit të tij kombëtar kishte emigruar në Gjermani dhe nuk mund të vinte në vendlindje, andaj unë në moshë të re nuk pata mundësinë ta takoja dhe njohja ime me të ishte vetëm përmes asaj që na tregonin familjarët, bashkëvendësit dhe aktivistët e çështjes kombëtare lidhur me aktivitetin e tij që e bënte në mërgim me organizatat për çështje kombëtare.

Me Hyzriun jemi njohur personalisht pas luftës kur është kthyer përfundimisht për të jetuar në Nerodime. Fillimisht takimet tona ishin të rastit për ndonjë kafe dhe temat e bisedave ishin rreth jetës në fshatin tonë, përjetimet tona gjatë kohës së okupimit, pastaj aktivitetet tona, shkollimi, e tjerë, përgjatë kohës kur ai nuk kishte jetuar në vendlindje, pastaj, me kohën nuk mungonin edhe tregimet e tij për gjatë qëndrimit në Gjermani, aktivitetet e tij për çështje kombëtare, punën dhe jetën në përgjithësi.

Në çdo takim ai vazhdimisht kërkonte nga ne që të jemi më aktiv në jetën publike dhe kërkonte nga ne që të angazhohemi për të mirën e vendit, për të kërkuar kushte më të mira dhe zhvillim më të madh të vendit në përgjithësi dhe të fshatit, andaj me insistimin e tij, ne filluam të takoheshim më shpesh një grup më i madh i bashkëvendësve. Pastaj, duke parë vullnetin e tij që

të jetë edhe ai më aktiv, ne vendosëm që Hyzriun ta bëjmë udhëheqës të fshatit, detyrë të cilën e pranoi pa asnjë hezitim.
Nga të gjitha angazhimet tona të udhëheqjes së fshatit, e që ishin shumë në krye me Hyzriun, vlen të përmendet rasti kur disa serbë të fshatit donin ta vizitonin fshatin Nerodime dhe me qëllimin që të shikonin mundësinë e kthimit të tyre. Ne si fshat u organizuam dhe e penguam këtë vizitë duke kërkuar nga ata që të na tregonin emrat e atyre që e kanë bërë masakrën në familjen Nuhaj. Për këtë organizim ne patëm disa takime me organizatat ndërkombëtare që merreshin me çështjet e kthimit. Edhe në këto takime ne vazhdimisht kërkonim që drejtësia të kryejë punën dhe vrasësit të dënohen.
Më kujtohet një takim me Hyzriun në shtëpinë e tij. Aty gjatë bisedës filloi të më tregonte për aktivitetin e tij për çështjen kombëtare që e kishte zhvilluar në Gjermani dhe pastaj më tregonte disa fotografi të cilat i kishte gjatë organizimit të demonstratave dhe tubimeve nëpër shtetet e Evropës, në të cilat ishin edhe disa nga figurat e njohura të çështjes kombëtare e me të cilët ky kishte bashkëvepruar. Në bisedë e sipër filloi të më thoshte edhe se si ndihej pjesërisht i plotësuar, pas atij angazhimi të gjatë në mërgim për lirinë e Kosovës dhe kthimi i tij në vendlindje për të jetuar dhe punuar, kjo veç ishte e realizuar sepse Kosova është shtet i pavarur, shtëpinë e kishte ndërtuar, ishte kthyer të jetonte në vendlindje, kishte hapur ordinancën e teknikës dentare, ku punësoi një bashkëvendas dhe punonte i lirë në vendin e tij, ashtu siç edhe e kishte menduar tërë kohën e qëndrimit në mërgim.
Kishte dëshirë që edhe shumë më tepër arritje të kombit t'i për jetonte, ishte i gatshëm dhe i pa përtesë që përsëri të angazhohej.

Përfundimisht Hyzriu do të mbetet në kujtesën time si njëri prej njerëzve me shumë energji, shumë potencial, shumë vullnet dhe inspirues i madh dhe, përkundër vuajtjeve në jetë, duke iu mohuar edhe liria e kthimit për dekada në vendlindje, gjithnjë ka gjetur forma e mënyra të kontribuojë e ndihmojë vendin e njerëzit në nevojë.

Shefqet Reka

Ardhja e Hyzriut në vendlindje pas luftës, më dha një fuqi për të

vazhduar aktivitetitn për një të ardhme më të mirë për fshatin tonë, dhe kështu vendosëm bashkarishtë që në udhehqje të fshatit të jetë Hyzriu.

Ndër prioritetet që kishte Hyzriu si udhëheqës ishin: infrastruktura mirë-qenja e qytetarëve, njëherit arriti që të bëj bashkimin e lagjeve të Nerodimës në një fjalë të vetme.

Hyzriu u përball edhe me një sfidë tjetër të rëndësishme për kohën e pas luftës në vitin 2009.

Serbët që dikur kishin banuar në fshatin tonë që historikisht ishin kolonistë, tentuan që me ndihmën e ndërkombëtarëve të kthehen dhe t'i vizitojnë vendbanimet e tyre. Ndërsa ata kishin harruar se Nerodimja ende kishte gjurmë gjaku nga masakrat e tyre.

Qëndrimi dinjitoz e i vendosur i Hyzriut bashkë me kryesinë e fshatit dhe bashkëfshatarët organizoj protestë masive në bllokimin e rrugës, ku ndikuam pozitivisht në mosrealizimin e planit të tyre.

Një ndër arsyet e kundërshtimit tonë ishte, se serbët ishin vetë ata që kontribuan në prishjen e raporteve ndëretnike. Ku gjatë luftës ishin radhitur në tri formacione ushtarake, paramilitar, beretkat e kuqe, si rezultat i këtyre formacioneve u dogj po thuaj se i gjithë fshati dhe u bë masakra në familjen Nuha.

Hyzriu dhe kryesia e fshatit ishin të përgaditur që të ballafaqohen edhe me ndërkombtarët me fakte dhe prova nëse ata insistojnë ti kthejnë serbët.
Për Hyzriun kam shumë për të shkruar, për personalitetin e tij vizionin që kishte për unitet të fshatit dhe prosperitetin e tij. Hyzriu ishte një njeri unifikues që i urrente ngjyrimet partiake dhe ideologjike.
Vdekja e hershme e tij ishte një goditje e rëndë për fshatin e më gjërë.
Hyzriu për mua ka qenë dhe do të mbetet emblemë e bashkimit të fshatit tonë.
Lavdi i qoftë dheu i Kosovës.

Hasan Reka

Shkëputje nga rrjedha e kujtimeve për jetën, veprën dhe sjelljen e bashkëqytetarit tonë Hyzri Rekaj

Nga fëmijëria e ime e mbajë mend një njeri i pranushëm me edukatë me kulturë dhe energjik.
Rrethanat sociale, Hyzriun e quan në dallgët e gurbetit, sepse ishte e pamundur punësimi, posaçërisht për shqiptarët.
Ishin këto vitet e fundit të shtatëdhjeta kur migroi në Gjermani, me profesionin "teknik stomatologjie".
Hyzriu radhitet në rrjedhën e lëvizjes kombëtare në fillim të viteve tetëdhjeta. Hyzriu për këto aktivitete politike e kombëtare pushteti e largoi nga vendlindja, familja, e të afërmit. Kuptoj se për Hyzriun këto masa u bënë një brum i fortë rezistence ndaj pushtetit.
Është një e veçantë e veprimtarëve të devotshëm që me vullnet të plotë i kthehen vendlindjes, familjes dhe të afërmve. Hyzriu kthehet pas luftës në vendlindje me të njejtën dallgë, por me dallgën e riatdhesimit që e fitoj me frymën e aktivitetit të vet.
Në fshat bashkë me rrethin tonë e krijoj një atmosferë të mirë ndërfamiljare, kontakte me secilën shtresë, e veçanta ishte se në rrafshin plural politik ishte unifikues, nuk dashti të rreshtohej në subjekte politike, banorët me vullnet e zgjodhën përfaqësues i fshatit, për secilën brengë të tyre, infrastrukturë, rindërtim, mirëmbajtje të hapësirave publike etj.

Unë përjetësisht do ta kujtoj si:
Investitor në ekonomi të vogël, teknik stomatologjie për banorët përreth dhe më gjërë, një punë humane dhe shumë profesionale. Humanist, Unifikues, familjar dhe meritor në të gjitha rrjedhat politike me përmbajtje kombëtare.
Respekt për veprat e Hyzriut.

Basri Kashtanjeva

Kam privilegjin dhe nderin të shkruaj disa fjalë për bashkëvendasin tim Hyzri Rekaj edhe pse fjalët janë të pakëta për këtë burrë, intelektual, udhëheqës, e kojshi i ëmbël, i qetë, i respektushëm, bujar e mbi gjitha njeri me virtyte të larta njerëzore.

Për bacën Hyzri më inspirojnë faktet dhe rrëfimet e gjagjait tim Avdi Kashtanjeva i cili ishte bashkëpuntor i pandashëm i bacës Hyzri në mërgim e posaçërisht në klubin "Emin Duraku" në Dysseldorf të Gjermanisë ku ai rrëfen për punën e palodhshme në organizimin dhe bashkimin e shqiptarve në një gjuhë të vetme pa ngjyrime plitike, partiake, ideologjike. Pra ai ishte i pashoqë, ishte unifikus, gjagjai im rrëfen edhe se si organizonin demostrata masive në gjitha qytete e Evropës në mbrojtje të Kosovës dhe të drejtave të saja të shkelura padrejtësisht nga Serbia fashiste.

Pata fatin edhe unë si një i ri ta njohë për se afërmi bacën Hyzri pas kthimit nga Gjermania në Kosovë pas luftës ku ishim me fat si fshat ta vendosim unanimisht pa asnjë kundërshtim të vetëm duke e njoftur personalitetin e tij i gjithë fshati njëzëri vendosi ta bëj krytar fshati.

Me një vullnet të pashoq filloj në organizimin dhe bashkimin e fshatit duke formuar kryesinë e fshatit duke vendosur në kryesi nga një përfaqësues nga secila lagje, filloj me kërkesat dërguar komunës së Ferizajt për rregullimin e infrastrukturës në fshatin

tonë ku prioritet ishte rregullimi dhe asfalltimi i rrugës, rregullimi i ujit të pijes, kanalizimit etj.

Ai hasi edhe me një sfidë të kohës e që ishte insistimi i serbëve në vizitë në Nerodime ku baca Hyzri së bashku me vendasit ishin të vendosurë të kundërshtojnë këtë synim të tyre ku edhe e arritëm me organizimin e protestës masive në 2009 ku u bllokua rruga për qarkullim dhe kështu dështoj plani i qetnikëve serbë për ta vizituar vendin ku e lanë të djegur e të përgjakur gjatë luftës.

Më duhet të evokoj edhe një kujtim me të ku ishte i caktuar ai për një mirëkuptim (pajtim) ndërmjet dy familjeve ku unë isha si i dërguar për me i ndëgjuar fjalët se si do të mbesin gjërat, më kujtohet kur baca Hyzri më dha fjalën mua dhe poashtu ndëgjoj mendimin tim pa hezituar, pa rezerva edhe pse unë isha i ri.

Për të shkruar për bacën Hyzri dhe jetën e tij është e pamundur të përshkruhen në një rrëfim, por vepra dhe puna e tij nuk do të vdesin kurrë.

Vdekja e tij e hershme la shumë projekte dhe punë të pakryera në fshatin tonë, ishte një humbje e madhe për fshatin tonë e më gjërë ikja e tij në amshim.

I lehtë të qoftë dheu i Kosovës baca Hyzri.

Do të mbetesh gjithëherë i paharruar në mendjet dhe zemrat tona!

Djali i Luftës

Kur e shikoj nga perspektiva e tanishme fillimin e jetës sime,

hapat e parë në botën e panjohur dhe pamundësinë për të mësuar përnjëherë kuptimin e gjërave që më rrethonin, më shfaqet vetja ashtu siç isha dikur, një qenie e brishtë që ende nuk dija asgjë; nuk dija asgjë për veten, për familjen, për kohën, për jetën.

Nuk e dija që unë kam lindur në kohë lufte, kur kufiri mes jetës dhe vdekjes pothuajse nuk ekzistonte; kur populli im përmes qëndresës heroike po hapëronte drejt lirisë së ëndërruar nga breza të tërë. Nuk e dija se pushtuesi shekullor serbo-sllav kishte thurur plane, memorandume dhe elaborate famëkeqe për ta çrrënjosur popullin tim nga Gadishulli Ilirik (Gadishulli Ballkanik) dhe trojet tona etnike, tokat e stërgjyshërve tanë t'i kolonizonte me hordhitë pan-sllaviste në.

Nuk e dija se nëna ime Drita, kur ishte nxënëse në Gjimnazin e Lipjanit në vitin shkollor 1974/75, ishte burgosur nga pushteti serb vetëm pse kishte shkruar dy fjalë "Kosova Republikë". Vetëm për këto dy fjalë, nëna ime dhe shokët e shoqet e saj dy muaj të rinisë së tyre i kaluan në errësirën e burgut sllav.

Nuk e dija që babi im në vitet e 80-ta, kishte shpërndarë pamflete aty ku studjonte, pamflete këto që me përmbajtjen e tyre kishin për qëllim të mbanin gjallë prushin e krenarisë kombëtare, ëndrrën e popullit për liri dhe mbi të gjitha, synonin nxitjen e rebelimit të popullit kundër regjimit serbo-sllav (JUG).

Në këtë angazhim babai im nuk ishte vetëm, kishte edhe të rinj të tjerë që ishin shokë të tij të idealit. Nuk e dija që pikërisht ideali kombëtar i kishte bashkuar prindërit e mi dhe ishte bërë themel i familjes që ata krijuan bashkë.

Nuk e dija që xhaxhai im Ganiu që ishte Drejtor shkolle dhe prindi im ishin diferencuar nga procesi edukativo-arsimor me urdhër të komiteteve komunale të viteve 80-të, madje edhe ishin arrestuar e burgosur për çështjen e të drejtave themelore kombëtare. Nuk e dija se stërgjyshi im, në vendlindjen time, kishte kryer atentat ndaj një gjakatari serbo-sllav, në kohën e Pavarësisë së Shqipërisë. Nuk e dija që xhandarmëria serbo-sllave kishte masakruar pesë kushërinjtë e stërgjyshërve të mi.

Nuk e dija që populli im kishte vuajtur shekuj me radhë nga pushtuesit që i lakmonin tokat shqiptare, i copëtonin, i grabitnin, i digjnin e sakatonin trojet autoktone, ato troje ku kohërat i kishin shtresuar gjurmët e lashtësisë sonë. Për t'i zhdukur këto gjurmë dhe për shuar emrin tonë, barbarët, ardhacakët e parazitët, na e ndanë atdheun në pesë shtete.

Nuk e dija që populli im ishte aq i qëndrueshëm, sa të përballej edhe me padrejtësitë e Evropës dhe Fuqive të Mëdha, që në momentet më dramatike të historisë sonë kombëtare, me gjakftohtësi merrnin anën e armiqve tanë, duke miratuar nëpër Konferenca Ndërkombëtare marrëveshje në dëm të popullit shqiptar.

Nuk e dija që regjimi gjakatar serb i kishte ndaluar shkollat në gjuhën shqipe me qëllim që të varrosë dijen, kulturën e dinjitetin tonë kombëtar. Por populli im kishte qëndruar aq stoik e i pamposhtur ndaj këtyre padrejtësive që thurreshin nga regjimi e shovinistët Serbo-sllav.

Nuk e dija që elita intelektuale e vendit tim ishte bashkuar si kurrë më parë bashkë me luftën UÇK-së, kësaj ushtrie që lindi nga populli i shumëvuajtur, që u ngrit kundër pushtuesit të egër për t'i dhënë fund robërisë. Lufta e drejtë e popullit dhe UÇK-së, për herë të parë në histori arriti të fitojë përkrahjen fuqive ndërkombëtare, me në krye SHBA-të, që na dolën në ndihmë me fuqinë më të madhe të Globit Nato-n deri në çlirimin përfundimtar.

Nuk e dija që edhe prindi im, që në ditët e para të luftës kishte rrokë armën për të luftuar armikun bashkë me bashkëfshatarët e mi. Por fati ishte ngritur kundër tij dhe babai im pas një kohe kishte rënë në pritë nga policia e paramilitarët serbo-sllavë, kishte përjetuar tortura çnjerëzore deri në djegie me rrymë, që e kishin sjellë në prag të vdekjes dhe pas 4 ditësh e kishin hedhur jashtë burgut për vdekje.

Nuk e dija që të pesë shtëpitë tona ishin djegur bashkë me fotografitë dhe kujtimet familjare ashtu siç ishin djegur e plaçkitur mbi 120 mijë shtëpi në mbarë Kosovën nga pushtuesi. Krahas djegjeve e shkatërrimeve, në këtë luftë të egër mbi 13 mijë persona kishin dhënë jetën që Kosova të fitojë të shtrenjtën liri, të jetë shtet i lirë e i pavarur.

Nuk e dija që nëna ime Drita më lindi në ditët më të vështira të luftës, në ilegalitet të plotë, prej malit deri tek Spitali "Nëna Terezë" në Prishtinë. Pas lindjes kishte marrë arratinë deri në Çegran të Maqedonisë, ku kishte qëndruar plotë 5 javë. Pas pesë javësh, më 8 qershor 1999, me kontingjentin gjerman unë dhe nëna kemi arrit në një shtet tjetër.

Nuk e dija që prindi im kishte marrë arratinë dhe ilegalisht ishte nisur për shërim jashtë vendit. Se ishin organizuar për

t'i ndihmuar në mënyrën më të mirë të mundshme shumë njerëz dashamirës nga të gjitha trojet shqiptare, duke filluar nga Nerodimja e Ultë, Ferizaj, Varoshi, Tetova, Tirana e Peja. Së fundi xhaxha Hyzriu e kishte marrë nga Tirana për në Gjermani dhe aty kishte filluar shërimin nga operacioni ilegal që kishte bërë në Kosovë, nga i cili kishte rezultuar humbja e dy pjesëve të trupit.

Nuk e dija që familja ime kishte punuar e vepruar intensivisht për çështjen kombëtare, ishte ngritur në çdo kohë dhe në çdo dekadë kundër pushtuesit gjakatar serb, për një qëllim të vetëm, lirinë e shtrenjtë të Kosovës. Në periudha të ndryshme kohore, kur atdheu kishte nevojë për t'i dalë zot, kur populli kishte nevojë për të kontribuuar për lirinë e tij, familja ime kishte qenë e rreshtuar dhe e përgatitur për t'i rezistuar armikut shekullor.

Nuk e dija që ishin burgosur e maltretuar skajshmërisht nga pushtuesi gjakatar serb aq shumë familjarë të mi, duke nisur nga nëna ime Drita në vitin 1974, xhaxhai im Nebihu më 1980, xhaxhai im Basriu më 1989, i izoluar dhe i akuzuar si organizator në Fabrikën e Veglave Ferizaj, më 1998 prindi im që kishte përjetuar meltretime çnjerëzore deri në prag të vdekjes. Pikërisht ky angazhim atdhetar i familjareve të mi kishte nxitur pushtetin që gjatë vitit 1985 të bllokojë si në geto tërë familjen time duke u marrë të gjithëve pasaportat, në mbështetje të atij nenit famëkeq të Jug-vë që ishte i njohur për të gjithë. Nuk e dija që xhaxha Hyzriut që nga viti 1983 i kishin ndaluar ardhjen në vendlindja dhe për pasojë kishte humbur komunikimin me familjarët.

Për të gjitha këto unë kam filluar për herë të parë të di kur i kam mbushur 6 vjet dhe në festën e ditëlindjes sime i dëgjova të më

thonë së pari: “Ti je Djali i luftës”. Ende nuk e kuptoja mirë pse më quanin kështu dhe pse mua ma festonin ditëlindjen e gjithë familja e gjerë. Krahas familjes sime, iniciatori kryesor për të gjitha të mirat që më bëheshin ishte xhaxhai im Hyzriu, i cili gjithmonë ishte i gatshëm e i kujdesshëm që për atë ditë të bënte diçka të veçantë për mua. Shumë shpesh e dëgjoja në raste të ndryshme të thoshte: “Mos ma harroni Djalin e Luftës”. Kur i mbusha 12-13 vjet fillova të mendoj e ta pyes babanë tim dhe xhaxha Hyzriun se si ishte puna me mua.

Gradualisht i kuptova të gjitha ato që i thash më lart, e kuptova që dita e lindjes sime ishte një histori në vete, ishte një akt i dramës përplot vuajtje e sakrifica të familjes dhe popullit tim liridashës.

Fakti tjetër që fillova të kuptoj dhe që më bëri të ndihesha krenar ishte shkollimi i gjeneratës sonë jashtë vendit, që nuk pati fatin të shkollohej në atdheun e vet. Edhe pas gjithë atyre përpjekjeve të pushtuesit gjakatar për të na e ndërprerë shkollimin, shumë nga gjeneratat tona në mërgatë iu sulën fakulteteve dhe dolën kuadro të profileve të ndryshme, si në Gjermani, Angli e Belgjikë.

Duke qenë i vetëdijshëm për vuajtjet që ka përjetuar familja ime, duke i njohur të gjitha ato ngjarje të rënda e trishtuese nëpër të cilat kanë kaluar familjarët e mi, kisha shtytje për të rrëfyer e qe besa edhe të ju ndihmoj sa të mundem autorëve.

Xhaxha Hyzriun e kujtoj gjithmonë si një njeri të veçantë, mënyra se si fliste me një qetësi të jashtëzakonshme, urtësia dhe

afërsia e tij kanë lënë gjurmë të përjetshme tek unë dhe tek të gjithë ata që e njohën.

Edhe kur u kthye në Kosovë, ishte e pa mundur që të mos më thërriste për të më uruar ditëlindjen dhe gjithmonë më thoshte: "Urime ditëlindja Djali i Luftës", sepse rrallëherë më thërriste në emër. Unë kam qenë i përkëdhelur nga ai dhe gjithë familja.

Rrallë më ka rastisur të dëgjoj për njerëz si xhaxha Hyzriu që kishte punuar tërë jetën për lirinë e Kosovës, që nga rinia e tij sa ishte në atdhe, pastaj sa qëndroi në mërgatë, por edhe kur vendosi të kthehej në vendlindje. Kur autorët më lejuan t'i shoh disa rrëfime për veprimtarinë e tij, menjëherë shfaqa dëshirën të rrëfej edhe unë, nëse më lejohej për njeriun aq të çmuar e me vlera kombëtare, të flas për personalitetin e xhaxha Hyzriut ashtu si e ruaj në kujtesën time. Gjithashtu, shfaqa gatishmërinë që t'u ndihmoj deri në finalizimin e këtij projekti.

Vdekja e parakohshme e xhaxhait tim më ka tronditur shumë dhe më ka krijuar një zbrazësi që do ta ndjej gjithmonë. Xhaxha Hyzriu për mua do të mbetet një figurë e veçantë si njeri, si familjar, por mbi të gjitha si personalitet kombëtar, që tërë jetën me pietet iu përkushtua kauzës kombëtare.

I falënderoj autorët që më dhanë mundësinë të evokoj kujtime për xhaxhain tim të dashur.

Krenarë që të patëm!

Do të kujtojmë deri në përjetësi!!!

I yti dhe i juaji "Djali i Luftës". Djali i LU'ARD. SH. REKAJ

I lindur në Luftë, në mes jetës dhe vdekjes 21.02.199

ALBANIEN - KOSOVA

15
1998

8:30 PM
2.MAR.1998

8:35 PM
2.MAR.1998

8:32 PM
2.MAR.1998

1998

8:51 PM
2.MAR.1998

Kapitulli IV

Më 13 shtator 2017 me pjesëmarrjen e familjarëve, shokëve, bashkëveprimtarëve u bë vorrimi i atdhetarit Hyzri Rekaj. Ishte një moment shumë i rënd dhe pikëllues për të gjithë pjesë-marrësit, të ndahesh nga një personalitet që mbi të gjitha ishte shumë njerëzor, ishte vërtetë e vështirë.

Ndarja nga Hyzri Rekaj

Për të folur para të pranishmëve për jetën dhe veprën e Hyzri Rekës, në emër të familjes, fjalën e rastit e mbajti Nuhi Syla.

Të nderuar dhe shumë të respektuar të pranishëm!
Sot është ditë pikëllimi!
Sot po i themi lamtumirë babait, bashkëshortit, vëllait e mbi të gjitha atdhetarit largpamës, Hyzriut tonë të dashur!
Hyzriu lindi më 7 mars 1952 në fshatin Neredime e Epërme.
Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen drejtimin e mjekësisë në Prishtinë (1969 - 1973).
Dëshira e madhe e tij ishte të vazhdonte studimet për stomatologji por për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe mungesës së fakultetit të stomatologjisë ëndrra e tij për të vazhduar me karrierë akademike u bë e pamundur.
Në vitin 1977-1978, sapo mbaroi shkollën e mesme, për shkak të pamundësisë për t'u punësuar mori rrugën e gurbetit duke u vendosur në Gjermani. Atje u punësua në qytetin e Noisit në profesionin e tij si teknik i dhēmbëve, ku punoi deri në vitin 2005.
Edukatën e tij patriotike dhe atdhetare që kishte marrë në vendlindje nga babai dhe rrethi, pati mundësi të vazhdoj edhe në Gjermani ku ra në kontakt me bashkëmendimtar të shumtë.
Aktivitetin e parë konkret Hyzriu me bashkëpunëtorë e zhvilloj gjatë vitit 1980 kur sjelli pamfletat e para në Kosovë me qëllim vetëdijësimin e masave popullore për gjendjen e rëndë të bashkëkombasëve nën regjimin jugosllav.

Pikë grumbullimi rreth aktivitetit kombëtar ishte Klubi i punëtorëve shqiptar "Emin Duraku", ku analizohej gjendja e rëndë në atdhe dhe sikur shifej se ajo ishte drejt përkeqësimit të mëtejmë në të gjitha sferat e jetës dhe kjo ishte arsyeja që ky klub u shndërrua në një qerdhe të veprimtarisë atdhetare duke u konfrontuar haptas me Konsullatën Jugosllave.

Në vitin 1981 kur shpërthyen demostratat e mëdha të rinisë studentore në Dysseldorfin e patriotëve u shpalos pankarta "Kosova Republikë"' si shenjë mbështetje dhe përkrahje e fuqishme kësaj kërkese legjitime të studentëve dhe popullit shqiptar në Kosovë. Në këtë periudhë një punë të madhe organizative në diasporë në demaskimin e regjimit jugosllav bënin vëllezërit Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, me të cilët Hyzriu me kohë kishte vendosur kontakte.

Ishte klubi i Dysseldorfit, ku Hyzriu disa mandate ishte kryetar, i cili shpalosi idenë e krijimit të një platforme të përbashkët veprimi për të gjitha klubet shqiptare, së pari në Gjermani, e pastaj edhe ato tē shteteve tjera ku zhvilloheshin aktivitetet kombētare.

Me iniciativën e Hyzriut duke e parë nevojën e aktivieteve të ndryshme edhe kulturore, sportive dhe informative, klubi emërohet Qendra Kulturoro - Informative Shqiptare „Emin Duraku“.

Përveç aftësive organizative ai kishte edhe një talent në letërshkrime artistike dhe si rezultat i punës së tij shkroi broshurën "Pasqyra e mërgimtarit" dhe dramën "Dora e pajtimit“ (1986).

Aktivietet e njëpasnjëshme, bënë që Hyzriut t'i ndalohet ardhja në vendlindje dhe të cilësohet me terminologjinë e njohur të

kohës: si njeri nacionalist, irridentist, separatist, shkatërrues i shtetit etj. Përkundër kësaj, Hyzriu me shokë nuk e ndali aktivitetin, përkundrazi, vazhduan edhe në shtetet tjera: Zvicer, Belgjikë, Francë, Suedi, Austri dhe Holandë.

Gjithmonë në rrjedha të ngjarjeve dhe frymën e përhapjes së idesë për liri, Hyzriu gjatë viteve të famshme 1989/1990 ishte aktiv në sensibilizimin dhe përkrahjen e rezistences paqësore tè Kosovës.

Në fund të viteve të 90-ta represaljet e pushteti serbë bënë të padurueshme dhe për të ndryshuar kjo gjendje tani më rezistenca e popullit të marrë kahjen e luftës së mirëfilltë të armatosur me ç'rast Hyzriu me gjithë forcë doli në përkrahje duke arsyetuar bindshëm këtë nevojë të re tek opinioni gjerman dhe mërgimtarët. UÇK-ja për Hyzriun u bë shpresa vendimtare për çlirimin e vendit nga akupimi serb. Këtë dashuri ndaj UÇK-së me një vizion largëpamës, Hyzriu e përhapi edhe te opinioni gjerman dhe në mërgatën shqiptare duke krijuar unitet në misionin për lirinë e atdheut duke përkrahur dhe ndihmuar luftën përmes vijes institucionale.

Pas 19 viteve, në 2005 Hyzriu u kthye në vendlindje, dhe me plot vullnet, entusiazëm dhe punë të palodhshme vijoi jetën në gjirin familjare, në vendlindjen dhe atdheun e tij tani më të çliruar. Ishte i madh aktiviteti i tij për zhvillimin dhe lulëzimin e vendlindjes në çdo segment të jetës.

Karakteristikë e Hyzriut në jetën e tij, si në familje ashtu edhe në shoqëri, ishte uniteti, toleranca, mirëkuptimi, eleganca dhe dashuria në mes njerëzve. Përqarjet i urrente gjithëherë, ishte përherë i afërt dhe i dashur me njerëzit që e rrethonin.

Sëmundja tinzare na e mori. Neve na la të pikëlluar për jetë, por edhe fshati dhe rrethina do e ndijnë mungesën e tij.
Ndarja e parakohshme e tij edhe festat do t'na i bënë pikëlluese, kjo ditë na e ka ngulitur thikën në zemrat tona.
Thonë se koha shëron plagët, por sytë tanë do të mbushen me lot sa më tepër ta kuptojmë se ai nuk është më fizikisht në mesin tonë, sepse tani në këto momente nga dhimbja e madhe edhe lotët nuk po dalin sepse dhimbja ka kapluar shpirtat tanë.
Ke qenë krenaria e familjes sonë, mbetesh përjetë në zemrat tona.
Tani është momenti trishtues i ndarjes së përherëshme, pusho i qetë në tokën e Kosovës që tërë jetën ia kushtove, tani shpirti yt prej engjëlli do të pushon në paqën e përherëshme kurse në zemrat tona do të mbetesh për jetë e mot.
Të nderuar të pranishëm, me këtë rast ju falënderojmë nga zemra për prezencën tuaj në këtë rast pikëllimi dhe ndarje të dhimbëshme.
Lavdi jetës dhe veprës së Hyzriut, i qoftë i lehtë dheu i Kosovës!
Ju faleminderit!

Me fjalë rasti u paraqit edhe Rifat Hamiti, mësues i shkollës shqipe në Dysseldorf.

I dashuri shok, mik e bashkëveprimtar Hyzri Rekaj,

Edhepse jemi të vetëdijshëm se vdekja është ligj absolut i natyrës, ikja jote e parakohëshme nga kjo jetë, pos që ka shkaktuar dhembje të madhe tek bashkëshortja jote Jaklina, vajza jote Iliriana, tek vëllezërit tuaj e gjithë farefisi yt, pikëllim

të madh shkaktoi edhe tek unë, shokët e bashkëveprimtarët tuaj të QKISH „Emin Duraku“ dhe gjithë mërgimtarëve të Dysseldorfit, madje edhe të Gjermanisë e më gjërë.

S'kanë se si mos të ndiejnë dhëmbje e pikëllim të gjithë ata që të njohën nga afër e nga larg, për afër një çerek shekulli përmes aktivitetit atdhetar e patriotik, fillimisht si anëtar i LPRK, pastaj si themelues dhe udhëheqës i klubit të shqiptarëve nga Jugosllavia „Emin Duraku“ e pastaj duke u ngjitur deri në majën e LDK, për Gjermani, Lëvizjes gjithëpopullore, si e quaje ti.

Për një çerek shekulli, sa veprove në mërgim për kauzën kombëtare-çlirim të shqiptarëve të pushtuar dhe bashkimin e trojeve kombëtare, veprimtarinë tënde e karakterizoi guximi, vendosmëria, gadishmëria për bashkëpunim me të gjithë që punonin për të mirën e Atdheut. Ti ishe një analist i shkëlqyer i rrethanave e interesave kombëtare në raport me faktorin ndërkombëtar dhe interesat gjeostrategjike të fuqive të mëdha.

Derisa të gjitha këto veti e cilësi të çmueshme të personalitetit tënd, i dashuri shokë Hyzri, për ne bashkëveprimtarët tuaj ishin ndihmë e madhe për veprim, ato për armikun tonë shekullor serb, për përfaqësitë konsullare dhe UDB Jugosllave u bënë halë në sy, u bënë pengesë e madhe për të vazhduar me hegjemonizmin e tyre dhe mohimin e identitetit shqiptar në Dysseldorf e më gjërë, për çka t'u mohua e drejta ty dhe disa shokëve tuaj të klubit për 20 vite ta vizitoni Kosovën.

Vërtet ti nuk munde për 20 vite ta vizitosh Kosovën, por kurrë nuk pushove së punuari për të gjatë gjithë kohës, pra edhe në kohën e luftës çlirimtare të UÇK-ës. Se e deshe fortë Atdheun, se punove shumë për çlirimin e tij, tregoi edhe vendimi yt shumë i

guximshëm e i rrallë që të kthehesh në Kosovë menjëherë pas çlirimit, për të dhënë kontributin në Atdhe. U ktheve, hape laborin stomatologjik, u ndihmove atyre që patën nevojë për ty dhe familjen, krijove mirë-qenjen tënde e të familjes me punë, me djersën tënde.
Hyzri, miku, shoku e bashkëveprimtari ynë, ti sot po shkon nga kjo jetë, prapa po e lë shoqën, vajzën, vëllezërit e farefisin e shokët me dhëmbje të madhe, por këtë pikëllim do t'ua lehtësoj krenaria që të patën ty bashkëshort, baba, vëlla. Pas ikjes sate në amshim në kujtim të përhershëm do të mbetet vepra jote që bëre në të mirë të Atdheut. Krenar do të ndihemi edhe ne shokët e bashkëpunëtorët tauj dhe gjithë bashkatdhetarët e Dysseldorfit e më gjërë.
Lamtumirë shok i dashur!
I lehtë të qoftë dheu i Kosovës që aq shumë e deshe dhe punove për të!
Kujtimi për ty do të jetë i përjetshëm.
Nerodime, 13.09.2017

Për të nderuar jetën dhe veprën patriotike të Hyzriut Qendra Kulturore në bashkëpunim me familjen e tij mbajtën edhe një Mbledhje Përkujtimore në Dysseldorf, e ku morën pjesë, pos familjes edhe një numër i madh i shokëve, miqve e bashkë-veprimtarëve nga e gjithë Gjermania.
Kujtimi për Hyzriun do të mbetet i përjetshëm te unë Rifat Hamiti.

Në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e dhënë në shërbim të atdheut, konsulli i përgjithshëm i Konsullatës së Kosovës, Arjan Kashtanjeva i ndan një mirënjohje Hyzri Rekës postmortum.

Akademi përkujtimore

Mbrëmja përkujtimore e mbajtur më 26.11.2017, në Dyseldorf, kushtuar atdhetarit Hyzri Rekaj

Për ta nderuar e evokuar kujtimet për veprën madhështore të atdhetarit, Hyzri Rekaj, shokët Sylë Nuha, Haxhi Bega, Nazmi Nuha, Rifat Hamiti, Sabri Shehu, e shokë të tjerë s'bashku me familjen organizuan këtë mbrëmje përkujtimore.

Në sallën e mbushur me shokë e familjar në një ambient shumë pikëllues, ku secili secilit i jepte ngushllime, në fytyrat e tyre vërehej dhimbja e madhe, por edhe krenaria që kishin pas fatin të ishin bashkëveprimtar me Hyzriun.

Kishte shokë që kishin udhëtuar nga larg (qindra kilometra), që ta ndajnë dhimbjen së bashku. Prezent ishin edhe kolegët e punës ku punojë për shumë vite. Në emër të kolegëve tubimin përkujtimor e përshëndeti, kolegu i tij z.Olaf.

Së pari u dëgjua Himni kombëtar.

Mbrëmjen e shpalli të hapur mësuesi i shkollës shqipe në Dysseldorf Rifat Hamiti. Pasi falenderojë të pranishmit për pjesëmarrje, i ftojë për një minut heshtje.

Ku në mes të tjerash, foli dhe dha një kronologji duke e përshkruar Hyzriun si një figurë të dalluar atdhetare, dhe unifikuese.

Për të folur për jetën dhe veprën e Hyzri Rekës, në emër të "Qendrës Kulturo informative Shqiptare" "Emin Duraku" dhe gjithë shokëve të Hyzriut fjalën e mbajti Sabri Shehu.

Sabri Shehu

(fjala e plotë në youtube: Fjala e rastit në akademin përkujtimore për Hyzri Rekën)

(https://youtube.com/watch?v=btRBkkAAf2k&feature=share) .

Fjalimi me rastin e akademisë përkujtimore për jetën dhe veprën e Hyzri Rekaj
Dysseldorf, 26.11.2017

E nderuar dhe e respektuar familje Rekaj, e nderuar z. Zhaklin bashkëshortja e Hyzriut, e nderuar Zonja Iliriana vajza e Hyzriut të nderuar vëllezër të Hyzriut, këtu dhe në atdhe, të nderuar bashkëpunëtorë, shokë, miq, bashkatdhetarë, të nderuar të pranishëm. Dysseldorfi kjo fole e njohur për komunitetin shqiptar në diasporë, kjo qendër e gravitetit atdhetar, na ka takuar në vazhdimësi dhe sa herë që atdheu ka lëshuar kushtrim, nëpër kohë e etapa të ndryshme, për përkrahje dhe ndihmë të çfarëdo lloji, jemi takuar, për manifestimin e datave dhe ngjarjeve të rëndësishme të historisë së lavdishme të kombit tonë. Por sot, sot jemi mbledhur në këtë akademi për një ndarje, një dhimbje, për të ndarë një pikëllim, jemi mbledhur për të

ngushëlluar njeri tjetrin, por në të njejtën kohë, për të shpalosur figurën e një njeriu të madh, që i dha shpirt e zemër organizimit atdhetar në këtë vend. Jemi tubuar, për të përkujtuar dhe nderuar njeriun, që rrezatonte unitet, devotshmëri, atdhedashuri, sakrificë, sinqeritet, super elegancë dhe virtyte njerëzore e kombëtare, njeriun që quhej Hyzri Rekaj.

Të flasësh për biografinë e Hyzriut, na duhen ditë të tëra, por do mundohem shkurtimisht të përmbledh me pak fjalë, e për t'ju mundësuar edhe pjesëmarrësve tjerë, që të kontribojnë me përkujtimet e tyre.

Hyzri Rekaj u lind në fshatin Nerodime të Ferizajt, më 7 mars të vitit 1952. Si koincidencë kjo datë përputhet me një datë të madhe historike për kombin tonë, që quhet Dita e mësuesit, që me plot gojë mund të themi se përkon plotësisht me veprimtarin e Hyzriut. Sepse, Ai ishte vërtetë mësues i atdhedashurisë për gjeneratat e ardhshme që gravituan nëpër kohën e veprimtarisë së Tij.

Ishte fëmija i 6 nga 9 fëmijët e Shukrije e Bajram Rekajt. Ai u rrit dhe u edukua me atdhedashuri nga Familja e tij. Shkollën fillore e kreu në vendlindje kurse atë të mesmen në Prishtinë, në drejtimin e mjekësisë, me theks, teknik dental i stomatologjisë, gjatë viteve 1969-1973, profesion të cilin e ushtroi gjatë gjithë jetës.

Pas mbarimit të shkollës së mesme, meqenëse punësimi në Kosovë, nëpër qendra të mjekësisë familjare apo nëpër spitale, bëhej në mënyrë selektive, ose duhej të ishe i përkatësisë serbo-malazeze, ose në një mënyrë duhej të ishe i përgdhelur i pushtetit të asaj kohe. Hyzriu nuk i takonte asnjërës kategori, andaj detyrohet të mirret me punë ndër më të rëndat, për të

ndihmuar familjen e tij. Para tij të njejtin fat për punësim e kishte pas edhe vëllai i madh Nebiu, i cili ishte dashtë të migrojë dhe kishte ardhur në Dysseldorf. Ai në bisedë e sipër me bashkëvendasit e tij, rrëfen për mbarimin e shkollës së Hyzriut dhe pamundësinë e tij për punësim, Qamil Rexhepi poashtu mërgimtar i të njejtit fshat të lindjes së Hyzriut, arrin që t'ia gjej një vend pune si teknik dental në një laborator në Dysseldorf. Nuk vonoi shumë dhe Hyzriu në qershor të vitit 1977 erdhi dhe u vendos në Dysseldorf, ku vazhdoi punën në profesionin e tij.

Ishin vitet e 70-ta, kur populli jonë në Kosovë po merrte frymë pak më lirshëm, prandaj edhe aktiviteti kombëtar po organizohej në masë më të madhe. Hyzriu me ardhjen e Tij këtu, u kyq në Organizatat vepruese kombëtare duke dhënë kontributin e Tij dhe duke fuqizuar veprimtarinë e mërgimtarëve, arrijnë që të krijojnë një fole të veçantë për shqiptarët, themelojnë klubin e punëtorëve shqiptar nga ish Jugosllavia.

Duke mos patur mundësi që aktivitetin kombëtar ta zhvillojnë lirshëm, Hyzriu me bashkëpunëtorë, shkëpusin klubin nga Konzullata Jugosllave dhe veprojnë si komunitet, të organizuar në klubin e vetëm shqiptar në Gjermani dhe Europë që barte emrin e heroit kombëtar Emin Duraku. Hyzriu nuk ishte vetëm një aktivist i thjeshtë, por ai ishte bashkëpunëtorë i afërt edhe i vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, këtë e argumenton edhe pjesëmarrja e Hyzriut në dasmën e Kadri Zekës dhe Saime Jusufit.

Veprimi dhe angazhimi i Tij me shokë dhe bashkëpunëtorë në çështjen kombëtare ishte vendosë nën vëzhgim të organeve famëkeqe, udbeske. Përveç aktivitetit të tij në klub, Hyzriu u

aktivizua me shokë edhe në organizimet ilegale të kohës, duke kontribuar maksimalisht në propagandë dhe agjitacion, për të senzibilizuar bashkatdhetarët dhe për të fuqizuar organizimin kombëtar. Veprimtaria prej një militanti dhe atdhetari të mirëfillt, bën që Hyzriut dhe bashkëpunëtorëve t'iu pa-mundësohet kthimi në atdhe; por malli për atdheun i kishte shndërruar në punë dhe angazhim maksimal. Aktiviteti atdhetar tani u shtri në shumë shtete përreth dhe Hyzriu u bë një emër i njohur për veptimtarët e asaj kohe. Nuk kishte organizim të asnjë demostrate ku nuk ishte në ballë të saj Hyzriu. Iniciativa për hapjen e shkollës me mësim plotësues në gjuhën shqipe, përkrahet fuqishëm nga Hyrziu dhe angazhimi i Tij do të jetë i gjithanshem deri sa në vitin 1985 realizohet hapja e saj. Shkolla bëhet një vatër për juniorët vetëm ashtu mund t'ia prenim rrugën të gjithë agjenturave të huaja. Eksodi i viteve të 90-ta, e gjen Hyzriun në përpjekje për përhapjen e pluralizmin politik sepse ai kishite krijuar tani edhe një bindje, se edhe ne shqiptarët duhet të ecim në hap me kohën, nga bashkatdhetareët ishte zgjedhë, anëtar i kryesisë së degës së LDK-së në Gjermani. Kur masat represive serbe morën hov të madh në Kosovë, eksodi po rritej në vazhdimësi. Ardhjen e shumë të rinjëve nga Kosova edhe në Dysseldorf, përgjat viteve 90-ta, e më tej, Hyzriu i pret ngrohtësisht, i ofroi, i ndihmoi, i udhëzoi e këshilloi, i përkrahu dhe dëgjoi, duke i bashkuar të gjithë grupmoshat për të avancuar sa më tepër organizimin në shërbim të atdheut. Në vitin 1993, me qenëse Hyzriu ishte me banim në qytetin e Neusit, dhe duke e parë se shumë bashkatdhetarë ishin vendosur në këtë qytet, Ai mori iniciativë që të themelojë edhe aty shkollën me mësim plotësues në gjuhën shqipe.

Kur Kosova filloi të bëhet sa më e njohur në arenën ndërkombetare, Hyzriu me kryesinë e klubit të atëhershëm mori qëndrim që të kalohet në një stad tjetër organizimi, jo më vetëm si klub, por si Qendër Kulturore Informative Shqiptare, qendër kjo, që pati rol kryesor në të gjitha zhvillimet e më vonshme. Aktivitetet e qendrës kulturore informative shqiptare do jenë të shumëanshme, krijohet klubi i futbollit FC Kosova, dhe më vonë edhe trupa artistike. Të gjitha këto organizime do e kenë përkrahjen e Hyzriut dhe bashkëveprimtarëve të tij pa hezitim. Dalja në skenë e UÇK-së, u prit me gëzim dhe shpresë, e cila u mbështet plotësisht që nga ditët e para. Në konferencën e Rambujesë nga Qendra jonë morën pjesë bashkatdhetarët tanë me 7 autobus në demostratën e organizuar për të mbeshtetur delegacionin tonë moralisht dhe në çdo segment në rast nevoje. Qendra jonë u bë objekt i shumë takimeve të rëndësishme, të oficerëve dhe ushtarakëve tanë që "këshilloheshin dhe merrnin vendime të rëndësishme në shërbim të luftës çlirimtare“. Nën udhëheqjen e Hyzriut me shokë, u organizua demostratë gjithëpopullore, shumë e fuqishime, para Landestagut të NRW-së, për të senzibilizuar opinionin gjerman, për masakrën e ushtrisë serbe në Prekazin legjendar, ndaj Familjes Jashari dhe rënies heroike të tyre: Televizioni gjerman atëbotë mori pjesë në demostratë duke pasqyruar ngjarjen, drejtë dhe me besnikëri.

Nën udhëheqjen e Hyzriut, qendra jonë u bë objekt i grumbullimit të mjeteve materiale dhe teknike si dhe efektivit njerëzor duke u bë shembull për shumë qytete tjera. Në përkrahje të Hyzriut shumë veprimtarë tanë morën pjesë aktive në përgaditjen dhe përcjelljen e ushtarëve vullnetare, e disa nga ata edhe personalisht morën pjesë në UÇK, ka të tillë që kanë

rënë edhe dëshmor, por ka edhe shumë të plagosur. Dëshira dhe ëndërra e Tij edhe pse jo e plotë, u realizua kur qetnikët u detyruan të lëshojnë Kosovën. Natyrisht që Hyzriu shprehte vazhdimisht dhembje për vëllezërit tanë që nuk ishin çliruar plotësisht, por çdo herë thoshte se forcimi dhe zhvillimi i shteteve tona, do të mundësoj që edhe ata një ditë të gëzojnë lirinë sikur ne.

Çlirimi i Kosovës hapi një dilemë për Hyzriun, çka më tej, të rri këtu dhe të mohoj vetvehten, apo të kthehem në vendin për të cilin punova e veprova tërë jetën. Natyrisht që vendosi të kthehej duke u bë shembull shumë i rrallë nga gjithë diaspora shqiptare.

Në vitin 2002 ndërtoi shtëpinë, në vitin 2005 hapi një laborator dental në vendlindjen e tij "Nerodent" dhe u kthye përfundimisht në atdhe. Atje iu përvesh punës duke punuar me orë të tëra, duke kontribuar në vetëdijësimin e bashkëpunëtorëve në sektorin e shëndetësisë dhe duke vënë zbatimin e përvojës së tij.

Atje punësoi edhe punëtorë dhe krijoi një emër shumë pozitiv tek klientët e tij për kualitetin dhe sjelljen shembullore që kishte. Të gjithë këtë elan që e kishte, ia ndërpreu një sëmundje e rëndë, që është bërë një armik i madh për njerëzimin. U operua në Prishtinë në vitin 2016, por edhe pse operacioni pati sukses për një kohë, gjendja e tij u përkeqësua pas disa muajve. Ai iu nënshtrua disa terapive, por fatkeqësisht pa sukses. Në një takim që kishim me disa shokë, në bisedë e sipër na thot: më mbetet merak që shiptarëve në Dysseldorf, nuk munda t'ua lë një qendër të veten kulturore. Shpresoj dhe uroj e ky amanet i Hyzriut të realizohet.

Data 11 shtator që na përkujton viktimat e Kullave Binjake të Njujorkut, u bë një ditë zie, për familjarët, shokët, miqët si dhe bashkatedhetarët. Në këtë datë u nda fizikisht nga ne, njeriu që shkroi historinë e shqiptarëve në Dysseldorf.
Vdekja e Tij ishte një humbje e madhe për të gjithë ne, por këtë humbje duhet ta shndërrojmë në punë dhe forcë, në angazhim, për të ndihmuar njëri tjetrin dhe tërë Shqipërinë.
Tani trupi i tij prehet i qetë në vendlindjen e tij të dashur, për të cilën nuk kurseu asgjë. Pjesëmarrja në varrimin e Tij ishte shumë e madhe nga vendasit, miqtë, shokët dhe bashkë-veprimtarët. Mbi varrin e tij në mesin e disa kurorave u vendosën edhe 2 kurora nga bashkëveprimtarët e Qendrës Kuturore Informative Shqiptare "Emin Duraku" nga Dysseldorfi.
Hyzriu për Dysseldorfin është figura më emblematike, si referencë për brezat që vijnë, se si punohet për atdheun.
Prapa ka lënë shkrime letare, dramën Dora e Pajtimit, broshurat Pasqyra e mërgimtarit dhe Teknika e dhëmbëve për brezat.
I qoftë i lehtë dheu i Shqipërisë
Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekaj.

Në vazhdim në emër të familjes Rekaj fjalën përshëndetëse mbajti, vëllai Hyzriut, Shabi Rekaj, ku në mes tjerash vlerësojë shumë organizimin që shokët kishin përgaditë këtë mbrëmje akademike. Në vazhdim i njoftojë, të pranishmit se familja kishte përgaditë një përmbledhje të fotove nga lindja, të cilat shoqëroheshin gjatë kësaj mbrëmje në sfond.
Fjala e plotë e Shabi Rekës :

Shabi Rekaj

Të nderuar e shumë të respektuar të pranishëm.

Në emër të familjes Rekaj dhe në emrin tim personal, më lejoni të ju falënderoj për këtë Akademi përkujtimore që ia kushtuat bashkëveprimtarit e bashkatdhetarit të juaj të çështjes kombëtare Hyzri Rekajt.

Të nderuar të parnishëm.

Edhe ne familja e gjerë dhe farefisi kemi kujtime të pashlyera e vepra të mirëfillta për punën dhe krijimtarinë e tij për kauzën Kombëtare.

Sot është dita e juaj që të shprehni e të shfletoni kujtimet që keni pas dhe keni për bashkëveprimtarin e juaj Hyzriun.

E gjithë kjo veprimtari e Hyzriut në dekada ishte sukses në bashkëpunim me punën e juaj të përbashkët.

Të nderuar bashkatdhetarë.

Për ta nderuar veprimtarinë e Hyzriut ju zgjodhët muajin nëntor festën e Flamurit e Pavarësinë e Shqipërisë për të mbajt këtë Akademi përkujtimore.

Neve kjo ditë na bën më krenar e më të fuqishëm për pasionin e tij të kauzës kombëtare.

Të nderuar bashkëveprimtar.

Ju njoftojmë se për hirë të veprimtarisë të Hyzriut i cili la gjurmë të pashlyera në mesin ku jetoj dhe veproj, ne familja kemi planifikuar që të përmbledhim një Autobiografi bashkë me ndihmën e juaj për të sensibilizuar veprën e tij madhështore.

Ju mirëpresim për bashkëpunim.

Ju faleminderit për punën dhe kontributin e juaj që dhatë për këtë Akademi përkujtimore.
Me respekt familja Rekaj.
Në fund paraqiti para të pranishmëve, iniciativën e kërkuar nga familja, dhe shokëve të tij, që në të ardhmën e afërt të bëhet një Monografi për të.
(Referati).
Pastaj u lexua letra Halil Gashit bashkëveprimtarit, dërguar enkas mbrëmjes.

Në vazhdim po ju shkruaj linqet e videove që janë për:
1. Akademinë përkujtimore për Hyzriun;
https://youtu.be/tonhxr71Ipo
2. Pllaka përkujtimore Nerodime e Epërme;
https://youtu.be/bNj5PXqFpZY
3. Promovimi i librit Fanaratë e Dysseldorfit;
https://youtu.be/SZCfH6FmgE8
4. Protestë kushtuar Grupit Kumanova;
https://youtu.be/AiGnMbIQkBc

Halil Gashi

Fjala e rastit në tubimin përkujtimor për Hyzri Rekaj të mbajtur në Dysseldorf të Gjermanise më 26.11.2017

Të nderuar dhe të respektuar të gjithë ju pjesëmarrës të këtij tubimi Përkujtimor.

E nderuara familje Rekaj

E nderuara zonja Zhaklinë, më lejoni që në këto çaste pikëlluese të ju shprehi edhe një herë ngushllimet e mia më të thella për vdekjen e Hyzriut, ju humbët bashkëshortin e juaj, njeriun që e përcjellë në rrugëtimin e tij jetësor me të gjitha sfidat, i qëndrove pranë deri në shkuarjen e tij në amshim. Ishe dhe do të mbetesh krenare që kishe një bashkëshort të tillë.

Ilirjanë ti humbe babain për të cilin ishe thesari më i çmuar, ishe gurë xhevahiri në jetën e tij, bëhuni të forta bashkë me nënën dhe të jeni krenare që e patët një njeri siç ishte Hyzriu.

Të nderuar vëllezër të Hyzriut, të nderuar Ju bashkëveprimtar të Hyzriut, më lejoni që t'iu shprehë edhe Juve me këtë rast ngushllimet më të thella për vëllain e juaj të çmuar, me të cilin jeni krenar që e patët një vëlla të tillë, i cili la gjurmë të thella në rrugëtimin e tij atdhetar. Ndërsa, ju të nderuar bashkëkohanik dhe bashkëveprimtar të Hyzriut të cilët rrugëtuat me dekada së bashku, në këto çaste të dhembjes që më Hyzriu nuk është në mesin tuaj, ju shpreh ngushëllimet e mija. Hyzriun e njoha një ditë të diele të shtatorit të vitit 1995 në ambientet e klubit në Volk Klinger Strase, atëbotë ishte kryetar i këtij klubi ku më priti vëllazërisht, shihej se ishte i regjur në mërgim dhe kishte

një sens të veçantë për të ofruar bashkëvendasit e tij. Hyzriu e kishte kuptuar drejtë misionin e tij se vetëm të bashkuar shqiptarët mund të rrugëtojnë drejtë aspiratave të tyre shekullore. Më vonë mësova se Hyzriu bashkë me shumë bashkëveprimtar të këtij klubi kishin qenë bashkëkohanik dhe bashkëveprimtar të Jusuf & Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës, te cilët tërë jetën e tyre ia kishin kushtuar kauzës kombëtare.

Të nderuar ju të pranishëm në këtë tubim përkujtimor më lejoni edhe pak minuta që të them edhe pak fjalë për shokun dhe mikun e juaj dhe timin që iku kaq herët në amshim.

Gjatë asaj periudhe sa qëndrova në mërgim nga Hyzriu mësova se klubi shqiptar "Emin Duraku" nuk ishte vetëm klub i thjeshtë, kishte një histori dhe një traditë, kishte një krenari aty të shqiptarisë të krijuar me dekada, dhe se ishte avansuar në qendër kulturore dhe informative shqiptare. Aty takova veteranët e kauzës kombëtare, bashkëkohanikët dhe bashkëveprimtarët e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës, të Enver Hadrit dhe shumë atdhetarëve të tjerë të shquar, ani pse këta veteran të lartë përmendur që unë aty pata nderin ti njoh vetëm nga modestia e tyre ngelnin të palartësuar se liderët e përmendur të tyre. Pra, ata ishin Nebi Reka, Nazmi Nuha, Hyzri Rekaj, Sylë Nuha, baca-Zymer Kryeziu, Hamdi Gashi, Avdi Begisholli-baca tjetër, Mërtez Nuha, Malush Ademaj, Sadri Gashi, Basri Rekaj, Haxhi Bega, mësuesi Rifat Hamiti, Sabri Shehu, Arif Haliti, më pas edhe Shabi Rekaj ... e shumë të tjerë. Aty kishin vepruar edhe Ibrahim dhe Muhamet Kelmendi, Mustafè Kelmendi, Mustafë Mekaj, bajraktari i të gjitha demonstratave dhe shumë veprimtarë dhe të përndjekur të tjerë nga regjimi i atëhershëm

Jugosllav. Ishin vitet më të vështira, por edhe të lumtura, që i kalova në këtë mjedis.

Isha, jam dhe mbetem krenar që mu dha rasti që për këto vite isha pjesë përbërëse dhe frymova me tërë qenjën time në këtë rrugëtim ku Hyzriu printe me shembëlltyrën e tij të atdhetarit. Jam i bindur që të gjithë e donin dhe kishin një respekt të madh për kontributin e tij, kishte një sens të liderit të krijuar me dashurinë dhe respektin ndaj secilit që anagazhohej në rrafshin kombëtar, por njëherit ishte i pakompromis ndaj atyre që çalonin në këtë rrafsh.

Hyzriu ishte i vlerësuar lartë nga bashkëkombasit tanë, por edhe Ai kishte një respekt të veçantë për secilin nga ta, këtë e kuptova më fortë kur Hyzriu u kthye në Kosovè në vitin 2005 në Nerodimën e dashur të tij, e cila aq shumë i kishte munguar.

Isha bashkë me Hyzriun edhe në Kosovë pas kthimit të tij atje deri në çastet e fundit të jetës se tij kur Ai iku në amshim. Patëm gjithë kohën që së bashku të shijojmë lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, por edhe të rikapitulojmë tërë atë veprimtari kombëtare në klubin shqiptar “Emin Duraku”, ishte shumë i lumtur që idealet e tij dhe të bashkëveprimtarëve të tij u bënë realitet me çlirimin dhe Pavarësinë e Kosovës.

Të flasësh për Hyzriun, për personalitetin e tij prej njeriut, atdhetarit dhe veprimtarit të shquar të kauzës kombëtare nuk mund të bëhet për disa minuta e as për disa orë, por për këtë lypset shumë kohë, ngase është një jetë e tërë e një atdhetari.

Duke respektuar kohën tuaj të çmuar, krejt për fund dua të them që konsideroj se isha me fat që njoha edhe shumë bashkë-veprimtar të këtij klubi për afro gjashtë vite sa isha me ta dhe isha bashkudhëtar i tyre në këtë klub në të gjitha ato sfida kur

Kosova përpëlitej në gjakun e bijve dhe bijave më të mira të kombit.
Jam thellë i bindur se Hyzriu prehet në paqe në Nerodimën e tij të dashur, në dheun e Kosovës, anipse më duket e padrejtë që iku para kohe në moshën kur duhej të shijonte edhe më gjatë frytet e lirisë dhe pavarësisë së shtetit të Kosovës.
E konsideroj si privilegj që pata një shok siç ishte Hyzriu. E kujtoj shumë shpesh një thënje të tij, kur thoshte se në mërgim, jeta i nxjerr në pah vetëm karakteret e forta, e i tillë ishte vetë Hyzriu.
Edhe një herë ngushllime për të gjithë Ju që jeni tubuar aty për të nderuar jetën dhe veprën e Hyzri Rekaj. Ju falënderoj shumë që më dhatë mundësinë që të them këto fjalë për shokun dhe mikun tonë të përbashkët.
Halil Gashi, Pejë, nëntor.

Në vazhdim të mbrëmjes morën fjalën bashkatdhetarët e familjarët:
Pjetër Coli foli për veprimtarin dhe kontributin e tij në fondin e Qeverisë së Kosovës, duke shpalosë gjithë veprimtarin e tij që lidhet në këtë fond.
Ibrahim Kelmendi kishte përgadit një shkrim që u lexua dhe përmes tij evokojë kontributin atdhetar të Hyzriut.

Ibrahim Kelmendi

HYSRI REKAJ – Fryma Jote po e mbijeton vdekjen Tënde! (më 11 shtator 2017)!

Për këtë dëshmon edhe Akademia përjujtimore që po e mbajnë për Ty shokët dhe bashkëveprimtarët shumë-vjeçarë, këtë të diel (më 26 nëntor 2017) në Dysseldorf, ku e kalove pjesën më të madhe të rrojtjes Tënde fisnike - duke ushtruar veprimtari të ngjeshur kombëtare! Unë kam arsye tepër subjektive për të rikujtuar Ty, Shok e bashkëveprimtar, duke ua rrëfyer tani të tjerëve. Po përcaktohem t'i drejtohem Frymës që ke lënë pas. U njohëm në Dysseldorf në qershor të vitit 1978. Dhe qysh atëherë dëshira dhe përcaktimi për të bërë veprimtari kombëtare na shoqëruan gjatë gjitha viteve në vazhdim, deri sa Kosova u çlirua nga pushtimi serb. Atëbotë, në Dysseldorf, në mesin e bashkatdhetarëve, imigrantë ekonomikë, ishe me i arsimuari – kishe shkollim të mesëm për teknikë të dhëmbëve. Por pasioni patriotik për t'iu përkushtuar veprimtarisë kombëtare të kishin motivuar paraardhësit e tu, mirëpo fati deshi që ti të vazhdosh në mëgrim këtë rrugë të trasuar nga aktivitetet e familjes tënde. Qysh në maj 1978 Ti dhe disa bashkatdhetarë patriotë patët sfiduar komplotin që po impononte Konsullata Jugosllave, kryesisht përmes nëpunësit të saj Zenel Syka. Ai kishte angazhuar disa argatë. Ndër ta u shqua Enver Maliqi (tani milioner dhe nënkrytar i Shkupit). Ai, në koordinim me Zenel

Sykën, duhet të ketë organizuar një sulm kriminal – plagosjen me thikë të kryetarit të parë të Klubit në formim në Dysseldorf, Bashkëveprimtarit Rrahman Bega. Pasi u njohëm, sofistikuam taktikën se si ta sfidonim komplotin e konsullatës, duke organizuar një bërthamë të shokëve. Ajo taktikë doli e fituar, edhe pse rrethi i bashkëveprimtarëve vuajti sakrifica të mëdha gjatë viteve në vazhdim, duke filluar me burgosje të Kryetarit të dytë të Klubit Shqiptar, Vëllait Tënd, Nebihut, dhe shokëve tjerë që ishin në kryesi të Klubit gjatë viteve të para, si Samedin Iljazi, Qazim Shala dhe të tjerë. Nuk po zgjatëm se kujtuari të asaj bashkëveprimtarije, meqë do t'i kapërcente përmasat e një fjale që i shkon një akademije përkujtimore. Do përzgjedh disa kujtime që m'u kanë arkivuar ekstra në kujtesë. Qysh në vitin 1978 ma mundësove fillimin e njohjes me bashkatdhetarët në Bruksel, meqë atje e kishe Vëllain e dytë, Basriun. Në banesë të tij patëm krijuar bazën fillestare të koordinimit të veprimtarisë kombëtare. Ajo bashkëveprimtari atje ishte voluminoze dhe e frytshme gjatë viteve në vazhdim. Në verë të viti 1979 nuk hezitove të më ndihmoje për një udhëtim gjysmë-ilegal në Kosovë, i cili qe shoqëruar edhe me rrezikim ekstra, për shkak të ca angazhimeve kombëtare atje. Në verë të vitit 1980 tregove gatishmëri që shtëpia Juaj në Nerodime (Ferizaj) të bëhej bazë e një aksioni goxha të rrezikshëm. Një Mik gjerman dhe Shoqja e tij greke shfaqën gatishmëri që të merrnin me vete matrial (ky material është përgatitur në Gjermani-Dysseldorf). Për atë veprim ata devijuan tranzitin, që të kalonin nga shtëpia e Familjes Tuaj. Aty ata dorëzua 1000 ekzemplarë të fletushkës "Bashkimi", të cilin ne atëherë e quanim Organ i Frontit të Kuq Popullor. Për shpërndarje të tij në Kosovë u angazhuan

Vëllezërit Tu dha ca bashkëvprimtarë tjerë. Në qershor 1981 kishim vendos të bënim demonstratën e radhës në Bruksel (e para e atij lloji aty). Disa komplotistë të asaj kohe kishin bindur Jusufin (Gërvallën) se demonstrata në Bruksel do të shkaktonte gjakderdhje të madhe në mes të shqiptarëve. Për të krijuar atë panik ishin angazhuar sidomos Vebi Ibrahim, Musa Hoti dhe disa të tjerë në Bruksel, për të cilët atëherë dyshonim se ishin argatë të shërbimeve të Beogradit. Për të anuluar vendimin për mbajtje të demonstratës, me kërkesë të Jusufit mbajtëm një konsultë në Vlebert, në banesë të z. Besim Rexhaj. Morën pjesë edhe Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla. Ajo konsultë mori vendim që demonstrata në Bruksel të anulohej, përkundër përpjekjes Tënde dhe timen që t'i bindnim Jusufin e Kadriun, se ato kërcënime do t'i sfidonim pa pasoja. U ngarkuam Ti dhe unë të shkonim në Bruksel, që t'i bindim bashkëveprimtarët për anulim të demonstratës, edhe pse thirrjen publike e kishim shpërnda disa ditë përpara. Shkuam, por nuk i bindem dot. Njoftuam Jusufin e Kadriun. Qysh të hënën vendosen të vinin Kadriu e Bardhoshi si përforcim, që t'i bindim bashkë-veprimtarët në Bruksel të anulonim demonstratën. Jusufi nuk mundi të vinte, meqë ende nuk i ishte njohur azili dhe nuk kishte dokument për dalje jashtë Gjermanisë. Kryebazën e strehimit në Bruksel e patëm te Vëllai Yt, Basriu, edhe pse kishin banesë të vogël. Aty u mblodhën bashkëprimtarët e përkushtuar, të cilët kishin marrë inciativën për organizim të demonstratës. Kur u bindën edhe Kadriu e Bardhoshi, se demonstrata duhet të mbahet, iu shtruam punës për përgatitje organizative, duke qëndruar në banesë të Familjes së Basriut gjatë gjithë javës. Fatkeqësisht, në njërën nga ditët pasuese, u hetua në vepër Vebi

Ibrahimi duke kurdisur eksploziv në auto të Bardhoshit, të parkuar në afërsi të banesës së Basriut. Por iku pa mund ta zinim që t'ia ndreqnim samarin... Demostrata qe mrekullisht e suksesshme, pa asnjë incident. Por, atë sukses e vuajtën konkretisht Basriu dhe Bashkëshortja e tij, Shyhretja, bashkë me fëmijë, meqë kur shkuan për pushim në Kosovë, policia atje i persektutoi dhe ua pamundësoi të ktheheshin në Bruksel. Megjithatë, asnjëherë nuk u ankuan dhe nuk u bënë pishman për atë angazhim aq të vyer. Gjatë verës se vitit 1981 mrekullove edhe Jusufin e Kadriun me zgjuarsi gjatë diskutimit që po u bënim Tezave për Republikë të Kosovës, të cilat i kishte hartuar OMLK-ja si platformë për bashkim. Në gusht 1981 ajo platformë që miratuar, por realizimi i saj simbolik u komplotua nga Sabri Novosella në tetor 1981. Kjo e shtyri bashkimin deri më 17 Janar 1982, kur në banesë të Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla u mor vendimi për Bashkim në Lëvizjen për Republikën e Kosovës. Natën kur ndodhi vrasja e kobshme e 17 janarit 1982 ishim bashkë me qindra bashkëveprimtarë në Klub, meqë organizuam shfaqjen e tv-dramës "Gërsheta lufte". Të nesërmen e hershme na erdhi lajmi i kobshëm për atentate ndaj bashkëveprimtarëve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Në fillim të viteve të 90-ta, edhe pse Ti u angazhove edhe në LDK, asnjëherë nuk ndodhi asnjë keqkuptim mes nesh, respektivisht as mes Lëvizjes dhe LDK-së në Dysseldorf e rrethina. Përkundrazi, Ti tashmë ishe edhe promotor i bashkë-veprimtarisë edhe nga ai pozicionim i ri organizativ. Dhe prandaj Klubi Shqiptar në Dysseldorf u shqua në gjithë emigracionin e viteve 1979-1999 si një epiqendër frymëzuese e orientuese. Sa për ilustrim, guxoj të pohoj se gjatë aksionit

gjithëpërfshirës për të ndihmuar financiarisht arsimin në Kosovë në vitin 1996, më shumë pat grumbulluar ndihma Klubi në Dysseldorf, se sa gjithë emigracioni në Amerikë. Gjithashtu guxoj të supozoj që edhe UÇK-në financiarisht, materialisht dhe me bashkëluftetarë duhet ta ketë ndihmuar më shumë imigracioni në Dyseldorf me rrethina, që bashkëkoordinoheshin nga Ti e veprimtarët shumë të përkushtuar të Klubit, - se sa gjithë emigracioni në Amerikë. Por, këtë emigracion përherë e ka karakterizuar modestia fisnike, duke u vetëlavdëruar më se paku, edhe pse duhet të kontribuar më se shumti. Të tjera veprimtari shpresoj t'i rrefejmë e publikojmë në një monografi, të cilën moti po e planifikojmë, dedikuar Klubit Shqiptar në Dysseldorf, i cili e mbante emrin e Heroit antifashist Emin Duraku. Nuk do të na falet mospërgatitje e një monografije për Klubin, për të cilin kontribuat shumë Ju Vëllezërit Rekaj, bashkë me qindra bashkëveprimtarë që jetonin e vepronin në Dysseldorf me rrethina.

- I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty, Shok e bashkëveprimtar shumë i respektuar!

Nazmi Nuha (1947) foli gjërë e gjatë për aktivitetin e Hyzriut dhe veprimtarin e tij që nga fillimi

Nazmi Nuha (1947)

Të dashur vëllezër,

Në fillim më lejoni t'u shpreh ngushëllimet më të thella për ndarjen e parakohëshme nga jeta të atdhetarit Hyzri Rekaj.

Jeta dhe vepra e Hyzriut është e mbushur me vetëm një qëllim, angazhim dhe kontribut në shërbim të atdheut!

Ne kur u vendosëm në Dysseldorf pas disa viteve konkretisht më vitin 1978 arritëm të themelonim klubin atdhetar me emrin e patriotit "Emin Duraku", në themelim ishte Rrahman Bega, Nebih Reka, Ramadan Ramadani, e shumë shokë të tjerë. Ne ishim punëtor krahu prandaj ardhja e Hyzriut në Dysseldorf ishte një sukses për avancimin e punës së klubit tonë.

Hyzri Rekaj dhe Ibrahim Kelmendi kanë qenë shtyllat kryesore të organizimit tonë.

Hyzriu ka merita në çdo lëvizje atdhetare që është bërë!

Në çdo periudhë Hyzriu ka ditur të ruaj orientimin atdhetar!

Hyzriu me shokë (edhe unë Nazmi Nuha) ka merita të mëdha edhe në hapjen e klubeve të reja ne Gjermani duke pasur si shembull klubin e Dysseldorfit.

Në kohën e luftës së UÇK-së luajti një rol të madh unifikues në shërbim të organizimit të logjistikës në shërbim të atdheut.

Të flasësh për Hyzriun duhen libra të tërë por besoj se nuk do ta teproj nëse them se vepra e Hyzriut është kontribut që i ngjanë rilindasëve të kombit shqiptar!
Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekës

Pastaj fjalën e mori Qamil Rexhepi (1950), ku shpalosi kujtimet e tij për Hyzriun si një atdhetar i veçant i çështjes kombëtare

Qamil Rexhepi (1950)

Fjala e mbajtur në akademin përkujtimore për nder të veprës së Hyzri Rekajt (26.11.2017 në Dysseldorf)

Të dashur bashkatdhetar,

Me hidhërim të madh morëm lajmin për ndarjen e para-kohëshme nga jeta të atdhetarit Hyzri Rekaj.

Ai si i ri erdhi në Dysseldorf dhe me ndihmën time u punësua si teknik medicional në Neuss.

Porsa erdhi në mërgim u angazhua maksimalisht në organizimet atdhetare, ai me angazhimin e vet tregoj se dashuria ndaj atdheut ka rrënjët thellë në shpirtin e tij. Nuk ka organizim që në foltore të mos ishte oratori shembullor Hyzri Rekaj, në demostratën e organizuar në muajin mars 1981, nga Hyzriu me shokë, në përkrahje të demostratave në Kosovë, për herë të parë u shpalos parulla shumë e madhe "Kosova Republikë", më pas e njejta do të vendoset në lokalin e klubit "Emin Duraku" në Dysseldorf !

Hyzriu mendjendritur ishte një fanar që ndriçonte rrugën drejt çlirimit të atdheut, ai me veprën e vet do të jetoj përherë në zemrat tona, ai do të mbetet si figurë më shembullore për brezat duke treguar se si ndihmohet dhe kontribohet për atdhe!

Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekës!

Sadri Gashi mori fjalën, dhe ju drejtua me fjalën Kryetar do të mbahesh mend për shumë vite, si udhëheqës i dalluar i çështjes kombëtare.
Ai lexojë poezin kushtuar Hyzriut.

Sadri Gashi për Hyzri Rekajn

Lamtumirë shok!
Sa e sa herë së bashku mbajtëm
Akademi përkujtimore
Duke përkujtuar vëllezërit Gërvalla
Kadriun e Zija Shemsiun
Dhe shumë e shumë dëshmorë tjerë
Asnjëherë, as që kam paramenduar
Se do të vijë koha
Te jem në Akademinë tuaj përkujtuese
O mik, o shok, o vëllai ynë
O kryetar i klubit tonë
O Hyzri, Hyzri Rekaj
Lamtumirë mik, shok
Vëlla Hyzri
Lamtumirë, lamtumirë...!
Sa e mallkueshme, qenka ky mort!
Morti i vëllait, shokut e mikut tonë
Si mallkim fatkob erdhi
Dhe mori pa na pyet fare:
Si do pajtojmë e përballojmë ?
Mungesën e tuaj
Ti ike, ike
vëlla n'amshim
Duke përmbushur fjalën tënde:
"Me lirinë e Kosovës
Do kontribuoj atje
N'vendlindje

Në Nerodime
N'atdheun tim

Lamtumir Hyzri, lamtumirë!
Atje n'botën e amshueshme
Po t'presin:
Cimeri yt
baca Jakup,
Shoferi i Autobusit tonë n'demostrata
26.11.2017

Arif Haliti pasi përshëndeti pjesëmarrësit dhe ngushllojë për ndarjen nga jeta të Hyzriut, foli për ardhjen e tij në Dysseldorf dhe njohjen e tij me atdhetarin Hyzriun, si dhe bashkëveprimin, në planin e interesit kombëtar. Foli edhe për personalitetin njerëzor të Hyzriut, që mendon se është shembull për brezat që vijnë.
Lavdi jetës dhe veprës së Hyzri Rekës.
Përparim Reka (nipi i Hyzriut).
Ai foli në emër të babait të tij, (Nebihut), i cili për shkaqe shëndetësore nuk kishte mundësi të marrë pjesë. Falenderojë pjesëmarrësit për këtë organizim madhështor për xhaxhain e tij. Për karakterin e Hyzriut si familjar tha se ishte kënaqësi dhe nder që i takonte familjes sonë sepse vlerat e tij atdhetare e njerëzore janë të nivelit të mrekullueshme.
Në fund fjalën e mori Iliriana vajza e Hyzriut, pasi falenderojë dhe përshëndet të pranishmit, në këtë akademi duke ju shprehur njëkohësisht edhe atyre ngushllimet e sinqerta për humbjen e shokut të tyre, u ndal në përshkrimin, u ndal në karakterin e tij si

prind, për këshillat e udhëzimet e tij të përhershme, për plotësimin e gjitha nevojave për të ecur përpara drejtë diturive të reja. Pasi babi ishte teknik i dhëmbëve edhe unë si vajza e tij do të shkojë gjurmëve të tij.

Mbrëmja akademike përfundojë, ku të gjithë shpalosën kujtimet për atdhetarin Hyzri Rekaj, duke qenë të bindur se jeta e tij si referencë, ishte shembulli më i pastër që duhet ndjekur brezat që vijnë.

Pason libri i zisë me disa faqe të të shkruara e të nënshkruara nga ngushëlluesit.



E nderuara Zhaklina

Kemi qenë shumë të tronditur kur murrëm lajmin se ka ndëruar jetë Hyzriu.
Dhe në këtë kohë të kesh forcë ta përballosh gjithë mërzinë.

Pra dhe njëherë Ngushllime

Jürgen dhe Marlies Hirzinger

Libri
i
kujtimeve
për
Hyzriun







"Ai që nuk jep një pikë gjak, dhe një qindarkë, për mëmëdhe, ai nuk e meriton të varroset në atdhe"

Sami Frashëri

Përmbajtja

Hyrja 3

Kapitulli I

1. Hyzri Bajram Rekaj ……..… 11

Kapitulli II

1. Samedin Ilazi …….. 33
2. Xhemail (Hasan) Nuha ……...… 44
3. Sofije Dumnica ……...… 49
4. Xhafer Shatri ……..... 51
5. Malush Ademaj ……... 57
6. Shabi Nuhaj …… 59
7. Mufail Demiri ……..… 65
8. Mursel Nuha ……...…. 69
9. Nuhi Bytyqi …… 76
10. Nezir Nuha ……. 80
11. Ryshë Blenishti …….. 84
12. Haxhi Bega ……... 87
13. Gani Nuha ……..… 93
14. Sherif Gashi ……... 95
15. Gani Nebih Kashtanjeva …… 98
16. Ismet Rashiti …… 102
17. Dëfrim Ramadani ……..... 106
18. Hasan Hoti ……... 108
19. Gzim Nikqi …….. 109
20. Bujar Neziri ……. 110
21. Arif Haliti …… 112

22. Mehmet Breznica …… 116
23. Tafil Januzi …….. 125
24. Sejdi Sopi ……..… 127
25. Sadri Bega ……..... 129
26. Vesel Ismaili ……..... 134
27. Sadri Gashi ……..….. 138
28. Rifat Hamiti …… 143
29. Hafiz Gagica …… 149
30. Sabri Shehu …….. 154
31. Jacquelina Rekaj Baetsen ……...…. 160
32. Hamdi Gashi …… 170
33. Enver Hoxha – Klein ……..…… 172
34. Mustafë Rugova ……... 179
35. Faridin Tafallari ……... 181
36. Sylejman Jakupi ……...…… 189
37. Hysen Gega 191
38. Iliriana H. Rekaj ……... 193

Kapitulli III

1. Dr. Asllan Bajrami ……...…. 199
2. Muharrem Kashtanjeva …… 202
3. Blerim Ramadani …….. 204
4. Fehmi Reka ……...… 207
5. Shefqet Reka ……. 210
6. Hasan Reka ……...… 212
7. Basri Kashtanjeva ……. 214
8. Djali i Luftës ……. 216

Kapitulli IV

1. Ndarja nga Hyzri Rekaj 227
2. Akademi përkujtimore 234
3. Sabri Shehu 236
4. Shabi Rekaj 243
5. Halil Gashi 245
6. Ibrahim Kelmendi 249
7. Nazmi Nuha 254
8. Qamil Rexhepi 256
9. Sadri Gashi për Hyzri Rekajn 258

Biografia e autorëve

Prof. Shabi B. Rekaj

Lindi më 14.04.1958 në fshatin Nerodime e Epërme, Komuna Ferizaj.
Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, kurse gjimnazin në Ferizaj, studimet i vazhdoj në Fakultetin filozofik në Prishtinë dega histori, ku diplomoj në vitet 80-ta dhe mori titullin, Profesor i historisë.
Në korrik 1980 bashkë me rrethin e ngushtë familjar, morën një aksion ilegal mjaftë të rrezikshëm të asaj kohe ku shpërdan pamflete, prej Kaçanikut deri në Prishtinë, të sjellura dhe të organizuara nga Hyzriu me shokë nga Gjermania.
Krahas studimeve, punoj afër katër vite mësimdhënës në shkollën e fshatit deri më 1982.
Në këtë vit diferencohet nga procesi edukativo-arsimor nga komiteti Komunal Ferizaj me vendimin; ”I papërshtatshëm për punë dhe veprimtari arsimore”.
Shërbimin ushtarak e kreu në Rijekë.
Ishte pjesëmarrës në demostratat e vitit 1981.
Nga 1987 u detyrua të punojë si kondukter pranë Kosovatransit në Ferizaj deri më 1992. Në vitin 1990 punojë intezivishtë në Këshillin e pajtimit të gjaqeve për katër fshatra, ku mbajti fjalën e rastit në Manastirc.
Ishte pjesmarrës në demostrata e protesta në përkrahje të Minatorve edhe në Prishtinë.

Më 1992, u bë largimi masiv i shqiptarëve nga puna dhe të njejtin fat pati edhe ai.
Nga viti 1992 dha një kontribut të mirëfillt si kryetar i LDK-së në fshatin e lindjes deri në vitin 1996.
Në vitin 1997 punësohet në Shkollën fillore "Gjon Sereqi" në Ferizaj, profesor i historisë pas 15 viteve i diferencuar, aty merr edhe vendimin e punës.
Korrik 1998, i armatosur me armë përsonale inkuadrohet në radhët e Nënzonës së UÇK-së në Nerodime të Epërme.
Pas një kohe të shkurt bie në pritë nga paramilitarët e policia sërbo-sllave, duke i bartë fshatarët dhe nënën Shukrije në drejtim të fshatit Dremjak.
Në burg qëndroj disa ditë, i maltretuar egërsisht, ku për-doret shufra gome, shufra hekuri por edhe elektroshokun dhe e sollën në prag të vdekjes.
Shoku Asllan Bajrami (stomatolog) rrezikoj jetën e vet, për ta tërhequr dhe shpëtuar nga vdekja.
Në gusht 1998 e bënë operacionin në kokë, nga Xheladin Reçica, dhe me ndihmën e nipit Mufailit ia del të kalon në Tetovë për ta ndihmuar Samedin Ilazi.
Prej aty depërtoj në Shqipëri, ku Hyzriu e kishte transferuar në Gjermani, (të ndihmuar me pasaportë të Malush Ademajt).
Aty fillojë rehabilitimin dhe trajtimin mjekësor.
Më 8 qershor 1999 bashkëshortja arrinë me kontigjentin gjerman me fëmijë nga Çegrani.
Diploma i'u pranua nga ministria Gjermane e arsimit, por nuk u përfill nga KASH-i e më vonë LASH-i, që të punoj në mësimin plotësues.

Në viti 2003, kryen kursin për kontrollor, dhe ngasës i autobusit dhe punoj deri më 2007.
Për shkak të problemeve shëndetësore u largua nga puna për të vazhduar trajtimin mjekësor.
Është Recenzent i dy librave historike,"Simbolet Pellazgo-Ilire Shqiptare" dhe "Planeti i Trojës është gjallë" (autor Gani Rekaj).
Ndihmojë e kontribuojë në librin "Fanarët e Dysseldorfit në Gjermani"(autor Halil Gashi).
Në vitin 2019 koordinon bashkë me Këshillin e fshatit punët për ngritjen e pllakës përkujtimore të 10 Martirëve e Dëshmorve të cilët ranë për çështje kombëtare në kohëra të ndryshme që nga viti 1912.
Gjatë jetës për shkak të veprimtarisë atdhetare katër herë e humbi punën në profesionin si mësimdhënës.
Për shkak të torturave gjatë luftës posedon gjurmë të thella trupore dhe shkallën e invaliditetit, por nuk merr benifite as nga Gjermania e as nga Kosova.
Shabiu jeton në Kaarst të Gjermanisë me bashkëshorten Dritën fëmijët, Gazmendin, Sarandën, Florentin e Luardin.

Sabri Shehu

I lindur më 27 qershor 1968 në fshatin Izhanc, komuna e Ferizajt.
Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, vitin e parë dhe të dytë në fshatin Firajë kurse drejtimin bashkëpunëtorë teknik i matematikës e kreu në Ferizaj me sukses shembullor.
Fëmijërin e kaloj në një ambient atdhetar, në odën ku flitej vetëm për trimëri dhe përpjekje për liri. Familja kishte një të kaluar liridashëse prandaj bisedat që zhvilloheshin në odën e burrave ndikuan në formimin e tij me frymë atdhetare. Në moshë të re ra në kontakt me literaturën ilegale dhe grupet e organizuara patriotike të cilat ndikuan thellë në ndërdijen e tij dhe ndezën flakën e atdhedashurisë e cila me kohë rritej edhe më shumë.
Një ndikim të madh në formimin e tij atdhetar pati veçmas radio Tirana e në veçanti "Emisioni për shqiptarët jashtë atdheut" që me zërin kumbues të gazetarëve të kohës do të përgaditej si kuadër që jetën do ta vendos në shërbim të atdheut!
Pas shkollimit të mesëm kreu shërbimin e detyruar ushtarak në Ohër dhe Kërqovë.
Në vitin 1988/89 fillon studimet në fakultetin Elektroteknik (Elektronikë) në Universitetin e Prishtinës. Ishte pjesëmarrës i të gjitha ngjarjeve dhe demostratave të kohës, që u ndezën me minatorët që ishin futur në grevë urie.

Kishte raporte vëllazërore me heroin Feriz Guri dhe me shumë shokë të ilegalës !
Për shkak të rrethanave të krijuara në vend në vitin 1992 lëshon Kosovën dhe vendoset në Dyseldorf të Gjermanisë.
Atje aktivizohet në Qendrën Kulturore Informative Shqiptare "Emin Duraku" duke dhënë një kontribut modest në shërbim të atdheut.
Për shkak të aftësisë organizative dhe zërit radiofonik ka drejtuar manifestime të ndryshme patriotike si dhe demostratën më të madhe që u mbajt më 2 mars 1998 në Dyseldorf (shiko youtube: https://youtube.com/watch?v=tkIj9YHqhK0&feature=share dhe që ndikoj në mobilizimin ushtarëve dhe ndihmës logjistike për UÇK-në. Kontribuoj edhe për luftën e UÇK-së në Iliridë dhe të UÇPMB-së, pas paraqitjes së FBKSH bëhet pjesë e strukturave organizative. Qëllimi dhe angazhimi i tij është në realizimin e kauzës shekullore shqiptare, bashkimin në një shtet të vetëm shqiptar!
Jeton me gruan Fatmiren dhe fëmijët Liridonin, Drilonën dhe Vlorën në Neuss të Gjermanisë me shpresën se një ditë do të kthehet në atdhe për të jetuar.

Shabi Rekaj & Sabri Shehu

Monografi

Hyzri Rekaj

Shtypshkronja
StarGraf – Ferizaj
200 copë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

929(496.51-22) Rekaj, Hyzri

Rekaj, Shabi
Monografi : Hyzri Rekaj / Shabi Rekaj, Sabri Shehu . -
Ferizaj : StarGraf, 2023. - 272 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Shehu, Sabri

ISBN 978-9951-682-46-6